TRANSPARENCY INTERNATIONAL MACEDONIA

TRANSPARENCY INTERNATIONAL
the coalition against corruption

SISTEMI KOMBËTAR PËR INTEGRITET - VLERËSIMI PËR MAQEDONINË

Kingdom of the Netherlands

KY PROJEKT ËSHTË FINANCUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN DHE NGA AMBASADA E MBRETËRISË SË HOLANDËS.

TRANSPARENCY INTERNATIONAL MACEDONIA

TRANSPARENCY INTERNATIONAL
the coalition against corruption



SISTEMI KOMBËTAR PËR INTEGRITET - VLERËSIMI PËR MAQEDONINË

MAJ 2016

Sistemi Kombëtar për Integritet i Maqedonisë është përgatitur nga Transparency International– Maqedoni, në bashkëpunim me Sekretariatin e Transparency International në Berlin.

Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian dhe Mbretëria e Holandës në Republikën e Maqedonisë.

Ky publikim është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian dhe Mbretërisë së Holandës në Republikën e Maqedonisë. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Transparency International - Maqedoni dhe në asnjë rast nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Bashkimit Evropian dhe Ambasadës së Holandës në Republikën e Maqedonisë.

Autorë:

Hulumtues kryesor:	**dr. Slagjana Taseva**
Drejtues i projektit:	**Metodi Zajkov**
Kryeredaktore:	**dr. Slagjana Taseva**
Bashkëpunëtore në hulumtim:	**mr. Dona Dimov Markovska**
	mr. Juliana Karai
Kontrolli i jashtëm:	**Aleksandar Krzhalovski**
Shtypi:	**Datapons Skopje**
Tirazhi:	**300**

Janë bërë përpjekje maksimale për verifikim të saktësisë së të dhënave të përmbajtura në këtë raport. Besohet se të gjitha të dhënat deri në dhjetor të vitit 2015 janë të sakta. Për çdo rast, Transparency International nuk mban përgjegjësi për pasojat e përdorimit të Raportit për qëllime dhe kontekste tjera.

ISBN 978-608-65772-6-1

PËRMBAJTJA

I. PËR VLERËSIMIN E SISTEMIT KOMBËTAR PËR INTEGRITET 15

II. PËR MBLEDHJE EKZEKUTIVE 25

III. PROFILI I VENDIT 33

IV. PROFILI I KORRUPSIONIT 41

V. AKTIVITETET KUNDËR KORRUPSIONIT 47

VI. SISTEMI KOMBËTAR PËR INTEGRITET 53

1. LIGJVËNIA 53
2. PUSHTETI EKZEKUTIV 67
3. GJYQËSORI 81
4. SEKTORI PUBLIK 97
5. AGJENCITË PËR ZBATIM TË LIGJEVE 111
6. PROKURORIA PUBLIKE 121
7. KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE 133
8. ENTI SHTETËROR PËR REVIZION 145
9. AVOKATI I POPULLIT 161
10. KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIM TË KORRUPSIONIT 175
11. PARTITË POLITIKE 189
12. MEDIET 207
13. SHOQËRIA CIVILE 223
14. SEKTORI AFARIST 231
15. NDËRMARRJET PUBLIKE 247

VII. REKOMANDIME 259

VIII. BIBLIOGRAFIA 267

SHKURTESA

- **(ASHMAA)**
  AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
- **(AA)**
  AGJENCIA PËR ADMINISTRATË
- **(USAID)**
  AGJENCIA E SHBA-VE PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR
- **(PVB)**
  PRODHIMI VENDOR BRUTO
- **(BSP)**
  BYROJA PËR SIGURI PUBLIKE
- **(BFP)**
  BYROJA PËR FURNIZIME PUBLIKE
- **(KB)**
  KËSHILLI BUXHETOR
- **(VMRO-DPMNE)**
  ORGANIZATA E BRENDSHME REVOLUCIONARE MAQEDONASE – PARTIA DEMOKRATIKE PËR UNITETIN KOMBËTAR MAQEDONAS
- **(SP)**
  SEKRETARIATI I PËRGJITHSHËM
- **(SHC)**
  SHOQËRIA CIVILE
- **(GREKO)**
  GRUPI I SHTETEVE KUNDËR KORRUPSIONIT
- **(BDI)**
  BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM
- **(ESHR)**
  ENTI SHTETËROR PËR REVIZION
- **(KSHPK)**
  KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIM TË KORRUPSIONIT
- **(KSHZ)**
  KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
- **(SHPK)**
  SHOQATA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
- **(BE)**
  BASHKIMI EVROPIAN
- **(KE)**
  KOMISIONI EVROPIAN
- **(RUKERR)**
  REGJISTRI UNIK KOMBËTAR ELEKTRONIK I RREGULLOREVE
- **(SEFP)**
  SISTEMI ELEKTRONIK PËR FURNIZIME PUBLIKE
- **(LPK)**
  LIGJI PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
- **(LPKI)**
  LIGJI PËR PARANDALIM TË KONFLIKTEVE TË INTERESIT
- **(LNA)**
  LIGJI PËR NËPUNËS ADMINISTRATIVË
- **(LPSP)**
  LIGJI PËR TË PUNËSUARIT NË SEKTORIN PUBLIK
- **(LNSH)**
  LIGJI PËR NËPUNËS SHTETËRORË
- **(LP)**
  LIGJI PËR POLICI
- **(LQLIKP)**
  LIGJI PËR QASJE TË LIRË TE INFORMATAT ME KARAKTER PUBLIK
- **(LPP)**
  LIGJI PËR PROCEDURË PENALE
- **(LPP)**
  LIGJI PËR PROKURORI PUBLIKE
- **(SHGM)**
  SHOQATA E GAZETARËVE TË MAQEDONISË
- **(SHGJM)**
  SHOQATA E GJYKATËSVE TË MAQEDONISË
- **(IDSCSH)**
  INSTITUTI PËR DEMOKRACI "SOCIETAS CIVILIS" - SHKUP
- **(KZQSH)**
  KOMISIONI ZGJEDHOR I QYTETIT TË SHKUPIT
- **(IPA)**
  INSTRUMENTI PËR NDIHMË PARAADERUESE

- **(IPK)**
  INDEKSI I PERCEPTIMIT TË KORRUPSIONIT
- **(IKENTSHI)**
  INSTRUMENT I KOMISIONIT EVROPIAN PËR NDIHMË TEKNIKE DHE SHKËMBIM TË INFORMATAVE
- **(PP)**
  PROKURORIA PUBLIKE
- **(KQLIKP)**
  KOMISIONI PËR QASJE TË LIRË TE INFORMATAT ME KARAKTER PUBLIK
- **(KPT)**
  KOMISIONI PËR PARANDALIMIN TË TORTURËS
- **(PL)**
  PARTIA LIBERALE
- **(SHGM)**
  SHOQATA E GAZETARËVE TË MAQEDONISË
- **(TVM)**
  TELEVIZIONI I MAQEDONISË
- **(QMBN)**
  QENDRA PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR E MAQEDONASE
- **(SNILR)**
  STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR INSTITUCIONET E LARTA REVIZORE
- **(MPB)**
  MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
- **(MSHIA)**
  MINISTRIA PËR SHOQËRI INFORMATIKE DHE ADMINISTRATË
- **(MF)**
  MINISTRIA E FINANCAVE
- **(SNILR)**
  STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR INSTITUCIONET E LARTA REVIZORE
- **(FMN)**
  FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR
- **(MKP)**
  MEKANIZMI KOMBËTAR PARANDALUES
- **(NDI)**
  INSTITUTI KOMBËTAR DEMOKRATIK PËR ÇËSHTJE NDËRKOMBËTARE
- **(SKI)**
  SISTEMI KOMBËTAR PËR INTEGRITET
- **(BPRM)**
  BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
- **(OJQ)**
  ORGANIZATA JOQEVERITARE
- **(PRSM)**
  PARTIA E RE SOCIALDEMOKRATE E MAQEDONISË
- **(OSBE)**
  ORGANIZATA PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË
- **(KKZ)**
  KOMISIONET KOMUNALE TË ZGJEDHJEVE
- **(MPH)**
  MASA TË POSAÇME HETUESE
- **(NPSH)**
  NDËRMARRJE NË PRONËSI SHTETËRORE
- **(UNDP)**
  PROGRAMI PËR ZHVILLIM I KOMBEVE TË BASHKUARA
- **(VNRR)**
  VLERËSIMET PËR NDIKIMIN E RREGULLAVE
- **(SZMKO)**
  SEKRETARIATI PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES KORNIZË TË OHRIT
- **(SKBFP)**
  SISTEM I KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK
- **(GK)**
  GRUPI KËSHILLËDHËNËS
- **(LSDM)**
  LIDHJA SOCIALDEMOKRATE E MAQEDONISË
- **(KGJ)**
  KËSHILLI GJYQËSOR
- **(KGJB)**
  KËSHILLI GJYQËSOR BUXHETOR
- **(TI)**
  TRANSPARENCY INTERNATIONAL
- **(DSK)**
  DREJTORIA PËR SIGURI DHE KUNDËRZBULIM
- **(DHP)**
  DREJTORIA E TË HYRAVE PUBLIKE
- **(RQ)**
  REGJISTRI QENDROR

I. NË LIDHJE ME VLERËSIMIN E SISTEMIT KOMBËTAR PËR INTEGRITET

Qasja në vlerësimin e Sistemit Kombëtar për Integritet që përdoret në këtë Raport mundëson kornizë për analizë të mangësive të vendit të dhënë lidhur me korrupsionin dhe efektivintetin e përpjekjeve kombëtare për luftën kundër korrupsionit. Korniza i përfshin të gjitha institucionet dhe aktorët themelorë që e formojnë shtetin. Ato i përfshijnë të gjitha degët e pushtetit, sektorit publik dhe privat, mediet dhe shoqërinë civile ("shtyllat", si që është shfaqur në diagramin më poshtë). Konceptin e Sistemit Kombëtar për Integritet e zhvilloi Transparency International si pjesë e qasjes së vetë holistike ndaj luftës kundër korrupsionit. Edhe pse nuk ekziston model për sistem efektiv për parandalim të korrupsionit, ka konsensus ndërkombëtar gjithnjë e më të madh lidhur me karakteristikat kryesore institucionale të cilat funksionojnë më mirë për parandalimin e korrupsionit dhe për promovimin e integritetit.



Vlerësimi i Sistemit Kombëtar për Integritet është vegël e fuqishme për përfaqësim, që jep pasqyrë gjithëpërfshirëse për kontekstin institucional të vendit lidhur me integritetin, llogaridhënien dhe transparencën. Sistemi i fuqishëm dhe funksional kombëtar për integritet shërben si mur mbrojtës kundër korrupsionit dhe e garanton llogaridhënien, kurse sistemi i dobët zakonisht shkakton korrupsion sistematik dhe krijon sërë problemesh në udhëheqje. Si rezultat, vlerësimi jo vetëm që jep shqyrtim gjithëpërfshirës të nevojave të reformave, por gjithashtu mundëson rrënjësisht të kuptohet realizueshmëria e tyre politike. Përforcimi i Sistemit Kombëtar për Integritet promovon udhëheqje më të mirë në të gjitha aspektet e shoqërisë, e në fund edhe kontribuon për shoqëri më të drejtë.

PËRKUFIZIME

Transparency International e përdor përkufizimin në vijim për "korrupsion":

> **„Abuzimi i pushtetit të besuar për përfitime personale. Korrupsioni mund të kategorizohet si i madh, i vogël dhe politik, varësisht nga sasia e humbur dhe sektori ku ndodh".[1]**

"Korrupsioni i madh" përkufizohet si "veprime të cilat kryhen në nivel të lartë të pushtetit të cilat i shtrembërojnë politikat ose funksionimin e shtetit, duke u mundësuar udhëheqësve përfitim në dëm të të mirës publike".[2] "Korrupsioni i vogël" përkufizohet si "abuzim i përditshëm i pushtetit të besuar nga funksionarë të nivelit të ulët dhe të mesëm gjatë kontakteve të tyre me qytetarët e rëndomtë, të cilët shpesh mundohen të gjejnë qasje te mallrat ose shërbimet themelore në vende si'ç janë spitalet, shkollat, policia dhe agjencitë tjera".[3] "Korrupsioni politik" përkufizohet si "manipulim i politikave, institucioneve dhe rregullave procedurale gjatë shpërndarjes së mjeteve dhe financimit nga marrësit e vendimeve politike, të cilët abuzojnë pozitën e vet që të mbajnë fuqinë, statusin dhe pasurinë."[4]

QËLLIMET

Qëllimet kryesore të vlerësimit të Sistemit Kombëtar për Integritet janë që të mundësohet:

- Kuptim më i mirë i përparësive dhe dobësive të Sistemit Kombëtar për Integritet të Republikës së Maqedonisë në suaza të komunitetit kundër korrupsionit dhe jashtë tij dhe
- Të krijohet dinamikë te palët kryesore të prekura në Republikën e Maqedonisë për menaxhim të fushave me prioritet në Sistemin kombëtar për integritet.

Sipas kësaj, qëllimi kryesor i vlerësimit është të vlerësohet efektivitetit i institucioneve maqedonase në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe përparimin e transparencës dhe integritetit. Si shtesë, qëllimi i tij është promovimi i procesit të vlerësimit si pikënisje për aksion te pushteti dhe komuniteti kundër korrupsionit nga aspekti i reformave politike, përfaqësim në bazë të provave ose analiza të mëtejme rrënjësore të çështjeve konkrete lidhur me udhëheqjen. Ky vlerësim duhet të shërbejë si bazë për aktorët kryesorë në Maqedoni për përfaqësim të reformës të qëndrueshme dhe efektive.

METODOLOGJIA

Në metodologjinë e Transparency International, Sistemin Kombëtar për Integritet e përbëjnë 13 shtylla. Janë shtuar edhe dy shtylla të cilat janë të rëndësishme për sistemin për integritet në Maqedoni: Ndërmarrjet publike dhe Prokuroria Publike.

---

1 Transparency International, „The Anti-Corruption Plain Language Guide" (Udhëzues kundër korrupsionit në gjuhë të thjeshtë) (Berlin: Transparency International, 2009), f. 14. http://www.transparency.org/whatwedo/pub/the_anti_corruption_plain_language_guide [qasur më 21 dhjetor 2012].
2 Njëjtë, f. 23.
3 Njëjtë, f. 33.
4 Njëjtë, f. 35.

INSTITUCIONE KRYESORE TË PUSHTETIT	AGJENCI NGA SEKTORI PUBLIK	AKTORË JOQEVERITAR
Shtëpia ligjvënëse (Kuvendi i Republikës së Maqedonisë)	Sektori publik/ Institucione nga administrata publike	Partitë politike
Pushteti ekzekutiv/Qeveria	Agjenci për zbatim të ligjeve (Policia etj.)	Mediet
Gjyqësori	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve	Shoqëria civile
Prokuroria Publike	Avokati i Popullit	Subjektet afariste
	Enti Shtetëror për Revizion	Ndërmarrjet publike
	Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit	

Çdonjëra nga 15 shtyllat është vlerësuar nga aspekti i tre dimensioneve që janë kryesore për kapacitetin e saj për parandalim të korrupsionit:

- Kapaciteti i saj, nga aspekti i resurseve dhe pavarësisë;
- Korniza e saj ligjore dhe praktikat për udhëheqje të brendshme, me përqendrim në atë nëse institucionet në atë shtyllë janë transparente, llogaridhënëse dhe nëse veprojnë me integritet dhe
- Roli i saj në sistemin gjithëpërfshirës për integritet, me përqendrim në shkallën deri në të cilën institucionet në atë shtyllë i përmbushin rolet e veta të dhëna nga aspekti i parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit.

Çdo dimension matet me shumë të njëjtë të treguesve. Vlerësimi për çdo dimension e shqyrton edhe kornizën ligjore për çdo shtyllë, si dhe praktikat reale institucionale, me të cilat theksohen të gjitha mospërputhjet ndërmjet dispozitave formale dhe gjendjes reale.

DIMENSIONI	TREGUESIT (E DREJTA DHE PRAKTIKA)
Kapaciteti	Resurset Pavarësia
Udhëheqja	Transparenca Llogaridhënia Integriteti
Roli në suaza të sistemit të udhëheqjes	Tregues karakteristik për shtyllën e dhënë

Qëllimi i vlerësimit **nuk është** të ofrojë vlerësim më të hollësishëm të çdo shtylle. Në të vërtetë, **qëllimi i tij** është përfshirje më e gjerë, duke përfshirë të gjitha shtyllat relevante në numër më të madh të treguesve, me qëllim që të fitohet pasqyrë për sistemin e tërësishëm. Vlerësimi, gjithashtu, ka për qëllim të shqyrtojë raportin ndërmjet shtyllave pasi që mangësitë e një institucioni mund të rezultojnë në mangësi serioze në sistemin e tërësishëm. Kuptimi i

raportit ndërmjet shtyllave ndihmon të caktohet prioritet i fushave për reforma.

Me qëllim që të merren parasysh faktorët e rëndësishëm nga konteksti, vlerësimi është vënë në analizë koncize të gjendjes së përgjithshme politike, sociale, ekonomike dhe kulturore – "themeli" – ku funksionojnë këto 15 shtylla.

POLITIKA	SHOQËRIA	EKONOMIA	KULTURA

Vlerësimi i Sistemit Kombëtar për Integritet është vegël për hulumtim të cilësisë. Vlerësimi drejtohet nga një shumë "fletësh për vlerësim sipas treguesve" që i zhvilloi Transparency International. Ato përmbajnë "pyetje për vlerësim" për çdo tregues, të shoqëruar me pyetje shtesë për qartësim dhe udhëzime për vlerësim. Si shembull për procesin janë pyetjet për vlerësim dhe qartësim në vijim për resurset të cilat realisht janë në dispozicion në gjyqësor:

SHTYLLË	Gjyqësori
NUMRI I TREGUESVE	3.1.2
EMRI I TREGUESIT	Resurse (praktika)
PYETJA E VLERËSIMIT	Deri në çfarë shkalle gjyqësori ka nivelin e përshtatshëm të resurseve financiare, personelit dhe infrastrukturës për funksionim të vërtetë dhe efektiv?
PYETJE QARTËSIMI	A është buxheti i gjyqësorit i mjaftueshëm për të kryer detyrat e veta? Si shpërndahet buxheti i Gjyqësorit? Kush e shpërndan? Në praktikë, si përcaktohet pagat (nga gjykatësit eprorë, kushtetuta, ligji)? A janë nivelet e pagave të gjykatësve dhe prokurorëve të përshtatshme ose janë aq të ulëta sa për shkaqe ekomomike pranojnë korrupsionin? A janë pagat e gjykatësve përafërsisht të njëjta me pagat e avokatëve? A ka numër të mjaftueshëm të nëpunësve, resurseve bibliotekare dhe pajisjes bashkëkohore kompjuterike për gjykatësit? A ka stabilitet në resurset njerëzore? A ka personeli mundësi për trajnim? A ka trajnime të mjaftueshme për përmirësim të njohurive të gjykatësve nga fusha e drejtësisë, shkathtësitë juridike, përfshirë procedurat gjyqësore dhe drejtimin e lëndëve, përpilimin e vendimeve dhe për konfliktet e interesit?
NOTA MË E ULËT (1)	Resurset ekzistuese financiare, njerëzore dhe infrastrukturore të gjyqësorit janë minimale dhe tërësisht të pamjaftueshme për kryerjen efektive të detyrave.
NOTA MESATARE (3)	Gjyqësori ka në dispozicion disa resurse të caktuara. Por ka mangësi të mëdha në resurse që çojnë në shkallë të caktuar të mosefektivitetit gjatë zbatimit të detyrave.
NOTA MË E LARTË (5)	Gjyqësori ka bazë përkatëse të resurseve për kryerje efektive të obligimeve të veta.

Pyetjet kryesore që përdoren nga Transparency International (TI) në mbarë botën, për secilin tregues, janë zhvilluar nëpërmjet analizës së praktikave më të mira ndërkombëtare, si dhe me përdorimin e përvojës personale nga veglat ekzistuese për vlerësim të secilës shtyllë dhe me kontribut të ekspertëve (ndërkombëtarë) të institucioneve përkatëse. Udhëzimi për vlerësim të Maqedonisë fitohet sipas notës së treguesve, por sipas nevojës hulumtuesi kryesor ka shtuar pyetje ose disa prej tyre kanë mbetur të zbrazëta pasi nuk janë relevante të gjitha aspektet për kontekstin kombëtar. Informatat e plota mbi metodologjinë dhe pyetjet për vlerësim janë në dispozicion në internet faqen e Transparency International.[5]

Për përgjigje të pyetjeve për qartësim, ekipi hulumtues u mbështet në katër burime kryesore të informatave: Ligjvënie kombëtare, raporte sekondare dhe hulumtime, biseda me ekspertë kryesorë dhe pyetësorë të shkruar. Burimet sekondare përfshijnë raporte të besueshme nga organizatat kombëtare civile, organizatat ndërkombëtare, organet qeveritare, fokus-grupet dhe bashkësi të akademike.

Me qëllim që të fitohet një pasqyrë thelbësore për gjendjen ekzestuese, për secilën shtyllë kishte së paku dy raportues që u intervistuan – së paku një përfaqësues nga shtylla që vlerësohet dhe një ekspert për temën, por si subjekt i jashtëm. Veç kësaj, u zhvilluan biseda edhe me më shumë raportues kryesorë, gjegjësisht persona të “fushës”. Gjithashtu u bisedua edhe me profesionistë me ekspertizë në më shumë se një shtyllë, me qëllim që të fitohet një pasqyrë gjithëpërfshirëse për shtyllat.

SISTEMI I VLERËSIMIT

Edhe pse bëhet fjalë për vlerësim të cilësisë, u dhanë nota numerike që të grumbullohen informatat dhe të theksohen dobësitë kryesor dhe përparësitë e sistemit për integritet. Notat u dhanë në shkallë prej 100 poenë, ndarë në 25 njësi, përfshirë edhe pesë vlera të mundshme: 0, 25, 50, 75 dhe 100. Notat i ndihmojnë lexuesit që të mos humbet në detajet dhe të fitohet pasqyra për sistemin në tërësi dhe jo vetëm theksim i pjesëve të posaçme. Notat e treguesve janë dhënë mesatarisht në nivel të dimensioneve, kurse notat sipas tre dimensioneve janë dhënë në vlerat mesatare për të arritur te nota e përgjithshme për secilën shtyllë, që e jep përshkrimin e përgjithshëm për ndërlikueshmërinë e përgjithshme të sistemit.

SHUMË E FUQISHME	81-100
E FUQISHME	61-80
MESATARE	41-60
E DOBËT	21-40
SHUMË E DOBËT	0-20

Notat nuk janë të përshtatshme për krahasim mes vendeve ose për krahasime tjera sasiore për shkak të ndryshimeve në burimet e të dhënave në vendet e ndryshme që zbatojnë metodologjinë për vlerësim dhe për shkak të mungesës së këshillit ndërkombëtar për revizion që do të kishte për detyrë të sigurojë krahasim të notave.

[5] www.transparency.org/policy_research/nis/methodology (qasur më 7 gusht 2015).

QASJA KONSULTATIVE DHE KONSTATIMET E VLEFSHMËRISË

Procesi i vlerësimit në Maqedoni kishte komponentë të fortë konsultative, me qëllim që të përfshijë të gjithë vepruesit kryesorë kundër korrupsionit në qeveri, shoqërinë civile dhe sektorët tjerë të rëndësishëm. Qasja kishte dy qëllime: të prodhojë prova dhe të përfshijë shtrirje të gjerë të palëve të prekura në drejtim të ndërtimit të dinamikës, vullnetit politik dhe kërkesave nga qytetarët për iniciativa reformuese.

Grupi këshillëdhënës (GK) u formua për konsultime dhe këshilla në lidhje me studimin. GK përbëhej prej 13 individëve nga sektori civil, qeveria, sektori privat, bashkësia akademike dhe donatore. Grupi përbëhej prej një paneli të gjerë të anëtarëve nga sektorë të ndryshëm sipas përkatësive të tyre politike. Anëtarët e GK-së mbajtën takimin e parë për prezantim të projektit, dy takime të GK-së dhe Punëtorinë për integritet kombëtar, që u mbajt më 7 prill të vitit 2016.

Lista e anëtarëve të GK-së:

EMRI DHE MBIEMRI	INSTITUCIONI/ORGANIZATA
dr. Goran Kalajxhiev	Kryetar i Komitetit të Helsinkut në Republikën e Maqedonisë / Profesor në Universitetin “Shën Cirili dhe Metodi” – Shkup, Fakulteti i Drejtësisë “Justinian I”
mr. Aleksandar Jovanovski	Instituti për Politika Evropiane
Ljubica Nuri	MATTO Oda Tregtare e Maqedonisë – Turqisë
Olivera Cvetanovska	Ish këshilltare në Ministrinë e Ekonomisë
Teofil Blazhevski	Gazetar
dr. Frosina Remenski	Profesore në Fakultetin për Siguri.
Mane Kolev	Ish anëtar i KSHPK
Emina Nuredinovska	Qendra për Bashkëpunim Ndërkombëtar e Maqedonisë
dr. Milka Ristova	Ish gjykatëse në Gjykatën e Lartë
mr. Suzana Saliu	Legjislaturë / Avokati i Populllit
dr. Ivana Shumanovska	Docente në Universitetin “Shën Cirili dhe Metodij” – Shkup, Fakulteti i Drejtësisë “Justinian I”
dr. Manfredas Limantas	Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shkup
Arlinda Idrizi	Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Republikën e Maqedonisë

GK u takua dy herë: më 19 tetor të vitit 2014 dhe më 7 tetor të vitit 2015. Në takimin e parë, anëtarët e GK-së shqyrtuan burimet në dispozicion për secilën shtyllë, përfshirë sondazhet, regjistrat e institucioneve dhe raportet e bashkësisë akademike, shoqërisë qytetare dhe institucioneve tjera hulumtuese.

Anëtarët e GK-së e ngritën çështjen e mungesës së të dhënave të sakta statistikore në

Maqedoni dhe ofruan përkrahjen e tyre për fitimin e të dhënave statistikore. Ata që punojnë në bashkësinë akademike ofruan të shpërndajnë të dhënat nga sondazhi që veç më e kanë zbatuar. Anëtarët e GK-së diskutuan mbi karakterin e Ndërmarrjeve publike (NP) të cilat nuk janë tërësisht në pronësi shtetërore por as nuk janë ndërmarrje private. Të drejtat e NP-së burojnë nga publiku, qeveria dhe gjithashtu nga punëtorët. 51% e aksioneve të disa NP-ve janë në pronësi të ndërmarrjeve që gjenden në bursë, që krijon drejtim të ndryshëm dhe obligime për përputhshmëri.

Më 29 tetor të vitit 2014, Transparency International – Maqedoni, së bashku me Shefin e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë, Ekselenca e tij, ambasadori Aivo Orav mbajtën takimin e parë për prezantim të projektit dhe metodologjisë, si dhe të rezultateve të pritura.[6]

Sfida më e madhe për zbatim të projektit ishte mungesa e bashkëpunimit nga institucionet maqedonase. Sekretariati i Kuvendit (shtëpisë ligjvënëse), Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit (KSHPK)[7], Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nuk bashkëpunuan me ekipin hulumtues. Delegacioni i BE-së në Maqedoni theksoi nevojën për bashkëpunim me projektet e financuara nga BE-ja te drejtuesit e këtyre institucioneve, por kjo nuk arriti rezultat.

Në takimin për vlefshmëri të vlerësimit, i mbajtur më 7 tetor të vitit 2015, njëzëri u miratua konkluzioni për domosdoshmëri për revizion të metodologjisë ekzistuese ku njëlloj vlerëson “ligjet” dhe “praktika”, pasi mangësitë serioze në praktikë kanë ndikim shumë më të dëmshëm në fushë/institucion të caktuar se sa që ka parashikueshmëria e ligjit për atë fushë. U propozua shtimi i matjes shtesë sa i përket aspektit të “praktikës” me qëllim që më mirë të pasqyrohet realiteti.[8]

Përsëri, pas diskutimit ndryshime u bënë vetëm në notat e lidhura me sektorin qytetar, mediet dhe pushtetin ekzekutiv. Sipas rekomandimeve të GK-së, ekipi hulumtues i Transparency International – Maqedoni dha pasqyrë të posaçme (tabela) për vlerësim të “ligjeve” dhe “praktikës”.

Sekretariati i Transparency International – Maqedoni në Berlin rishikoi dhe miratoi raportin e plotë, kurse kontrolli i jashtëm dha komente gjithëpërfshirëse dhe informata shtesë për shtylla të posaçme.

---

6 http://www.transparency.mk/index.php?option=com_content&task=view&id=1011&Itemid=57 (qasur më 4 gusht të vitit 2015).

7 Përfaqësues të KSHPK morën pjesë vetëm në Punëtorinë për vlefshmëri të rezultateve të hulumtimit. Aty ofruan të dorëzojnë të gjitha informatat e nevojshme deri më 11.4.2016, që fatkeqësisht nuk u realizua.

8 Procesverbali i takimit të GK mbajtur më 7 tetor të vitit 2015.

2

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Republika e Maqedonisë gjendet në një moment kritik. Sipas komisarit të Bashkimit Evropian (BE), Johanes Han, skandalet e fundit për përgjimin e paligjshëm me mijëra aktorë politikë në Maqedoni zbuloi "shqetësim serioz dhe përfshirjen politike dhe korrupsionin në nivel të lartë" që pastaj e dërgoi vendin në krizë në vitin 2015. Nga shkurti i vitit 2015, lideri i opozitës, Zoran Zaev, ka publikuar një varg të të ashtuquajturave "bomba" ose ekstrakte audio, duke pohuar që 670.000 biseda janë incizuar në mënyrë të fshehtë nga më tepër se 20.000 numra telefonikë të Maqedonisë. Në materialet e incizuara dhe të publikuara, dëgjohet si funksionarë të lartë qeveritarë komplotojnë si të kurdisin votat për zgjedhjet, korruptim të gjykatësve dhe dënim të kundërshtarëve politikë. Z. Zaev ka publikuar që incizimet janë bërë nga qeveria për të cilat ka kuptuar opozita.[9] Në maj të vitit 2015, tre funksionarë të lartë qeveritarë dhanë dorëheqje, ndërsa e ashtuquajtura "Marrëveshja e Përzhinos" (marrëveshja e ndihmuar nga BE-ja ndërmjet partisë së Kryeministrit dhe opozitës), që synon reformë juridike dhe institucionale, me qëllim të sigurimit të zgjedhjeve të lira dhe medie të lira; si dhe për krijimin e Prokurorisë Speciale Publike për të hetuar parregullsitë dhe korrupsionin e supozuar në bisedat e përgjuara. Zgjedhjet ishin caktuar më 24 prill 2016, ndërsa BE-ja do të vlerësojë vendin pas zgjedhjeve në bazë të asaj nëse janë plotësuar të gjitha prioritetet reformuese të përmbajtura në marrëveshje dhe nëse votimi ka qenë i lirë dhe i rregullt.[10]

Më tutje, në Raportin për të drejta të njeriut të Seksionit të Shtetit të SHBA-ve (vitin 2014) theksohet që gjatë vitit ka pasur raporte të besueshme që qeveria është përzier në lëndë të profilit më të lartë, që kanë përfshirë keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe keqpërdorim të pozitës për frikësim të liderëve kryesorë opozitarë. Më tutje, janë vlerësuar probleme në polici dhe me korrupsion në gjyqësorin.[11] Konsiderohet që problemet më të rëndësishme në lidhje me të drejtat e njeriut dalin nga niveli i lartë i korrupsionit dhe që qeveria nuk e respekton sundimin e të drejtës, vazhdimisht e kufizon lirinë e medieve, përzihet në gjyqësor dhe bën përzgjedhje në lidhje me ndjekjen penale. Sistemi gjyqësor është i nën përzierjes politike, mungesë e efikasitetit, favorizim i personave në pozitë të mirë, zgjatje të proceseve gjyqësore, shkelje e të drejtës për gjykatë publike dhe korrupsion[12].

Sipas Raportit të Komisionit Evropian (KE) për përparimin e Maqedonisë për vitin 2015[13], vendi ka vendosur kornizën e duhur juridike dhe institucionale për luftë kundër korrupsionit, ndërsa gjatë dhjetë viteve të fundit ka përvojë me parandalimin dhe akte paditëse për korrupsion. Megjithatë, Raporti i KE-së për përparimin e vendit për vitin 2015 nuk shënon përparim në vitin e kaluar për çështjet e hapura të identifikuara. Korrupsioni mbetet i përhapur në përmasa të mëdha. Raporti pohon për mungesë të vullnetit politik, ndërsa përzierja politike në punën e autoriteteve relevante e dëmton kapacitetin për përballimin efektiv me korrupsionin dhe parandalon institucionet që në mënyrë proaktive dhe jo-selektive të veprojnë, veçanërisht me lëndët e nivelit të lartë.[14] Raporti rekomandon që vendi të dedikojë vëmendje

[9] http://www.nytimes.com/2015/05/19/world/europe/macedonias-leaders-unable-to-resolve-festering-crisis.html?_r=0
[10] http://www.balkaninsight.com/en/article/corruption-justice-top-agenda-in-commission-report-11-10-2015 [11.11.2015]
[11] http://www.state.gov/j/drl/rls/hrrpt/humanrightsreport/#wrapper f. 15.
[12] http://www.state.gov/j/drl/rls/hrrpt/humanrightsreport/#wrapper f. 1.
[13] Raporti për përparimin e Republikës së Maqedonisë, 2015, Komisioni Evropian, Bruksel, f. 15 (i gatshëm në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf]
[14] Raporti për përparimin e Republikës së Maqedonisë, 2015, Komisioni Evropian, Bruksel, f. 15 (i gatshëm në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf]

të posaçme gjatë vitit rrjedhës për krijimin e kornizës për mbrojtje të denoncuesve, në përputhje me standardet evropiane dhe praktikat më të mira.[15]

Anketa për mendimin publik të cilën e ka realizuar Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit (KSHPK) në vitin 2015 tregon që arsyet kryesore për korrupsion janë të lidhura me probleme sistemore (*"të ardhura të vogla të nëpunësve shtetërorë" dhe "procedura të gjata dhe të ngadalshme administrative");* institucione joefikase dhe joefektive ("*autoritete joefikase kundër korrupsionit" dhe rregulla të paqarta me mungesa që mundësojnë manipulime")* si dhe vlera të shumta morale të pranuara ndaj korrupsionit si sjellje normale.[16] Këtë e plotësojnë nivelet relative të ulëta të besimit në institucionet dhe frika nga shkëmbimi i informatave të ndjeshme, të cilën e konfirmojnë edhe përgjigjet e qytetarëve që ishin pyetur të theksojnë arsyen kryesore për ngurrimin e denoncimit të korrupsionit. Një pjesë e caktuar, gjegjësisht 20.3% e të anketuarve kanë theksuar që "*mungesa te besimit e autoritetet kompetente"* të ndërmarrin aktivitete është arsye kryesore përse zgjedhin që mos të denoncojnë korrupsion, ndërsa 17.0% kanë deklaruar që arsye kryesore për ngurrimin e denoncimit të korrupsionit është "*frika nga hakmarrja".*[17]

ZBULIME KRYESORE

Vlerësimi i Sistemit Kombëtar për Integritet (SKI) tregon që ndonëse Maqedonia ka kornizë të mirë ligjore për luftë kundër korrupsionit, ka zbatim të dobët të ligjeve kundër korrupsionit. Me institucionet që janë përgjegjëse për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit nuk udhëhiqet në mënyrë efektive dhe nuk janë të pavarura mjaftueshëm për të përballuar korrupsionin. Përveç kësaj, u mungon integriteti.

Për shembull, Republika e Maqedonisë deri më tani ka nënshkruar dhe ratifikuar të gjitha marrëveshjet relevante ndërkombëtare, ka miratuar ligjet e duhura dhe ka përfshirë standardet e nevojshme, gjegjësisht "ligjvënien evropiane" për aderim në BE. Korniza ekzistuese ligjore është pikënisje për bashkëpunim efektiv ndërkombëtar në materien ligjore, hetimet dhe kthimin e mjeteve. Më tutje, Republika e Maqedonisë është mes vendeve të para nga Ballkani Perëndimor dhe vendeve kandidate dhe anëtare të BE-së që ka formuar Komision Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit (nëntor 2002), e cila, gjithashtu, është në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara për luftën kundër korrupsionit, e ratifikuar në vitin 2007.

Krahas të gjitha këtyre, mekanizmat në fjalë nuk janë efektivë. Studimi për SKI tregon dallime të mëdha në rezultatet nga treguesit për "të drejtën" dhe "praktikën".

---

15 Raporti për përparimin e Republikës së Maqedonisë, 2015, Komisioni Evropian, Bruksel, f. 15 (i gatshëm në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf]

16 Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit, 2015, Vlerësimi i nivelit dhe karakterit të korrupsionit dhe dukshmëria dhe perceptimi i politikës kundër korrupsionit, Shkup, Twinning Projekt i BE-së "Mbështetje për parandalim efikas dhe kuftë kundër korrupsionit" f. 7.

17 Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit, 2015, Vlerësimi i nivelit dhe karakterit të korrupsionit dhe dukshmëria dhe perceptimi i politikës kundër korrupsionit, Shkup, Twinning Projekt i BE-së "Mbështetje për parandalim efikas dhe luftë kundër Korrupsionit" f. 10.



Në përgjithësi, ekzistojnë resurse të mjaftueshme dhe relativisht të mjaftueshme janë nivelet e pavarësisë formale, transparencë, llogaridhënie dhe integritet në shumë institucione. Megjithatë, ekzistojnë edhe mangësi serioze në praktikat e institucioneve në lidhje me treguesit mbi integritetin, pavarësinë dhe llogaridhënien që tregojnë rezultate më të dobëta, siç është treguar në tabelën më poshtë.



Madje edhe KSHPK-ja, që është zgjedhur nga Kuvendi dhe është e pavarur sipas ligjit, përballet me probleme të mëdha në lidhje me llogaridhënien, integritetin, transparencën, që kontribuon për rolin e parëndësishëm në luftën kundër korrupsionit. Në kombinim me bashkëpunimin e kufizuar institucional, mungesën e sundimit të të drejtës, pavarësinë e pamjaftueshme të gjyqësorit dhe lirinë e kufizuar të medieve vendosen kushte që në Maqedoni rezulton në rritje të pakontrolluar të korrupsionit.

SHTYLLAT E SISTEMIT KOMBËTAR PËR INTEGRITET

Sistemi Kombëtar për Integritet i Maqedonisë karakterizohet me dominim të pushtetit ekzekutiv dhe dobësi të institucioneve tjera kryesore. Pushteti ekzekutiv dhe ligjvënës janë veçanërisht të fuqishëm në kuptim të kapacitetit të tyre dhe pozitën e tyre në luftën kundër korrupsionit. Pushteti ekzekutiv, gjithashtu, në masë të madhe është i pavarur – gjegjësisht, tepër i pavarur, por treguesit tregojnë që strukturat e menaxhimit të brendshëm të pushtetit ekzekutiv, që duhet të promovojnë transparencë, llogaridhënie dhe integritet janë të dobëta. Pushteti ekzekutiv është tepër i dobëta në kuptim të menaxhimit të brendshëm.

Mangësitë e pavarësisë së pushtetit ligjvënës dhe gjyqësorit dhe mbikëqyrja e tyre e pasuksesshme mbi pushtetin ekzekutiv tregojnë mangësi të mëdha në sistemin e kontrollit. Institucionet shtetërore që kanë për detyrë të parandalojnë dhe luftojnë korrupsionin, që janë KSHPK dhe Prokuroria Publike, janë tepër të dobët dhe nuk kanë resurse përkatëse dhe sistem për menaxhim të brendshëm. Dobësia e institucioneve shtetërore është rezultat i mungesës së plotë të vullnetit politik për përballim me korrupsionin.

Kjo është me rëndësi të madhe sepse aktorët jo-shtetërorë që duhet të shërbejnë si rojtarë, siç janë mediet dhe sektori afarist, janë në mesin e shtyllave më të dobëta në Republikën e Maqedonisë. Aktorët e sektorit qytetar dhe partitë politike tregojnë rezultate të dobëta në gjithë treguesit, veçanërisht në lidhje me menaxhimin e brendshëm dhe nuk kanë kapacitete të zbatojnë kontrolle të institucioneve qeveritare. Agjencitë për zbatimin e ligjit nuk janë të pavarura. Ju mungojnë struktura për menaxhim të mirë të brendshëm dhe nuk mund të kryejnë rolin e tyre për hetim dhe ndjekje të korrupsionit.

Nga ana tjetër, shtyllat më të fuqishme në Republikën e Maqedonisë janë Enti Shtetëror për Revizion dhe Avokati i Popullit; dy institucionet e pavarura dhe shënojnë nota më të mira në të gjitha shtyllat te treguesit e menaxhimit të brendshëm (transparencë, llogaridhënie dhe integritet). Treguesit tregojnë që Enti Shtetëror për Revizion ka kapacitet të mjaftueshëm dhe luan një rol relativisht të fuqishëm në luftën kundër korrupsionit, ndonëse Avokati i Popullit nuk ka kapacitete të mjaftueshme të kryejë detyrat personale.

SISTEMI KOMBËTAR PËR INTEGRITET



(PL) PUSHTETI LIGJVËNËS

(PE) PUSHTETI EKZEKUTIV

(GJ) GJYQËSORI

(SP) SEKTORI PUBLIK

(AZL) AGJENCITË PËR ZBATIMIN E LIGJEVE

(PP) PROKURORIA PUBLIKE

(KSHZ) KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

(ESHR) ENTI SHTETËROR PËR REVIZION

(AP) AVOKATI I POPULLIT

(KSHPK) KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIM TË KORRUPSIONIT

(PP) PARTI POLITIKE

(MED) MEDIE

(SHC) SHOQËRI CIVILE

(SA) SEKTORI AFARIST

(NP) NDËRMARRJE PUBLIKE

III. PROFILI I VENDIT: BAZAT PËR SISTEMIN KOMBËTAR PËR INTEGRITET

BAZAT PËR SISTEMIN KOMBËTAR PËR INTEGRITET

Meqë Sistemi Kombëtar për Integritet është thelluar mirë në kontekstin e plotë social, ekonomik dhe kulturor të vendit, këtu është pasqyruar një analizë e shkurtë e këtij konteksti që më mirë të kuptohet si ndikojnë këta faktorë mbi integritetin në Maqedoni. Ekzistojnë katër lloje të ndryshme të "bazave" të sistemit: baza politike-institucionale, baza sociale-politike, baza sociale-ekonomike dhe baza sociale-kulturore.

BAZAT POLITIKE-INSTITUCIONALE

NË ÇFARË SHKALLE INSTITUCIONET SHTETËRORE TË VENDIT MBËSHTESIN SISTEM EFEKTIV KOMBËTAR PËR INTEGRITET?

Nota **25**

Korniza ligjore në Maqedoni i garanton të drejtat qytetare dhe politike të qytetarëve dhe parashikon procese themelore demokratike, megjithatë këto dispozita ligjore në praktikë shkelen. Më 9 shkurt 2015 ndodhi një skandal politik kur opozita e akuzoi qeverinë për përfshirje të përgjimit të paligjshëm të bisedave private ndërmjet politikanëve dhe funksionarëve. Pastaj, vijoi kriza politike në të cilën BE-ja ndihmoi për arritjen e marrëveshjes ndërmjet liderëve të partive më të mëdha politike. Një pjesë e marrëveshjes ishte që zgjedhjet të zhvillohet në prill të vitit 2016[18].

Kushtetua e Maqedonisë dhe ligjet tjera parashikojnë zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike. Megjithatë, mangësitë në praktikat zgjedhore mund të sjellin kriza politike në Maqedoni. Raporti përfundimtar i misionit për vëzhgimin e zgjedhjeve të OSBE/ODHIR për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare të vitit 2014 thekson që kanë qenë të zbatuara në mënyrë efektive, përfshirë edhe vetë ditën e zgjedhjeve. Megjithatë, raporti, gjithashtu thekson kritika për sjelljen e partisë në pushtet, përfshirë edhe qasjen ekskluzive në resurse administrative, mediet kryesore private dhe financim privat. Përveç kësaj, raporti ka theksuar shqetësim në lidhje me ndarjen e pabarabartë të aktiviteteve të partisë në pushtet në cilësinë si qeveri e shtetit dhe si parti politike; njoftime për frikësim të votuesve; mospërputhje të Listave zgjedhore; kontroll indirekt nga partia në pushtet mbi mediet, në të cilën shteti dominon në hapësirën e reklamimit; mungesa e suksesit të medieve për të bërë dallimin mes mbulimit të funksionarëve shtetërorë në cilësinë e ministrave dhe si kandidatë, që ka kontribuar për mjegullimin e vijës ndërmjet shtetit dhe partisë; dhe shumicën e medieve që janë monitoruar në masë të madhe kanë qenë të njëanshëm në dobi të partisë në pushtet dhe kandidatin e tyre presidencial, dhe kanë qenë negativ kundër partisë kryesore opozitare

[18] Komisionit Evropian (2015, f. 6).

dhe kandidatit të tyre.[19]

Me Kushtetutë dhe ligje janë garantuar të gjitha të drejtat qytetare. Gjendet në vend korniza e plotë për mbrojtje të të drejtave themelore, por fokusi duhet të vendoset më tepër në zbatimin efektiv. Situata në lidhje me lirinë e shprehjes edhe më tutje është mjaft problematike. Kjo ndodh madje edhe pas prezantimit të ligjeve të reja të plota për medie në fund të vitit 2013, pas konsultimeve të gjera publike dhe këshilla nga organizatat ndërkombëtare.[20]

Mbisundimi i të drejtës në mënyrë formale është garantuar me Kushtetutë, ku doktrina e ndarjes së kompetencave i rregullon marrëdhëniet ndërmjet Kuvendit, pushtetit ekzekutiv dhe gjyqësorit. Kushtetuta parashikon rolin e Kuvendit në mbikëqyrjen e pushtetit ekzekutiv dhe llogaridhënien para Kuvendit dhe pavarësinë e gjyqësorit. **Megjithatë, shikuar realisht, janë prishur ndarja** ndërmjet **pushtetit dhe sundimi i të drejtës me dominimin e pushtetit ekzekutiv dhe dobësitë e pushtetit ligjvënës dhe gjyqësorit.**

Kriza politike që arriti kulmin me skandalin e përgjimit të paligjshëm paraqet një kërcënim për themelet e sundimit demokratik në Maqedoni. Marrëveshja e arritur në ndërmjetësim të Komisionit Evropian (KE) ndërmjet partisë në pushtet dhe partive opozitare paraqet një mundësi për të themeluar një dialog konstruktiv për krijimin e besimit dhe respektimin e sundimit të të drejtës. Mossuksesi do të sjell shkelje të demokracisë parlamentare në Republikën e Maqedonisë.[21]

BAZAT SOCIO-POLITIKE

NË ÇFARË SHKALLE MARRËDHËNIET NË GRUPET SOCIALE DHE NDËRMJET GRUPEVE SOCIALE DHE SISTEMI POLITIK NË VEND MBËSHTESIN SISTEMIN EFEKTIV KOMBËTAR PËR INTEGRITET?

Nota **50**

Shoqëria maqedonase dhe politika janë të ndara sipas linjës së fuqishme etnike ndërmjet qytetarëve maqedonas dhe shqiptarë. Nuk ka lidhje të fuqishme ndërmjet shoqërisë dhe politikës, duke marrë parasysh dobësitë e grupeve qytetare, partive politike dhe shoqatave.

Në Maqedoni janë regjistruar 52 parti politike, dhe pjesa më e madhe e tyre nuk janë aktive. Më dominuese janë elitat politike ndërsa fuqia është koncentruar në liderët partiakë dhe lojtarët kryesorë politikë që janë të ndarë në bllokun etnik maqedonas dhe shqiptar. Më tutje, kriza e fundit politike ndërmjet pushtetit dhe partive në opozitë dëshmoi që interesat partiake janë mbi interesat kombëtare.[22]

Edhe më tej pengohet përparimi në lidhje me mbrojtjen e pakicave nga mungesa financiare dhe njerëzore dhe mungesa e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përkatëse. Duhet një qasje më aktive për të garantuar identitetin etnik, kulturor dhe gjuhësor të të gjitha ko-

[19] Njëlloj, f. 17.
[20] Raporti për përparimin e Republikës së Maqedonisë 2014, Komisioni Evropian, (Bruksel, Komisioni Evropian 2014), f. 17 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-progress-report_ en.pdf [qasur më 4 gusht, 2015].
[21] Komisioni Evropian 2015., f. 6-7.
[22] Komisioni Evropian 2014, f. 6.

muniteteve.[23] Marrëveshja kornizë e Ohrit që është arritur ndërmjet partive politike që përfaqësojnë maqedonasit dhe shqiptarët etnikë në vitin 2001 ka dhënë bazën për marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve. Ka hapësirë për përmirësim në fushat e jo-diskriminimit, përfaqësimit të drejtë dhe në përdorim të gjuhëve dhe në arsim. Ka një Komision për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, por me mungesë të resurseve financiare dhe njerëzore që në mënyrë përkatëse të zbatojnë detyrat nga mandati. Ligji Kundër Diskriminimit ende nuk është përshtatur me ligjet evropiane, sepse nuk ndalon drejtpërdrejtë diskriminimin në fushën e punësimit dhe okupacionit.

Shkalla e pjesëmarrjes së qytetarit në politikë është e ultë. Janë vërejtur përmirësime formale në kuptim të ligjvënies dhe mekanizmave për konsultim, por organizatat qytetare edhe më tutje shprehin brengosje në lidhje me kushtet e vështira në të cilat funksionojnë dhe mungesën e vullnetit të pushtetit për dialog.[24] Megjithatë, në vitin 2014/15, grupet qytetare janë koordinuar për të kundërshtuar gjykimin e një gazetari,[25] me qëllim që kundërshtojnë reformat kontroverse në arsim[26] dhe të sigurojnë publikim të bisedave të përgjuara[27] që zbuluan mbikëqyrjen e tyre të paligjshme. Organizatat qytetare kanë organizuar aktivitete të përbashkëta me partitë politike opozitare dhe kanë përforcuar aktivitetet e tyre në lidhje me çështjet kundër korrupsionit, të drejtat e pakicave dhe integrimet evropiane. Në protestën kundër Qeverisë që u organizua më 17 maj 2015 janë paraqitur një numër i madh i qytetarëve dhe për herë të parë në një vend u mblodhën qytetarë me origjinë të ndryshme etnike dhe sociale[28].

BAZAT SOCIO-EKONOMIKE

NË ÇFARË SHKALLE GJENDJA SOCIO-EKONOMIKE NË VEND MBËSHTET SISTEMIN EFEKTIV KOMBËTAR PËR INTEGRIM?

Nota **50**

Ndonëse ka një jo-stabilitet politik dhe korrupsion ekzistues, kalimi i Maqedonisë drejt një ekonomie tregtare ka lehtësuar relativisht stabilitetin e lartë social dhe politik, i cili ka mundësuar që ekonomia të përshtatet me masat e përgjithshme reformuese.

Fondacioni Heritixh (The Heritage Foundation)[29] thekson që gjatë pesë viteve të fundit liria ekonomike në Maqedoni ka përparuar për 1.1 pikë, me përmirësim të dukshëm në vlerësim te gjysma e treguesve për liri ekonomike, përfshirë edhe lirinë afariste, lirinë e korrupsionit dhe lirinë tregtare.

Ndonëse Maqedonia ka bërë përparim të dukshëm në lidhje me rritjen e të ardhurave dhe

[23] Komisioni Evropian 2014, f. 12.
[24] Komisioni Evropian 2014, f. 12.
[25] https://www.youtube.com/watch?v=vqOz3vJ0e_w
[26] http://www.studentskiplenum.org/ Komisioni Evropian 2015, f. 67.
[27] http://gragjanite.mk/ Komisioni Evropian 2015, f. 9.
[28] https://www.google.cz/search?q=%D0%BF%D1%80%D0%BE%D1%82%D0%B5%D1%81%D1%82+%D0%BD%D0%B0+17+%D0%BC%D0%B0%D1%98&tbm=isch&tbo=u&source=univ&sa=X&ved=0ahUKEwiokJboyYbKAhXIRhQKHXfYA78QsAQIVA&bi- w=1024&bih=447 (qasur më 6 gusht 2015).
[29] Fondacioni Heritixh 2015, Indeksi i lirisë ekonomike (Uashington DC: The Heritage Foundation, 2015), http://www.heritage. org/index/country/macedonia [qasur më 4 gusht, 2015].

uljen e përgjithshme të varfërisë[30], sipas Indeksit për zhvillim njerëzor të Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) për vitin 2014 (HDI), Maqedonia radhitet në vendin e 84-të nga 187 vende. Hulumtimi i njëjtë zbulon që edhe më tutje, ka pabarazi ekonomike, me 33.3% të popullatës që jeton nën linjën e varfërisë.[31] Përveç kësaj, individët që jetojnë mbi linjën e varfërisë në kuptim të të ardhurave të tyre edhe më tutje përballen me mungesë të arsimit, shëndetit dhe kushteve tjera për jetë. Në vitin 2012, mbi 37.000 familje janë mbështetur në ndihmën sociale, dhe ajo do të thotë që secili anëtar i familjes ka jetuar me më pak se 2 dollarë amerikanë në ditë.[32] Ekspertët thonë që neto-rroga mesatare[33] (361 EUR) në Maqedoni nuk pasqyron shtrirjen e rrogave të vogla, sepse ka rroga jashtëzakonisht të larta që rritin mesataren dhe dredhin të vërtetën.[34]

Maqedonia nuk mbledh statistikë zyrtare kombëtare për varfërinë. Të dhënat e vetme relevante mund të gjenden në raportet që i përgatisin organizatat ndërkombëtare. Në regjistrimin e fundit që u zhvillua në vitin 2002[35] dhe sipas të dhënave që ka publikuar Banka Botërore, deri në 2005, 370.000 qytetarë kanë braktisur vendin, dhe ajo është 18,2% të popullatës, në bazë të numrit të regjistrimit nga 2002, dhe 500.000 qytetarë punojnë jashtë vendit. Shumat e huaja për Maqedoninë nga qytetarë që punojnë jashtë janë burim i rëndësishëm i të ardhurave për ekonominë Maqedonase[36].

Tatimi i barabartë konkurrues dhe regjimi i lirë tregtar, i plotësuar me kornizën relative efikase rregullatore, kanë mundësuar paraqitjen e një sektori dinamik privat. Megjithatë, zhvillimi afatgjatë varet nga zbatimi i reformave më të thella institucionale.[37]

Sipas Indeksit për Liri Ekonomike të fondacionit Heritixh për vitin 2015, Maqedonia është vlerëuar me 67.1, që e vendos në vendin e 53-të si ekonomi e lirë në Indeksin për vitin 2015. Nga viti 2015, vlerësimi i përgjithshëm është zvogëluar për 1.5 pikë, gjatë së cilës ka përmirësime në lirinë nga korrupsioni dhe liria tregtare, por janë zvogëluar liritë e punëtorëve, liria afariste, drejtimi me shpenzimet qeveritare dhe liria monetare.

Sektori afarist në Maqedoni e përdor kornizën liberale të vendit, megjithatë korrupsioni dhe nepotizmi dominojnë në administratën publike dhe procedurat për Furnizime Publike, që i rrit shpenzimet për biznes dhe i dekurajon investimet e huaja.[38] Njëkohësisht, ndërmarrjet përballen me një numër të madh të problemeve të dukshme, përfshirë edhe qasje të kufizuar në kapital dhe kredi dhe pamundësi për të mbështetur në gjykatat për zgjedhje juridike në kontestet me institucionet. Infrastruktura nuk është përmirësuar sepse prioriteti i qeverisë ishte ndërtimi i përmendoreve grandioze, dhe jo rrugëve dhe projekteve tjera të infrastrukturës[39].

---

30 Njëlloj.

31 Programi për zhvillim i kombeve të Bashkuara, Raporti për zhvillimin njerëzor për 2014, Qëndrueshmëria e përparimit njerëzor: Ulja e dobësive dhe përdorimi (Nju Jork: UNDP, 2014.), f.181. http://www.iq.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/ hdr/2014-human-development-report/ [qasur më 14 gusht, 2015].

32 Njëlloj.

33 http://www.stat.gov.mk/ (qasur më 5 gusht 2015)

34 Prof. Zdravko Saveski për http://www.makdenes.org/content/article/25240535.html [qasur më 7 gusht, 2015].

35 http://www.stat.gov.mk/OblastOpsto.aspx?id=31 (qasur më 28 korrik 2015.)

36 http://www.globusmagazin.com.mk/?ItemID=1EADC6DA4B307842B7099F976DCABA7E (qasur më 5 gusht 2015)

37 Fondacioni Heritixh 2015, f. 299.

38 Njëlloj.

39 Raporti i parë dhe i dytë për "Shkupi 2014", http://opstinacentar.gov.mk/LinkClick.aspx?fileticket=FFWpQbLwYvc%3d&portalid=0&language=mk-MK http://opstinacentar.gov.mk/Portals/0/Documentatin/Banners/izvestaj%20II%2024.11.2013.pdf

BAZAT SOCIO-KULTURORE

NË ÇFARË SHKALLE NORMAT DHE VLERAT KRYESORE ETNIKE NË SHOQËRI KONTRIBUOJNË PËR SISTEM EFEKTIV KOMBËTAR PËR INTEGRITET?

Nota **50**

Zhvillimi ekonomik dhe zhvillimi social dhe kulturor janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin. Zhvillimi ekonomik është instrument për ndryshim shoqëror, ndërsa faktorët socialë dhe kulturorë janë parakushte për rritje të suksesshme dhe të qëndrueshme[40].

Sipas anketës nga viti 2010 për vlerat sociale maqedonase, pesë vlerat më të rëndësishme për qytetarët janë respektimi i të drejtave njerëzore (15,6%) paqe/pa dhunë (15,4%), demokraci (13,3%), mbisundimi i të drejtës (10,4%) dhe respektimi i jetës së njeriut (10,0%).[41]

Vlerat për të cilat konsiderohet që janë më pak të rëndësishme janë llogaridhënia/transparenca (2,1%) dhe vetërealizimi (2,9%).

[40] Kimio Uno, Tregues për zhvillim social dhe kulturor, Universiteti Kelo, Japoni, 2004, http://www.eolss.net/ EolssSampleChapters/C11/E1-11-08/E1-11-08-TXT.aspx [qasur më 28 korrik 2015.]

[41] Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Vlera sociale maqedonase (Shkup: MCMS, 2010.) f. 5, http://www. mcms.org.mk/images/docs/2011/macedonian-societal-values-2011.pdf [qasur më 28 korrik 2015.].

IV. PROFILI I KORRUPSIONIT

Ndonëse secila qeveri nga pavarësia e Maqedonisë deri sot pohon që prioritet është lufta kundër korrupsionit, korrupsioni edhe më tutje është një dukuri mjaft e përhapur. Shpenzimet publike nuk janë tërësisht transparente, nuk ka transparencë në financimin e partive politike dhe shpenzimet publike dhe shumica e qytetarëve nuk dëshirojnë të paraqesin raste të korrupsionit ose sjelljes së paligjshme. Me ngecjen e përpjekjeve kundër korrupsionit, Indeksi i Perceptimit për korrupsion të Transparency International – Maqedoni është rritur[42] dhe tani merr vendin e 66 nga gjithsej 168 shtete të radhitura[43]. Pothuaj se 69% e të anketuarve në Barometrin për Korrupsion Global[44] të Transparency International 2013 kanë menduar që korrupsioni është i njëjtë ose më i keq në periudhën ndërmjet viteve 2011 dhe 2013.

Raportet e përparimit të BE-së që çdo vit përgatiten për ndjekjen e përparimit të Maqedonisë në rrugën për qasje në BE disa herë deri më tani kanë zbardhur probleme të dukshme me mungesën e transparencës në financim të partive dhe shpenzimet e përgjithshme publike[45]. Në Raportin nga viti 2014 janë theksuar problemet me mbisundimin e të drejtës dhe korrupsionit. Raporti merr konkluzionin që korrupsioni edhe më tutje është "problem serioz", veçanërisht në fushën e prokurimeve publike dhe financimin e partive politike. Ndonëse gjatë viteve të fundit korniza ligjore është përputhur me atë evropiane, sërish ngec zbatimi. Joshpesh zbatohen dënime të larta për veprat e korrupsionit, të cilat do të mund të kishin ndikim kthyes, dhe duhet përmirësim i dukshëm i kapacitetit të gjykatave për tu përballuar me lëndë të korrupsionit. Kontrollet e brendshme janë të dobëta kundër sjelljes së korruptuar në administratën shtetërore dhe publike.

Projekti qeveritar për rindërtim dhe rimëkëmbje të ndërtesave dhe ndërtimi i përmendoreve në Shkup "Shkupi 2014" është burim i kontroverseve në Maqedoni. Projekti është kritikuar për shkak të tonit nacionalist që është i dukshëm në zgjedhjen në lidhje me stilin arkitektonik, si dhe në lëndët dhe temat që janë zgjedhur për përmendoret dhe statujat. Megjithatë, kritikat më dominuese janë në lidhje me çmimin e lartë të projektit, për të cilin shumë mendojnë që është lidhur me mashtrime në prokurimet publike.[46] Kur filloi projekti në vitin 2008, ishte projektuar rreth 80 milionë EUR. Në konferencë për mediet në prill të vitit 2013, Ministria e Kulturës pranoi që janë shpenzuar 207 milionë EUR në objekte të reja, përmendore dhe skulptura. Por, vlerësimi i organizatave qytetare është që qeveria ka shpenzuar dy herë më tepër se ajo shumë[47], ndërsa partitë në opozitë si LSDM, besojnë që shuma është diku 580 milionë EUR.[48]

Pas zgjedhjes së tij në mars 2013, kryetari i ri i komunës (i opozitës) së Qendrës ka filluar

[42] Transparency International, *Indeksi i perceptimit për korrupsion, 2014 (Berlin:* Transparency International, 2014) http://www.transparency.org/cpi2014/infographic/global [qasur më 20 korrik, 2015].

[43] Transparency International, *Indeksi i perceptimit për korrupsion, 2015 (Berlin:* Transparency International, 2015) http://www.transparency.org/cpi2015 [qasur më 27 janar, 2016.].

[44] http://www.transparency.org/gcb2013/country/?country=macedonia_%28fyr%29 (qasur më 21 korrik, 2015)

[45] Komisioni Evropian 2015, f. 6. http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_the_former_ yugoslav_republic_of_macedonia.pdf [qasur më 15 nëntor, 2015].

[46] http://opstinacentar.gov.mk/%D0%A1%D0%B5%D1%80%D0%B2%D0%B8%D1%81%D0%B8-%D0%B7%D0%B0-%D0%B3%D1%80%D0%B0%D1%93%D0%B0%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%B5/%D0%9D%D0%BE%D0%B2%D0%BE%D1%81%-D1%82%D0%B8/ArtMID/549/ArticleID/644 http://www.transparency.org.mk/en/images/stories/publications/report_second_sk2014. pdf (qasur më 19 shtator, 2015)

[47] https://freedomhouse.org/report/nations-transit/2014/macedonia#_ftn69 (qasur më 21 korrik, 2015)

[48] LSDM, http://fokus.mk/sdsm-proektot-skopje-2014-namesto-80-chineshe-580-milioni-evra/ [qasur më 21 korrik, 2015].

revizion për të shikuar si janë shpenzuar të hollat që kanë qenë të ri-dedikuara nga buxheti shtetëror për Qendrën në projektin "Shkupi 2014". Në periudhën nga viti 2007 deri në vitin 2013 për ndërtimin e përmendoreve dhe përmbajtjeve shoqëruese nga buxheti qendror në llogarinë e Komunës Qendër janë transferuar gjithsej 3.551.068.000,00 denarë (58.023.986,00 EUR) për të cilat nuk ka arsyetim ligjor. Sipas Nenit 3 të Ligjit për përmendore dhe shënime përkujtimore, këto vendime mund t'i miratoj vetëm Kuvendi[49]. Në nëntor 2013, komisioni publikoi raportin e fundit, me të cilin ka arritur konkluzionin që procedurat jo-besnike për prokurime, mungesa e kontrollit të cilësisë dhe parregullsi tjera i ka kushtuar tatimpaguesit së paku 8 milionë EUR. Partia në pushtet VMRO-DPMNE ka kontestuar raportin duke thënë që merr anë të caktuar.[50]

Mungesa e transparencës në proceset e prokurimeve publike paraqet një problem të madh. Sipas raportit nga viti 2014 nga Qendra për Komunikime Qytetare, organizatë qytetare nga Shkupi[51], 30% të marrëveshjeve për Prokurime Publike kanë qenë të firmosura vetëm me një ndërmarrje që ka marrë pjesë në procesin e ankandit publik. Përveç kësaj, institucionet kanë shmangur zbulimin e informatave të rëndësishme në lidhje me ofertat ndonëse e-ankandi është i detyrueshëm në Maqedoni, në 35% të prokurimeve të monitoruara nuk kanë qenë të organizuara këto ankande. Shpesh kanë qenë të anuluar tenderët, ndërsa 328 marrëveshje në shumë prej 22.4 milionë EUR ishin firmosur pa e zhvilluar procesin e tenderit.[52]

Megjithatë, ka edhe zhvillime pozitive. Sipas Grupit Shtete Kundër Korrupsionit (GRE-KO), Maqedonia ka zbatuar 10 nga 13 rekomandimet e GREKO-s nga rrethi fundit i vlerësimeve të përgjigjes maqedonase ndaj korrupsionit, dhe pjesërisht janë zbatuar 3 rekomandimet tjera[53]. Rekomandimet kanë të bëjnë me përmirësimin e kodit penal në lidhje me ndjekjen penale për korrupsion dhe transparencën e financimit të partive politike. Barometri i Transparency International[54] (TI) për korrupsionin global të vitit 2013 tregon që përqindja e personave që kanë pranuar marrje të ryshfetit gjatë 12 muajve para raportit është zvogëluar për 4 përqindje pikë, në 17%, në krahasim me vitin 2010, ndonëse në tërësi raporti udhëzon rritjen me një pikë në perceptimin për korrupsion në vitin 2013.

[49] Dy raporte për gjendjen faktike të realizimit të projektit "Shkupi 2014" dhe përfshirja e Komunës Qendër, të publikuar në http://opstinacentar.gov.mk/ (qasur më 20 korrik 2015)

[50] https://freedomhouse.org/report/nations-transit/2014/macedonia#_ftn69 (qasur më 20 korrik 2015)

[51] Qendra për komunikime qytetare, *Raporti i monitorimit të prokurimeve publike në RM, nr. 24 (Shkup: Qendra për Komunikime Qytetare*, 2015). http://www.ccc.org.mk/images/stories/24m.pdf [qasur më 30 korrik 2015].

[52] Njëlloj

[53] GREKO, *Rreth i tretë i vlerësimeve, raporti i dytë i pasqyrimit për "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë" „Inkriminime" (ETC 173 dhe 191, GPC 2) „Transparencë e financimit të partive" (Strasburg,* GREKO, 2014) http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/round3/GrecoRC3%282014%292_Second_The%20former%20Yugoslav%20Republic%20of%20Macedonia_EN.pdf [qasur më 30 korrik, 2015].

[54] Transparency International, Barometri i Korrupsionit Global, 2013 (Berlin: Transparency International, 2013), http://www. transparency.org/gcb2013/country/?country=macedonia_%28fyr%29 [qasur më 20 korrik, 2015.].

V. AKTIVITETE KUNDËR KORRUPSIONIT

Njoftimi për korrupsionin është ende tabu në realitet. Sipas anketës që publikoi Qendra për Gazetari Hetimore SHKUP Maqedoni, në maj 2015, linjat telefonike për denoncimin e ryshfetit dhe korrupsionin nuk funksionojnë[55]. Njësia kundër korrupsionit në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) ishte reformuar dhe tani ka profil më të lartë "Sektori për Luftë Kundër Korrupsionit" ndonëse ky status është ende i dobët. Nga vetëm 19 pozita të sistematizuara në vende pune, mbetet edhe një e treta që duhet të plotësohet.

Qendra hulumtuese në kuadër të prokurorisë publike për "luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit:, ndonëse e themeluar në vitin 2011, ende nuk është funksionale dhe nuk janë themeluar qendra tjera hulumtuese. Janë plotësuar vetëm rreth 40% prej 45 vendeve të ndara në KSHPK dhe ka kompetenca të kufizuara. Ndonëse Sektori për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale (SKBSP) i MPB-së ka fituar kompetenca të reja në fushën e promovimit të integritetit, ende nuk ka pavarësi.

Në lidhje me veprimtaritë për zbatim të ligjeve, ka 50% zvogëlim të vendimeve për shkelje lidhur me korrupsionin në vitin 2013 (63 në krahasim me 123 në vitin 2012); 56 nga vendimet kanë qenë lidhur me keqpërdorimin e funksionit publik, dhe 3 me ryshfet. Kapaciteti i plotë i gjykatave është i dobët për lëndët me korrupsion, veçanërisht me raste të profilit të lartë, ku procedura është e gjatë dhe joefikase.

Sistemi për kontroll të brendshëm të administratës qendrore dhe lokale edhe më tutje është i dobët, dhe mbetet ende të themelohen mekanizma për denoncim në sektorin publik dhe privat.

Republika e Maqedonisë ka ratifikuar Konventën penale për korrupsion të Këshillit të Evropës (ETS 173) më 28 korrik 1999. Konventa ka hyrë në fuqi më 1 korrik 2002. Protokolli plotësues i Konventës penale (ETS 191) ishte ratifikuar më 14 nëntor 2005. Ky hyri në fuqi më 1 mars 2006. Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit penal ishin miratuar më 10 shtator 2009, me çfarë, mes tjerash, ishte bërë përputhje e dispozitave lidhur me korrupsionin dhe Konventën. Në vitin 2014 ishte ndryshuar Kodi zgjedhor për të zgjidhur mangësitë që ishin sugjeruar nga OSBE/ODHIR në lidhje me financimin e fushatave zgjedhore, dhe ishte ndryshuar Kodi penal me prezantimin e një vepre të re penale – pagesa e paligjshme e mjeteve shtetërore gjatë zgjedhjeve. Ligji për menaxhimin me pronë të sekuestruar është zgjeruar me shtrirje për të përfshirë edhe lëndët e shkelura dhe lëndët drejtuese dhe janë reviduar rregullat për menaxhim me pronë të marrë dhe të sekuestruar.

Ligji për parandalimin e korrupsionit (LPK) dhe Ligji për parandalimin të konfliktit të interesave (LPKI) janë miratuar pak para dhe japin bazë relative stabile për rregullat dhe standardet për integritet. Ato kanë të bëjnë me të gjithë nëpunësit publikë, përfshirë edhe deputetët, gjyktarët dhe prokurorët.

GREKO ka bërë rrethin e katërt të vlerësimit në gjysmën e dytë të vitit 2013 me çfarë ka përfshirë edhe parandalimin e korrupsionit lidhur me deputetët, gjykatësit dhe prokurorët. Ende nuk është ratifikuar Konventa e OECD-së për luftë kundër korrupsionit të nëpunësve

[55] https://freedomhouse.org/report/nations-transit/2014/macedonia#_ftn69 (qasur më 20 korrik 2015.) http://www.transparency. org.mk/en/index.php?option=com_content&task=view&id=498&Itemid=30

të huaj shtetëror në transaksionet ndërkombëtare afariste.

KSHPK-ja është trupi kryesor kundër korrupsionit në Maqedoni dhe ka filluar me punë në nëntor 2002 si trup parandalues kundër korrupsionit. KSHPK ka 7 anëtarë me orar të plotë pune, të emëruar nga Kuvendi dhe dorëzon raport vjetor para Parlamentit. Kryetari i shtetit dhe Qeverisë e publikon për mediet. Sekretariati i KSHPK-së numëron 26 anëtarë që punojnë në administratë. Fokusi kryesor i Komisionit është grumbullimi dhe shqyrtimi i deklaratave për pronë të deklaruar dhe konflikte të interesave. Ligji i përcakton kompetencat e Komisionit ashtu që secili person duhet të sigurojë këto informata.

KSHPK, gjithashtu është përgjegjëse për përgatitjen e strategjisë së kundër korrupsionit, si dhe monitorimin e zbatimit. Strategjia e parë kundër korrupsionit ishte miratuar në vitin 2003 ndërsa e fundit përfshin periudhën prej 2016 deri më 2019. Institucionet shtetërore punojnë bashkë me KSHPK-në për përgatitje të Strategjisë dhe për zbatimin përkatës.

Nuk ka mjaft vetëdije te qytetarët dhe besim për punën e KSHPK-së. KSHPK-ja pranon një numër të vogël të denoncimeve (201 në vitin 2013, 177 në 2012). Ka parashtruar 9 kërkesa te Prokuroria Publike në vitin 2013 për fillim të procedurës penale. Lëndët që KSHPK -ja i drejton në prokurori jo shpesh rezultojnë me procedurë të suksesshme.

Në sektorin joqeveritar dhe disa iniciativa të Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të SHBA-ve (USAID) që filloi në vitin 2013 kanë për qëllim mbështetjen e organizatave qytetare dhe përmirësim të integritetit dhe llogaridhënies së institucioneve shtetërore. Programi përfshin Sistem të Monitorimit të Korrupsionit, që mbledh informata për llojin, nivelin dhe tendencat e korrupsionit, si dhe për platformën e kundër korrupsionit që e përbëjnë 15 organizata qytetare që punojnë kundër korrupsionit, dhe që ka filluar të funksionojnë më 9 dhjetor 2014.[56]

[56] http://www.mcms.org.mk/en/news-and-publicity/news/1604-platforma-za-antikorupcija.html (qasur më 4 gusht 2015.)

VI. SISTEMI KOMBËTAR PËR INTEGRITET

1. LIGJVËNIA

PËRMBLEDHJE

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtutjeshëm: Kuvendi) është formalisht i pavarur, por në të vërtetë, vartësia është kompromet uar. Deputetët mund të respektojnë obligimet për parashtrim të deklaratave për konflikt të interesave dhe për pronë, por prona e tyre dhe interesat nuk përditësohen rregullisht. Nuk ka kod të shkruar të sjelljes që do të sigurojë integritet të deputetëve dhe do të përmbajë praktikat në lidhje me korrupsionin dhe sjelljen jo-etike. Ka të vendosura rregulla për dhurata dhe përfaqësim, por nuk ka mekanizma të brendshëm për mbikëqyrje të këtyre rregullave.

Largimi me forcë i deputetëve dhe medieve nga Kuvendi gjatë debatit për Buxhetin e vitit 2013, më 24 dhjetor 2012, ka ndikuar dukshëm mbi skenën politike dhe mbi punën e Kuvendit. Komisioni anketues ka dhënë rekomandime si të parandalohen incidente tjera të ngjashme. Pas krizës politike të shkaktuar nga zbulimi i përgjimit të paligjshëm nga Qeveria, si dhe nga skandalet e korrupsionit, partitë opozitare refuzuan të marrin pjesë në punën e kuvendit pas zgjedhjeve të vitit 2014 deri më 1 shtator 2015, kur ishte miratuar “Marrëveshja e Përzhinos” mes palëve, që ka mundësuar vazhdimin e punës së Kuvendit.[57]

Në përgjithësi, dispozitat ligjore janë të përshtatshme për kapacitetet dhe menaxhimin e Kuvendit. Megjithatë, në realitet, duhet të përmirësohet transparenca e procesit ligjvënës, veçanërisht në kuptim të pjesëmarrjes publike dhe konsultime. Në pyetje është pavarësia e Kuvendit, duke marrë parasysh perceptimin që Kuvendi nuk e plotëson përgjegjësinë për kontrollon përkatës të Qeverisë/Pushtetit ekzekutiv. Tabela më poshtë i tregon notat sipas treguesit për pushtetit ligjvënës në lidhje me kapacitetin, menaxhimin dhe rolin në Sistemin Kombëtar për Integritet.

NOTA E PËRGJITHSHME PËR SHTYLLËN: **51,3/100**

[57] Përmbajtja e “Marrëveshjes së Përzhinos“ http://www.mkd.mk/makedonija/politika/dui-go-objavi-celosniot-dogovor-na-liderite-od-2-juni [qasur më 4 gusht, 2015].

DIMENSIONI	TREGUESI	E DREJTA	PRAKTIKA
Kapaciteti 62,5/100	Resurset	100	50
	Pavarësia	75	25
Qeverisja 54,1/100	Transparenca	75	50
	Llogaridhënia	75	50
	Integriteti	50	25
Roli 37,5/100	Mbikëqyrja e pushtetit ekzekutiv	25	
	Reforma ligjore	50	

Vlerësimi për shtyllën sipas të drejtës dhe praktikës



Baza e Kuvendit është kornizë stabile ligjore. Ligjet garantojnë resurse përkatëse dhe në mënyrë formale sigurojnë Kuvend të pavarur dhe transparent që i plotëson kërkesat për integritet. Në çdo rast, ka shqetësim që në praktikën e pushtetit ligjvënës seriozisht mungon pavarësia dhe integriteti.

STRUKTURA DHE ORGANIZIMI

Kuvendin e përbëjnë 123 deputetë që zgjidhen për mandat prej 4 viteve sipas një sistemi proporcional. Kuvendi miraton ligje kur është arritur shumicë që është e domosdoshme për miratimin e ligjeve, siç është parashikuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë; miraton amendamente kushtetuese, ligje dhe rezoluta dhe gjithashtu miraton rregulla per-

sonale të brendshme, buxhet shtetëror, ratifikon marrëveshje ndërkombëtare dhe miraton referendume.

Kuvendi e zgjedh Qeverinë, kryetarin dhe tre nënkryetarët e Kuvendit. Gjithashtu, emëron dhe shkarkon bartës të funksioneve publike, siç janë avokati i popullit, prokurori publik, anëtarët e KSHPK-së dhe revizori shtetëror. Funksioni mbikëqyrës i Kuvendit përfshin kompetenca për fillimin e hetimeve kuvendore, votim të besimit të qeverisë ose ministrave dhe parashtrimi të parashtesave për largimin e kryetarit të shtetit para Gjykatës Kushtetuese. Kuvendi ka 21 trupa përhershëm punues dhe katër këshilla: Këshilli Kombëtar për Integrim në BE, Këshilli për Kanalin Kuvendor (Këshilli për mbështetje të TV kanalit të Kuvendit), Këshilli Buxhetor dhe Këshilli për Marrëdhëniet Ndëretnike.

Kuvendi i porsazgjedhur ka marrë mandatin më 10 maj 2014. Kanë munguar 34 deputetë të opozitës sepse ata kanë dorëzuar dorëheqjet e tyre në shenjë proteste ndaj aktiviteteve të partisë në pushtet. Mungesa e deputetëve të opozitës në Kuvend ka penguar punën e tij dhe mundësinë për të siguruar kushte për zhvillimin e debatit dhe kontrollit. Ndonëse kjo, koalicioni i pushtetit mirëmban shumicë të qëndrueshme.

VLERËSIMI

KAPACITETI

1.1.1 RESURSET (E DREJTA)

Nota 100

Deri në çfarë shkallë ekzistojnë dispozita që i mundësojnë pushtetit ligjvënës resurse përkatëse financiare, njerëzore dhe të infrastrukturës për të kryer në mënyrë efektive kompetencat?

Ligji për Kuvend[58] dhe Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë[59] i rregullojnë resurset – njerëzore, infrastrukturore dhe financiare – që janë të nevojshme për punën e Kuvendit, përfshirë edhe përcaktimin e procedurave për kalkulim dhe shpërndarje të resurseve. Këshilli Buxhetor (KB) i Kuvendit propozon programe që do të përfshihen në Buxhetin Shtetëror për vitin e ardhshëm[60] dhe jep drejtime për përgatitjen e buxhetit të Kuvendit. KB-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave (MF), i propozojnë Qeverisë sa mjete do të jenë të nevojshme për Kuvendin për tre vitet e ardhshme, të ndjek shpenzimet e Kuvendit në kuadër të buxhetit shtetëror dhe propozon ri-shpërndarje të mjeteve të aprovuara me buxhetin shtetërorë.[61] Sekretari i Përgjithshëm[62] të cilin e zgjedh Kuvendi është përgjegjës për nëpunës shtetërorë[63] që japin shërbime profesionale, administrative, teknike dhe tjera për deputetët.[64] Kuvendi siguron resurse për shërbimet e e-parlamentit[65] dhe për bibliotekën[66].

58 Gazeta Zyrtare E RM-së, nr. 104/2009.
59 Rregullore e Kuvendit të RM-së, Gazeta Zyrtare E RM-së, nr. 91/2008, 119/2010.
60 Ligji për Kuvendin e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 104/2009, neni 27.
61 Ligji për Kuvendin e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 104/2009, neni 27.
62 Ligji për Kuvendin e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 104/2009, neni 41.
63 Ligji për Nëpunës Shtetërorë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 59/2000, 112/2000, 34/2001, 103/2001, 43/2002, 98/2002, 17/2003, 40/2003, 85/2003, 17/2004, 69/2004, 81/2005, 61/2006, 36/2007, 161/2008, 6/2009, 114/2009, 35/10, 167/10,36/11, 6/12, 24/12, 15/13, 82/13, 106/2013), neni 3.
64 Ligji për Kuvendin e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 104/09, neni 9.
65 Ligji për Kuvendin e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 104/09, neni 42, paragrafi 9.
66 Ligji për Kuvendin e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 104/09, neni 42, paragrafi 10.

Deputetët kanë të drejtë të kërkojnë dhe të marrin informata nga sekretari i përgjithshëm për çështje të rëndësishme për kryerjen e funksionit të tyre dhe kërkojnë të marrin informata dhe ndihmë profesionale për çështje lidhur me punën e Kuvendit.[67]

1.1.2 RESURSET (PRAKTIKA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle pushteti ligjvënës ka resurse përkatëse për kryerjen e detyrave në praktikë?

Mbështetje profesionale për deputetët sigurohet nga donatorë të jashtëm. Në vitin 2014, numri të punësuarve në Kuvend është rritur nga 389 në 415[68]. Ndonëse rrogat e deputetëve jepen vazhdimisht, ka denoncime për vonesë të pagesave për shpenzime rruge deri më 7 muaj.[69]

Kuvendi nuk ka buxhet të pavarur, dhe në praktikë, vendimi përfundimtar për shumën e buxhetit të Kuvendit e merr ministri i Financave.[70] Përvojat tregojnë që nëse Kuvendi kërkon mjete plotësuese do të ndeshet me rezistencën e Qeverisë.

Instituti Parlamentar është themeluar me ndihmën e donatorëve të jashtëm të Institutit Kombëtar Demokratik për Punë Ndërkombëtare (NDI) [71]. Ai siguron hulumtime të pavarura dhe analizë si mbështetje për Kuvendin[72], si dhe trajnim dhe mbështetje të deputetëve të rinj[73]. Në periudhën prej qershorit 2011 deri në mars 2014[74] ishin zhvilluar më tepër se 130 trajnime, seminare, punëtori, konferenca dhe vizita studimore për zhvillimin profesional të nëpunësve nga Kuvendi.

1.1.3 PAVARËSIA (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle pushteti ligjvënës, sipas ligjit, është i pavarur dhe i lirë nga ndikimi i aktorëve të jashtëm?

Sipas Kushtetutës, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë është i pavarur dhe nuk u nënshtrohet aktorëve të jashtëm. Organizimi dhe funksionimi i Kuvendit janë të rregulluara me Kushtetutën dhe Rregulloren[75], ndërsa mandati i deputetit nuk mund të merret mbrapa.

Kuvendi mund të shpërbëhet kur më tepër se gjysma e numrit të plotë të deputetëve votojnë për shpërbërjen[76]. Në këtë rast, zgjedhjet zhvillohen në afat prej 60 ditëve nga shpërbërja e Kuvendit. Asnjë organ tjetër nuk mund të shpërbëjë Kuvendin.

67 Rregullore e Kuvendit të RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 91/2008, 119/2010, 130/2010, 23/2013
68 Buxheti i Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 180/2013, f. 15.
69 Intervistë me Marjanço Nikollovin, ish deputet në periudhën e mandatit prej 2008-2011 dhe 2011-2014. Kryetar i Komisionit për Financa dhe Buxhet dhe zëvendës-kryetar i Këshillit Buxhetor në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë (interviste ballë për ballë), më 22 tetor 2014.
70 Intervistë me Marjanço Nikollovin (interviste ballë për ballë), më 22 tetor 2014.
71 Deri më 24 qershor 2011, NDI a zbatuar projektin në partneritet me Institutin për Demokraci Parlamentare (IDP).
72 Kuvendi i RM-së, *Raporti për punën e Kuvendit në mandatin e shtatë parlamentar, 25 qershor 2011 – 5 mars 2014* (Shkup, Kuvendi i RM-së, 2014) f. 183.
73 Komisioni Evropian 2014., f. 7 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-the-former-yugoslav-republic- of-macedonia-progress-report_en.pdf [qasur më 8 tetor 2014].
74 Kuvendi i RM-së, 2014, f. 167-175.
75 Kushtetuta e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/1992, neni 61.
76 Kushtetuta e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/1992, neni 63.

Në fillim të çdo njësie kuvendore, Kryetari i Kuvendit propozon, ndërsa Kuvendi voton rendin e ditës të Kuvendit[77]. Në rast të çështjeve urgjente dhe që nuk mund të shtyhen, deputeti ose Qeveria mund të propozojë pikë të rendit të ditës dhe të shtyjë ose të tërheqë më tepër pika[78] pasi që të mblidhet seanca.[79]

Kuvendi zgjedh Kryetarin dhe një ose më tepër nënkryetarë nga rendi i deputetëve me shumicë votash nga numri i plotë i deputetëve[80]. Trupat punues zgjidhën nga rendi i deputetëve dhe përbëhen së paku nga pesë deputetë që u takojnë një ose më tepër partive politike.[81]

Policia nuk ka të drejtë për qasje në lokalet e Kuvendit pa aprovim paraprak nga Kryetari i Kuvendit.[82]

Deputetët kanë imunitet[83]. Ata nuk mund të akuzohen për vepër të kryer penale ose të paraburgosen për qëndrime që kanë shprehur në Kuvend ose për mënyrën që kanë votuar në Kuvend. Kuvendi vendos nëse ndonjë deputeti të caktuar do t'i merret imuniteti, në bazë të denoncimit të Komisionit për Çështje të Rregullores Mandatit dhe Imunitetit[84]. Deputeti nuk mund të merret në paraburgim pa aprovim të Kuvendit, përveç nëse ka kryer vepër penale për të cilën është parashikuar dënim me burg prej më së paku pesë vite. Kuvendi mund të vendosë për tërheqjen e imunitetit të deputeti pa kërkesën e tij/saj, nëse ajo është e nevojshme për kryerjen e funksionit të deputetit. Deputetë nuk mund të bëjnë funksione të dyfishtë në vende tjera publike ose profesionale.[85]

1.1.4 PAVARËSIA (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle pushteti ligjvënës, në praktikë, është i pavarur dhe i lirë nga ndikimi i aktorëve të jashtëm?

Pavarësia e deputetëve është rrezikuar nga sistemi zgjedhor në Maqedoni, që ju jep liderëve partiakë rolin kryesor në zgjedhjen e deputetëve. Deputetët janë në situatë të pakëndshme dhe janë bindës para politikës qeveritare[86]. Qeveria propozon numrin më të madh të ligjeve për të cilat vendos Kuvendi, ndërsa deputetët shpeshherë propozojnë amendamente për ligjet[87]. Sipas internet faqes së Kuvendit, në periudhën prej 1 tetor deri më 31 dhjetor 2013, në seanca qeveritare janë përcaktuar 49 (56% prej 88) propozim ligje[88]. Prej 2011 deri 2014, janë miratuar 907 ligje, prej të cilave Qeveria ka propozuar 888 (98%), ndërsa deputetët kanë propozuar 19 (2%)[89]. Nuk ka shembuj të Kuvendit që ka miratiuar Propozim-ligj në kundërshtim me vullnetin e pushtetit ekzekutiv.

---

77 Rregullore e Kuvendit të RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 91/2008, 119/2010, 130/2010, 23/2013, neni 69.
78 Rregullore e Kuvendit të RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 119/2010, neni 70.
79 Rregullore e Kuvendit të RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 91/2008, 119/2010, 130/2010, 23/2013, neni 77.
80 Ligji për Kuvendin e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 104/2009, neni 17
81 Ligji për Kuvendin e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 104/2009, neni 12.
82 Ligji për Kuvendin e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 104/2009, neni 43.
83 Kushtetuta e RM-së, neni 17, Ligji për Kuvendin e RM-së, nene 53-54, Rregullore e Kuvendit të RM-së, neni 64.
84 Rregullore e Kuvendit të RM-së, Gazeta Zyrtare E RM-së, nr. 91/2008, 119/2010, 130/2010, 23/2013, neni 54.
85 Ligji për Kuvendin të RM-së, Gazeta Zyrtare E RM-së, nr. 104/2009, neni 7.
86 Intervistë me Marjanço Nikollovin (interviste ballë për ballë), më 22 tetor 2014.
87 Intervistë me dr. Voisllav Stojanovskin, këshilltar juridik, Komiteti i Helsinkut për të Drejta të Njeriut në RM (interviste ballë për ballë), më 10 tetor 2014.
88 Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, *Pasqyra e pushtetit, monitorimi i transparencës së procesit të përgatitjes së ligjeve, raport tremujor nr. 1 për periudhën 1 tetor – 31 tetor (Shkup,* Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, 2013.)
89 Kuvendi i RM-së, 2014, f. 38.

Të enjten e fundit të çdo muaji, deputetët kanë të drejtë t'i parashtrojnë pyetje kryetarit të shtetit ose çdo anëtari të Qeverisë ose pyetje për funksionarët publikë lidhur me punën e tyre[90]. Në praktikë, deputetët çdo muaj u parashtrojnë pyetje ministrave qeveritarë. Pyetjet që janë kryesore për punën e pushtetit ekzekutiv nuk marrin përgjigje përkatëse.[91]

Qeveria përzihet në punën e Kuvendit. Një shembull i dukshëm për atë ndodhi më 24 dhjetor 2012, gjatë debatit parlamentar për buxhetin e vitit 2013. Para fillimit të seancës, deputetët e opozitës ishin të larguar me dhunë nga Kuvendi për shkak të kritikave të tyre për shumën e buxhetit dhe për procedurën e miratimit. Nuk ishte e qartë nëse njësitë speciale të policisë ose sigurimi i Kuvendit ishin përgjegjës për largimin e dhunshëm të deputetëve[92]. Të gjitha mediet ishin larguar nga Kuvendi, ndërsa deputetët e miratuan Propozim-buxhetin për vitin 2013 pa pjesëmarrjen e deputeteve të opozitës. Komisioni Anketues ad-hok i përbërë nga parti të ndryshme që ishte formuar nga Kryetari i Kuvendit, ka shqyrtuar incidentin dhe ka dorëzuar raport më 26 gusht 2013, duke theksuar që Kuvendi nuk ka kapacitete të mjaftueshme për tu përballur me konteste dhe të japë rekomandime[93]. Grupi punues ishte aktiv deri në tetor 2013, kur anëtarët e Lidhjes Social Demokrate (LSDM) kanë braktisur grupin në protestë për shkak të arrestimit të kryetarit të Këshillit Komunal të Komunës Qendër. Si rezultat i kësaj, grupi punues nuk arriti të mbarojë punën e rekomandimeve të Komisionit, posaçërisht të ndryshimeve të Rregullores së Kuvendit[94].

QEVERISJA

1.2.1 TRANSPARENCA (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle ka dispozita të cilat mundësojnë që publiku të arrijë në informata relevante dhe me kohë për punën dhe procesin e vendimmarrjes së pushtetit ligjvënës?

Ligji parashikon që Kuvendi dhe trupat punues të sigurojnë informata për punën e tyre para se të hapen seancat kuvendore për publikun.[95] Megjithatë, Kuvendi mund të përjashtojë publikun me shumicë të dy të tretave të shumicës së votave të deputetëve[96]. Qytetarët dhe mediet gjithashtu mund të jenë të pranishme në seancat e trupave punues së Kuvendit[97]. Kuvendi siguron informata para organizatave ndërkombëtare për punën, përfshirë edhe punën e trupave punues dhe delegacioneve të përhershme[98]. Nuk ka kufizime ligjore për gazetarët që njoftojnë për Kuvendin dhe për deputetët. Aktet, debatet, diskutimet, shkresat zyrtare dhe raportet e Kuvendit për punën e trupave punues duhet të jenë në dispozicion të medieve, përveç nëse Kuvendi ose trupi ipunues vendosin që të punojnë pa praninë e publikut[99]. Kuvendi dhe trupat punues mund të publikojnë njoftim për mediet për atë ku janë zhvilluar seancat e mbyllura.

---

90 Rregullore e Kuvendit të RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 91/2008, 119/2010, 130/2010, 23/2013, neni 37.
91 Intervistë me Marjanço Nikollov (interviste ballë për ballë), më 22 tetor 2014.
92 Komiteti i Helsinkut për të Drejta të Njeriut, *Raport special për seancën 49 të Kuvendit të RM, e mbajtur më 24 dhjetor 2012 – Ndodhitë para dhe në Kuvend (Shkup:* Komiteti i Helsinkut për të Drejta të Njeriut, 2013) f.14.
93 http://sdsm.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=5&articleId=8530 (qasur më 12 nëntor 2014.)
94 Komisioni Evropian 2013., f. 7 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-the-former-yugoslav-republic- of-macedonia-progress-report_en.pdf [qasur më 14 tetor 2014].
95 Rregullore e Kuvendit të RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 91/2008, 119/2010, 130/2010, 23/2013, neni 2.
96 Kushtetuta e RM, Gazeta Zyrtare e RM, nr. 52/1992, neni 70 dhe Rregullore e Kuvendit të RM, Gazeta Zyrtare e RM, nr. 91/2008, 119/2010, 130/2010, 23/2013, neni 2.
97 Rregullore e Kuvendit të RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 91/2008, 119/2010, 130/2010, 23/2013, neni 226-227.
98 Rregullore e Kuvendit të RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 91/2008, 119/2010, 130/2010, 23/2013, neni 225.
99 Rregullore e Kuvendit të RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 91/2008, 119/2010, 130/2010, 23/2013, neni 228.

Kuvendi e drejton TV-kanalin[100] e Kuvendit i dedikuar për informim dhe edukim të qytetarëve për jetën politike. Kuvendi, sipas ligjit, duhet të ketë internet faqe me informata për strukturën organizative dhe për punën e Kuvendit dhe trupa punës në përbërje[101]. Kuvendi duhet të publikojë buletinin për punë dhe procesverbal dhe shënime nga seancat[102]. Megjithatë, nuk ekziston kërkesë ligjore për publikimin e propozim-ligjeve për të cilat diskutohet në Kuvend. Kuvendi mund të vendosë të bëjë këtë nëse kjo është pjesë e interesit të posaçëm publik.[103]

Regjistrimi i votimit mund të jetë publik, me përdorimin e pajisjeve teknologjike ose me ngritjen e dorës[104], përveç kur zhvillohet votim i fshehtë dhe kryetari i Kuvendit i publikon rezultatet dhe publikon nëse ndonjë propozim është miratuar ose refuzuar.[105]

Çdo të premte, Kuvendi ndan hapësirë që deputetët të mund të zhvillojnë takime me elektoratin.[106]

Deputetët janë të obligohen të paraqesin pronën e tyre në KSHPK dhe në Drejtorinë për të Hyra Publike (DHP). Në KSHPK dhe në DHP duhet të paraqiten ndryshimet në pronë të deputetëve ose anëtarit të familjes[107]. Nëse nuk jepen të dhënat ose nuk paraqiten ndryshime ose jepen të dhëna të pasakta ose atje ku ka rritje joproporcionale të pronës, mund të rezultojë me nisje të procedurës për shqyrtimin e pronës së një deputeti.

1.2.2 TRANSPARENCA (PRAKTIKA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle publiku, në praktikë mund të arrijë te informatat relevante dhe në kohë për punën dhe procesin e vendimmarrjes së pushtetit ligjvënës?

Kuvendi punon në mënyrë transparente. Seancat plenare dhe mbledhjet e komisioneve emetohen në TV kanalin e Kuvendit, edhe pse sipas disa bashkëbiseduesve kjo bëhet në terminët e natës kur qytetarët nuk mund t'i shohin.[108]

Internet faqja e Kuvendit rregullisht përditësohet me raporte nga Kuvendi, duke përfshirë orarin javor të seancave, takimeve dhe debateve.[109] Propozim-rendi i ditës për seancat e Kuvendit shpallet me kohë në internet faqen[110] ku me kohë shpallen edhe propozim-ligjet.[111] Kuvendi, gjithashtu shpall informata edhe nëpërmjet Fejsbukut[112], Tviterit[113] dhe Jutjubit.[114] Në praktikë, seancat ligjvënëse zakonisht janë të hapura për publikun dhe për qytetarët[115] nuk kanë qasje të lirë në ndërtesën e Kuvendit.[116]

Anketa për punën e Kuvendit e zhvilluar nga Instituti për Demokraci "Societas Civilis" –

---

100 Ligji për kuvendin e RM, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 104/2009, Kapitulli IX: TV kanali i Kuvendit, neni 32-35
101 Rregullore e Kuvendit të RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 91/2008, 119/2010, 130/2010, 23/2013, neni 233.
102 Rregullore e Kuvendit të RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 91/2008, 119/2010, 130/2010, 23/2013, neni 107, artikulli 4.
103 Rregullore e Kuvendit të RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 91/2008, 119/2010, 130/2010, 23/2013, neni 230.
104 Rregullore e Kuvendit të RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 91/2008, 119/2010, 130/2010, 23/2013, neni 96.-së
105 Rregullore e Kuvendit të RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 91/2008, 119/2010, 130/2010, 23/2013, neni 103.
106 Ligji për Kuvendin e RM-së, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 104/2009, neni 36.
107 Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, neni 34.
108 Deklaratë nga pjesëmarrës në Punëtorinë për verifikim, të mbajtur më 7.4.2016.
109 http://www.sobranie.mk/pocetna.nspx [qasur më 22 tetor 2014].
110 http://www.sobranie.mk/dneven-informator.nspx [qasur më 22 tetor 2014].
111 http://www.sobranie.mk/materijali.nspx [qasur më 22 tetor 2014]
112 https://www.facebook.com/SobranieRM?fref=ts (qasur më 11 tetor 2014)
113 https://twitter.com/SobranieMK (qasur më 11 nëntor 2014)
114 https://www.youtube.com/channel/UCD5qpVe9-yNv4Xu4b3EuKFw (qasur më 11 nëntor 2014)
115 Intervistë me Voisllav Stojanovskin (Interviste ballë për ballë), Shkup, 20 nëntor 2014.
116 Deklaratë nga pjesëmarrës në Punëtorinë për verifikim, të mbajtur më 7.4.2016.

Shkup (IDSCS), në periudhën prej 15 maj deri më 15 qershor të vitit 2014[117] tregon se 54,7% e të anketuarve besojnë se miratuesit e ligjeve nuk i njoftojnë qytetarët sa duhet për punën e tyre, kurse gjysma e të anketuarve (48,9%) mendojnë se deputeti nga njësia e tyre nuk është në dispozicion për takimet me qytetarët.[118]

Largimi i deputetëve me dhunë gjatë debatit për buxhetin e vitit 2013, që ndodhi më 24 dhjetor të vitit 2012, shënoi ndryshimin në marrëdhëniet në Kuvend me mediet dhe me publikun. Lënda e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) u hodh poshtë nga Gjykata kushtetuese, me pohime se largimi i deputetëve me dhunë nga Kuvendi është shkelje e lirisë së tyre të shprehjes. Gjykata ka vendosur se gazetarët janë ftuar të largohen nga galeria për shkak të sigurisë së tyre dhe që të mbahet rendi në Kuvend. SHGM e referoi lëndën te Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut.

1.2.3 LLOGARIDHËNIE (E DREJTA)

Nota **75**

Deri në çfarë shkalle ka dispozita që sigurojnë se pushteti ligjvënës duhet të dorëzojë raporte dhe të jetë i përgjegjshëm për veprimet e veta? A ka dispozita për konsultime me publikun për çështje relevante?

Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese kontrollon punën ligjvënëse të Kuvendit dhe Kryetari ka autorizim për të mos nënshkruar ligj.[119] Deputetët kanë imunitet dhe nuk mund të ndiqen penalisht për votimin dhe qëndrimet e tyre që i shfaqin në Kuvend.[120] Kuvendi nuk është i detyruar të këshillohet me publikun në procesin e marrjes së vendimeve të veta. Kuvendi mundet, por nuk është i detyruar që të organizojë këshillime publike për propozim-ligje. Pas debatit të përgjithshëm, mund të vendosë të autorizojë organ pune që të organizojë dhe caktojë debat publik për propozim-ligj që ka interes më të gjerë publik.[121] Vendimi duhet të shpallet edhe në gazetë ditore. Kuvendi mund të thërrasë ekspertë që do të kontribuojnë në debat dhe secili grup parlamentar mund të caktojë bashkëpunëtorë të jashtëm.[122] Organi i punës dorëzon raport te Kuvendi së bashku me propozim-ligjin për lexim të dytë.[123]

Gjykata Kushtetuese ka të drejtë të revokojë ose shfuqizojë ligj nëse konsideron se ligji nuk është në përputhje me Kushtetutën.[124] Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të zbatueshme.[125]

Deputetët kanë të drejtë dhe obligim që të informojnë votuesit për punën e Kuvendit.[126] Secili person ose subjekt juridik mund tu dorëzojë peticion ose propozim organeve shtetërore, përfshirë edhe Kuvendin[127] dhe ka të drejtë që të marrë përgjigje në afat prej 30 ditësh.[128]

[117] Projekt i financuar nga BE-ja "Kuvendi nën llupë, përforcimi i debatit politik dhe diskursit diskutues" zhvilloi anketë kombëtare mbi perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit. Anketa u zhvillua drejtpërdrejt me 1.000 të anketuar, duke marr parasysh gjininë, moshën, përkatësinë etnike, tiparet arsimore dhe gjeografike të popullatës.
[118] http://www.idscs.org.mk/en/running-projects/parliament-watch/519-national-survey-on-the-work-of-the-parliament-2014 [qasur më 21 tetor 2014].
[119] Kushtetuta e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/1992, neni 75.
[120] Kushtetuta e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/1992, neni 64.
[121] Rregullore e Kuvendit të RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 91/2008, 119/2010, 130/2010, 23/2013, neni 147.
[122] Rregullore e Kuvendit të RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 91/2008, 119/2010, 130/2010, 23/2013, neni 145.
[123] Rregullore e Kuvendit të RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 91/2008, 119/2010, 130/2010, 23/2013, neni 148.
[124] Kushtetuta e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/1992, neni 112.
[125] Kushtetuta e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/1992, neni 112.
[126] Ligji për deputetë, Gazeta zyrtare e RM, nr. 84/05, 161/2008, 51/11, 109/2014, neni 20.
[127] Ligjin për veprim sipas propozimeve dhe parashtresave, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/2008, 13/2013, neni 1 dhe neni 3.
[128] Ligjin për veprim sipas propozimeve dhe parashtresave, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/2008, 13/2013, neni 9.

1.2.4 LLOGARIDHËNIA (PRAKTIKA)

Nota **50**

Në çfarë shkallë, në praktikë, pushteti ligjvënës dhe anëtarët e tij dorëzojnë raporte dhe japin llogari mbi punën e tyre?

Në praktikë, Kuvendi dhe anëtarët e tij nuk raportojnë në mënyrë efikase për punën e tyre. Në debatet e Kuvendit shpesh mungon përmbajtja dhe përgjigjet zyrtare të parashtresave dhe kërkesave nuk janë efektive.

Refuzimi nga deputetët e opozitës pas zgjedhjeve të vitit 2014 që të marrin pjesë në seancat e Kuvendit si shenjë proteste kundër pushtetit akoma më shumë çrregulluan natyrën përfshirëse të punës së Kuvendit,[129] por edhe pas kthimit të tyre në Kuvend në shtator të vitit 2015, seancat e Kuvendit nuk janë dalluar me ndërveprimin e deputetëve dhe nuk ka shkëmbim të argumenteve dhe mendimeve për propozimet ligjvënëse.[130]

Organet e punës mund të organizojnë debate dhe diskutime për propozim-ligjet, por ato nuk janë efektive në tërësi. Komisioni i Vazhdueshëm Anketues për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut ka mbajtur vetëm një takim në periudhën mes vitit 2012 dhe vitit 2014.

Qytetarët mund të kërkojnë takime me deputetët nga njësia zgjedhore që të ankohen ose të ngrejnë çështje të caktuara. Megjithatë, takimet shpesh mbahen në lokale për partitë politike dhe pjesë e madhe e partive nuk kanë lokale të veta për takime me elektoratin.[131] Qytetarët gati se aspak nuk kanë mundësi të takohen me Kryetarin e Kuvendit.[132] Por nuk ka shumë besim se politikanët do të angazhohen për problemet e qytetarëve.[133]

Imuniteti i deputetëve nuk domethënë se ka privilegje për ta, por u jep mjaftë hapësirë dhe liri të votojnë dhe të flasin pa frikë në Kuvend.[134] Në periudhën ndërmjet vitit 2004 dhe 2014, Kuvendi ka revokuar imunitetin parlamentar në katër raste.[135]

Ekziston perceptimi se është dobësuar roli i Gjykatës Kushtetuese si kontrolli Kuvendit. Në vitin 2014 kishte më pak revizione fuqiplota para Gjykatës, krahasuar me vitin 2013, kurse Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë numër më të vogël të dispozitave ligjore dhe ligjeve.[136]

1.2.5 MEKANIZMAT PËR INTEGRITET (E DREJTA)

Nota **50**

Në çfarë shkallë ka mekanizma që sigurojnë integritetin e anëtarëve të pushtetit ligjvënës?

[129] Komisioni Evropian 2014, f. 6.
[130] Instituti për demokraci “Societas Civilis” – Shkup (IDSCS), Raport nga ndjekja e cilësisë së debateve në Kuvend “Kuvendi nën llupë, përforcim i debatit politik dhe diskursit diskutues” qershor-korrik 2014 (Shkup: IDSCS, 2014). IDSCS dhe Instituti për Evropën qendrore, lindore dhe Ballkan (IECOB), duke nisur prej qershor të vitit 2014 ndjekin cilësinë e debateve në parlamentin maqedonas. Gjetjet kryesore nga raporti i parë i ndjekjes së cilësisë së debateve në Maqedoni është që në periudhën e ndjekjes prej 19 qershor deri më 3 gusht të vitit 2014, ku u mbajtën 20 seanca të Kuvendit, fjalimet e deputetëve kryesisht ishin të përkrahura me argumente.
[131] Intervistë me Marjanço Nikollovin (Interviste ballë për ballë), Shkup, më 22 tetor 2014.
[132] Deklaratë e pjesëmarrësve nga Punëtoria për verifikim e mbajtur me 7.4.2016.
[133] Intervistë me Marjanço Nikollovin (Interviste ballë për ballë), Shkup, më 22 tetor 2014.
[134] Intervistë në gazetën ditore “Nova Makedonija” me Osman Kadriun, profesor i drejtësisë, Shkup 10 korrik 2010, në dispozicion në: http://novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=71010856167&id=9&prilog=0&setIzdanie=22030.
[135] http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=71010856167&id=9&setIzdanie=22030 [qasur më 11 nëntor 2014].
[136] Intervistë me Voisllav Stojanovskin (Interviste ballë për ballë), Shkup, 20 nëntor 2014.

Ka numër të madh të dispozitave ligjore që sigurojnë integritetin e deputetëve. Por nuk ka kodeks universal për sjelljen e deputetëve[137] dhe nuk ka organ të pavarur përgjegjës për etikën e deputeteve dhe Kuvendit.

Ka kufizime sa i përket pranimit të dhuratave nga deputetët.[138] Si nëpunës, ata mund të pranojnë dhurata që mbeten në pronësi të shtetit dhe mund të pranojnë dhurata personale në vlerë deri më 200 EUR, me kusht që personi që e jep dhuratën të vijë nga shtet tjetër, organ, institucion ose organizatë ndërkombëtare dhe dhuratat të jenë suvenir ose ndonjë lloj i solidaritetit ose bashkëpunimit. [139]

Pozita e deputetit nuk është e pajtueshme me pozita ose profesione tjera.[140] Kur do t'u përfundojë mandati, deputetët dhe personat e tjerë zyrtarë janë lëndë e kufizimeve të marrëdhënieve të punës që i parandalon të punësohen në tre vitet e ardhshme në institucione ku kanë kryer mbikëqyrje ose kanë pasur marrëdhënie kontraktuese derisa ka zgjatur mandati i tyre.[141]

Ka Ligj për lobim, por përgjegjësia për zbulimin e marrëveshjeve dhe përmbajtjes së takimeve ndërmjet zyrtarëve dhe lobistëve u bie lobistëve dhe jo deputetëve ose nëpunësve tjerë. [142] Zyrtarisht, ka vetëm një obligim për regjistrin e lobistëve që duhet ta ruajë sekretari i përgjithshëm i Kuvendit.[143]

Deputetët kanë detyrim të paraqesin pronën e tyre në afat prej 30 ditësh pas nisjes së mandatit të tyre. Formulari për gjendjen e pronës kërkon regjistrim detajor të pronës së patundshme të deputetit, pronës së tundshme me vlerë më të madhe, letra me vlerë, huazimet dhe borxhet, si dhe prona tjetër që është në pronësi të tij ose në pronësi të familjes së tij.[144] Të dhënat që gjenden në deklaratat janë informata publike përveç informatave që janë të mbrojtura me ligj.[145] Prej vitit 2012, funksionarët duhet të dorëzojnë edhe "Deklarata për interesa". KSHPK-ja ka të drejtë të shpallë deklaratat për pronën dhe të nis procedura për përcaktimin e gjobave për funksionarët që nuk kanë dorëzuar deklarata për pronën ose deklarata për interesat.[146]

1.2.6 MEKANIZMAT PËR INTEGRITET (PRAKTIKA)

Nota 25

Në çfarë shkallë në praktikë sigurohet integriteti i ligjvënësve?

Integriteti i ligjvënësve nuk sigurohet në masë të mjaftueshme në praktikë. Kuvendi ende nuk ka miratuar Kodeks të sjelljes edhe pse miratimi i tij ishte kusht për "Marrëveshjen e marsit"[147] ndërmjet partive, e cila u nënshkrua pas miratimit të raportit të Komisionit An-

[137] GREKO, Rrethi i katërti vlerësimeve për parandalim të korrupsionit lidhur me deputetët, gjykatësit dhe prokurorët, Raport prej vlerësimit "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" GREKO, Strasburg, 2014, f. 9.
[138] Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 70/2007 dhe teksti i pastruar Gazeta Zyrtare 28/99, neni 15 dhe 16.
[139] Ligji për përdorimin dhe drejtimin me pronë të përdorur dhe drejtuar nga organet shtetërore, Gazeta zyrtare e RM -së nr. 98/2008, 145/2010, 104/2013, neni 77.
[140] Ligji për Kuvendin e RM-së, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 104/2009, neni 7, artikulli 2.
[141] Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 70/2007, 128/99, neni 17, artikulli 1.
[142] Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 106/08 dhe 135/11.
[143] GREKO, 2014, f. 15.
[144] Ligji për Kuvendin e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 104/2009, neni 15e
[145] Ligji për Kuvendin e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 104/2009, neni 16.
[146] Ligji për parandalim të korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, neni 36.
[147] Marrëveshja pas ngjarjeve të 24 dhjetorit.

ketues për ngjarjet e ndërlidhura me krizën në Kuvend gjatë debatit për buxhetin e vitit 2013 më 24 dhjetor të vitit 2012. Kryetari i Kuvendit ka deklaruar se do të angazhohet për miratimin e Kodeksit,[148] por ai ende nuk është miratuar.

Deputetët nuk i respektojnë dispozitat që gjenden në Rregulloren e Kuvendit, të cilat janë të ndërlidhura me sjelljen gjatë seancave të Kuvendit. Për shembull, deputetët flasin dhe veprojnë për punë për të cilat vet do të zgjedhin, pa marr parasysh temën e seancës së Kuvendit dhe nuk i respektojnë rregullat për komunikacion në Kuvend.[149] Anketa që e zhvilloi IDSCS tregon që 52,6% e të anketuarve besojnë se ligjvënësit në situata të caktuara përdorin gjuhë të papërshtatshme në diskutime.

Organizatat e sektorit qytetar kritikojnë Ligjin për lobim pasi që i kufizon aktivitetet e tyre dhe përpjekjet për ndikim mbi vendimmarrje. Ligji nuk është efektiv. Është miratuar në gusht të vitit 2008, por krahas kësaj, madje edhe pas shtatë vitesh punë ka vetëm një lobist të regjistruar. Sipas GREKO, duhet të ketë më shumë transparencë në kontaktin mes deputetëve dhe lobistëve dhe palëve tjera të treta mbi propozimet ekzistuese ligjvënëse jashtë seancave të Kuvendit dhe organeve të tij të punës. GREKO rekomandon themelimin e rregullave se si deputetët të kontaktojnë me lobistët dhe palët tjera të treta që kërkojnë të ndikojmë mbi procesin ligjvënës[150].

KSHPK-ja ka verifikuar Deklaratat për interes të të gjithë 123 deputetëve. Në katër raste në vitin 2012 kishte konflikt të interesave, ku kishte kryerje të funksioneve që nuk i përgjigjen mandatit të deputetit. Në tre prej këtyre rasteve, deputeti ka hequr dorë nga funksionet e papërshtatshme. Në rastin e katërt, deputeti kishte paralajmërim nga KSHPK-ja pasi që nuk ka pushuar me veprimtarinë e tij mësimdhënëse. Më vonë, dekani i institucionit ku personi ka ligjëruar nuk ia ka vazhduar kontratën për vitin e ardhshëm[151]. Në çdo rast, kur KSHPK-ja do të nis procedurë për kundërvajtje për mosdorëzim të deklaratave për pronë ose deklaratave për interesa, zbatimi i pamjaftueshëm i dënimeve nga gjykatat e ç'vlerëson punën e Komisionit dhe nuk mund të pengojë funksionarët që i keqpërdorin rregullat.[152]

Nuk ka regjistër përkatës për dhurata dhe përfaqësimet që i pranojnë deputetët dhe nuk ka udhëzime për deputetët për dhënie ose pranim të dhuratave.[153]

ROLI

1.3.1 MBIKËQYRJA EKZEKUTIVE

Nota **25**

Në çfarë shkalle pushteti ligjvënës kryen mbikëqyrje efektive mbi pushtetin ekzekutiv?

Mungesa e pavarësisë së Kuvendit dhe mungesa e integritetit e kompromenton rolin e tij për kryerjen e mbikëqyrjes efektive të pushtetit ekzekutiv. Deputetët janë zgjedhur sipas listave të partive pas liderëve të partive politike, dhe ajo ndihmon në mungesën e vullnetit nga ana e tyre të kontrollojnë pushtetin ekzekutiv nga e cila varet shumica e deputeteve dhe vendet e tyre.[154]

[148] http://www.independent.mk/articles/9500/Assembly+MPs+Code+of+Ethics+Has+Not+Been+Brought+Up+Yet (qasur më 11 nëntor 2014)
[149] Intervistë me Voisllav Stojanovskin (Interviste ballë për ballë), Shkup, 20 tetor 2014
[150] GREKO, 2014, f. 56.
[151] GREKO, 2014, f. 17.
[152] Komisioni Evropian 2014., f. 43.
[153] Enti Shtetëror i Revizionit, 2012, f. 5.
[154] Intervistë me Marjanço Nikollovin (Bisedë private mes dy personave), më 22 tetor 2014.

Kushtetuta përcakton që Qeveria dhe çdo anëtar i saj janë përgjegjës para Kuvendit[155]. Sipas rregullës, ajo bëhet me anë të mekanizmave të pyetjeve nga deputetët, interpelancë dhe shpërbërje të Kuvendit, dhe ajo automatikisht do të thotë shpërbërje e Qeverisë. Pyetjet për deputetët nuk janë efektive, veçanërisht pasi që kanë munguar deputetët nga opozita. Interpelanca e anëtarëve të Qeverisë ose funksionarëve është mekanizëm që shpesh përdoret. Interpelanca mund të jenë në lidhje me punën e çdo funksionari, Qeverisë dhe ndonjë anëtari të saj, si dhe për çështje të lidhura me punën e organeve shtetërore[156]. Madje edhe kur ka pasur interpelanca, ato çdoherë kanë mbaruar pa sukses.[157]

Së paku 20 deputetë mund të propozojnë formim të Komisionit Anketues[158]. Komisionet Anketuese i mundësojnë Kuvendit kontroll të fakteve, jo vetëm mbi Qeverinë, por edhe mbi institucionet tjera. Zbulimet nga komisionet anketuese formojnë bazë për procedurë të shqyrtimit të përgjegjësisë së funksionarëve[159]. Kuvendi ka formuar komision të përhershëm anketues për mbrojtje të të drejtave qytetare dhe lirive, por nuk ka komision të specializuar antikorrupsioni.

Komisionet anketuese deri më sot nuk janë efektive[160]. Ka një perceptim që ato formohen për të zvogëluar tensionin dhe të shqyrtohet gjendja, por puna e tyre nuk rezulton me ndryshime efektive[161]. Komisioni i Përhershëm Anketues për Mbrojtje të të Drejtave Qytetare dhe Lirive nuk ka funksion hetimor ose ligjvënës. Zbulimet e Komisionit janë bazë për fillimin e procedurës për përgjegjshmëri të funksionarëve, por ato procedura asnjëherë nuk janë filluar nga Komisioni.

Pasi Qeveria do të përgatisë propozim-buxhetin, ia dorëzon para Kuvendit. Zhvillohet debat për propozim-buxhetin dhe deputetët kanë të drejtë të propozojnë amendamente për buxhetin[162]. Në praktikë, Kuvendi nuk merr pjesë në përgatitje e buxhetit, ndërsa deputetët nuk kanë kontroll mbi shpenzimin buxhetor. Qeveria nuk është e obliguar të dorëzojë raporte tremujore për shpenzimin e buxhetit. Deputetët vetëm informohen si shpenzohet buxheti pas bilancit përfundimtar. Kuvendi nuk ka procedurë formale për revizion të raporteve të revizorëve nga Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR), ndërsa deputetët e interesuar raportet e ESHR-së mund t'i shqyrtojnë vetëm në lokalet e arkivit të Kuvendit.[163]

1.3.2 REFORMAT JURIDIKE

Nota **50**

Në çfarë shkalle pushteti ligjvënës ju jep prioritet kundër korrupsionit dhe menaxhimin si elemente për shqetësim në vend?

Republika e Maqedonisë ka kornizë të avancuar ligjore për luftë kundër korrupsionit, megjithatë, ndonëse miratohen ligjet kundër korrupsionit, Kuvendi nuk ka treguar aspak interes për gjërat lidhur me korrupsionin. Ndonëse Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Kor-

[155] Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.52/1992, neni 92.
[156] Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.52/1992, neni 72.
[157] Intervistë me Marjanço Nikollovin (Bisedë private mes dy personave), më 22 tetor 2014.
[158] Kushtetuta e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/1992, neni 76.
[159] Kushtetuta e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/1992, neni 76.
[160] Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni, Kontrolli Parlamentar mbi Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, Shkup: Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni, 2013) f. 8.
[161] Intervistë me Marjanço Nikollovin (Bisedë private mes dy personave), më 22 tetor 2014.
[162] Intervistë me Marjanço Nikollovin (Bisedë private mes dy personave), më 22 tetor 2014.
[163] Deklaratë nga pjesëmarrës në Punëtorinë e verifikimit të zhvilluar më 7.4.2016r.

rupsionit ekziston 12 vite, deri më tani ka pasur vetëm një debat për raportin vjetor. Nuk ka debate as për raportet që dorëzohen nga Enti Shtetëror i Revizionit, Avokati i Popullit ose trupat tjerë shtetërorë.

Kodi zgjedhor ishte ndryshuar[164] për të zgjidhur mangësitë që ishin treguar nga OSBE/ODHIR në lidhje me financimin e fushatave zgjedhore, dhe u ndryshua edhe Kodi Penal[165] me prezantimin e veprës së re penale: "përdorimi i kundërligjshëm i mjeteve buxhetore gjatë kohës së zgjedhjeve". Ende duhen resurse të mëdha materiale për Prokurorinë Publike për të siguruar zbatimi i plotë i Ligjit të ri për procedurë penale[166]. Ligji për menaxhimin me prona të sekuestruar u zgjerua me shtrirje për të përfshirë edhe lëndët penale dhe drejtuese dhe ishin reviduar rregullat për menaxhim me pronë të sekuestruar dhe të marrë. GREKO ka bërë rrethin e katërt të vlerësimeve në gjysmën e dytë të vitit 2013 që ka përfshirë edhe parandalimin e korrupsionit lidhur me deputetët, gjykatësit dhe prokurorët[167].

Janë ratifikuar instrumentet ligjore më poshtë lidhur me korrupsionin: Konventa penale e Këshillit të Evropës për Korrupsion dhe Konventa civile për parandalimin e korrupsionit; Konventa e Strasburgut (Konventa për larjen, zbulimin, sekuestrimin dhe marrjen e të ardhurave nga vepra penale); Konventa e OKB-së për luftën kundër krimit të organizuar transnacional bashkë me protokollet; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Konventa e OKB-së kundër korrupsionit (UNICAC). Ende nuk është ratifikuar Konventa e OECD-së për luftë kundër korrupsionit të nëpunësve të huaj shtetëror në transaksionet ndërkombëtare afariste.

REKOMANDIME

R1. Kuvendi të kërkojë përgjegjësi nga personat zyrtarë që i kanë emëruar për të udhëhequr institucionet kundër korrupsionit.

R2. Kuvendi të themelojë revizion mbi zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare kundër korrupsionit, siç janë UNCAC-ja dhe programi kombëtar për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

[164] Kodi zgjedhor, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/2006, 136/2008, 148/2008, 155/2008, 63/2008, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 196/15.

[165] Kodi penal, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 37/96, 80/99, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/11, 135/11, 185/11, 142/12, 166/12, 55/13, 82/13, 14/14, 27/14, 28/14,115/2014.

[166] Komisioni Evropian 2014., f. 42.

[167] GREKO, 2014, f. 2.

2. PUSHTETI EKZEKUTIV – QEVERIA

PËRMBLEDHJE

Pushteti ekzekutiv – Qeveria është shtylla më e fuqishme në kuptim të të drejtës dhe resurseve. Qeveria formohet nga koalicioni i partive që kanë shumicën në Kuvend. Qeveria që formohet në qershor 2014 është koalicioni shumë-etnik ndërmjet VMRO-DPMNE-së[168] dhe BDI-së[169]. Sipas Kushtetutës, pushteti ekzekutiv është i pavarur, por është lëndë e mbikëqyrjes nga Kuvendi. Në praktikë, Qeveria nuk është thirrur për përgjegjësi për shkak të mungesës së shumicës së deputetëtve të opozitës, si dhe për shkak të kontrollit mbi deputetët e udhëheqjes së politikës që udhëheq pushteti. Nuk ka rregulla për promovim të integritetit të funksionarëve nga pushteti ekzekutiv.

Ka një kornizës ligjvënëse që përcakton përgjegjësitë në procesin e marrjes së vendimeve. Janë vendosur strukturat dhe procedurat që drejtojnë rolin ekzekutiv dhe funksionet, por nuk ka transparencë të mjaftueshme për atë se si zbatohet roli ekzekutiv dhe funksionet.

Me pushtetin ekzekutiv dominojnë partitë në pushtet dhe aktivitetet ekzekutive janë të centralizuara. Nëpunësit shtetërorë emërohen në bazë të lidhjeve partiake, dhe jo sipas meritave, ashtu që korrupsioni është i madh.

Tabela më poshtë i tregon notat sipas treguesve për kapacitetin e pushtetit ekzekutiv, menaxhimin dhe rolin e tij në sistemin e integritetit. Pjesa tjetër e këtij kapitulli prezanton analizën cilësore të çdo treguesi.

VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM PËR SHTYLLËN: 65,2/100

DIMENSIONI	TREGUES	E DREJTA	PRAKTIKA
Kapaciteti 1,6/100	Resurset	/	75
	Pavarësia	100	100
Qeverisja 54,1/100	Transparencë	75	50
	Përgjegjësia	75	25
	Integriteti	50	50
Roli 50/100	Mbikëqyrja e pushtetit ekzekutiv	50	
	Reforma ligjore	50	

[168] Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO – DPMNE).
[169] Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI).

Vlerësimi për shtyllën sipas të drejtës dhe praktikës



Pushteti ekzekutiv

STRUKTURA DHE ORGANIZIMI

Pushtetin ekzekutiv e ka Qeveria e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtutjeshëm: Qeveria), që është përbërë nga Kryeministri, katër zëvendës dhe 21 ministra. Qeveria zgjidhet me shumicë të votave nga gjithë deputetët në Kuvend dhe ministrat nuk mund të jenë përfaqësues në Kuvend. Kryetari i Republikës së Maqedonisë e emëron Kryeministrin, pas aprovimit nga Kuvendi.

Sekretariati i Përgjithshëm (SP) është përgjegjës për koordinimin, që përfshin përgatitjen e takimeve të pushtetit ekzekutiv, përgatitje të programeve të punës dhe prioriteteve strategjike, si dhe monitorim dhe njoftim për punën, koordinimin të politikave, koordinim të komunikimit me Qeverinë dhe koordinim të marrëdhënieve qeveritare me Kuvendin, institucionet publike dhe organizatat joqeveritare (OJQ).

Çdo ministri ka aktiviteteve për përgatitje të ligjeve që i koordinon. Sekretariati për Ligjvënie, që jep mendime mbi përputhshmërinë e propozim-ligjit me Kushtetutën dhe ligjet tjera, për përshtatjen dhe përputhjen e ligjeve kombëtare me ligjet evropiane dhe jep këshilla për teknikat e përgatitjes së ligjeve.

Sekretariati për Çështje Evropiane është përgjegjës për koordinim të çështjeve lidhur me integrimet evropiane. MF e përgatit strategjinë fiskale, e koordinon përgatitjen dhe monitorimin e buxhetit dhe jep mendime për vlerësimet e ndikimeve fiskale që përgatitin ministritë. Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA) është përgjegjëse për mbikëqyrje të vlerësimeve të ndikimit të rregullores (MNRR) që i bëjnë gjitha ministritë ose ministria kompetente duhet të japë një pasqyrë të mendimeve të fituara.

Këshilli Kombëtar i Sigurisë i shqyrton çështjet lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen e vendit dhe i jep propozime politike Kuvendit dhe nga Qeveria në fushën e sigurisë kombëtare.[170]

[170] Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, *Kryetari i Republikës është Kryetar i Këshillit të Sigurisë së Republikës së Maqedonisë, neni 86.*

VLERËSIMI

KAPACITETI

2.1.1 RESURSET (PRAKTIKË)

Nota 75

Në çfarë shkalle pushteti ekzekutiv ka resurse përkatëse për kryerje efektive të detyrave të duhura?

Pushteti ekzekutiv ka resurset përkatëse njerëzore, teknike dhe financiare. Gjatë tre viteve të fundit, buxheti i plotë i Qeverisë dhe numrit i të punësuarve është rritur mbi 48%.

Shërbimin Qeveritar[171] e udhëheq Sekretari i përgjithshëm të cilin e emëron dhe shkarkon Qeveria[172]. Qeveria mund të formojë trupa punes të përhershëm ose të përkohshëm[173], si dhe trupa të përhershëm konsultimi të këshillave ligjorë dhe ekonomikë[174] dhe mund të formojë Komision për Revizion si trup i përhershëm profesional.[175] Qeveria mund të formojë edhe trupa të përkohshëm për çështje të caktuara.[176] Pushteti ekzistues ekzekutiv ka formuar gjashtë komisione të ngjashme të përkohshme.

Qeveria ka resurse përkatëse njerëzore, teknike dhe financiare për kryerje të obligimeve për miratimin e politikave, në mbështetje të teknologjive bashkëkohore informative dhe komunikimit[177]. Numri i të punësuarve në administratë është më shumë sesa është e nevojshme[178], pjesërisht sepse ata janë anëtarë të partisë që shpërblehen me shërbim publik, dhe në atë vëllim që pushteti nuk mund të sigurojë për të gjithë punësuarit kushte përkatëse për punë, siç janë tavolina të punës dhe kompjuterë.[179] Ka një mendim të përhapur që administrata publike është partiake dhe nuk ka transparencë dhe ka pak besim në pavarësinë e institucioneve shtetërore[180].

Sipas buxhetit shtetëror, shpenzimet nga puna e Qeverisë në vitin 2012 kanë qenë 14.592.081 EUR me 288 të punësuar[181]; në vitin 2013 buxheti i plotë ka qenë 17.784.260 EUR, me 416 të punësuar[182], ndërsa buxheti i plotë i Qeverisë për vitin 2014 ka qenë 19.661.642 EUR, me 427 të punësuar[183]. Gjatë tre viteve të fundit, buxheti i plotë i Qeverisë dhe numri i të punësuarve është rritur për mbi 48%.

---

171 Vendim i Qeverisë nr. 23-6094/1 nga 13 shkurti 2001, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 12/2001.
172 Ligji për Qeverinë e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 59/2000, 12/2003, 55/2005, 37/2006, 115/2007, 19/2008, 82/2008, 10/10, 51/11, 15/2013, neni 39, parag.1.
173 Rregullore e Qeverisë së RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 36/2008, Komisioni për çështje banesore dhe emigrimi, Komisioni për emërim, Komisioni për Privatizim dhe Komisioni për Prodhimtari të Synuar, neni 31.
174 Rregullore e Qeverisë së RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 36/2008, neni 36.
175 Rregullore e Qeverisë së RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 36/2008, neni 40.
176 Komisioni për Teknologji Informatike, Komisioni për Luftë Kundër Prodhimtarisë së Paligjshme, Tregti dhe Përdorim të Drogave, Komisioni i Posaçëm për Përcaktim të Kushteve të Njohjes së Gjuhës Maqedonase për Përfitim të Shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, UNESKO Komisioni Kombëtar i Republikës së Maqedonisë dhe Komisioni Kombëtar për Luftë Kundër Tregtisë me Qenie Njerëzore dhe Migracionit të Paligjshëm në Republikën e Maqedonisë.
177 Intervistë me Magdalena Shalevën (Bisedë private mes dy personave), Shkup, 14 nëntor 2014.
178 Maja Tomiq, gazetare, http://www.utrinski.mk/?ItemID=F2821FF44E353A4A9866D6B4FDA68EEA, [qasur më 14 nëntor 2014.].
179 Intervistë me Magdalena Shalevën (Bisedë private mes dy personave), Shkup, 14 nëntor 2014.
180 Komisioni Evropian 2014., f. 8.
181 Buxheti i Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 180/2011, f. 22.
182 Buxheti i Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 167/2012, f. 21.
183 Njëlloj.

2.1.2 PAVARËSIA (E DREJTA)

Nota 100

Në çfarë shkalle, sipas ligjit, është i pavarur pushteti ekzekutiv

Qeveria është e pavarur, por, sipas parimeve të demokracisë parlamentare, ajo është përgjegjëse para Kuvendit.

Kryetari luan rol ceremonial dhe përfaqëson shtetin në ngjarje shtetërore zyrtare, por nuk është i përfshirë në punën e përditshme të Qeverisë.[184]

Qeveria përbëhet nga kryeministri dhe ministrat.[185] Kryeministri është përgjegjës për organizimin e plotë të pushtetit ekzekutiv dhe bashkëpunon me organet tjera, ndërmarrjet publike dhe institucionet.[186] SP jep mbështetje logjistike dhe profesionale për qeverinë, ministrat dhe trupat tjerë të administratës publike, posaçërisht në lidhje me prioritetet strategjike dhe analizat politike.[187] Kryeministri ka imunitet, ndërsa Kuvendi vendos për imunitetin e tij/saj[188]. Funksioni kryetar i Qeverisë dhe ministër nuk mund të lidhet me kryerjen e funksioneve tjera publike ose profesioneve.[189]

Nuk ka dispozita ligjore që kufizojnë aktivitetet e pushtetit ekzekutiv në Maqedoni dhe që kufizojnë segmente tjera të pushtetit.

2.1.3 PAVARËSIA (PRAKTIKA)

Nota 100[190]

Në çfarë shkalle, në praktikë, është i pavarur pushteti ekzekutiv?

Pushteti ekzekutiv është i pavarur dhe dominues në qeverisjen e Republikës së Maqedonisë në një shkallë që rrezikon pavarësinë e dy segmenteve tjera, pushtetin ligjvënës dhe gjyqësor. Në shumë raporte është shprehur shqetësim që pushteti ekzekutiv drejtpërdrejt dhe thërthorazi i kontrollon dy pushtet tjera[191]. Partitë afër pushtetit që ngatërrojnë linjën ndërmjet shtetit dhe partisë, me çfarë prishet besimi në institucionet publike. Gjithashtu, ka një shqetësim serioz në lidhje me kontrollin qeveritar mbi institucionet publike dhe mediet.[192]

Pushteti ekzekutiv i politizon institucionet e shtetit dhe përzihet në proceset e marrjes së vendimeve[193]. Nuk ka mbikëqyrje të veprimit, me çfarë nuk ka përgjegjshmëri, dhe ajo është keqësuar më shumë me mungesën e opozitës në Kuvend. Akuzimet e hershme nga opozita

[184] Kushtetuta e RM-së, Gazeta Zyrtare E RM-së, nr. 52/1992, neni 79.
[185] Ligji për Qeverinë e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 59/2000, 12/2003, 55/2005, 37/2006, 115/2007, 19/2008, 82/2008, 10/10, 51/11, 15/2013, neni 2.
[186] Ligji për Qeverinë e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 59/2000, 12/2003, 55/2005, 37/2006, 115/2007, 19/2008, 82/2008, 10/10, 51/11, 15/2013, neni 11.
[187] Ligji për Qeverinë e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 59/2000, 12/2003, 55/2005, 37/2006, 115/2007, 19/2008, 82/2008, 10/10, 51/11, 15/2013, neni 16.
[188] Kushtetuta e RM-së, Amendamenti XXIII, Gazeta Zyrtare e RM-së, 107/2005, neni 89.
[189] Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.52/1992, neni 89.
[190] Grupi këshillimor i takimit këshillues i zhvilluar më 7.10.2015 ka vërejtur që kjo pyetje sqaruese nuk është relevante për Maqedoninë dhe ajo është arsyeja themelore përse ky tregues ka notë të lartë.
[191] SIGMA/OECD "Raporti i vlerësimit të Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, 2012", Raporte kombëtare të vlerësimit 2012/05 (Bruksel: OECD, 2012), f. 3.
[192] Komisioni Evropian 2014., f. 5.
[193] Biseda telefonike të publikuara për punësim dhe procese të vendimmarrjes.

që qeveria ka orkestruar përgjime masive të bisedave telefonike të mbi 20.000 personave e zbulon shkallën e dominimit doli nga kontrolli i pushtetit ekzekutiv në jetën politike në Republikën e Maqedonisë[194]. Kryetari nuk ka marrë asnjë aktivitet për parandalimin e punës së paligjshme të pushtetit ekzekutiv.

QEVERISJA

2.2.1 TRANSPARENCA (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle janë themeluar rregullore që sigurojnë transparencë të aktiviteteve relevante të pushtetit ekzekutiv?

Ekzistojnë mekanizma gjithëpërfshirës ligjorë për sigurimin e transparencës së buxhetit shtetëror dhe mjeteve të funksionarëve nga pushteti ekzekutiv. Megjithatë, rregulloret që kanë të bëjnë me transparencën e punës së pushtetit ekzekutiv nuk janë të përshtatshme, siç është, për shembull, përmbajtja e takimeve të kabinetit.

Sekretari i përgjithshëm i Qeverisë kryeson me takimin e Sekretarëve shtetërorë njëherë në javë në Kolegjium të Përgjithshëm[195], një trup përgjegjës për vendimmarrje nëse pikat e parashtruara nga ministrat janë të gatshme për të vazhduar në seancë qeveritare në të cilën do të votohet për ato pika.[196]

Votimi në seancat qeveritare zakonisht është publik, megjithatë për disa çështje, votimi është i fshehtë[197]. SP është përgjegjës për procesverbalin e seancave qeveritare[198]. Merren shënime dhe incizohen bisedat, përveç kur bëhet fjalë për informata të fshehta. Janë në vend rregullore si të punohet me informata konfidenciale[199]. Procesverbali i seancës qeveritare nuk është publik dhe vetëm kryeministri mund të autorizojë publikimin e shënimeve të shkurta dhe të incizimeve[200].

Kryeministri është përgjegjës për informimin e publikut për punën e Qeverisë dhe për zbatimin e programit vjetor[201], përveç kur bëhet fjalë për informata për sigurinë shtetërore, sekrete zyrtare dhe afariste dhe të dhëna personale të qytetarëve, në përputhje me Ligjin për mbrojtje të të dhënave personale[202]. Për parashtresat te Kryeministri, përgjigjet Kabineti i Kryeministrit, ndërsa për parashtresat e Qeverisë përgjigjet SP-ja.[203]

MF-ja e përgatit strategjinë fiskale[204], e koordinon përgatitjen dhe monitorimin e buxhetit vjetor dhe mendimet për vlerësimet e ndikimeve fiskale që përgatitin ministritë. Buxheti i Qeverisë është publik dhe MF-ja është përgjegjëse për përgatitjen e buxhetit shtetëror

[194] Zoran Zaev, http://www.slobodnaevropa.mk/content/news/26837839.html.
[195] Rregullore e Qeverisë së RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 36/2008, neni 75, parag.1.
[196] Rregullore e Qeverisë së RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 36/2008, neni 76, parag.1.
[197] Ligji mbi Qeverinë e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 59/2000, 12/2003, 55/2005, 37/2006, 115/2007, 19/2008, 82/2008, 10/10, 51/11, 15/2013, neni 20, parag.(3).
[198] Rregullore e Qeverisë së RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 36/2008, neni 101, parag.7.
[199] Rregullore e Qeverisë së RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 36/2008, neni 103, parag.1.
[200] Rregullore e Qeverisë së RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 36/2008, neni 103, parag.3.
[201] Rregullore e Qeverisë së RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 36/2008, neni 138, parag.1.
[202] Ligji për Qeverinë e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 59/2000, 12/2003, 55/2005, 37/2006, 115/2007, 19/2008, 82/2008, 10/10, 51/11, 15/2013, neni 7, parag.1.
[203] Rregullore e Qeverisë së RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 36/2008, neni 143.
[204] Ligji për Buxhetin, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 64/2005, 4/2008, 103/2008, 156/2009, 95/2010, 180/2011, 171/2012, neni 16, parag.1.

dhe për dorëzimin para Qeverisë[205]. Raportet pas përfundimit të buxhetit shtetëror në baza mujore duhet të publikohen në internet faqen e MF-së[206]. MF-ja para Qeverisë dorëzon raport për zbatimin e buxhetit shtetëror për gjashtë muajt e fundit dhe publikohet në internet faqen e MF-së[207]. Buxheti shtetëror dhe bilanci përfundimtar miratohen nga Kuvendi dhe publikohen në Gazetën Zyrtare.[208]

Funksionarët e pushtetit ekzekutiv obligohen të parashtrojnë deklarata për gjendjen e pronësisë në KSHPK dhe DHP dhe ato janë publike.[209] Gjithashtu, duhet të paraqiten edhe rritje të gjendjes pronësore[210]. Kundër një bartësi të funksionit mund të fillohet procedurë për shqyrtimin e gjendjes së pronës, nëse ai/ajo nuk ka siguruar të dhëna ose nuk ka dorëzuar me kohë raportin dhe nëse të dhënat e dorëzuara nuk janë të sakta ose nuk përputhen me rritjen e gjendjes pronësore[211]. Bashkë me nisjen e procedurës, DHP-ja dorëzon propozim në gjykatës kompetentë themelorë për masën e përkohshme të ndalimit të personit për të përdorur pronën.[212]

2.2.2 TRANSPARENCA (PRAKTIKA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle në praktikë ka transparencë për aktivitetet relevante të pushtetit ekzekutiv?

Qeveria jep informata për një pjesë të aktiviteteve që i kryen dhe në mënyrë aktive përdor internet faqen dhe rrjetet sociale. Megjithatë, në mënyrë pro-aktive publikohen vetëm njoftimet për medie, por jo edhe për vendimet qeveritare ose procesverbalet nga seancat.

Nuk ka mjaft informata në lidhje me shpenzimet buxhetore dhe ka nivel të ultë të transparencës në procesin e miratimit të ligjeve. Nuk ka regjistër të qartë të interesave të funksionarëve të zgjedhur dhe bartës të emëruar të funksioneve, ndërsa ajo vazhdon të pengojë mbikëqyrjen efektive mbi pronën dhe konfliktin e interesave.

Qeveria ka strategji ambicioze për të përmirësuar transparencën dhe të zmadhojë pjesëmarrjen e publikut në procesin e miratimit të politikave[213]. Në praktikë, Qeveria ka internet faqen e vet që përmban informata të përgjithshme, ku publikohen gjitha deklaratat për shtyp[214], konferenca për medie[215], fjalime[216] dhe intervista të anëtarëve të qeverisë. Qeveria rregullisht vendos informata në lidhje me zbatimin e aktiviteteve në rrjetet sociale siç janë Fejsbuk[217], Tviter[218] dhe Jutub[219].

---

[205] Ligji për Buxhetin, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 64/2005, 4/2008, 103/2008, 156/2009, 95/2010, 180/2011, 171/2012, neni 14.
[206] Ligji për Buxhetin, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 64/2005, 4/2008, 103/2008, 156/2009, 95/2010, 180/2011, 171/2012, neni 53, parag.1.
[207] Ligji për Buxhetin, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.64/05, 04/08, 103/08, 4/08, 103/08, 156/09, 95/10 156/09, 95/10, 180/11 и 171/12, neni 53, parag.4.
[208] Ligji për Buxhetin, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 64/2005, 4/2008, 103/2008, 156/2009, 95/2010, 180/2011, 171/2012, neni 54, parag.1.
[209] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, neni 33.
[210] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, neni 34.
[211] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, neni 36, parag.3.
[212] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, neni 36, parag.5.
[213] SIGMA-OECD, Vlerësimi i *Reformave në administratën publike të Republikës së Maqedonisë (Paris:* SIGMA-OECD, 2014), f. 4.
[214] http://vlada.mk/soopstenija-blog?language=en-gb (qasur më 28 nëntor 2014)
[215] http://vlada.mk/pres-blog?language=en-gb (qasur më 28 nëntor 2014)
[216] http://vlada.mk/govori-blog?language=en-gb (qasur më 28 nëntor 2014)
[217] https://www.facebook.com/VladaMK (qasur më 28 nëntor 2014)
[218] https://twitter.com/VladaMK (qasur më 28 nëntor 2014)
[219] https://www.youtube.com/user/VladaMakedonija (qasur më 28 nëntor 2014)

Si pjesë e përmirësimit të shërbimeve të prezantuar me e-qeveri dhe sistemin njësportel[220]. Janë publikuar edhe raportet vjetore të Qeverisë dhe raporti për 100 ditët e para të punës.[221]

Përveç kësaj, në internet faqen e Qeverisë, qytetarët ftohen të paraqesin ide, propozime dhe projekte për të gjitha fushat e jetës sociale[222]. Ka të hapura linja telefonike për denoncimin e korrupsionit në Drejtorinë Doganore, Drejtorinë për të Hyra Publike, Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve dhe MPB-në.[223]

Megjithatë, në realitet, Qeveria me publikun ndan vetëm informata që janë në interes të saj.[224]

Nuk janë verifikuar gjendjet pronësore të ministrave. Transparency International i ka krahasuar biografitë e ministrave dhe deklaratat e gjendjes pronësore dhe ka zbuluar që në biografinë e një ministri është theksuar që ai është drejtor i ndërmarrjes, por atë nuk e ka paraqitur në deklaratën e tij për pronë që ka dorëzuar në KSHPK[225]. KSHPK ka për obligim, sipas ligjit, të ndërmarrë masa në këto raste, por ka refuzuar tu përgjigjet kërkesave për informata në këtë rast. Përveç kësaj, nuk ka regjistër të qartë të interesave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar në funksione, dhe kjo vazhdon të parandalojë mbikëqyrjen efektive mbi pronat dhe konfliktin e interesave[226]. Me vështirësi ndiqen ndryshimet në deklaratat e pronave të bartësve të funksioneve.[227]

Buxhetin e Qeverisë e përgatit MF-ja dhe ai publikohet në internet faqen e saj. Nuk dorëzohet raport tremujor por vetëm bilanc përfundimtar që nuk publikohet.[228]

Procesverbalet nga seancat qeveritare nuk janë publike, rendi i ditës nuk publikohet, ndërsa në konferenca për medie nëpër seanca qeveritare publikohen vetëm informata të zgjedhura.[229]

Sekretariati i Ligjvënies dëshiron të përmirësojë shkathtësitë për përgatitje të ligjeve në të gjitha ministritë. Sekretariati ka trajnuar trajnerë për përgatitjen e dokumenteve ligjore dhe ka publikuar dy udhëzues me parime të përcaktuar për përgatitjen e ligjvënies dhe shkrirje në Ligjvënien Evropiane[230]. Megjithatë, nuk ka procedura të qarta në lidhje me pjesëmarrje ne publikut dhe debat publik në proceset e miratimit të politikave dhe ligjeve.

Shpeshherë Qeveria i përgatit aktet shpejtë dhe nuk respektohen çdoherë rregullat për përgatitjen e ligjeve[231]. Mahnit shpejtësia me të cilën miratohen ligjet; në disa raste, i gjithë procesi politik, nga parashtrimi i propozim-ligjit deri në miratim në Kuvend zgjat më pak se një muaj[232]. Qeveria e përdor procedurën e shkurtuar për miratimin e ligjeve urgjente, me qëllim të shmangies së diskutimit publik[233]. Në vitin 2015, Kuvendi nga themelimi i tij ka miratuar 4.2 ligje në ditë.[234]

[220] Komisioni Evropian 2014., f. 9.
[221] http://vlada.mk/node/9453?language=en-gb (qasur më 28 nëntor 2014)
[222] http://vlada.mk/node/23 (28 nëntor 2014)
[223] http://vlada.mk/node/138 (28 nëntor 2014)
[224] Intervistë me Magdalena Shalevën (Bisedë private mes dy personave), Shkup, 14 nëntor 2014.
[225] http://vlada.mk/?q=node/61?language=mk (qasur më 26 janar 2015)
[226] Komisioni Evropian 2014., f. 42.
[227] Intervistë me Malinka Ristevska-Jordanovën (Bisedë private mes dy personave), Shkup, 12 nëntor 2014
[228] Intervistë me Malinka Ristevska-Jordanovën (Bisedë private mes dy personave), Shkup, 12 nëntor 2014
[229] Intervistë me Malinka Ristevska-Jordanovën (Bisedë private mes dy personave), Shkup, 12 nëntor 2014
[230] SIGMA-OECD, 2014), f. 27.
[231] Intervistë me Malinka Ristevska-Jordanovaën (Bisedë private mes dy personave), Shkup, 12 nëntor 2014
[232] SIGMA-OECD, 2014, f. 27.
[233] Intervistë me Malinka Ristevska-Jordanovaën (Bisedë private mes dy personave), Shkup, 12 nëntor 2014
[234] Deklaratë e pjesëmarrësit (deputet) në punëtorinë për verifikim të zhvilluar më 7.04.2016.

2.2.3 PËRGJEGJËSIA (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle janë vendosur dispozita me të cilat anëtarët e pushtetit ekzekutiv detyrohen të dorëzojnë raporte dhe të përgjigjen për veprimet e tyre?

Ekzistojnë ligje përkatëse, përfshirë edhe dispozita ligjore në lidhje me përgjegjësinë e pushtetit ekzekutiv. Qeverinë e zgjedh dhe shkarkon Kuvendi me shumicën e votave të numrit të plotë të deputetëve.[235] Ekzistojnë disa mekanizma të përgjegjsisë me të cilat pushteti ekzekutiv është përgjegjës para pushtetit ligjvënës, siç janë pyetjet të deputetëve, interpelanca dhe votimi i mosbesimit të Qeverisë. Kuvendi mund të themelojë komisione anketuese, dhe ka edhe "Kod të praktikave të mira për pjesëmarrje të shoqërisë civile në procesin e krijimit të politikave"[236].

Megjithatë, Kuvendi nuk ka kapacitet të sigurojë përgjegjësi të pushtetit ekzekutiv për procedurat e tij, dhe numri i madh i ligjeve të miratuara me procedurë të shkurtuar nuk mundëson debat të përshtatshëm publik.

Qeveria dhe çdo anëtar i saj përgjigjen për punën e tyre para Kuvendit[237]. Votimi i mosbesimit të Qeverisë mund të filojë me së paku 20 deputetë dhe miratohet me shumicën e votave nga numri i plotë i deputetëve. Nëse Qeverisë i votohet mosbesim, ajo ka për detyrë të dorëzojë dorëheqjen.[238]

Funksionari që është lëndë e interpelancës ka të drejtë të dorëzojë përgjigje me shkrim te kryetari i Kuvendit, më së voni 15 ditë nga dita e pranimit të interpelancës[239]. Nëse Kuvendi e pranon interpelancën, merr qëndrim në lidhje me interpelancën[240]. E drejta e deputetëve të parashtrojnë pyetje deputetësh drejt Qeverisë në Kuvend është një prej mekanizmave më të rëndësishme për përgjegjësi.[241]

Anëtarët e Qeverisë obligohen të japin sqarim për hapat e tyre dhe marrjen e vendimeve.[242]

Kuvendi mund të themelojë komision anketues për çdo lloj të pyetjeve me interes publik, ndërsa zbulimet e komisioneve janë bazë për nisjen e procedurës për përcaktim të përgjegjësisë së bartësve të funksioneve publike.[243]

Pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin e krijimit të ligjeve garantohet me ligj[244]. Në vitin 2011[245] ishte miratuar "Kodi i praktikës së mirë për pjesëmarrje të shoqërisë civile në proceset e krijimit të politikave", ndërsa në vitin 2012 ishte miratuar strategjia e dytë për bashkëpunim.[246]

---

[235] Ligji për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 59/2000, 12/2003, 55/2005, 37/2006, 115/2007, 19/2008, 82/2008, 10/10, 51/11, 15/2013, neni 3 parag.2.
[236] http://www.nvosorabotka.gov.mk/sites/default/files/dokumenti/kodeks_na_dobri_praktikii.pdf (kontrolluar më 14 janar 2015).
[237] Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë neni 92, neni 4(2) nga Ligji për Qeverinë e RM-së.
[238] Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 52/1992, neni 92.
[239] Rregullore e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 91/2008, 119/2010, 130/2010, 23/2013, neni 46.
[240] Rregullore e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 91/2008, 119/2010, 130/2010, 23/2013, neni 49, parag.4.
[241] Rregullore e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 91/2008, 119/2010, 130/2010, 23/2013, nenet 37-44.
[242] Rregullore e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 36/2008, neni 122.
[243] Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/1992, neni 76.
[244] SIGMA-OECD, 2014: 12 стр.
[245] Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 99/2011.
[246] Qeveria e RM-së "Strategjia për bashkëpunim të Qeverisë me shoqërinë qytetare 2012-2017" (Shkup: Qeveria e RM, 2012).

Anëtarët e Qeverisë në mënyrë ligjore obligohen të japin sqarim për vendimet e tyre posaçërisht në procesin e krijimit të ligjeve. Propozim-raporti për vlerësimin e ndikimit të rregullores dhe ligjet e propozuara duhet të publikohen në ENER dhe në internet faqet e ministrive[247], me përjashtim të ligjeve të propozuara me përdorim të procedurës urgjente dhe të shpejtë.[248] Ministritë mund të organizojnë diskutime publike në procesin e zbatimit të PVR-së dhe gjatë përgatitjes së ligjvënies së propozuar.[249] Paralajmërimi për diskutim publik duhet të publikohet në ENER dhe në internet faqen e ministrisë.

2.2.4 PËRGJEGJËSIA (PRAKTIKA)

Nota **25**

Sa efektive është mbikëqyrja e aktiviteteve të pushtetit ekzekutiv në praktikë?

Mekanizmat për përgjegjësi, të themeluar me Kushtetutë dhe në ligjet në praktikë nuk janë efektive.

Nuk ka ndarje të pushtetit dhe Kuvendi është tërësisht nën ndikimin e Kryeministrit dhe partisë së tij. Kuvendi nuk bën mbikëqyrjen e aktiviteteve të pushtetit ekzekutiv[250]. Në periudhën shtator-dhjetor 2014, deputetët kanë parashtruar 119 pyetje dhe kanë marrë 94 përgjigje[251]. Pas kthimit të opozitës në Kuvend është rritur numri i pyetjeve të deputetëve edhe në periudhën janar-dhjetor 2015 dhe janë parashtruar gjithsej 344 pyetje.[252]

ESHR-ja bën revizion të punës së organeve ekzekutive, ndërsa raportet dorëzohen në Kuvend. Në vitin 2012 ishte bërë revizion i Qeverisë për të vlerësuar efektivitetin dhe efikasitetin e kontrolleve të brendshme[253]. Përveç zbulimeve për shpenzimeve të papërshtatshme[254], të cilat në përputhje me ligjin duhet të referohen te prokurori publik dhe KSHPK, dhe përskaj shqyrtimit të raporteve të plota vjetore të ESHR-së nga Kuvendi, ka aktivitete të kufizuara për monitorimin e zbulimeve të ESHR-së për ministritë individuale.[255]

SP-ja dhe Seksioni për Bashkëpunim me Organizata Joqeveritare zyrtarisht e koordinojnë bashkëveprimin e Qeverisë me organizatat qytetare[256]. Në praktikë, qeveria në baza vjetore i shpërndan mjetet nga buxheti shtetëror për financim të aktiviteteve programore të OJQ-ve. Shembuj për pjesëmarrje të sektorit qytetar janë themelimi i Këshillit për Avancim të Bashkëpunimit, Dialogut dhe Nxitjen e Zhvillimit Shoqëror[257], si dhe thirrjen e sektorit qytetar për kontribut në përgatitjen e programit vjetor për vitin 2015.[258]

Ndonëse ministritë obligohen të publikojnë të gjitha propozim-ligjet, në praktikë ka shumë propozime të cilat nuk janë vendosur në dispozicion për debate publike[259]. Nga tetori i vi-

247 Udhëzime për procedura ministrore në përdorimin e procesit për vlerësim të ndikimit të rregullores, neni 17.
248 Rregullore e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 36/2008, neni 71, parag.1.
249 Udhëzime për procedura ministrore në përdorimin e procesit për vlerësim të ndikimit të rregullores, neni 24.
250 Intervistë me Magdalena Shalevën (Bisedë private mes dy personave), Shkup, 14 nëntor 2014.
251 http://www.sobranie.mk/pratenicki-prashanja.nspx (kontrolluar më 17 dhjetor 2014).
252 http://www.sobranie.mk/pratenicki-prashanja.nspx (kontrolluar më 31 dhjetor 2015).
253 No.10-110/6.
254 http://grid.mk/news/506565580/molk-vo-vladata-za-skandalozniot-revizorski-izveshtaj(kontrolluar më 21 dhjetor 2014).
255 Komisioni Evropian, 2014: f. 9.
256 http://www.nvosorabotka.gov.mk/ (kontrolluar më 9 dhjetor 2014).
257 Qeveria e RM-së, Vendim për themelimin e këshillit për avancim të bashkëpunimit, dialogut dhe nxitjes së zhvillimit të shoqërisë qytetare, nëntor 2014.
258 Publikuar në: http://www.nvosorabotka.gov.mk/, [kontrolluar më 9 dhjetor 2014.].
259 Simona Ognenovska dhe Borjan Gjuzellov "Pasqyra e Qeverisë: *pjesëmarrje të publikut në proceset e përgatitjes së ligjeve",* (Shkup, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, 2014), f. 45.

tit 2013 deri më shtator 2014, në Kuvend për shqyrtim kanë hyrë 381 propozim-ligje, dhe vetëm 201 propozim-ligje janë publikuar në Regjistrin Unik Kombëtar Elektronik të Rregulloreve të Republikës së Maqedonisë (ENER) në periudhën e njëjtë.[260]

Për 155 propozim-ligje, prej gjithsej 381 është zbatuar "procedura e shkurtër", dhe vetëm një numër i vogël i tyre (32) në vitin 2013 janë publikuar në ENER[261]. Faqja nuk azhurnohet në mënyrë të drejtë dhe si rezultat i kësaj, publiku nuk ka interes për ueb faqen. Subjektet e përfshira në këto procese thonë që me ENER-ja mundësohet që ligjet të shmangin mbikëqyrje nga organizatat joqeveritare (OJQ) sepse nëse do të duhej të ketë ndonjë ndikim, ENER-ja do të duhej të vëzhgohet vazhdimisht.[262] Në këtë drejtim, Qeveria nuk dëshiron që në mënyrë të drejtë të konsultojë sektorin publik, përfshirë edhe atë afarist.[263]

Gjithashtu, Qeveria ka miratuar edhe plan të dytë të veprimit për realizim të qëllimeve të parashikuar me Partneritetin e Hapur Qeveritar.[264] Raporti është i dobët sepse nuk jep detaje mbi përpjekjet e bëra dhe nuk identifikon fusha në të cilat Qeveria mund të punojë dhe të përmirësohet transparenca dhe përgjegjësia.[265]

Anëtarët e Qeverisë nuk përgjigjen për shkeljet e tyre, ndërsa gjykatat tregojnë tendencë për të mbështetur ankesat e dorëzuara nga bartësit e funksioneve publike për fyerje[266] dhe u jep dëmshpërblime të mëdha nëpunësve të lartë.[267]

2.2.5 MEKANIZMAT PËR INTEGRITET (E DREJTA)

Nota **50**

A ka mekanizma me të cilat do të sigurohej integriteti i anëtarëve të pushtetit ekzekutiv?

Ekzistojnë ligje përkatëse me të cilat promovohet integriteti i nëpunësve, por nuk ka mekanizëm për zbatimin efektiv të ligjeve[268]. Ka një Kod të sjelljes, si dhe dispozita për luftë kundër korrupsionit, të zbatueshme për anëtarët e Qeverisë dhe bartësve të funksioneve publike. Anëtarët e Qeverisë dhe bartësit e funksioneve publike obligohen të shmangin çdo konflikt të interesave, si dhe dyshim për konflikt të interesave.[269]

Gjithashtu, ka dispozita me të cilat ndalohen anëtarët e Qeverisë dhe personat zyrtarë të marrin dhurata, shërbime, ndihmë ose ndonjë dobi tjetër në lidhje me kryerjen e funksionit, dhe të cilat do të mund të ndikojnë mbi vendimet e tyre[270]. Personi zyrtar nuk guxon të pranojë dhurata me vlerë mbi 200 EUR, të holla, letra me vlerë, pa dallim nga shuma e tyre,

---

260 Njëlloj.
261 Ognenovska dhe Gjuzellov, 2014: f. 39.
262 Ognenovska dhe Gjuzellov, 2014: f. 39.
263 Intervistë me Malinka Ristevska-Jordanovën (Bisedë private mes dy personave), Shkup, 12 nëntor 2014.
264 Raporti vjetor për zbatimin e Planit të Veprimit për partneritet të hapur qeveritar, http://www.opengovpartnership.org/ country/macedonia (kontrolluar më 20 prill 2015).
265 Neda Korunovska, "Mekanizmi për njoftimin e pavarur Maqedoni: *Raporti për përparimin 2012-2013*", *(Shkup:* Reaktor - Hulumtim në Aksion, 2013.).
266 Në periudhën prej 1 mars deri 15 qershor 2014 Qendra për Zhvillim të Medieve ka ndjekur 40 raste të më tepër se 60 seancave në Gjykatën Themelore Shkupi 2.
267 Vera Koco dhe Margarita Caca Nikollovska, "Analiza e dispozitave të Ligjit për përgjegjësi qytetare për ofendim dhe fyerje" (Shkup: Instituti për të Drejta të Njeriut, 2012), f. 5.
268 Komisioni Evropian, 2015, f. 11. http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_the_former_ yugoslav_ republic_of_macedonia.pdf
269 Kodi etik i anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe bartësve të funksioneve publike të emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë (7.4.2010), neni 10.
270 Kodi etik i anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe bartësve të funksioneve publike të emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë (7.4.2010), neni 13.

si dhe ar ose gjëra tjera të çmueshme.[271]

Nëse personit zyrtar i ofrohet dhuratë, ai/ajo duhet të refuzojë, të përcaktojë identitetin e ofruesit, dhe nëse bëhet fjalë për dhuratë që nuk mund të kthehet, atëherë duhet të paraqitet tek organi kompetent, të theksojë dëshmitarët dhe dëshmitë tjera dhe në afat prej 48 orëve të dorëzojë raport me shkrim për ngjarjen te organi kompetent që ka zgjedhur, gjegjësit që ka emëruar[272]. Megjithatë, rregullorja nuk thekson organ në të cilin nëpunësi mund të paraqesë pranimin e dhuratës ose të veprojë në mënyrë tjetër në këto raste dhe nuk thekson procedura tjera për veprim në këto raste.

Në kuptim të masave mbrojtëse pas largimit nga detyra, nëpunësit zyrtar e kanë të ndaluar në periudhë prej tre vitesh nga pushimi kryerjes së detyrave publike, ose pas pushimit e punësimit, të punësohen në shoqëri tregtare në të cilën kanë bërë mbikëqyrje, ose me të cilën kanë vendosur marrëdhënie kontraktuese gjatë kryerjes së detyrave publike.[273]

Personi zyrtar nuk mund të jetë anëtar në borde drejtuese ose mbikëqyrëse në ndonjë shoqëri tregtare, ndërmarrje publike, agjenci, fond ose organizatë tjetër, përveç nëse nuk është përcaktuar me ligj.[274]

Megjithatë, sërish, ka përjashtime varësisht se cili nëpunës shtetëror ose person me detyra të veçanta dhe autorizime të caktuara me ligj mund të jetë anëtar i organeve drejtuese ose mbikëqyrëse të ndonjë shoqërie tregtare.[275]

Personat zyrtarë obligohen që në afat prej 30 ditësh të emërimit të tyre të dorëzojnë në KSHPK deklaratë në lidhje me konflikt të mundshëm të interesave.[276]

Transparency International – Maqedoni ka kontribuar për një debat të gjerë për njohje të rolit të informatorëve në përpjekjet për luftën kundër korrupsionit. Gjithashtu thekson nevojën e miratimit të një ligji që do të mbrojë personat që denoncojnë shkelje. Kjo çështje ishte theksuar si prioritet i agjendës politike dhe Ligji për mbrojtjen e informatorëve ishte miratuar në nëntor të vitit 2015[277]. Ligji i ri ofron mbrojtje të gjerë të informatorëve. Të punësuarit, si në publik ashtu edhe në privat, do të kenë mundësinë të denoncojnë raste të sjelljes së paligjshme ndaj organeve përkatëse.

2.2.6 MEKANIZMAT PËR INTEGRITET (PRAKTIKA)

Nota **50**

Deri në çfarë shkalle sigurohet integritet i anëtarëve të pushtetit ekzekutiv në praktikë?

Nuk ka informata të mjaftueshme në dispozicion për zbatimin e standardeve të integritetit, përveç për funksionimin e kornizës për konflikt të interesave. Megjithatë, konflikti i interesave të funksionarëve më të lartë qeveritarë nuk shqyrtohet në mënyrë të drejtë.[278]

Nuk ka mekanizëm efektiv për ndjekje të efektivitetit të rregullave pas skadimit të mandateve

[271] Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 70/2007, 144/2009, neni 15.
[272] Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 144/2009, neni 16.
[273] Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 144/2009, neni 17..
[274] Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 144/2009, neni 18, parag.1.
[275] Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 144/2009, neni 18, parag.2.
[276] Ligji për parandalimin e Konfliktit të interesave, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 144/2009, neni 20-a.
[277] Ligji për mbrojtjen e informatorëve, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.196/2015.
[278] http://www.dksk.org.mk/index.php?option=com_frontpage&Itemid=1&limit=5&limitstart=5 (kontrolluar më 28 dhjetor 2014).

të funksionarëve qeveritarë dhe publikë[279]. KSHPK-ja është përgjegjëse për zbatimin e këtyre rregullave, por asnjëherë nuk ka publikuar asnjë lloj informacioni lidhur me këtë çështje.[280]

ROLI

2.3.1 MENAXHIMI NË SEKTORIN PUBLIK (E DREJTA DHE PRAKTIKA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle pushteti ekzekutiv bën përpjekje dhe është aktiv në zhvillimin e sektorit publik të menaxhuar mirë?

Ministrat qeveritarë obligohen me përgjegjshmëri kolektive për politika qeveritare, ndonëse janë përgjegjës individualisht për sjelljen dhe punën e ministrive të tyre[281]. Ministrat janë në krye të ministrive dhe janë përgjegjës për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve tjera[282]. Qeveria e mbikëqyr punën e ministrive[283] dhe Qeveria ka mundësi të largojë ose të tërheqë rregullore ose akte tjera ministrore dhe administrative që nuk janë në përputhje me ligjin.[284]

Qeveria duhet të zbatojë vendimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet kur organet kompetente nuk kanë zbatuar vendimin e gjykatës[285]. Në praktikë, Qeveria i tejkalon kufizimet kushtetuese të fuqisë personale. Këto shkelje dëshmohen vështirë, por megjithatë, me skandalin e përgjimit zbulohen disa prej metodave me të cilat Qeveria veproi në kundërshtim me kushtetutën.

Qeveria ka mekanizma dhe organe për menaxhim me punën e shërbimit shtetëror, dhe gjoba deri në shumë prej 1.500 deri 8.000 EUR janë të parashikuara për nëpunës shtetërorë që nuk i kanë prezantuar ose kanë zbatuar standardet për cilësi në kundërshtim në shërbimet shtetërore.[286] Numri i funksionarëve për menaxhim dhe zbatim të kontrolleve të brendshme qeveritare nuk është i përshtatshëm[287] dhe nuk ka monitorim përkatës të zbatimit të politikave.[288]

Ministrat monitorojnë punën e nëpunësve të tyre, por nëpunësit zgjidhen në bazë të përkatësisë etnike dhe politike, dhe jo sipas meritës, që e rrezikon besnikërinë e tyre ndaj institucioneve.[289]

---

279 Intervistë me Malinka Ristevska-Jordanovën (Bisedë private mes dy personave), Shkup, 12 nëntor 2014.
280 Njëlloj.
281 Ligji për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 59/2000, 12/2003, 55/2005, 37/2006, 115/2007, 19/2008, 82/2008, 10/10, 51/11, 15/2013, neni 13.
282 Ligji për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 59/2000, 12/2003, 55/2005, 37/2006, 115/2007, 19/2008, 82/2008, 10/10, 51/11, 15/2013, neni 13.
283 Ligji për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 59/2000, 12/2003, 55/2005, 37/2006, 115/2007, 19/2008, 82/2008, 10/10, 51/11, 15/2013, neni 30 parag.1.
284 Njëlloj.
285 Ligji për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 59/2000, 12/2003, 55/2005, 37/2006, 115/2007, 19/2008, 82/2008, 10/10, 51/11, 15/2013, neni 37.
286 Ligji për prezantimin e sistemit për menaxhimin me cilësinë dhe kornizën e përbashkët për vlerësimin e punës dhe dhënies së shërbimeve të shërbimit shtetëror, Gazeta Zyrtare nr. 69/2013, neni 12, parag.1.
287 Enti Shtetëror i Revizionit, raporti i fundit i revizorëve për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, nr. *09-270/14*, (Shkup: Enti Shtetëror i Revizionit, 2012).
288 SIGMA-OECD, 2014: 4 f.
289 Intervistë me Malinka Ristevska-Jordanovën (Bisedë private mes dy personave), Shkup, 12 nëntor 2014.

2.3.2 SISTEMI LIGJOR

Nota **50**

A i jep pushteti ekzekutiv prioritet përgjegjshmërisë publike dhe luftës kundër korrupsionit si interes në vend?

Nuk ka sundim përkatës me sektorin publik. Ka një numër të madh të rasteve me nepotizëm sepse partia në pushtet ka vendosur anëtarë të saj në gjitha nivelet e institucioneve nën kontroll të shtetit. Ky është edhe një fakt që zbulohet nga incizimet e bisedave të përgjuara[290]. Qeveria në mënyrë deklarative bën përpjekje të luftojë kundër korrupsionit, por asnjëherë nuk zbaton mekanizma përkatës. Sipas Raportit të përparimit të KE-së nga viti 2015: "duhet të shikohen rezultatet më konkrete në praktikë dhe në uljen dhe parandalimin e korrupsionit. Resurset e ndryshme njerëzore dhe financiare në organet e ndryshme për zbatimin e ligjit dhe në agjencitë mbikëqyrëse janë të dobëta dhe kompetencat e tyre, statusi, pavarësia dhe transparenca duhet të përforcohen për të filluar aktivitetet efektive".[291]

Raporti i fundit për zbatimin e programit shtetëror për parandalimin e korrupsionit (strategjia për luftën kundër korrupsionit) tregoi që nga 156 aktivitete të planifikuara, janë realizuar vetëm 42%[292]. Nuk ka vlerësim të ndikimit të aktiviteteve që janë zbatuar.

Ndikimi i tepërt i Qeverisë mbi pushtetin ligjvënës dhe gjyqësorin e ka shtypur përgjegjësinë qeveritare me dobësimin e sistemit të kontrollit. Sipas Raportit të përparimit nga KE në vitin 2015, besimi i publikut në organet për parandalimin e korrupsionit është në nivel të ultë, ndërsa korrupsioni vazhdon të paraqet një problem serioz.[293] Ligjvënia për parandalimin e korrupsionit injorohet ose nuk zbatohet në mënyrë efektive.[294]

Reformat e fundit ligjore dhe administrative në fushën e parandalimit të korrupsionit janë Kodi zgjedhor[295] dhe Kodi penal[296] ndërsa është zgjeruar edhe shtrirja e Ligjit për menaxhim me pronë të sekuestruar. Sipas raportit të përputhjes nga rrethi i tretë i vlerësimit të GREKO-s, kriminalizimi ekzistues i procedurave korruptuese në masë të madhe janë në përputhje me Konventën penale kundër korrupsionit.

Ligji për parandalimin e konfliktit të Interesave ishte plotësuar dhe ndryshuar në janar 2012 si reagim i kritikave në Raportin e përparimit te vendit në vitin 2010 nga KE-ja, ndërsa deklaratat për konflikte të interesave vetëm grumbullohen dhe regjistrohen, por nuk kontrollohen.[297]

KE-ja luan një rol të rëndësishëm në nxitjen e reformave për luftë kundër korrupsionit, fakt që krijon shqetësim rreth kohëzgjatjes dhe qëndrueshmërisë së ligjeve për parandalimin e korrupsionit.[298]

---

[290] http://www.balkaninsight.com/en/article/macedonia-tapes-reveal-massive-party-employment(kontrolluar më 28 nëntor 2014).
[291] Komisioni Evropian, 2015: f. 15.
[292] http://dksk.org.mk/images/Drzavni_Programi/godisen_izvestaj_final.pdf(kontrolluar më 28 nëntor 2014).
[293] Komisioni Evropian, 2014: f. 15.
[294] SIGMA-OECD 2012: 13 f.
[295] Kodi zgjedhor, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 40/2006, 136/2008, 148/2008, 155/2008, 63/2008, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14p
[296] Kodi penal, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 37/96, 80/99, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/11, 135/11, 185/11, 142/12, 166/12, 55/13, 82/13, 14/14, 27/14, 28/14, 115/2014.
[297] SIGMA-OECD, 2012: 12 f.
[298] SIGMA-OECD, 2012: 1 f.

REKOMANDIME

R1. Qeveria duhet të ndërmarrë masa efektive rreth sigurimit të një liste të qartë dhe përditësuar të nëpunësve të zgjedhur dhe të emëruar.

R2. Qeveria duhet të sigurojë përgjegjësi efektive, integritet dhe sjellje etnike të ministrave dhe funksionarëve të pushtetit ekzekutiv.

R3. Qeveria duhet të prezantojë vegla për qytetarët për të siguruar kontroll dhe të zmadhojë transparencën e shpenzimit publik.

3. GJYQËSORI

PËRMBLEDHJE

Pavarësia e gjyqësorit garantohet me ligj. Megjithatë, në praktikë, gjyqësori vuan nga ndikimi i papërshtatshëm nga liderët politikë dhe pushteti ekzekutiv në lidhje me rastet penale, si dhe në raste në të cilat janë vënë në pyetje interesat e udhëheqjes politike.[299] Zgjedhja dhe avancimi i gjykatësve është i politizuar dhe mekanizmat për të siguruar transparencë dhe paanësi në procesin e zgjedhjes së gjykatësve injorohen. Këshilli Gjyqësor (KGJ) është i dobët dhe gjyqësori nuk siguron mbikëqyrje efektive të pushtetit ekzekutiv. Kodi i etikës gjyqësore nuk zbatohet dhe gjykatësit nuk përgjigjen për procedurat e tyre.

Nga ana tjetër, pozitive është që buxheti i gjyqësorit në vitet e fundit është rritur dukshëm, ndërsa rrogat në gjyqësor janë të përshtatshme, por gjyqësorit ende i mungojnë infrastruktura dhe personeli. Ndonëse konsiderohet që gjyqësori punon mirë dhe i pavarur në vendimet në pjesën e madhe të rasteve qytetare, sërish konsiderohet për një degë më të korruptuar.

Në tabelën më poshtë janë theksuar notat e treguesve që përmbledhin vlerësim të gjyqësorit në lidhje me kapacitetin e tij, drejtimin e brendshëm dhe roli në Sistemin Kombëtar për Integritet të Maqedonisë. Vijon nota për çdo tregues.

Nota e përgjithshme e shtyllës: **51,3/100**

DIMENSIONI	TREGUESI	E DREJTA	PRAKTIKA
Kapaciteti 50/100	Resurset	75	50
	Pavarësia	50	25
Qeverisja 54,1/100	Transparenca	75	50
	Llogaridhënia	75	25
	Integriteti	75	25
Roli 50/100	Mbikëqyrja e pushtetit ekzekutiv	50	
	Ndjekja e korrupsionit	50	

[299] Ligji për ofendime dhe shpifje në Maqedoni është i paqartë dhe krijon mënyra që personat e fuqishëm politik të padisin gazetarët për njoftime hetimore, kritika dhe komente të padëshiruara. Kjo është bërë një taktikë e shpeshtë për frikësimin me qëllim të heshtën mediet, veçanërisht magazinat e pavarura si “Fokus”, i njohur për njoftimin hetimor kritik për institucionet politike dhe krijuesit e ligjeve.

Nota e shtyllës sipas të drejtës dhe praktikës



STRUKTURA DHE ORGANIZIMI

Gjyqësori funksionon në kuadër të sistemit kontinental ligjor ka pesë lloje të gjykatave: gjykatat themelore, gjykatat e apelit, gjykatat administrative, gjykatat e larta administrative dhe gjykatat supreme të Republikës së Maqedonisë.[300] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë e mbron Kushtetutën.[301]

Ka 27 gjykata themelore që punojnë në një ose më tepër komuna, katër gjykata të apelit dhe Gjykatë Supreme[302] me seli në kryeqytetin Shkup. Dy prej gjykatave themelore janë gjykata të specializuara. Gjykata Themelore Shkupi 1 është gjykatë e specializuar penale, në të cilën ishte formuar një departament në vitin 2008 për zgjidhjen e lëndëve penale të lidhura me korrupsionin dhe krimin e organizuar. Gjykata Themelore Shkupi 2 është gjykatë e specializuar qytetare. Ka një Gjykatë Administrative të posaçme vendimet e cilave mund të apelohen në Gjykatën Administrative të Lartë dhe dy gjykatat kanë selinë në Shkup. Gjykata Supreme është gjykata më e lartë kombëtare në të cilën apelohen vendimet.

Gjykatës, kryetarë të gjykatave dhe gjykatës-porotë emërohen dhe shkarkohen nga Këshilli Gjyqësor, që gjithashtu është kompetent për disiplinën dhe përparimin e gjykatësve. Në vitin 2015 është themeluar edhe Këshilli për Përcaktimin dhe Nisjen e Procedurës për Caktimin e Përgjegjësisë për Gjykatës (procedurë disiplinore dhe procedurë për punë joprofesionale dhe pavetëdijshme, në përputhje me ligj). Nga viti 2013, gjykatësit për gjykatat themelore mund të zgjidhen vetëm nga kuadrot e diplomuara të Akademisë së Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë. Shoqata e Gjykatësve në Maqedoni (SHGJM) i përfaqëson interesat e gjykatësve ndërsa është themeluar edhe Bordi Këshillimor për këshillim rreth zbatimit të Kodit për etikë gjyqësore.

[300] Ligji për Gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-se, nr. 58/2006, 35/2008, 150/2010, (U.No.256/07, 74/08, 12/11).
[301] Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni108.
[302] Në Manastir, Gostivar, Shkup dhe Shtip.

VLERËSIMI

KAPACITETI

3.1.1 RESURSET (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle ligjet sigurojnë rroga përkatëse dhe kushte pune për gjyqësorin?

Sistemi i rrogave në gjyqësor është themeluar me ligj[303]. Rrogat në gjyqësor kalkulohen në përputhje me llojin e gjykatës, funksionin gjyqësor, natyrën e ndërlikuar të detyrave, nivelin e përgjegjësisë së gjykatësit, kualifikimet e gjykatësit dhe përvojën e punës në jurisprudencë.[304] Rroga themelore e gjykatësve është në përputhje me rrogën e funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar.[305] Gjykatësit, gjithashtu, kanë të drejtë në beneficione dhe kompensime.[306] Megjithatë, nuk ka mekanizëm përkatës për lirimin e përshtatjes së rrogës në përputhje me inflacionin. Rrogat në gjyqësor mund të zvogëlohen vetëm si rezultat i mekanizmit disiplinor,[307] dhe nuk mund të zvogëlohen sipas ligjit ose vendimit të organit shtetëror.[308]

Me ligj të posaçëm[309] rregullohet përgatitja dhe zbatimi i buxhetit gjyqësor, si dhe procedura për themelimin dhe punën e Këshillit Gjyqësor Buxhetor (KGJB). Buxheti gjyqësor është një paragrafi posaçëm në buxhetin shtetëror.[310] Me buxhetin gjyqësor financohen gjykatësit, Këshilli Gjyqësor dhe Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë.[311]

KGJB-ja përbëhet nga kryetari, që gjithashtu edhe kryetar i KGJ dhe nëntë anëtarë.[312] Anëtarët e KGJB-së e përfshijnë edhe ministrin e Drejtësisë dhe funksionarë tjerë të lartë gjyqësorë.[313] Vendimi në KGJB merret me shumicë të anëtarëve[314] dhe KGJB-ja përpilon buxhetin gjyqësor, e shpërndan dhe përgatit raportet vjetore për realizimin e buxhetit.[315]

KGJB në fillim përgatit propozim-buxhet[316] në shumë prej 0,8% nga prodhimi vendor bruto (PVB). Gjatë revizionit të buxhetit shtetëror, mjetet financiare për gjyqësorin nuk mund të zvogëlohen.[317] Së paku 2.5% e buxhetit duhet të shpërndahet për zhvillimin profesional të gjykatësve, nëpunësve gjyqësorë, policinë gjyqësore dhe personelin tjetër gjyqësor.[318] Gjykatësi ka të drejtë dhe obligim të trajnimeve të përhershme profesionale gjatë mandatit të tij/saj[319]. Akademia organizon trajnime për gjykatës dhe për nëpunës të sektorëve tjerë në gjyqësor.[320]

---

303 Ligji për rrogat e gjykatësve, Gazeta Zyrtare e RM-se, nr. 110/2007, 103/2008, 161/2008, 153/2009, 67/10, 97/10, 135/11.
304 Ligji për rrogat e gjykatësve, Gazeta Zyrtare e RM-se, nr. 110/2007, 103/2008, 161/2008, 153/2009, 67/10, 97/10, 135/11, neni2 (1).
305 Ligji për rrogat e gjykatësve, Gazeta Zyrtare e RM-se, nr. 110/2007, 103/2008, 161/2008, 153/2009, 67/10, 97/10, 135/11, neni5 (2)r
306 Ligji për rrogat e gjykatësve, Gazeta Zyrtare e RM-se, nr. 110/2007, 103/2008, 161/2008, 153/2009, 67/10, 97/10, 135/11, neni12 (1)r
307 Ligji për rrogat e gjykatësve, Gazeta Zyrtare e RM-se, nr. 110/2007, 103/2008, 161/2008, 153/2009, 67/10, 97/10, 135/11, neni2 (3).
308 Ligji për rrogat e gjykatësve, Gazeta Zyrtare e RM-se, nr. 110/2007, 103/2008, 161/2008, 153/2009, 67/10, 97/10, 135/11, neni2 (2).
309 Ligji për buxhetin gjyqësor, Gazeta Zyrtare e RM-se, nr. 60/03,37/06,103/08,145/10.
310 Ligji për buxhetin gjyqësor, Gazeta Zyrtare e RM-se, nr. 60/03,37/06,103/08,145/10, neni108, Ligji për Gjykatat, neni2.
311 Ligji për buxhetin gjyqësor, Gazeta Zyrtare e RM-se, nr. 60/03,37/06,103/08,145/10, neni1, parag. 3.
312 Ligji për buxhetin gjyqësor, Gazeta Zyrtare e RM-se, nr. 60/03,37/06,103/08,145/10, neni7.
313 Kryetari i Gjykatës Supreme, kryetari i Gjykatës Administrative, kryetari i Gjykatës së Apelit në Shkup, Manastir, Gostivar dhe Shtip, dy kryetarë të gjykatave themelore të emëruar në përputhje me Ligjin për Gjykata dhe drejtori i Akademisë së Gjykatësve dhe Prokurorëve Publik.
314 Ligji për buxhetin gjyqësor, Gazeta Zyrtare e RM-se, nr. 60/03,37/06,103/08,145/10, neni8.
315 Ligji për buxhetin gjyqësor, Gazeta Zyrtare e RM-se, nr. 60/03,37/06,103/08,145/10, neni9b
316 Ligji për buxhetin gjyqësor, Gazeta Zyrtare e RM-se, nr. 60/03,37/06,103/08,145/10, nenet 14 dhe 15.
317 Ligji për buxhetin gjyqësor, Gazeta Zyrtare e RM-se, nr. 60/03,37/06,103/08,145/10, neni4.
318 Njëlloj.
319 Ligji për gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-se, nr. 58/2006, 35/2008, 150/2010, (U. nr. 256/07, 74/08, 12/11), neni54.
320 Ligji për Akademi të Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, Gazeta Zyrtare e RM-se, nr. 88/2010, 166/2012, 26/2013, neni1.

3.1.2 RESURSET (PRAKTIKA)

Nota **50**

A ka gjyqësori nivele përkatëse të resurseve financiare, personel dhe infrastrukturë për punë efektive në praktikë?

Resurset për gjyqësorin gjatë tre viteve të fundit janë të përshtatshme[321], ndonëse pjesërisht janë më të ulëta nga ajo e nevojshme, me çfarë mund të rritet rreziku nga ndikimi i padrejtë të pushtetit ekzekutiv mbi gjykatat[322]. Buxheti i plotë i gjyqësorit dhe numri i të punësuarve është i ndryshueshëm, për shembull, në vitin 2014 buxheti për gjyqësorin është rritur ndërsa numri i të punësuarve është zvogëluar.[323] Për shkak të nyjës në financimin, Gjykata Supreme nuk i ka kryer të gjitha revizionet ligjore dhe funksione mbikëqyrëse mbi gjykatat e shkalles më të ultë, ndërsa gjykatësit nuk kanë marrë mëditje dhe shpenzime për rrugë për pjesëmarrje në takime profesionale.[324]

Pjesa më e madhe e buxhetit gjyqësor shpenzohet në rroga. Në gjykata punojnë gjithsej 655 gjykatës.[325] Përpjesëtimi ndërmjet numrit të plotë të gjykatësve dhe popullsisë mbetet për 50% më i lartë nga mesatarja evropiane[326]. Rrogat e gjykatësve janë të përshtatshme, por nuk janë mjaft atraktive për të mbajtur kandidatët më të kualifikuar.[327] Zvogëlimi i rrogës mund të imponohet vetëm nga Këshilli Gjyqësor si masë disiplinore.[328]

Raporti i ESHR-së nga viti 2013 tregon që qasja e gjykatësve në veglat themelore të nevojshme për punë në masë të madhe varet nga gjykata[329]. Gjykata Themelore Shkupi 1 – Seksioni i specializuar gjyqësor përgjegjës për gjykimin e veprave nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsioni nuk ka resurse përkatëse dhe ka nevojë për personel plotësues dhe pajisje të modernizuara. Të gjitha gjykatat themelore kanë nevojë për këshilltarë ligjorë, daktilografë dhe tekste të rishikuara ligjore, ndërsa gjykatat nuk janë ende tërësisht të kompjuterizuara. Juritë gjyqësore dhe ekspertët nuk janë të paguar me kohë[330]. Përveç kësaj, qasja fizike në Gjykatën Themelore Shkupi 2, që vlen për më i frekuentuar, nuk është i përshtatshëm nuk ka ashensorë dhe nuk ka konstruksion për persona me nevoja të posaçme.

Në vitin 2014, buxheti fillestar për Akademinë ishte 568.227,00 EUR që ishte zvogëluar nga ribalansimi i buxhetit për 72.796,00 EUR.[331] Duke marrë parasysh rolin qendror në

[321] Buxheti i Republikës së Maqedonisë për 2012, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 180/211, f. 53, Buxheti i Republikës së Maqedonisë për 2013, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 167/2012) f. 53, Buxheti i Republikës së Maqedonisë për 2014, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 180/2013 f. 59.

[322] Emina Nuredinovska, Marija Sazdevski, Borjan Gjuzellov, "Raport i vlerësimit të korrupsionit në Maqedoni" (Shkup: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar 2014) f. 54

[323] Sipas buxhetit shtetëror, shpenzimet operative të pushteti gjyqësor për vitin 2012 kanë qenë 30.085.502 EUR me 2.999 të punësuar, në 2013 buxheti i plotë ka qenë 29.583.268 EUR me 3.043 të punësuar dhe buxheti i plotë për gjyqësorin në 2014 ka qenë 30.833.674 EUR me 2.965 të punësuar.

[324] Intervistë me Millka Ristovën, gjykatëse e pensionuar nga Gjykata Supreme e Maqedonisë (Interviste ballë për ballë) Shkup, 24 shkurt 2014.

[325] GREKO, 2014: f. 22, publikoi të dhënat vijuese: Në 2012 ka pasur 654 gjykatës, prej të cilëve 494 kanë punuar në gjyqet themelore, 103 në të apelit, 29 në Gjykatën Administrative, 12 në Gjykatën e Lartë Administrative dhe 16 në Gjykatën Supreme. Përveç kësaj, janë zgjedhur 1.844 gjykatës juri të marrin pjesë në gjykimet e gjykatave themelore dhe të apelit.

[326] Komisioni Evropian, 2014: f. 41.

[327] Intervistë me Millka Ristovën, gjykatëse e pensionuar nga Gjykata Supreme e Maqedonisë (Interviste ballë për ballë) Shkup, 24 shkurt 2014.

[328] Intervistë me Vladimir Pançevskin (përgjigje në pyetësor), 15 janar 2015.

[329] Intervistë me Millka Ristovën (Interviste ballë për ballë), Shkup, 24 shkurt 2014.

[330] Njëlloj.

[331] Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, "Raporti vjetor për punën e Akademisë së Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë për vitin 2014" (Shkup: Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publik, 2014), http://www.jpacademy.gov.mk/upload/Izvestai%20za%20Akademija/%D0%93%D0%9E%D0%94%D0%98%D0%A8%D0%95%D0%9D%20%D0%98%D0%97%D0%92%D0%95%D0%A8%D0%A2%D0%90%D0%88%202014.pdf [kontrolluar më15 shkurt 2015].

përmirësimin e profesionalizmit në gjyqësor. KE-ja konsideron që buxheti i Akademisë duhet të zmadhohet.[332]

Këshilli Gjyqësor është përgjegjës për mbledhjen e statistikës për gjyqësorin.[333]

Në gjykatat gradualisht instalohen sisteme bashkëkohore elektronike për shpërndarje dhe menaxhimin e rasteve. Megjithatë, nuk ka mjaft personel të trajnuar për punë me sistemet[334]. Orari i gjykimeve dhe seancave është shfaqur në gjykata.[335]

3.1.3 PAVARËSIA (E DREJTA)

Nota **50**

Sa është gjyqësori i pavarur sipas ligjit?

Pavarësia e gjyqësorit garantohet me Kushtetutën[336]. Vendimi për ndryshimin e Kushtetutës mund të miratohet në Kuvend me shumicë të dy të tretës nga numri i plotë i deputetëve.

KGJ-ja është përgjegjëse për emërimin, avancimin, shkarkimin dhe procedurat disiplinore për gjykatësit[337]. KGJ-ja zgjedh gjykatës për gjykatat themelore nga lista e kandidatëve të dorëzuar nga Akademia. Ekzistojnë rregulla të ndryshme për zgjedhje të gjykatësve në gjykatat më të larta në bazë të cilësive profesionale dhe reputacionit të kandidatëve[338]. KGJ-ja i zgjedh gjykatësit me votim të së paku dy të tretave nga anëtarët e KGJ-së që kanë të drejtë për votë[339]. Gjykatësit juri zgjidhen me mandat prej katër vitesh dhe mund të bëhet ri-zgjedhje të tyre.

Gjykatësit kanë mandat dhe mund të mbesin në funksionin e tyre deri në pensionim (64 vite për burra, 62 për gra). Mund të shkarkohen vetëm për arsye të theksuar në ligj (për shembull, akuzim për krime, me kërkesë të gjykatësit, humbje të aftësisë për të kryer funksione gjyqësore)[340] si dhe si rezultat i procedurë disiplinore dhe/ose procedurës për sjellje joprofesionale ose mashtrim gjatë kryerjes së mandatit gjyqësor[341]. Ka të drejtë ankese kundër vendimit disiplinor ose masë të miratuar nga KGJ-ja[342], para Këshillit për Vendosje për Ankesa[343] të themeluar nga Gjykata Supreme dhe i përpiluar nga nëntë anëtarë[344]. Kryetari i Gjykatës Supreme nuk mund të jenë anëtar i Këshillit për Vendosje të Ankesave,

[332] Komisioni Evropian, 2014: f. 41.
[333] Këshilli Gjyqësor i RM-së "Raporti i Këshillit Gjyqësor i RM për 2013 ", (Shkup: Këshilli Gjyqësor i RM-së, 2014), f. 20.
[334] Intervistë me Millka Ristovën (Interviste ballë për ballë), Shkup, 24 shkurt 2014.
[335] http://www.mio.gov.mk/?q=node/2045 (kontrolluar më28 nëntor2014).
[336] Kushtetuta e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/1992, neni98.
[337] Ligji për gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 58/2006, 35/2008, 150/2010, (U.nr.256/07, 74/08, 12/11),neni41. Përgjegjës për zgjedhjen dhe shkarkimin e gjykatësve profesionale, jurisë dhe kryetarëve të gjykatave dhe vlerësim të punës së gjykatësve, masave disiplinore dhe procedurave dhe tërheqjes së imunitetit gjyqësor.
[338] Ligji për gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 58/2006, 35/2008, 150/2010, (U.nr.256/07, 74/08, 12/11), neni46, dhe Ligji për Këshillat Gjyqësor, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.60/2006,150/2010,100/2011, neni41.
[339] Ligji për Këshillat Gjyqësorë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2006,150/2010,100/2011, neni42.
[340] Kushtetuta e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/92, Ndryshime dhe plotësime të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-se, nr. 107/2005; në kërkesë të gjykatësit, nëse tërësisht e humb aftësinë për kryerje të funksionit gjyqësor, që do të jetë e përcaktuar nga KGJ-ja; nëse i plotëson të gjitha kushtet e punësimit' nëse është gjykuar me vendim përfundimtar për shkelje penale të bërë me paramendim në dënim me burg pa kusht prej së paku gjashte muaj; nëse është zgjedhur ose emëruar në ndonjë funksion tjetër, përveç kur funksioni gjyqësor përkohësisht pezullohet sipas kushteve të caktuara me ligjin. Gjykatësi shkarkohet për shkak te shkeljes disiplinore që është i paaftë të kryejë funksionin e gjykatësit në përputhje me ligjin; për shkak të kryerjes joprofesionale dhe të pavetëdijshme të funksionit sipas kushteve të caktuara me ligj.
[341] Ligji për Këshillat Gjyqësorë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2006,150/2010,100/2011, neni53.
[342] Njëlloj.
[343] Këshilli për Vendosje mbi Ankesat e Këshillit Gjyqësor.
[344] Tre gjykatës nga Gjykata Supreme e RM-së, katër gjykatat nga katër gjykatat e apelit dhe dy nga gjykatat në të cilat zhvillohet procedura kundër gjykatësit.

ndërsa vendimi i Këshillit nuk mund të tërhiqet nga Gjykata Kushtetuese.[345]

Gjykatësi nuk mund të transferohet në vend tjetër kundër vullnetit të tij/saj.[346]

KGJ-ja përbëhet nga 15 anëtarë, prej të cilëve Kryetari i Gjykatës Supreme dhe ministri i Drejtësisë janë *ex officio* anëtarë, ndërsa tetë anëtarë zgjidhen nga gjykatësit e rendit të tyre.[347] Pesë anëtarët tjerë zgjidhen nga Kuvendi, më konkretisht, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe dy emërohen nga Kryetarit i RM-së dhe zgjidhen nga Kuvendi, prej të cilëve njëri duhet të jetë anëtar i komuniteteve që nuk janë shumicë në RM.

Komisioni i Venedikut rekomandon që të braktiset anëtarësia e ministrit të Drejtësisë dhe Kryetarit të Gjykatës Supreme nga KGJ[348]. GREKO, gjithashtu rekomandon që ministri i Drejtësisë nuk duhet të jetë anëtar i KGj-së, me qëllim që të përforcohet pavarësia e gjyqësorit nga ndikimi i padrejtë politik[349]. Në këtë drejtim, në Kuvend është dorëzuar propozim për ndryshim të dy funksionarëve me dy gjykatës, duke ardhur deri në 10 gjykatës në KGJ, prej të cilëve tre duhet të jenë përfaqësues të komuniteteve etnike që nuk janë shumicë[350]. Komisioni i Venedikut tregon që ndryshimi i Kushtetutës në mungesë të opozitës në Kuvend nuk është i përshtatshëm, sepse për ndryshime kushtetuese duhet mbështetje më e gjerë. Për momentin, anëtarët e KGJ-së zgjidhen me mandat prej gjashtë vitesh, me të drejtë të ri-zgjedhjes. Në përputhje me propozim ndryshimin e vitit 2014, anëtarët e KGJ-së nuk kanë të drejtë për ri-zgjedhje vijuese.[351]

Sipas Komisionit të Venedikut, anëtarësia e KGJ-së në të cilën dominojnë gjykatës do të krijonte "rrezik të korporatizmit" dhe KGJ-ja nuk do të duhet të izolohet nga mbikëqyrja e jashtme. Përveç kësaj, Komisioni i Venedikut rekomandon zvogëlimin e numrit të anëtarëve të KGJ-së.

3.1.4 PAVARËSIA (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle funksionon gjyqësori pa përzierje të Qeverisë ose aktorëve tjerë?

Pavarësia e gjyqësorit është kompromet uar. Ka përzierje politike në emërimin e gjykatësve, si dhe në vendimet për raste penale dhe në raste në të cilat janë rrezikuar interesat qeveritare, siç janë, për shembull, rastet me shpifje ose konteste zgjedhore[352]. Bisedat e përgjuara kanë zbuluar biseda të funksionarëve të lartë rreth emërimit dhe avancimit të gjykatësve. Ishte zbuluar që ministri i Punëve të Brendshme ka pasur listë të kandidatëve të kualifikuar dhe ka dhënë urdhra se kush të avancohet dhe cili emërim i pozitave më të larta të ndalohet.[353]

Vlerësohet se Këshilli Gjyqësor nuk vepron në mënyrë të pavarur dhe është nën ndikim të

[345] Ligji për Këshillat Gjyqësor, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2006,150/2010,100/2011, neni96.
[346] Ligji për Gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 58/2006, 35/2008, 150/2010 (У. бр.256/07, 74/08, 12/11, neni39 (6).
[347] Ligji për Këshillat Gjyqësorë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2006,150/2010,100/2011, neni6. Tre duhet patjetër të jenë anëtarë të komunitete që nuk janë shumicë në RM;
[348] Komisioni Evropian për Demokraci me anë të ligjit (Komisionit të Venedikut) "Mendim për shtatë amendamentet e Kushtetutës së IRJM-së në lidhje me këshillin gjyqësor, kompetenca e gjykatës kushtetuese dhe zonat speciale financiare" të miratuar nga Konventa e Venedikut në seancën e 100-të plenare (Romë: Komisioni Evropian, 10-11 tetor, 2014): f. 20.
[349] GREKO, 2014. 24 f.
[350] Propozim ndryshimet dhe plotësimet XXXIII, XXXIV, XXXVI, XXXVIII dhe XXXIX të Kushtetutës së RM-së.
[351] Komisioni i Venedikut, 2014: f. 12.
[352] Ilina Mangova, "A jep rezultate modeli për parandalimin e korrupsionit në Maqedoni?" *Faktorët kryesor të modelit të suksesshëm"* (*Shkup:* Instituti për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup (IDCDC), 2013.) f. 81.
[353] http://novatv.mk/index.php?navig=8&cat=18&vest=21055 [kontrolluar më19 mars 2015.).

pushtetit ekzekutiv.[354] Vlerësimi i KGJ-së për punën gjyqësore është përzgjedhës dhe pushteti ekzekutiv dhe partitë politike ndikojnë mbi emërimin, avancimin dhe shkarkimin e gjykatësve[355]. Përzierja politike në gjyqësor u zbulua me publikimin e bisedave telefonike të përgjuara në të cilët janë përfshirë politikanë dhe kryetari i KGJ-së[356]. Kryetari i Gjykatës Themelore Shkupi 1, sërish, pohon që "nuk ka transferim të gjykatësve, avancim ose mbrapsje si rezultat i përmbajtjes së vendimeve të tyre".[357]

Një numër i madh i gjykatësve janë shkarkuar. Këshilli Disiplinor është një organ për ankesa i themeluar nga Gjykata Supreme, i përbërë nga tre gjykatës nga Gjykata Supreme, katër nga Gjykata e Apelit dhe dy gjykatës të tjerë. Pjesëmarrja e gjykatësve në mekanizmin për kontroll konsiderohet që ndikon mbi pavarësinë, sepse mendohet që gjykatësit i ndjekin dëshirat e KGJ-së dhe nuk i vlerësojnë pavarësisht faktet që janë prezantuar në lidhje me mbështetjen e shkarkimit.

Një shembull për shkarkim është rasti "Justicia" në vitin 2014 në të cilin prokurori publik ka paraqitur kallëzime penale kundër 14 gjykatësve nga Gjykata Themelore Shkupi 1 dhe kundër 11 nëpunësve gjyqësorë nga gjykata e njëjtë për gjoja "keqpërdorimin e përgjegjësisë zyrtare dhe autorizimeve". Kryetari i KGJ-së shpalli pezullim të përkohshëm të gjykatësve. Ky rast konsiderohet si shembull i ndikimit të papërshtatshëm të jashtëm të pushtetit ekzekutiv në procedurat gjyqësore.[358]

Shpeshherë nuk sigurohen arsyet për shkarkim të gjykatësve. Në një rast, gjykatësi ishte shkarkuar 17 ditë para pensionimit[359]. Kryetari i Gjykatës Themelore Shkupi 1 në intervistë me hulumtuesin deklaroi që nuk ka shembuj në të cilët gjykatësit janë pezulluar pa dhënë arsye dhe vetëm në pak raste gjykatësit janë shkarkuar para skadimit të mandatit të tyre.[360]

Sipas Raportit të përparimit për vitin 2014, mandatet e gjykatësve duhet të mbrohen me ndryshimin e ligjit lidhur me procedurat disiplinore dhe shkarkimin, që nga ana tjetër, është tepër e ndërlikuar. KE-ja rekomandon përballim me punën e dobët të gjykatësve me anë të masave të korrigjimit, siç janë përmirësimet organizative dhe trajnimet, dhe jo me anë të urdhrave të shkarkimit ose penaleve disiplinore[361]. Në fakt, sistemi i përgjegjësisë të gjykatësve është ndërlikuar me prezantimin e "Këshillit për Përcaktimin e Llogaridhënies së Gjykatësve".[362]

Raporti i përparimit të vendit në vitin 2014 konstaton që ka disa "çështje rreth të cilave ka ndikim politik mbi procedura përkatëse gjyqësore". Në përputhje me anketën me gjykatësit, zbatuar nga Instituti për të Drejta të Njeriut nga Shkupi, 71.5% nga gjykatësit e anketuar janë përgjigjur që ka ndikim të shpeshtë ose pjesshëm nga degët tjera të pushtetit në vendimet për rastet. 27 gjykatës konsiderojnë që ky ndikim është praktikë e shpeshtë, ndërsa 18 gjykatës kënsiderojnë që kjo nuk është e shpeshtë.[363]

---

354 Intervistë me Millka Ristovën (Interviste ballë për ballë), Shkup, 24 shkurt 2014.

355 Margarita Caca Nikollovska, "Analiza e pavarësisë së gjyqësorit në Republikën e Maqedonisë – perceptime, vështirësi dhe sfida", Shkup: Instituti për të Drejta të Njeriut, Shkup 2013), f.146.

356 Bisedë ndërmjet Kryetarit të KGJ-së dhe shefit të kabinetit të Kryeministrit, bisedë ndërmjet partnerëve të koalicionit të bllokut maqedonas dhe shqiptar dhe bisedë ndërmjet ministrit për Punë të Brendshme që thekson që ka një fletore me emrat e personave të aprovuar dhe të janë të zgjedhur për gjykatës, dhe në fund ndërmjet drejtorit të UBK-së me dy kandidatë për gjykatës që janë të zgjedhur dhe punojnë si gjykatës.

357 Intervistë me Vladimir Pançevskin (përgjigje të pyetësorit), Shkup, 15 janar 2015.

358 Intervistë me Millka Ristovën (Interviste ballë për ballë), Shkup, 24 shkurt 2014.

359 Vendimi i parë ende nuk ka qenë finale kur është pensionuar, por edhe për këtë, procedura për aktivitete joprofesionale dhe jo-etike ka vazhduar dhe Gjykata Supreme ka marrë vendim për këtë rast konkret. Intervistë me Millka Ristovën (Interviste ballë për ballë), Shkup, 24 shkurt 2014.

360 Intervistë me Vladimir Pançevskin (përgjigje të pyetësorit), Shkup, 15 janar 2015.

361 Komisioni Evropian, 2014: f. 39.

362 Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 20/2015.

363 Nikollovska, 2014; f. 137.

QEVERISJA

3.2.1 TRANSPARENCA (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle janë vendosur dispozita që sigurojnë informata përkatëse për aktivitetet dhe proceset e marrjes së vendimeve të gjyqësorit që publiku mund të fitojë?

Gjykatësit obligohen të dorëzojnë fletë anketuese në KSHPK që janë të gatshme publikisht.[364]

Kryetari i gjykatës ose gjykatësi i emëruar nga kryetari mund të sigurojë informata për procesin e rasteve të caktuara. Secila gjykatë duhet të publikojë informata ditore për numrin e rasteve, emrin e gjykatësit në çdo rast dhe datë, kohën dhe gjykatën në të cilën do të zhvillohet procesi. Gjykatësit obligohen së paku njëherë në vit për të informojnë publikun për rezultatet nga puna e gjykatësve.[365]

Në përputhje me Kushtetutën, procedurat gjyqësore dhe publikimi i vendimeve duhet të jenë publike,[366] por publiku mund të përjashtohet në raste të përcaktuara me ligj[367]. Për shembull, publiku mund të përjashtohet nga një pjesë ose nga i gjithë procesi nëse është e nevojshme të mirëmbahet rendi publik, të mbrohet morali, të mbrohen jeta personale dhe private e të akuzuarve, dëshmitarëve ose të dëmtuarve, si dhe të mbrohen interesat e personave të moshuar[368]. Madje edhe në procedura në të cilat publiku është përjashtuar nga gjykimi, vendimi duhet të publikohet. Ndryshimet e fundit të Ligjit për Gjykatat përcaktojnë që vendimet gjyqësore duhet të publikohen në internet faqen e gjykatës në afat prej dy ditëve nga nënshkrimi i vendimit.[369]

Ligji nuk imponon ruajtjen e shënimeve nga procedurat gjyqësore. Në vend të shënimeve, mbahen proces verbale gjatë procedurave në gjykatë në të cilat duhet të theksohen çështjet kryesore[370]. Procesverbalet nuk janë publike dhe vetëm palët që marrin pjesë në rast kanë të drejtë të kontrollojnë dhe të marrin kopje nga dosja për rastin. Nëse dikush tjetër dëshiron të ketë qasje në dosje, duhet të kërkohet leje nga gjykatësi, nga Kryetari i Këshillit[371] ose nga kryetari i gjykatës[372].

Gjykata duhet të kenë zyrë për marrëdhënie me publikun e cila mund të japë informata plotësuese për vendime të publikuara në internet faqen e gjykatësit me kërkesë të palës së interesuar. Administrata gjyqësore[373] mund të organizojë lokale më të mëdha për persona gjatë kohës së gjykimeve që tërheqin më tepër interes publik.[374]

Gazetarët dhe qytetarët mund të marrin pjesë në seancë gjyqësore pa kërkuar paraprakisht aprovim nga gjykata. Në procedura gjyqësore, Kryetari i Gjykatës Supreme vendos nëse mund të publikohen publikisht në medie njoftime audio-vizuale dhe fotografi.[375]

---

[364] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, neni33.
[365] Ligji për gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-se, nr. 58/2006, 35/2008, 150/2010 (У. бр.256/07, 74/08, 12/11), neni97.
[366] Kushtetuta e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/92, neni102.
[367] Kushtetuta e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/92, neni102.
[368] Ligji për procedurë penale, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 15/97, 44, 2002, 74/2004, 83/2008, 67/2009, neni382.
[369] Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-se, nr. 150/2010, neni36.
[370] Rregullore gjyqësore, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/2013, neni191.
[371] Në disa raste, Këshilli Gjyqësor përbehet prej tre deri më pesë gjykatës.
[372] Rregullore gjyqësore, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/2013, neni93.
[373] Rregullore gjyqësore, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/2013, neni102.
[374] Rregullore gjyqësore, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/2013, neni101.
[375] Rregullore gjyqësore, Gazeta Zyrtare e RM-se, nr. 66/2013, neni104.

Nuk është e domosdoshme të publikohen informata për emërimin, transferimin dhe shkarkimin e gjykatësve, por këto vendime mund të gjenden në raporte dhe në internet faqet e gjykatave.

3.2.2 TRANSPARENCA (PRAKTIKA)

Nota **50**

Sa ka qasje publiku në informata gjyqësore dhe aktivitete në praktikë?

Në praktikë, sigurohet qasje në seanca gjyqësore. Megjithatë, qasja në informata shpesh është e kufizuar dhe nuk publikohen me kohë të gjitha vendimet gjyqësore.

Të gjitha gjykatat publikojnë raporte të rregullta për aktivitetet e tyre, shpenzimet dhe metodat e drejtimit.[376] Të gjitha raportet e dorëzuara nga gjykatat në Gjykatën Supreme janë të gatshme në internet faqen e Gjykatës Supreme[377]. Gjykatat publikojnë vendime dhe sigurojnë të dhëna statistikore[378]. Vendimet nuk publikohen çdoherë me kohë.[379] Gjykatat kanë departamente për marrëdhënie me publikun dhe mediet, ndërsa disa gjykata gjithashtu përdorin medie sociale siç është Fejsbuk, për të mundësuar që qytetarët të parashtrojnë pyetje dhe të marrin përgjigje.[380]

Shkresat dhe regjistrat tjerë të fshehtë nga procedurat gjyqësore janë të gatshme për publikun me anë të aplikacionit në përputhje me Ligjin për qasje të lirë në informata me karakter publik, por gjykatat vendosin sa informata do të publikohen në përputhje me obligimet e përcaktuar në Ligjin për informata të klasifikuara.[381]

Në përgjithësi, gjykatat janë të hapura dhe ka një hapësirë për publikun dhe për mediet. Gjyqtarët zakonisht lejojnë anëtarë të publikut dhe mediet të jenë të pranishme gjatë gjykimit, përveç në raste kur është caktuar me rregulla që publiku duhet të përjashtohet. Mediet duhet të kërkojnë leje për incizim të gjykimeve nga kryetari i gjykatës.[382]

Internet faqja e gjyqësisë rregullisht përditësohet me informata për konferencat për shtyp, orarin e gjykimeve ekzistuese, biografi të gjykatësve, raporte financiare, statistika gjyqësore dhe vendime përfundimtare anonime[383]. Ka një vegël për "Pyetje dhe përgjigje" në të cilën qytetarët mund të parashtrojnë pyetje për procedura përkatëse gjyqësore[384]. Në praktikë, publiku nuk është i informuar për emërimin, zhvendosjen dhe shkarkimin e gjykatësve.[385]

3.2.3 LLOGARIDHËNIA (E DREJTA)

Nota **75**

A janë vendosur dispozita për njoftim dhe përgjegësi të gjyqësorit për procedurat e tyre?

376 Intervistë me Vlladimir Pançevskin (përgjigje të pyetësorit), Shkup, 15 janar 2015.
377 http://www.vrhoven.sud.mk/VSUD/MatraVSUD.nsf/PravnaPodelba.xsp (kontrolluar më18 mars 2015).
378 http://www.osskopje1.mk/Novosti.aspx?novost=348 (kontrolluar më16 janar 2015).
379 http://www.dzlp.mk/mk/upraven_sudhttp://www.osohrid.mk/Novosti.aspx?novost=13, [kontrolluar më18 mars 2015.].
380 Si për shembull, Gjykata Themelore Shkup 1, https://www.facebook.com/pages/Osnoven-Sud-Skopje-1/172569432792924. (kontrolluar më12 mars 2015).
381 Intervistë me Vlladimir Pançevskin (përgjigje të pyetësorit), Shkup, 15 janar 2015.
382 Intervistë me Vlladimir Pançevskin (përgjigje të pyetësorit), Shkup, 15 janar 2015.
383 http://www.osskopje1.mk/Novosti.aspx?novost=348 (kontrolluar më16 janar 2015.)
384 http://www.osskopje1.mk/Novosti.aspx?novost=348 (qasur më16 janar 2015.)
385 Intervistë me Millka Ristovën (Interviste ballë për ballë), Shkup, 24 shkurt 2014.

Në përputhje me ligjin, gjykatësit duhet të japin sqarim për vendimet e tyre. Korniza ligjore është e ndërlikuar dhe përmban dispozita më të gjera për ankesa dhe sanksione disiplinore kundër gjykatësve. Ata gëzojnë nivel të lartë të imunitetit nga ndjekja për të gjitha llojet e krimit.

Në përputhje me ligjin, gjykatësit duhet të japin sqarime për vendimet e tyre: secili vendim gjyqësor duhet të përmbajë detaje për rastin, për gjykimin dhe për sqarimin[386]. Gjykimet pa sqarim duhet të anulohen, nëse në një vit kalendarik anulohen mbi 20% e numrit të plotë të rasteve të zgjedhura, ose 30% e numrit të plotë të rasteve të zgjedhura janë ndryshuar, konsiderohet që gjykatësi nuk është profesionist[387]. Ligji për gjykatat gjithashtu ndalon sjelljen joprofesionale dhe mashtrim gjatë kryerjes së funksionit gjyqësor, për shembull, sjellje e anuar në gjykime, vonesa në gjykim pa ndonjë bazë të caktuar, shkelje të rregullave të gjykimit të drejtë dhe prezantim publik të informatave dhe të dhënave për rast që nuk është marrë vendimi përfundimtar.[388]

Gjykatësit mund tu nënshtrohen dënimeve në përputhje me nenin 359 të Kodit penal për "pasurim të paligjshëm dhe fshehje të pronës" nëse dorëzohen informata të pasakta ose të paplota në fletët e tyre anketuese për gjendjen e pronës. Në përputhje me Ligjin për gjykata, mos paraqitja e pronës ose interesave dhe fshehja e pronës gjithashtu paraqesin shkelje disiplinore për të cilën gjykatësi mund të përgjigjet në procedurë disiplinore. Masat disiplinore për këto shkelje janë njoftime me shkrim, qortim publik ose ulje të rrogës në shumë prej 15% deri 30% të rrogës mujore të gjykatësit për periudhë prej një deri më gjashtë muaj.[389]

Gjykatësit kanë imunitet gjatë kryerjes së funksioneve të tyre[390]. Gjykatësi nuk mund të konsiderohet përgjegjës në kuptimin penal për mendim të dhënë në gjyq ose për vendim. Gjykatësi nuk mund të paraburgoset pa aprovim nga KGJ-ja, përveç nëse nuk është përcaktuar që ka kryer vepër penale që ka dënim me burg së paku prej pesë vitesh. Tërheqja e imunitetit të gjykatësve vendoset nga KGJ-ja me shumicë të dy të tretave nga numri i plotë i anëtarëve, me procedurë urgjente. KGJ-ja mund të vendosë të zbatojë imunitet mbi gjykatës madje edhe kur nuk mbështetet në imunitetin, nëse KGJ-ja mendon që ajo është e nevojshme për kryerjen e funksionit të gjykatësit.

Ligji për KGJ-në themelon dy procedura paralele për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit për shkelje disiplinore ose kryerje joprofesionale dhe jo-etike të detyrës së gjykatësit. Të dy procedurat mund të nisen me kërkesë të anëtarit të KGJ-së, kryetarit të gjykatës në të cilin punon gjykatësi, kryetarit të gjykatës më të lartë ose në seancë të përgjithshme të Gjykatës Supreme. Të dy procedurat janë urgjente, konfidenciale dhe zbatohen *in camera.* KGJ-ja mund të vendosë të zbatojë procedurë të hapur me kërkesë të gjykatësit kundër të cilit zhvillohet procedura. Të dy procedurat janë identike. Dallimi i vetëm është në atë që procedura për kryerje joprofesionale dhe jo-etike dhe është me kufizim kohor nëse kanë kaluar mbi pesë vite nga dita e shkeljes. Procedura për shkelje disiplinore gjithashtu është me kufizim kohor prej mbi tre vite nga shkelja.

Organi kompetent për procedura disiplinore kundër gjykatësve është KGJ-ja[391]. KGJ-ja themelon Komision Disiplinor që zbaton procedurën disiplinore[392], mbledh dëshmitë dhe informatat dhe dorëzon para KGJ-së propozim nëse duhet të zbatohet ose të shtyhet procedura disiplinore.[393]

[386] Ligji për gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 58/2006, 35/2008, 150/2010, (U.No.256/07, 74/08, 12/11).
[387] Ligji për gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 58/2006, 35/2008, 150/2010 (У. бр.256/07, 74/08, 12/11), neni75.
[388] Ligji për gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 58/2006, 35/2008, 150/2010 (У. бр.256/07, 74/08, 12/11), neni75.
[389] Ligji për gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 58/2006, 35/2008, 150/2010 (U.nr. 256/07, 74/08, 12/11), neni77, parag. 12 dhe neni78.
[390] Kushtetuta e RM-së. Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/92, neni100.
[391] Ligji për Këshillat gjyqësorë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2006,150/2010,100/2011, neni56.
[392] Njëlloj.
[393] Ligji për Këshillat gjyqësorë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2006,150/2010,100/2011, neni58.

Nëse KGJ-ja vendos që duhet të zbatohet procedurë, vendimi dorëzohet tek iniciatori dhe gjykatësi dhe dosja i dorëzohet Komisionit Disiplinor për zbatimin e procedurës[394]. Procedura mund të përfundojë me pezullim, masë disiplinore ose shkarkim të gjykatësit[395]. Gjykatësit mund të dorëzojnë ankesë kundër vendimit. Pës ankesën[396], vendos këshilli i themeluar nga Gjykata Supreme[397]. Vendimi përfundimtar publikohet në internet faqen e KGJ-se.

3.2.4 LLOGARIDHËNIA (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle anëtarët e gjyqësorit njoftojnë dhe janë përgjegjës për procedurat e tyre në praktikë?

Gjykatësit shpeshherë nuk japin sqarim për vendimet e tyre. Ka një numër të ankesave për punën e gjykatësve, që tregon se është lehtë të dorëzohen ankesa kundër gjykatësve. Me ankesat nuk veprohet çdoherë në mënyrë transparente dhe ka dyshime që imponohet një shtypje politike mbi procesin disiplinor për të shkarkuar disa gjykatës të caktuar.

Qytetarët shpesh e përdorin të drejtën e tyre për të dorëzuar ankesë kundër sjelljes së gjykatësit[398]. Sekretari i Përgjithshëm i KGJ-së është përgjegjës për përgjigjen e ankesave kundër gjykatësve dhe gjykatave nga qytetarë dhe subjekte juridike.[399] Në vitin 2013, prej gjithsej 1.061 ankesave, KGJ-ja ka caktuar që vetëm 41 ankesa dhe dëshmi janë me bazë.[400]

Procedurat disiplinore janë të përshpejtuara dhe urgjente dhe zbatohen pas dyerve të mbyllura, përveç nëse gjykatësi, që është lëndë e procedurës, nuk kërkon procedurë publike.[401] Ndryshimet dhe plotësimet e fundit[402] të procedurës disiplinore nuk kanë marrë parasysh çështjet e shprehura nga GREKO[403] në lidhje me mungesën e natyrës proporcionale të Këshillit Gjyqësor në procedurat disiplinore kundër gjykatësve dhe rreth shtypjeve politike për shkarkim të gjykatësve të caktuar. Përveç kësaj, GREKO thekson që në përputhje me standardet evropiane “gjykatësit nuk duhet të jenë personalisht përgjegjës nëse vendimi i tyre anulohet ose ndryshohet gjatë ankesës“.

GREKO rekomandon (I) përcaktim të qartë shkeljeve disiplinore që kanë të bëjnë me gjykatësit dhe zgjerimin e shtrirjes së sanksioneve për të siguruar proporcion më të mirë dhe (II) shkarkimi i gjykatësit të jetë i mundshëm vetëm për rastet më serioze të punës së keqe dhe në kohën më të shpejtë të mënjanohet mundësia për shkarkimin e gjykatësit vetëm në bazë të faktit që një vendim i tij/saj është në kundërshtim me gjykimin e drejtë[404]. Komisioni për Përcaktimin e Fakteve dhe Nisjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë i ri për momentin nuk i plotëson këto rekomandime nga GREKO.[405]

---

394 Detajet janë caktuar në Pyetësorin për Procedurë për përgjegjësi disiplinore të gjykatësve, Këshilli Gjyqësor, 30 janar 2007.
395 Këshilli Gjyqësor, takim i mbajtur më 31 janar 2007.
396 Ligji për gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 58/2006, 35/2008, 150/2010, (U.No.256/07, 74/08, 12/11), Article,74, 76, 78.
397 Ligji për gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 58/2006, 35/2008, 150/2010 (U.No.256/07, 74/08, 12/11), neni96.
398 Intervistë me Millka Ristovën (Interviste ballë për ballë), Shkup, 24 shkurt 2014.
399 Ligji për Këshillat Gjyqësorë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2006,150/2010,100/2011, neni31.
400 Këshilli Gjyqësor i RM-së, 2013; f. 27-28.
401 Këshilli Gjyqësor i RM-së, 2013, f. 10.
402 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshill Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë , Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 20/2015.
403 GREKO, 2014; f. 2
Këshilli Gjyqësor i RM-së, 2013, f. 10.
404 GREKO, 2014, f. 38.
405 Njëlloj.

3.2.5 MEKANIZMAT PËR INTEGRITET (E DREJTA)

Nota **75**

A ekzistojnë mekanizma me të cilat do të sigurohej integriteti i anëtarëve të pushtetit gjyqësor?

Janë vendosur rregulla të gjera në lidhje me integritetin e gjykatësve. Kodi i etikës gjyqësore nuk siguron drejtime të qarta për zbatimin e masave të integritetit. Nuk ka rregulla me të cilat do të mund të ndalohen gjykatësit të kalojnë në sektorin privat pas dorlheqjes nga puna ose pas shkarkimit të tyre.

Funksioni gjykatës nuk mund të ndërlidhet me kryerjen e funksioneve tjera publike ose profesione ose anëtarësim në parti politike. Organizmi politik dhe aktiviteti politik në gjyqësori janë të ndaluar me nenin 100 të Kushtetutës.[406]

Gjykatësit nënshtrohen në Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe Ligjin për parandalim të konfliktit të interesave. Gjykatësit obligohen të publikojnë pronën e tyre dhe me kohë të informojnë për ndryshime të pronës së tyre.[407] Fletat anketuese dorëzohet në KSHPK dhe në DHP. Çdo rritje e pronës, pa dallim nëse ky ndryshim ka të bëjë me gjykatës ose anëtar të familjes, duhet të paraqitet në KSHPK dhe DHP[408]. Mund të fillohet procedurë për kontrollin e pronës së gjykatësit nëse nuk sigurohen të dhëna ose nuk paraqitet ndryshimi i pronës ose nëse janë dorëzuar të dhëna të pasakta ose nëse ka rritje të shpejtë të pronës[409]. Gjykatësit, si dhe bartësit tjerë të funksioneve publike, kanë për obligim të dorëzojnë deklaratë të vërtetuar në noter me të cilën tërhiqen dispozitat për sekrete bankare në lidhje me të gjitha llogaritë vendore ose të huaja.[410]

Kodi i parë i etikës gjyqësore (2006) dhe i dyti (2014) ishin miratuar nga Shoqata e Gjykatësve të Maqedonisë (SHGJM) [411]. Kodi i etikës gjyqësore është një përmbledhje e parimeve dhe rregullave të sjelljes që duhet të respektohet nga secili anëtar i SHGJM-së gjatë kryerjes së funksionit[412]. Me kërkesë të gjykatësve ose të SHGJM-së, bordi këshillimor në kuadër të SHGJM-së jep këshilla për zbatimin e kodit, përfshirë edhe si të veprohet në raste të konfliktit të interesave dhe korrupsionit[413]. Të gjithë gjykatësit nuk janë anëtarë të SHGJM-së dhe kodi nuk është i obligueshëm për të gjithë gjykatësit. Duhet një kod i unifikuar që do të vlejë për të gjithë gjykatësit. Në kodin nuk ka procedurë të qartë për pranimin e dhuratave ose përfitimeve tjera.

Dhuratat janë të rregulluara me disa akte ligjore. Ligji për gjykata u ndalon gjykatësve të pranojnë dhurata ose të mira tjera lidhur me funksionin gjyqësor[414] dhe kjo gjë konsiderohet si shkelje disiplinore[415]. SHGJM-ja u ndalon gjykatësve të pranojnë dhurata ose premtime

[406] Ligji për Gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 58/2006, 35/2008, 150/2010 (У. бр.256/07, 74/08, 12/11), neni52, parag. 6p
[407] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, neni33-a, parag. 1.
[408] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, neni34.
[409] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, neni36.
[410] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, neni36.
[411] Shoqata e Gjykatësve të Maqedonisë është organizatë joqeveritare në të cilën ka pjesëtarë aktiv dhe gjykatës të pensionuar në Republikën e Maqedonisë, ndërsa gjykatësit në RM të emëruar në gjykata ndërkombëtare mund të bëhen anëtarë në baza vullnetare.
[412] http://www.mja.org.mk/ [kontrolluar më16 shkurt 2015.].
[413] Intervistë me Nikollço Nikollovskin, Shkup, 6 shkurt 2015.
[414] Ligji për gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 58/2006, 35/2008, 150/2010 (У. бр.256/07, 74/08, 12/11), neni58.
[415] Ligji për gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 58/2006, 35/2008, 150/2010 (У. бр.256/07, 74/08, 12/11), neni77.

për dhurata[416]. Megjithatë, gjykatësit mund të pranojnë dhurata personale në vlerë deri më 200 EUR, nëse dhuratën e jep ndonjë shtet i huaj, autoritet, institucion ose organizatë ndërkombëtare.[417]

Nuk ka kufizime për punësimin e gjykatësve të dalluar pas mandatit. Praktikantët konfirmojnë[418] që rregullat ekzistuese nuk imponojnë asnjë kufizim rreth punësimit të gjykatësit pas mandatit të tij/saj dhe gjykatësi mund të emërohet në çdo pozitë tjetër (në sektorin publik dhe privat) pas përfundimit të funksionit të gjykatësit.[419]

Në përputhje me nenet 28 dhe 29 të SHGJM-së, nëpunësit publikë obligohen të informojnë KSHPK-në nëse pas përfundimit të mandatit të tyre të ndërmarrin aktivitete të caktuara komerciale në fushën në të cilën kanë punuar. Nuk është theksuar që këto rregulla vlejnë edhe për gjykatës, ndërsa ligji nuk përmban sanksione nëse nëpunësit nuk i respektojnë rregulloret.[420]

3.2.6 MEKANIZMI PËR INTEGRITET (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle sigurohet integriteti i anëtarëve të pushtetit gjyqësor në praktikë?

Integriteti i anëtarëve të pushtetit gjyqësor në praktikë nuk sigurohet. Kodi i etikës gjyqësore përbëhet nga parime, por nuk siguron drejtime të qarta për gjykatësit.

Në përgjithësi, gjykatësit e respektojnë obligimin për të publikuar pronën e tyre[421], por në masë të madhe nuk përditësohen deklaratat[422]. Deklaratat publikohen në internet faqen e KSHPK-së, por nuk ka mekanizëm për ndjekjen e saktë të ndryshimeve të pronave të gjykatësve sepse në internet faqe nuk publikohet data e dorëzimit ose ndryshimit të deklaratës për gjendjen e pronësisë[423]. KSHPK-ja ka njoftuar që rastet e lidhura me çështje të deklaratave për gjendjen pronësore të gjykatësve dhe konflikte të interesave janë zvogëluar në 31 në vitin 2013,[424] në krahasim me 71 raste të vitit 2012.[425]

Rregulloret për rregullimin e konflikteve të interesit të gjykatësve në praktikë në përgjithësi respektohen. Gjykatësit kuptojnë që nëse nuk tërhiqen nga raste në të cilat ka konflikt të interesave, vendimin që do të merrnin mund të anulohet në bazë të konfliktit të interesave. Vetë gjykatësit shpeshherë kërkojnë tërheqje nga rastet.[426]

Në praktikë, nuk ka shumë gjykatës që e braktisin gjyqësinë për të ikur në sektorin privat. Megjithatë, GREKO u rekomandon autoriteteve të përballen me pyetjet rreth kufizimit të punësimit të gjykatësve pas largimit të tyre nga gjyqësia, për shembull, me azhurnimin e Kodit të etikës gjyqësore. Por, kjo çështje nuk është përfshirë në Kodin e etikës gjyqësore të re të miratuar në dhjetor të vitit 2014.

---

416 Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, neni30.
417 Ligji për përdorimin dhe shfrytëzimin e gjërave të organeve shtetërore, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 8/2005, neni77.
418 Intervistë me Millka Ristovën (Interviste ballë për ballë), Shkup, 24 shkurt 2014.
419 Njëlloj.
420 Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, neni29.
421 Intervistë me Millka Ristovën (Interviste ballë për ballë), Shkup, 24 shkurt 2014.
422 Njëlloj.
423 KSHPK, (e gatshme në http://www.dksk.org.mk/imoti_2/.)
424 KSHPK, Raporti Vjetor për vitin 2013, (Shkup: KSHPK, 2013), f. 24.
425 KSHPK, Raporti Vjetor për vitin 2013, (Shkup: KSHPK, 2013), f. 24.
426 Intervistë me Millka Ristovën (Interviste ballë për ballë), Shkup, 24 shkurt 2014.

Gjykatësit obligohen të dorëzojnë deklarata për konflikte të interesave në KSHPK. Në vitin 2013, KSHPK i kontrolloi deklaratat për interes[427] dhe filloi procedura penale kundër 32 gjykatësve për mos dorëzim të deklaratave.[428] Vetëm në dy raste procesi i kontrollit tregoi që interesat e gjykatësve nuk janë në përputhje me funksionin (gjykatës në Gjykatën Kushtetuese dhe gjykatës në Gjykatën e Apelit në Manastir).[429]

Dispozitat me të cilat gjykatësit obligohen të paraqesin dhuratat dhe mikpritjen nuk zbatohet në praktikë dhe gjykatësit nuk paraqesin dhuratat ose mirëpritjet.[430]

Ndonëse janë bërë disa ndryshime të kuadrit ligjor për të rritur pavarësinë e integritetin e gjyqësorit, konsiderohet që ka nivel të lartë të korrupsionit në sistemin gjyqësor. Rreth 74% e qytetarëve besojnë që gjykatësit janë të korruptuar. Megjithatë, ky mendim i qytetarëve është si rezultat i disa veçorive të sistemit gjyqësor.[431]

ROLI

3.3.1 MBIKËQYRJA EKZEKUTIVE

Nota **50**

Sa është efektive mbikëqyrja e gjyqësorit mbi pushtetin ekzekutiv?

Gjykata Kushtetuese mund të anulojë ose tërheq ligje për të cilat mendon që nuk janë në përputhje me Kushtetutën dhe para saj përgjigjet Kryetari i Republikës[432]. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare.[433]

Gjykata Administrative ka kompetencë gjyqësore të kontrollojë procedurat dhe vendimet e pushtetit ekzekutiv. Por, pushteti ekzekutiv nuk i respekton mjaftueshëm dhe nuk i zbaton vendimet gjyqësore në kuptim të realizimit të kompetencës përkatëse.

3.2.2 NDJEKJA E KORRUPSIONIT

Nota **50**

Sa i është dedikuar gjyqësori luftës kundër korrupsionit me anë të ndjekjes ose aktiviteteve tjera?

Gjyqësorit i mungon evidencë për përballimin me raste të korrupsionit në nivelin e lartë. Duhet një bashkëpunim më i mirë ndërmjet agjencive për të përcaktuar fushat problematike në përpjekjet për të parandaluar korrupsionin.[434]

Në vitin 2008 ishte themeluar një departament në Gjykatën Themelore Shkupi 1, i specializuar për raste lidhur me korrupsionin dhe krimin e organizuar[435]. Ky departament

[427] KSHPK, 2013), f. 37-38.
[428] Komisioni Evropian, 2014: f. 42.
[429] KSHPK, 2013, f. 37-38.
[430] Intervistë me Millka Ristovën (Interviste ballë për ballë), Shkup, 24 shkurt 2014.
[431] Nuredinovska, Sazdevski, Gjuzellov, 2014., f. 10.
[432] Kushtetuta e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/1992, neni108.
[433] Kushtetuta e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/1992, neni112.
[434] Komisioni Evropian, 2014: f. 11.
[435] Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 35/2008.

është përgjegjës për shkelje të kodit penal nga funksionarë publikë: keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe kompetencë; pranimi i ryshfetit me vlerë të madhe dhe ndërmjetësimi i paligjshëm.[436] Gjykata Themelore Shkupi 1 gjithashtu ka një departament të specializuar për ndihmë ligjore ndërkombëtare.[437]

Sipas Gjykatës Themelore Shkupi 1, gjykata ka punuar në 1.768 raste të krimit të organizuar (përfshirë 97 për korrupsion) në vitin 2012, prej të cilave 1.615 raste kanë qenë të përfunduara.

Prej vitit 2007 deri në vitin 2013, Departamenti për Krim të Organizuar në Gjykatën Themelore Shkupi 1 ka regjistruar 866 raste të korrupsionit, prej të cilëve 466 kanë qenë të zgjedhur. Raporti për përparim nga KE-ja për vitin 2014 ka shënuar ulje prej 50% të vendimeve për shkelje të korrupsionit (63 në krahasim me 123 në vitin 2012), 56 akuzime për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe 3 për ryshfet.[438]

REKOMANDIME

R1. Këshilli Gjyqësor duhet të sigurojë zbatim të plotë të emërimit dhe avancimit të gjykatësve në bazë të meritave, me çfarë do të përforcohet pavarësia, paanësia dhe integriteti i gjyqësorit.

R2. Këshilli Gjyqësor duhet të zhvillojë Kod të etikës gjyqësore të unifikuar me udhëzime për zbatim të tij dhe të vlejë për të gjithë gjykatësit.

R3. Këshilli Gjyqësor duhet të vendosë rregulla dhe rregullore për gjykatës në lidhje me pranimin e dhuratave, mikpritjes dhe dobive tjera.

[436] Ligji për gjykatat, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 58/2006, 35/2008, 150/2010 (U. nr.256/07, 74/08, 12/11), neni32.
[437] Intervistë me Vladimir Pançevskin (përgjigje të pyetësorit), Shkup, 15 janar 2015.
[438] Emilija Tupanzhiska-Gjorgjievska, "Raporti për monitorimin e rreziqeve nga korrupsioni dhe krimi i organizuar" (Shkup: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, 2015) f. 40.

4. SEKTORI PUBLIK

PËRMBLEDHJE

Korniza ligjore që rregullon pavarësinë, transparencën, llogaridhënien dhe integritetin e sektorit publik është gjithëpërfshirëse, por zbatimi në praktikë është në nivel të ultë. Ligjet dhe trupat ekzistuesë, që kanë për qëllim të sigurojnë sjellje etike ndërmjet të punësuarve në sektorin publik nuk janë efektive. Ato përfshijnë kode të ndryshme të sjelljes, rregulla për pranimin e dhuratave dhe shërbimeve, kufizime për punësimin, politika për konflikt të interesave dhe trupa të integritetit. Dispozitat zbatohen në mënyrë përzgjedhëse.

Shteti është punëdhënësi më i madh në Maqedoni, kryesisht, për shkak të mundësive në sektorin privat. Praktika e Qeverisë të krijojë vende të reja të punës për personat e rrezikuar socialë, si dhe për shpërblim të anëtarëve të partive politike me vende të punës në sektorin publik, në mënyrë artificiale ka rritur shërbimin publik. Punësimet e bazuara në anëtarësim në parti politike konsiderohet si praktikë “normale” në vend dhe nuk ka institucion shtetëror që merret me problemin e partizimit të sektorit publik. Fondet ekzistuese të shërbimit publik nuk janë në përputhje me nevojat.

Nuk ka procedura për mbikëqyrje të zbatimit të marrëveshjeve të dhëna me anë të procedurave për Furnizime Publike.

NOTA E PËRGJITHSHME PËR SHTYLLËN: 42,3/100

DIMENSIONI	TREGUESI	E DREJTA	PRAKTIKA
Kapaciteti 41,6/100	Resurset	/	50
	Pavarësia	75	0
Qeverisja 54,1/100	Transparenca	75	50
	Llogaridhënia	75	25
	Integriteti	75	25
Roli 31,25/100	Njoftimi e publikut	25	
	Bashkëpunimi me institucione publike, organizatat e sektorit civil dhe agjencitë në luftën kundër korrupsionit	25	
	Zvogëlimi i rreziqeve nga korrupsioni me anë të mbrojtjes së integritetit të prokurimit publik	50	
	Mbikëqyrja e NP-ve	25	

Vlerësimi për shtyllën sipas të drejtës dhe praktikës



STRUKTURA DHE ORGANIZIMI

Gjatë përgatitjes së kësaj analize, korniza ligjore për shërbimin publik bazohej në dy ligje kryesore: Ligjin për nëpunës shtetërorë[439] dhe Ligjin për nëpunës publikë[440]. Termi "administratë publike" është më i gjerë se "administratë shtetërore". Në administratën publike janë përfshirë edhe të punësuarit dhe institucionet nga fusha e arsimit, shëndetësisë, kulturës dhe veprimtaritë sociale.

Në shkurt të vitit 2014 u prezantuan Ligji për nëpunës administrativë (LNA) dhe Ligji për të punësuarit në sektorin publik (LPSP) që i kanë zëvendësuar ligjet ekzistuese. LNA-ja i ka sqaruar procedurat për plotësimin e vendeve të reja të punës me anë të punësimit, avancimit dhe lëvizjes, të bazuara mbi parimet e njohurive profesionale, kompetencave, qasjes së barabartë dhe transparencës. Ligji i obligon nëpunësit shtetërorë të vizitojnë trajnime të përgjithshme dhe të specializuar dhe prezanton konceptin e mentorimit, si dhe të sistemin e menaxhimit me efektin.

Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA) është përgjegjëse për koordinim të reformave në administratën publike, por koordinimi është i dobët[441]. Agjencia e Administratës (AA) është trup anonim shtetëror që përgjigjet para Kuvendit dhe merr përgjegjësi për zbatimin e ligjvënies për shërbimin shtetëror/publik.

Rregulla që përcaktojnë konflikt të interesave janë të përcaktuara në Kodet etike të nëpunësve shtetërorë/publikë si dhe në Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave, Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe Ligjin për përdorimin dhe marrjen e gjësendeve të organeve shtetërore.[442]

[439] Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.59/2000, 112/2000, 34/2001, 103/2001, 43/2002, 98/2002, 17/2003, 40/2003, 85/2003, 17/2004, 69/2004, 81/2005, 61/2006, 36/2007, 161/2008, 6/2009, 114/2009, 35/10, 167/10, 36/11, 6/12, 24/12, 15/13, 82/13, 106/2013), neni 3
[440] Ligji për nëpunës publikë, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.2/2010, 36/2011, 6/2012, 24/2012, 15/2013, 82/2013, 106/2013 dhe 132/2014
[441] Komisioni Evropian, 2015: f. 11.
[442] Ligji për shfrytëzim dhe disponim me sendet në pronë shtetërore, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.98/2008, 145/2010, 104/2013.

VLERËSIMI

KAPACITETI

4.1.1 RESURSET (PRAKTIKA)

Nota **50**

Në çfarë mase sektori publik disponon me resurse përkatëse për kryerjen efektive të detyrave?

Gjatë pesë viteve të fundit, Qeveria ka prezantuar katër pako kundër krizës, masa për sektorin publik[443]. Në vitin 2014 ka prezantuar edhe kufizim kohor për punësime të reja në administratën shtetërore dhe sektorin publik që ende është në fuqi[444]. Gjithashtu, është ndaluar plotësimi i vendeve të punës të zbrazura për shkak të pensionit me qëllim që të mundësohet kursimi i buxhetit shtetëror.[445] Përjashtim për këtë ndalim janë vendet e punës lidhur me Programin kombëtar për miratimin e të drejtës së BE-së dhe obligimet lidhur me punësimet e anëtarëve të komuniteteve pakicë, në përputhje me Marrëveshjen kornizë të Ohrit[446]. Në realitet, numri i vendeve të punës për nëpunës publikë vazhdoi të rritet[447]. Kufizimet që ishin imponuar për rritje të rrogave dhe shpenzimeve ishin zvogëluar[448]. Nuk ka ndalesa për prokurim të gjërave, siç janë mobile, pajisje dhe automjete dhe zvogëlim të numrit të udhëtimeve zyrtare.

Fondet e shërbimit publik nuk janë përcaktuar në bazë të nevojës dhe funksioneve, por janë përcaktuar nga nevojat e partive politike për të punësuar anëtarët e tyre.[449]

Në nëntor 2014, rrogat e të punësuarve në administratë janë rritur për 4%, që ishte mundësuar me anë të miratimit të ligjit me procedurë të ultë dhe pa konsultime. Buxheti për vitin 2015 është buxheti më i madh deri tani (3 miliard EUR).[450]

Shteti edhe më tutje është punëdhënësi më i madh në kushte të mungesës së mundësive për punësim në sektorin privat[451] dhe praktikë e vendosur e Qeverisë për të krijuar vende të reja të punës për personat e rrezikuar socialë dhe të punësojë në baza politike, me çfarë në mënyrë artificiale është rritur shërbimi shtetëror.

MSHIA është përgjegjës për përmirësim të menaxhimit me resurse njerëzore. Ministria ka nisur një anketë për matjen e angazhimit të punës dhe kënaqësisë së të punësuarve në 85 institucione shtetërore. Deri më tani janë përgjigjur më tepër se 80% të nëpunësve shtetërorë/publikë, ndërsa rezultatet kanë qenë në kuadër të mesatares ndërkombëtare për kënaqësinë e të punësuarve në administratën shtetërore.[452]

---

443 http://arhiva.vlada.mk/?q=node/2749 [kontrolluar më 25 nëntor2014]
444 Njëlloj.
445 Njëlloj.
446 Njëlloj.
447 http://prijava.aa.mk/default.aspx [kontrolluar më 24 nëntor 2014]
448 http://arhiva.vlada.mk/?q=node/2749 [kontrolluar më 24 nëntor 2014]
449 Intervistë me Malinka Ristevska-Jordanova, drejtore e Institutit për politika evropiane, ish këshilltare shtetërore në Sekretariatin për Çështje Evropiane, 19.12.2014 (Bisedë private mes dy personave).
450 http://faktor.mk/archives/123155?utm_source=rss&utm_medium=rss&utm_campaign=budzet-2015-zgolemenite-plati-i-penzii-nabildaa-budzet-od-3-milijardi-evra [kontrolluar më 25 nëntor2014]
451 http://www.makdenes.org/content/article/25207114.html, Државата е најголем работодавач [kontrolluar më 24 nëntor2014).
452 Sigma/OECD, *Vlerësim 2013*, (Bruksel: Sigma/OECD, 2013), f. 11.

4.1.2 PAVARËSIA (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë mase pavarësia e sektorit publik është mbrojtur me ligj?

Janë vendosur procedura të hollësishme për punësim të nëpunësve publikë, në përputhje me procese transparence të bazuara mbi profesionalizmin dhe kompetencat e kandidatëve. Në proceset e punësimit në sektorin publik, procedurat, gjithashtu kërkojnë që të respektohet parimi i përfaqësimit të drejtë të anëtarëve të komuniteteve.[453]

Të punësuarit në sektorin publik obligohen që punët të bëjë me drejtësi, profesionalizëm, efikasitet, rregullt dhe me kohë, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin[454]. Nëpunësi shtetëror/publik është i obliguar që të bëjë punën me paanësi dhe pa ndikim të partive politike, të mos udhëhiqet nga besimet politike ose nga interesat personale financiare dhe është i obliguar që të mbrojë reputacionin e sektorit publik[455]. Të punësuarit në sektori publik nuk guxojnë të marrin pjesë në fushata zgjedhore ose ngjarje tjera të këtij karakteri gjatë kohës së punës dhe nuk guxojnë të mbajnë ose theksojnë simbole partiake në hapësirën e punës.[456]

Nëpunësve publikë mund tu shqiptohen masa disiplinore për shkak të mosrespektimit të këtyre rregullave nga komisioni disiplinor që e drejtojnë personin udhëheqës ose sekretarin e institucionit. Ato kanë të drejtë të paraqesin ankesë[457] në gjykatën kompetente, sindikatë ose autoritet tjetër kompetent.[458]

Si organ i shkallës së dytë, për ankesat dhe apelet vendos organi për nëpunës shtetërorë – Agjencia për Administratë dhe ndërmerr masa tjera të përcaktuara me ligj.[459]

4.1.3 PAVARËSIA (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë mase sektori publik është liruar nga përzierja e jashtme gjatë aktiviteteve?

Politizimi i sektorit publik është një problem serioz[460]. Nëpunësit publikë shpeshherë degradohen në vende më të ulta të punës, veçanërisht pas ndryshimit të pushtetit[461].

---

[453] Ligji për nëpunës shtetërorë, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.59/2000, 112/2000, 34/2001, 103/2001, 43/2002, 98/2002, 17/2003, 40/2003, 85/2003, 17/2004, 69/2004, 81/2005, 61/2006, 36/2007, 161/2008, 06/2009, 114/2009, 35/2010, 167/2010, 36/2011, 6/2012, 24/2012, 15/2013, 82/2013, 106/2013 dhe 132/2014 si dhe vendimet e gjykatave kushtetuese); Ligji për nëpunës shtetërorë(„Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr.52/2010, 36/2011, 6/2012, 24/2012, 15/2013, 82/2013, 106/2013 dhe 132/2014). Vendime të Gjykatës kushtetuese e RM, nr.83/2010 më 8 qershor 2011, të shpallur në „Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr.86/2011; nr.77/2011 më 2 shtator 2011, shpallur në „Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr.132/2011; nr.184/2011 më 15 shkurt 2012, shpallur në „Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr.27/2012, nr.221/2011 më 11 mars 2012, shpallur në „Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr.53/2012; nr.42/2012 më 9 maj 2013, shpallur në „Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr.70/2013, nr.55/2012 më 24 prill 2013, shpallur në „Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr.75/2013 dhe nr.63/2013 më 8 tetor 2014, shpallur në „Gazeta Zyrtare e RM“ nr.156/2014.

[454] Njëlloj.

[455] Kodeksi etik i nëpunësve shtetërorë, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.59/2000, 112/2000, 34/2001, 103/2001, 43/2002, 98/2002, 17/2003, 40/2003, 85/2003, 17/2004, 69/2004, 81/2005, 61/2006, 36/2007, 161/2008, 06/2009, 114/2009, 35/2010, 167/2010, 36/2011, 6/2012, 24/2012, 15/2013, 82/2013, 106/2013 dhe 132/2014 si dhe vendimet nga Gjykata Kushtetuese); Kodeksi etik i nëpunësve shtetërorë (Gazeta Zyrtare e RM-së nr.133/2011, 139/2011).

[456] Njëlloj.

[457] Njëlloj.

[458] Njëlloj.

[459] Njëlloj.

[460] Komisioni Evropian, 2014: f. 7.

[461] Sigma/OECD, „Vlerësimi i shërbimit publik dhe kornizës administrative“ (Bruksel/OECD, 2008).

Nëpunësit publikë shpërndahen në vende të punës me nivel më të ultë dhe përgjegjësi më të ultë me çfarë lirohen vendet më të larta për nëpunës tjerë publikë që do të plotësohen me "shpërndarje" të paarsyetuar[462]. Ligji që mundëson degradime në situata të caktuara keqpërdoret[463], por ndonëse mundësia për këto degradime është përcaktuar me ligj, janë të lejuara vetëm në disa raste të caktuara, siç janë notë e "pakënaqshme" në kuadër të sistemit për drejtim me efektin ose gjatë ndryshimeve organizative që përfshijnë ulje të vendeve të punës.

Nuk ka institucione që kanë për qëllim të mbrojnë sektorin publik nga përzierja politike. Punësimi në bazë të anëtarësimit të parti politike konsiderohet si praktikë normale[464]. Avokati i Popullit prej kohe në kohe ka ngritur problemin e politizimit të sektorit publik me anë të raporteve dhe ka dhënë rekomandime të cilat nuk janë zbatuar.[465]

As Kryetari, e as Kuvendi dhe MSHIA -ja nuk e trajtuan këtë çështje.[466]

Emërimet bëhen sipas listave me anëtarë partiakë të përgatitur nga partitë politike në pushtet, pa i marrë parasysh kualifikimet dhe kompetencat e kandidatëve. Anëtarët e partive politike i kalojnë provimet për nëpunës shtetëror me rezultate maksimale, ndërsa komisionet për zgjedhje të nëpunësve publikë këtyre kandidatëve u japin pikë më të larta kur kryejnë intervistë dhe në atë mënyrë vendosen larë në listat e personave që kualifikohen për emërime të vendeve të punës në sektorin publik.[467]

Obligimi për sigurim të përfaqësimit të drejtë të komuniteteve të ndryshme pakicë në sektorin publik gjithashtu mundëson praktika anësore të punësimit. Partitë politike që i përfaqësojnë pakicat çdoherë janë pjesë e koalicioneve qeveritare[468]. Sekretariati për Zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (SZMKO-ja) është përgjegjës për menaxhim me nën-programin buxhetor (K-5) që ka për qëllim punësimin e nëpunësve shtetërorë/publikë nga komunitetet e pakicave. Një numër i anëtarëve të pakicave të ndryshme janë punësuar nga SZMKO-ja me anë të këtij programi[469]. Kandidatët e zgjedhur më pas janë shpërndarë nëpër ministritë ose organizatat shtetërore, ndërsa nevojat reale për kuadro të institucioneve nuk janë marrë parasysh.[470]

Në vitin 2000 ishte themeluar Agjencia për Nëpunës Shtetërorë – Agjencia e Administratës, si organ shtetëror autonom që përgjigjet para Kuvendit. Si organ i pavarur, duhet të mbrojë interesat e shërbimit publik. Megjithatë, pasi që MSHIA-ja ka marrë përgjegjësinë për koordinim të reformës në administratën publike, pavarësia e saj u zvogëlua, por nuk i mbron interesat e shërbimit publik[471]. MSHIA-ja është kritikuar për mungesë të efikasitetit dhe ka dyshime që në mënyrë efektive do të koordinojë administratën publike dhe do të zbatojë reformën në administratën publike.[472]

[462] Njëlloj.
[463] Sigma/OECD, „Vlerësimi i shërbimit publik dhe kornizës administrative" (Bruksel/OECD, 2008).
[464] Aneksi 2: Institucioni: Administrata publike, vlerësim i Sistemit kombëtar për integritet
[465] Intervistë me Malinka Ristevska-Jordanovën, drejtore e Institutit për Politika Evropiane, ish këshilltare shtetërore në Sekretariatin për Çështje Evropiane, 19.12.2014 (bisedë private mes dy personave) dhe Dragi Celevski, këshilltar shtetëror në Zyrën e Avokatit të Popullit, 19.12.2014 (bisedë private mes dy personave); Ljupço Farmakoski, ish këshilltar shtetëror për shoqëri informatike dhe administratë, intervistë e zhvilluar nëpërmjet postës elektronike (24.12.2014).
[466] Njëlloj.
[467] Intervistë me Ljupço Farmakoskin, ish këshilltar shtetëror për shoqëri informatike dhe administratë, intervistë e zhvilluar nëpërmjet postës elektronike (24.12.2014).
[468] Sigma/OECD, „Vlerësimi i shërbimit publik dhe kornizës administrative" (Bruksel/OECD, 2008).
[469] Njëlloj.
[470] Komisioni Evropian, 2014: f. 8.
[471] Intervistë me Malinka Ristevska-Jordanovën, drejtore e Institutit për Politika Evropiane, ish këshilltare shtetërore në Sekretariatin për Çështje Evropiane, 19.12.2014 (bisedë private mes dy personave).
[472] SIGMA/OECD, 2012: f. 8. http://www.sigmaweb.org/publicationsdocuments/fYRoM_Assess_2012.pdf

QEVERISJA

4.2.1 TRANSPARENCA (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë mase janë vendosur dispozita që sigurojnë transparencë në menaxhimin me financat, resurset njerëzore dhe informatat në sektorin publik?

Nëpunësit më të lartë të sektorit publik kanë për obligim të dorëzojnë në KSHPK fletë anketuese për gjendjen pronësore dhe dëftesa të llogarive të tyre në banka vendore dhe të huaja.[473] Nëpunësit e sektorit publik në administratën publike dhe administratën e qytetit të Shkupit kanë obligim të dorëzojnë fletë anketuese para organit që i punëson[474]. Të dhënat në fletat anketuese për gjendjen pronësore, përveç të dhënave që në përputhje me ligjin mund të mbeten konfidenciale, duhet të publikohen në internet faqen e KSHPK-së.[475]

Drejtoria e të Hyrave Publike (DHP) mund të nis procedurë për shqyrtimin e gjendjes pronësore nëse personi zyrtar nuk ka dorëzuar fletë anketuese, nëse të dhënat kanë qenë të paplota, të pasakta ose të paplota ose nuk kanë paraqitur ndryshime në pronë.[476] DHP-ja mund të dorëzojë edhe propozim në gjykatën themelore kompetente për masë të përkohshme për ndalim të disponimit me pronën.[477]

Ishte vendosur procedurë me të cilën sigurohet qasje në informata dhe evidenca të karakterit publik dhe dosjeve. Secili bartës zyrtar i informatave ka obligim të informojë publikun për të dhënat e kontaktit dhe për mënyrën e paraqitjes së kërkesave të qasjes në informata.[478] Bartësit e informatave janë organet e pushtetit shtetëror, organet e komunës, të qytetit të Shkupit dhe të komunave të qytetit të Shkupit, institucionet publike dhe shërbimet, ndërmarrjet publike, personat fizikë dhe juridikë që kryejnë autorizime publike.[479] Secili bartës i informatave ka për obligim të mundësojë qasje falas në informatë.[480]

Ligji i përcakton informatat që duhet patjetër të jenë të gatshme publikisht dhe bartësit e informatave ose persona tjerë zyrtarë që punojnë me informata kanë për obligim të ndihmojnë publikun gjatë kërkimit të informatave[481]. Bartësi i informatave është i obliguar që menjëherë t'i përgjigjet kërkesës së kërkuesit të informatës ose në afat prej 30 ditëve nga pranimi i kërkesës. [482] Nëse bartësi i informatës nuk i siguron parashtruesit qasje në informatë, kërkesa konsiderohet si e refuzuar dhe pastaj mund të paraqitet ankesë.[483]

Në fushën e prokurimeve publike nuk janë vendosur rregulla për menaxhim me evidencat e informatave për proceset e prokurimeve publike.[484]

---

[473] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.28/2002; 46/2004; 126/2006; 10/2008; 161/2008 dhe 145/2010). Vendime të Gjykatës Kushtetuese të RM, nr. 190/2002 më 30 prill 2003, botuar në Gazeta Zyrtare e RM nr. 33/2003; nr.44/2005 më 21 shtator 2005, botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë, nr. 89/2005 dhe nr.160/2006 më 10 janar të vitit 2007, botuar në Gazeta Zyrtare e RM-së nr.7/2007.
[474] Njëlloj.
[475] Njëlloj.
[476] Njëlloj.
[477] Njëlloj.
[478] Ligji për qasje të lirë ndaj informatave me karakter publik, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.13/2006, 86/2008, 6/2010 dhe 42/2014.
[479] Njëlloj.
[480] Njëlloj.
[481] Njëlloj.
[482] Njëlloj.
[483] Njëlloj.
[484] Ligji për furnizime publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 136/2007, 130/2008, 97/2010, 53/2011, 185/2011, 15/2013, 148/2013, 160/2013, 28/2014, 43/2014 dhe 130/2014, neni 14, alineja 1.

Qeveria emëron dhe shkarkon nga detyra drejtorë që udhëheqin me trupat shtetërore administrative, sekretarë shtetërorë dhe sekretarë të përgjithshëm[485]. Vendet e liruara në shërbimin shtetëror/publik plotësohen me anë të shpalljes publike dhe të brendshme, ndërsa ndryshimi ose zhvendosja e nëpunësit publik/shtetëror bëhet në kuadër të organit të njëjtë në vend tjetër pune dhe në vendin e njëjtë të punës ose nga pushteti shtetëror dhe lokal ose në organe dhe institucione tjera shtetërore.[486]

AA-ja e publikon shpalljen për vendin e punës në internet faqe dhe së paku dy gazeta ditore, prej të cilëve njëra është që shtypet në gjuhën maqedonas ndërsa tjetra është që shtypet në gjuhë të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë tjetër zyrtare që nuk është gjuha maqedonase.[487]

4.2.2 TRANSPARENCA (PRAKTIKA)

Nota **50**

Në çfarë mase në mënyrë efektive zbatohen dispozitat për transparencë të menaxhimit të financave, resurseve njerëzore dhe informatat në sektorin publik?

Në vitin 2013, numri i ankesave të dorëzuara në Komisionin për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informata me Karakteri Publik (KMDQLIKP), më së shumti kundër organeve të administratës shtetërore, pushtetit lokal dhe gjyqësorit, është zvogëluar për më shumë se gjysmë[488]. Tre të katërtat e ankesave kanë qenë si rezultat i dështimit të përgjigjes me kohë kërkesave për qasje në informata[489]. Megjithatë, për zbatimin efikas të Ligjit për qasje të lirë në informata me karakter publik (LQLIKP), KMDQLIKP-ja duhet të ketë kapacitet dhe fuqi të shqiptojë gjoba me të holla për shkelje.[490]

Në praktikë, nëpunësit e rendit të lartë nuk e paraqesin gjithë pronën e tyre[491]. Ndonëse fletat e tyre publikohen në internet faqen e KSHPK-së, janë paraqitur shumë raste të theksimit të gabuar dhe paraqitje e paplotë, si dhe fletët anketuese të plotësuara me gabime.[492]

Organizatat joqeveritare, siç janë Qendra për Komunikime Qytetare dhe Transparency International, në mënyrë të rregullt monitorojnë prokurime të rastësishme të organeve përgjegjëse lokale dhe kanë identifikuar problemet vijuese: kritere tepër të larta për pjesëmarrje të ofruesve, mungesë e përshtatjes së dokumentacionit të tenderit, specifikime të papërshtatshme teknike dhe vend i gabuar për dorëzimin e ofertës. Këto probleme pjesërisht janë rezultat i injorancës së autoriteteve përgjegjëse, por pjesërisht janë shkaktuar me mendim nga organet përgjegjëse.[493]

[485] Ligji për Qeverinë e RM-së, Gazeta zyrtare e RM-së, nr.59/2000, 12/2003, 55/2005, 37/2006, 115/2007, 19/2008, 82/2008, 10/2010, 51/2011, 15/2013 dhe 139/2014). Vendim i Gjykatës Kushtetuese të RM-së, nr.131/2000 më 31 mars 2001, bituaur në Gazeta Zyrtare e RM-së nr.26/2001.

[486] Ligji për nëpunës shtetërorë, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.59/2000, 112/2000, 34/2001, 103/2001, 43/2002, 98/2002, 17/2003, 40/2003, 85/2003, 17/2004, 69/2004, 81/2005, 61/2006, 36/2007, 161/2008, 6/2009, 114/2009, 35/2010, 167/2010, 36/2011, 6/2012, 24/2012, 15/2013, 82/2013, 106/2013 dhe 132/2014). Vendime të Gjykatës Kushtetuese të RM-së: nr.186/2000 prej 04.04.2001 botuar në Gazetën Zyrtare të RM-së nr.30/2001; nr.132/2001 prej 18.12.2002 botuar në Gazeta Zyrtare e RM-së nr.100/2002; nr.37/2003 prej 17.12.2003 botuar në Gazeta Zyrtare e RM-së nr.84/2003; nr.37/2008 prej 10.09.2008 botuar në Gazeta Zyrtare e RM-së nr.118/2008; nr.66/2008 prej 24.09.2008 botuar në Gazeta Zyrtare e RM-së nr.128/2008 dhe nr.206/2008 prej 23.12.2009 botuar në Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 1/2010. Ligji për ndryshim të Ligjit për Qeveri të RM, Gazeta Zyrtare e RM-së,nr.10/2010.

[487] Njëlloj..

[488] Komisioni Evropian, 2014: f. 9.

[489] Njëlloj.

[490] Njëlloj.

[491] Sigma/OECD, Vlerësim i SIGMA, 2008.

[492] Njëlloj.

[493] SIGMA-OECD, 2013: f. 50 http://www.sigmaweb.org/publicationsdocuments/FYROMAssessment_2013.pdf [kontrolluar më 1 dhjetor

Informatat për proceset e prokurimeve publike nuk sigurohen me kohë dhe të paplota. Disa institucione nuk kanë paraqitur njoftime për marrëveshjet e firmosura madje edhe shtatë muaj nga firmosja e tyre[494], me çfarë është shkelur Ligji për furnizime publike që obligon institucionet në afat prej 30 ditësh të publikojnë njoftime për marrëveshjet e firmosura në Sistemin Elektronik të Prokurimeve Publike (SEPP).[495] Gjithashtu, institucionet nuk paraqesin njoftime për marrëveshje të realizuara, një obligim që ishte prezantuar në maj të vitit 2013.[496] Për shembull, në vitin 2013, në SEPP ishin vendosur vetëm 6 njoftime, ndonëse janë publikuar 18.000 tenderë.[497]

Vendet e lira të punës çdoherë publikohen më mënyrë publike, por procedura nuk është çdoherë e drejtë dhe emërimet shpeshherë nuk bazohen në merita.[498]

4.2.3 LLOGARIDHËNIA (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë mase janë vendosur dispozita me të cilat sigurohet që të punësuarit e sektorit publik duhet të dorëzojnë raporte dhe të përgjigjen për veprat e tyre?

Ligji për mbrojtjen e informatorëve është miratuar më 9 nëntor 2015, por ende nuk ka filluar zbatimi i tij efikas[499].

Nëse nëpunësi shtetëror ka bërë shkelje të detyrave zyrtare, mund të jetë lëndë e procedurës disiplinore. Masat disiplinore mund të shqiptohen varësisht nga natyra e shkeljes. Nëse shkelja e detyrës zyrtare ka edhe përgjegjësi penale, procedura disiplinore për përcaktimin e përgjegjësisë së nëpunësit shtetëror/publik duhet të bëhet në afat prej dy viteve nga dita e zbulimit të shkeljes.[500]

Ditari qytetar është deklaratë e organeve shtetërore administrative për mundësimin e qasjes së qytetarëve në shërbime të standardizuara[501]. Prej qytetarëve kërkohet të vlerësojnë nivelin e sigurimit të shërbimeve.[502]

Në kuadër të projektit “Semafor (Vlerëso administratën)”, MSHIA-ja ka vendosur një pajisje në institucionet që japin shërbime me të cilën i’u mundësua qytetarëve të vlerësojnë punën e punëtorëve në sportel në kuptim të mirësisë, komunikimit, shërbimit dhe cilësisë së shërbimit (me shtypje të një prej tre butonave të pajisjes –e gjelbër, e verdhë, e kuqe – i kënaqur, neutral, i pakënaqur).[503]

Inspektorati Shtetëror i Administratës kryen inspektime të zbatimit të ligjeve të punës[504]. Inspektori ka për obligim të marrë masa në kërkesë të punëtorit për shqyrtim të të drejtave

2014]

494 http://www.ccc.org.mk/images/stories/k20m.pdf Raporti i katërt tremujor për Furnizime Publike në RM, raporti nr.20, maj 2014 (kontrolluar më 1 dhjetor 2014)

495 Njëlloj.

496 Njëlloj.

497 Njëlloj.

498 SIGMA-OECD, 2012 http://www.sigmaweb.org/publicationsdocuments/fYRoM_Assess_2012.pdf [kontrolluar më 1 dhjetor 2014], f. 7.

499 Punëtori në temë “Korniza normative dhe institucionale për mbrojtjen e informatorëve në Maqedoni” organizuar nga Transparency International – Maqedoni më 11.4.2016 në hotel “Stounbrixh” në Shkup.

500 Ligji për nëpunës administrativë, (Gazeta Zyrtare e RM-së, бр.27/2014 dhe 199/2014), neni 78 a (3).

501 http://www.mio.gov.mk/?q=node/2614 [kontrolluar më 1 dhjetor 2014]

502 Njëlloj.

503 http://semafor.mioa.gov.mk/semafor/frontPage [kontrolluar më 1 dhjetor, 2014]

504 Ligji për inspekcionin e punës, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.97/97, 164/2013.

të marrëdhënieve të punës dhe sigurisë gjatë punës.[505]

Organet administrative shtetërore obligohen të themelojnë njësi për revizion të brendshëm që bëjnë revizion vjetor financiar për përputhjen e sistemeve për kontroll të brendshëm, suksesin e punës dhe revizionet e TI-së.[506]

ESHR-ja kryen revizion të përputhjes gjatë të cilës vlerëson përputhjen e punës së sektorit publik me aktet ligjore, nënligjore dhe të brendshme.[507]

Raportin vjetor për punën ESHR-ja e dorëzon në parlament që miratohet më së voni deri në fund të tremujorit të parë të vitit rrjedhës për vitin e kaluar.[508]

4.2.4 LLOGARIDHËNIA (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë mase të punësuarit e sektorit publik duhet të dorëzojnë raport dhe të përgjigjen për veprimet e tyre në praktikë?

KSHPK-ja dhe ESHR-ja, si dhe Byrja për Prokurime Publike kanë rol të rëndësishëm në parandalimin e korrupsionit në prokurimet publike.[509] ESHR-ja hulumton parregullsitë, ndërsa KSHPK-ja paraqet të dhëna te Prokurori Publike, por nuk ka evidencë për masa të ndërmarra. Sistemi i parandalimit të korrupsionit në Furnizime Publike nuk është efektiv sepse këto parregullsi paraqiten çdo vit, pa mos marrë masa për përmirësim të sistemit.

Nuk ka mekanizëm për përballjen me ankesa nga qytetarë të synuar për sektorin publik ndërsa mekanizmat për mbikëqyrje shtetërore janë të dobët.

AA-ja ka mekanizëm për përballje me ankesat e të punësuarve në sektorin publik në lidhje me vendin e tyre të punës, por nuk ka evidencë si bëhet me keqpërdorimet e detyrës zyrtare nga të punësuarit në sektorin publik.

Kuvendi nuk zbaton procedura përkatëse për përgjegjësi dhe llogaridhënie të AA-së. Nuk ekziston komision i veçantë parlamentar për shqyrtimin e raporteve vjetore të Agjencisë dhe Kuvendi ato i aprovon në seancë plenare pa ndonjë debat thelbësor.[510]

4.2.5 MEKANIZMAT PËR INTEGRITET (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë mase janë vendosur dispozita me të cilat sigurohet integriteti i të punësuarve në sektorin publik

Ka kode etike për nëpunës shtetërorë, si dhe rregulla që përcaktojnë konflikt të interesave

[505] Njëlloj.
[506] Ligji për kontrollin e brendshëm financiar, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.90/09, neni 30.
[507] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.66/2010, 145/2010.
[508] Ligji për nëpunës shtetërorë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.59/2000, 112/2000, 34/2001, 103/2001, 43/2002, 98/2002, 17/2003, 40/2003, 85/2003, 17/2004, 69/2004, 81/2005, 61/2006, 36/2007, 161/2008, 06/2009, 114/2009, 35/2010, 167/2010, 36/2011, 6/2012, 24/2012, 15/2013, 82/2013, 106/2013 dhe 132/2014 si dhe vendimet e Gjykatës kushtetuese.
[509] QMBN, 2014: f. 95.
[510] SIGMA-OECD, 2013: http://www.sigmaweb.org/publicationsdocuments/FYROMAssessment_2013.pdf

për nëpunës shtetërorë[511]. Nëpunësit shtetërorë fitojnë kopje të Kodit etik dhe nga betimi[512]. Ryshfeti gjatë kryerjes së detyrave lidhur me zgjedhjet është shkelje disiplinore, ndërsa ryshfeti në sektorin publik është vepër penale[513]. Në dispozitat e njëjta përcaktohet që marrja e dhuratave ose marrja e një lloj dobie tjetër është gjithashtu shkelje disiplinore.

Në vend ka një kornizë ligjore për paraqitjen e pronës dhe deklarata të konfliktit të interesave, por ligjet përsëriten dhe përputhen[514]. Ligji për nëpunës shtetërorë dhe Ligji për prokurime publike gjithashtu përmbajnë rregullore që kanë të bëjnë me etikën dhe konfliktit të interesit që dalin nga Ligji për parandalim të konfliktit të interesave dhe Ligji për parandalim të korrupsionit.[515]

4.2.6 MEKANIZMAT PËR INTEGRITET (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë mase në praktikë sigurohet integriteti i të punësuarve në sektorin publik?

Mendimi publik në vend është ndarë në kuptim të suksesit të luftës kundër korrupsionit në administratën publike[516]. Në krahasim me gjendjen para katër viteve, numri i qytetarëve që besojnë se korrupsioni në sektorin publik është zvogëluar është më i madh nga numri i qytetarëve që mendojnë se korrupsioni është rritur[517]. Megjithatë, 23.8% besojnë që korrupsioni është në nivelin e njëjtë si para katër vitesh[518]. Qytetarët mendojnë që korrupsioni është mjaft i përhapur në proceset e marrjes së vendimeve në pjesën e prokurimeve publike, gjatë dhënies së koncesioneve dhe licencave dhe në punësimet dhe avancimet në sektorin publik[519]. Mendohet që korrupsioni më tepër mbisundon në nivelin qendror të administratës publike.[520]

Kodet ekzistuese të sjelljes, dhurata dhe rregulla për shërbim, kufizimet për punësim, politikat e konfliktit të interesave dhe trupat për integritet nuk janë efektive në sigurimin e sjelljes etike të të punësuarve në sektorin publik, ndërsa zbatimi i këtyre dispozitave është zgjedhor.[521]

Në vitin 2013 janë zhvilluar tre trajnime për parandalimin e korrupsionit dhe etikë për 67 nëpunës publikë, ndërsa në 2014 janë zhvilluar dy trajnime për 22 nëpunës publikë.[522]

Në vitin 2012, numri rasteve të denoncuara për korrupsion në proceset e prokurimit është rritur më tepër se dy herë ne krahasim me vitin paraprak: 28 raste (2011: 12); 12 persona

[511] Rregullat janë vërtetuar me Ligjin për parandalim të konfliktit të interesave, Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe Ligjin për shfrytëzim dhe disponim me sendet në pronë shtetërore nën shtyllën për agjenci për luftë kundër korrupsionit (mekanizma për integritet - ligj), si dhe në Kodeksin etik të nëpunësve shtetërorë dhe në Kodeksin etik të nëpunësve publikë.

[512] Ligji për nëpunës shtetërorë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.59/2000, 112/2000, 34/2001, 103/2001, 43/2002, 98/2002, 17/2003, 40/2003, 85/2003, 17/2004, 69/2004, 81/2005, 61/2006, 36/2007, 161/2008, 6/2009, 114/2009, 35/10, 167/10, 36/11, 6/12, 24/12, 15/13, 82/13, 106/2013), neni 3.

[513] Ligji për parandalim të korrupsionit.

[514] SIGMA-OECD, 2013: http://www.sigmaweb.org/publicationsdocuments/FYROMAssessment_2013.pdf [kontrolluar më 1 dhjetor 2014]

[515] Njëlloj.

[516] Transparency International – Maqedoni, *Promovim i transparencës dhe llogaridhënies në institucionet publike,* (Shkup: Transparency International – Maqedoni, KSHPK dhe OSBE, 2012).

[517] Njëlloj.

[518] Njëlloj.

[519] Njëlloj.

[520] Njëlloj.

[521] Intervistë me Malinka Ristevska-Jordanovën, drejtore e Institutit për Politika Evropiane, ish këshilltare shtetërore në Sekretariatin për Çështje Evropiane, 19.12.2014 (bisedë private mes dy personave)

[522] Kontribut për Raportin për përparim në KE (Kapitulli 23 Gjyqësori dhe të drejtat themelore), Sekretariati për Çështje Evropiane

kanë qenë të dënuar për vepra penale dhe shkelje lidhur me prokurimet në vitin 2012 (në 2011 dhe 2011 nuk ka pasur vendime gjyqësore).[523]

ROLI

4.3.1 TË MËSUARIT E PUBLIKUT

Nota **25**

Në çfarë mase sektori publik e informon dhe mëson publikun për rolin e saj në luftën kundër korrupsionit?

Në vitin 2007 ishte vendosur linjë telefonike falas (199) për denoncimin e ankesave kundër korrupsionit[524]. Me atë ka menaxhuar MPB-ja. Deri në nëntor 2014 janë denoncuar 3.945 raste[525]. Ministria e Transportit dhe Lidhjeve e shfaq këtë numër në internet faqen e saj. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Drejtoria e Doganave kanë linje të posaçme falas për ankesa dhe denoncim të korrupsionit[526]. DHP-ja ka linjen e saj të ankesave (198), por deri më tani janë paraqitur raste të korrupsionit ndonëse është paraqitur sjellje joprofesionale nga të punësuarit[527]. Ministria e Mbrojtjes ka linjën e saj telefonike për ankesa.[528]

4.3.2 BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET PUBLIKE, ORGANIZATAT QYTETARE DHE AGJENCITË PRIVATE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Nota **25**

Në çfarë mase sektori publik bashkëpunon me agjencitë për mbikëqyrjen e shërbimeve publike, bizneset dhe sektorin qytetar në iniciativat kundër korrupsionit?

Në rastin më të mirë, ka bashkëpunim ndërmjet sektorit publik dhe organizatave qytetare dhe bizneseve në projektet kundër korrupsionit të nisur nga komuniteti ndërkombëtar. Për shembull, QMBM-ja bashkëpunim me KSHPK-në, si pjesë e programit të USAID-it kundër korrupsionit.[529] Transparency International Maqedoni dhe QMBM-ja ishin të përfshira në hartimin e Programit shtetëror për parandalimin e korrupsionit dhe zbatimin përkatës.

Megjithatë, KSHPK-ja në mënyrë zgjedhore bashkëpunon me organizatat qytetare, madje edhe me ato që janë partnere me programin e USAID-it kundër korrupsionit. Për shembull, KSHPK-ja refuzoi të bashkëpunojë me Transparency International Maqedoni në hartimin e analizës për situatën për NSI-në në Maqedoni.

---

523 SIGMA-OECD, 2013: f. 50 http://www.sigmaweb.org/publicationsdocuments/FYROMAssessment_2013.pdf [kontrolluar më 1 dhjetor, 2014]

524 http://www.mkd.mk/makedonija/politika/telefonskite-linii-za-prijavuvanje-mito-i-korupcija-se-mrtvi Linjat telefonike falas janë "të vdekura" [kontrolluar më 4 dhjetor 2014].

525 Njëlloj.

526 Njëlloj.

527 Njëlloj.

528 Njëlloj.

529 Intervistë me Emina Nuredinoskën, udhëheqëse e Seksionit, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, intervistë nëpërmjet postës elektronike më 3.10.2014.

4.3.3 ZVOGËLIMI I RREZIQEVE NGA KORRUPSIONI ME ANË TË MBROJTJES SË INTEGRITETIT TË PROKURIMEVE PUBLIKE

Nota **50**

Në çfarë mase është vendosur kornizë efektive për ruajtje të integritetit të procedurave për prokurime publike, përfshirë edhe sanksione përkatëse për veprim të padrejtë të furnizuesve dhe nga nëpunësit shtetërorë dhe mekanizma për kontroll dhe ankesa?

Ligji parashikon tre lloje të procedurave për veprim të shpërndarjes së marrëveshjeve për prokurime publike: e hapur, e kufizuar, dialog konkurrues dhe procedurë me negociata.[530]

Në vitin 2013, në 68% e prokurimeve publike ka qenë e përdorur procedura e hapur[531]. Sistemi kombëtar për prokurime publike ka një procedurë të thjeshtësuar për konkurrencë. Tenderët duhet të publikohen në SEPP[532]. Në 11% të marrëveshjeve për prokurime publike ka qenë përdorur procedura për negociata. Ka disa përjashtime të kushtit për ankand publik, në përputhje me rregullat e BE-së.[533]

Ligji vendos rregulla që sigurojnë objektivitet në procedurën për zgjedhje të zbatuesit[534]. Ofruesi përgatit tenderin në përputhje me dokumentacionin e tenderimit[535]. Komisioni për Prokurime Publike ka për obligim të mbajë procesverbal për procedurën e hapjes publike të ofertave[536]. Nuk mund të jenë lëndë e vlerësimit ofertat që nuk janë hapur gjatë hapjes publike[537]. Komisioni kontrollon tërësinë dhe vlefshmërinë e dokumentacionit dhe përgatit raport me shkrim të procedurës së zbatuar[538]. Organi kontraktues ka për obligim të ruajë gjithë dosjen për procedurën së paku 5 vite nga kompletimi i marrëveshjes.[539]

Ligji përcakton përdorim të dokumenteve standarde për oferta tenderi.[540]

Në vitin 2014, në funksion ishte vendosur Këshilli për Prokurime Publike si organ i ri për mbikëqyrje[541]. Oferta më e volitshme ekonomike mund të zgjidhet vetëm me aprovim të Këshillit për Prokurime Publike. Ky sistem nuk është në përputhje me ligjin e BE-së. Obligimi që palët kontraktuese të marrin aprovim nga Këshilli për Prokurime Publike para firmosjes së marrëveshjes krijon ngarkesë të panevojshme administrative.[542]

Komisioni Shtetëror për Ankesa është organ i pavarur shtetëror që është kompetent për zgjedhjen e ankesave lidhur me procedurat për shpërndarjen e marrëveshjeve, si dhe ankesa kundër vendimeve të Këshillit për Prokurime Publike.[543] Numri i plotë i rasteve në

[530] Ligji për prokurime publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.136/2007, 130/2008, 97/2010, 53/2011, 185/2011, 15/2013, 148/2013, 160/2013, 28/2014, 43/2014 dhe 130/2014.
[531] MCMS, 2014: f. 91.
[532] Ligji për prokurime publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.136/2007, 130/2008, 97/2010, 53/2011, 185/2011, 15/2013, 148/2013, 160/2013, 28/2014, 43/2014 dhe 130/2014.
[533] Njëlloj.
[534] Njëlloj.
[535] Njëlloj.
[536] Njëlloj.
[537] Njëlloj.
[538] Njëlloj.
[539] Njëlloj.
[540] Rregullore për përmbajtjen e dokumentacionit për tenderin, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.19/2008.
[541] Ligji për prokurime publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.136/2007, 130/2008, 97/2010, 53/2011, 185/2011, 15/2013, 148/2013, 160/2013, 28/2014, 43/2014 dhe 130/2014, neni 12.
[542] Njëlloj.
[543] Ligji për prokurime publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.136/2007, 130/2008, 97/2010, 53/2011, 185/2011, 15/2013, 148/2013, 160/2013, 28/2014, 43/2014 dhe 130/2014.

vitin 2013 është zvogëluar nga 585 në 2012 në 553 në vitin 2013. Përqindja e zgjedhjes së rasteve është 95%.[544] Arsye kryesore për refuzimin e ankesave është parashtrimi i vonuar, për shembull, ankesë për dokumentacion të tenderit të paraqitur gjatë marrjes së vendimit për zgjedhje.[545] Komisioni nuk është pajisur mirë me resurse financiare dhe njerëzore.[546]

KSHPK-ja, ESHR-ja dhe Ministria e Ekonomisë (në kuptim të koncesioneve dhe partneriteteve publike-private) gjithashtu kanë kompetencë juridike për mbikëqyrje të prokurimeve publike.[547]

Megjithatë, nuk ka procedura për mbikëqyrje të zbatimit të marrëveshjeve.

Byroja për Prokurime Publike (BPP) është institucioni themelor për krijimin e politikave dhe trajnimeve për prokurime publike. Janë të punësuar 20 persona me orar të plotë dhe një drejtor, ndërsa buxheti, që në vitin 2013 është 770.000 EUR, bazohet në buxhetin shtetëror dhe të ardhurat personale (për shembull, të ardhurat nga përdoruesit e sistemit për e-prokurime). Në vitin 2012, buxheti është rritur prej 504.000 EUR në 770.000 EUR, që është e nevojshme për zhvillim plotësues të sistemit për e-prokurime. BPP-ja i merr gjitha të dhënat lidhur me procedurat e zbatuara për dhënien e marrëveshjes dhe në mënyrë maksimale përdor (për shembull, shpallje publike dhe dokumente tenderi) dhe vendos në dispozicion për të gjitha palët e interesuara. Në këtë mënyrë kontribuon për transparencën dhe integritetin e gjithë sistemit. Të dhënat jo vetëm që do të përdoren për përgatitjen e raporteve të hollësishme statistikore, por shërbejnë edhe si bazë për masa tjera (ligjore). Dokumentet e publikuara të tenderit përdoren edhe nga OSH-të tjera si modele për prokurimet e tyre.[548]

Janë përcaktuar kushtet minimale për kualifikime profesionale për personat që kryejnë punë profesionale për prokurimet publike[549]. Ligji përcakton që personat kompetentë për vlerësim duhet të jenë të ndryshëm nga ata përgjegjës për aktivitetet e mbikëqyrjes[550]. Gjithashtu, ligji kërkon sqarimet dhe plotësimet gjatë procesit të ofrimit të jenë të ndarë në mesin e gjithë ofruesve dhe kjo rregull të zbatohet edhe në praktikë.[551]

Të gjithë ofruesit duhet të informohen për vendimet e marra gjatë procesit të ankandit[552]. Palët kontraktuese obligohen të publikojnë njoftime për marrëveshjet e dhëna në afat prej 30 ditëve nga firmosja e marrëveshjes[553]. Gjithashtu, kanë për obligim të ruajnë regjistra dhe statistikë për të gjitha marrëveshjet[554]. Të gjitha marrëveshjet për kontratat e firmosura janë publike dhe mund të gjenden në sistemin online (https://e-nabavki.gov.mk).[555]

Ofruesit që kanë marrë pjesë në procedurë për prokurim publik kanë të drejtë të shqyrtojnë raportin e procedurës[556]. Disa institucione nuk i dorëzojnë me kohë raportet e marrëveshjeve

[544] Komisioni Evropian, 2014; f. 25.
[545] Njëlloj.
[546] Komisioni Evropian, 2014; f. 30
[547] Ligji për prokurime publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.136/2007, 130/2008, 97/2010, 53/2011, 185/2011, 15/2013, 148/2013, 160/2013, 28/2014, 43/2014 dhe 130/2014.
[548] Vlerësim i SIGMA 2013: f. 147.
[549] Ligji për prokurime publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.136/2007, 130/2008, 97/2010, 53/2011, 185/2011, 15/2013, 148/2013, 160/2013, 28/2014, 43/2014 dhe 130/2014.
[550] Njëlloj.
[551] Njëllojp
[552] Ligji për prokurime publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.136/2007, 130/2008, 97/2010, 53/2011, 185/2011, 15/2013, 148/2013, 160/2013, 28/2014, 43/2014 dhe 130/2014, neni 167
[553] Njëlloj.
[554] Njëlloj.
[555] Byroja për prokurime publike, *Raport vjetor për prokurime publike për vitin 2013*, (Shkup: Byroja për prokurime publike, 2013). http://javni-nabavki.finance.gov.mk/bjn-portal/wordpress/wp-content/uploads/Izvestaj_na_BJN_za_2013.pdf [kontrolluar më 5.12.2014]
[556] Ligji për prokurime publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.136/2007, 130/2008, 97/2010, 53/2011, 185/2011, 15/2013, 148/2013, 160/2013, 28/2014, 43/2014 dhe 130/2014.

të firmosura[557]. Me atë shkelet Ligji për Prokurime Publike në pjesën që përcakton se institucionet kanë për obligim që në afat prej 30 ditësh të publikojnë raporte për marrëveshjet e firmosura me anë të Sistemit Elektronik të Prokurime Publike.[558]

4.3.4 MBIKËQYRJA E NDËRMARRJEVE PUBLIKE (NP)

Nota **25**

Në çfarë mase shteti ka politikë të qartë dhe të qëndrueshme për pronësinë e ndërmarrjeve publike dhe strukturat e nevojshme për zbatimin e kësaj politike?

Nuk ka politikë të qartë dhe qëndrueshme për pronësinë e NP-ve dhe nuk ka strukturë të qartë të drejtimit që mund të ndiqet me kujdes. Nuk ka trup të pavarur të centralizuar për koordinim të themeluar nga Qeveria për kryerjen e funksionit të pronësisë në kuptim të NP-ve.

Ndërmarrjet individuale publike përgjigjen para ministrive në të cilat krijohen politika që janë relevante për sektorin e NP-së. Kjo shpesh krijon një konflikt interesash që ka të bëjë me të drejtën e ministrave për emërim të anëtarëve të strukturave drejtuese dhe vëzhguese të NP-në. Gjithashtu, kjo mundëson edhe një situatë në të cilën vendimet politike në lidhje me NP shpesh janë përputhur me nevojat politike të garniturës politike në pushtet, si, për shembull, për punësim, ndërtim të rrugëve dhe shërbime tjera komunale që janë relevante për jetën e përditshme të qytetarit. Interesat afatgjate dhe buxhetet e NP-ve përcaktohen në përputhje me programet politike dhe nevojat e fushatave, në vend që të jenë në përputhje me nevojat e vërteta të NP-ve.

REKOMANDIME

R1. Duhet të vendoset mekanizëm (në formë të komisionit të parlamentit, agjenci e re ose ndonjë nga agjencitë ekzistuese) për mbikëqyrje të rregullt (mujor ose tremujor) të punësimeve të reja në administratën publike.

R2. Duhet të përcaktohen autorizime dhe procedura për mbikëqyrje të zbatimit të marrëveshjeve në prokurime publike.

[557] Qendra për Komunikime me Qytetarët, Raporti i katërt tremujor për prokurimet publike në Republikën e Maqedonisë, raporti nr.20, (Shkup: Qendra për Komunikim me Qytetarët, 2014), http://www.ccc.org.mk/images/stories/k20m.pdf [kontrolluar më 1 dhjetor 2014]
[558] Njëlloj.

5. AGJENCITË PËR ZBATIM TË LIGJEVE

PËRMBLEDHJE

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) kryen mbikëqyrje të punës së shërbimit policor në Maqedoni.

Puna e MPB-së rregullohet me dy ligje të veçanta, Ligji për policinë dhe Ligji për punë të brendshme[559]. Komisioni Evropian[560] vlerësoi që Maqedonia ka zhvilluar model të mirë të organizimit të policisë, që bazohet në reformat e mëdha policore që nisën para 15 vitesh dhe vazhdojnë deri në ditën e sotme.[561]

MPB-ja është një nga organet më të fuqishme dhe me ndikim më të madh në Maqedoni dhe kësaj ministrie i jepet pjesë e konsiderueshme e buxhetit shtetëror.

Çështja e korrupsionit në polici është zgjidhur deri në një shkallë me vënien në fuqi të masave parandaluese. Vënia në fuqi e Masave të Posaçme Hetuese (MPH)[562] ndihmoi në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit në administratën publike, si dhe në sektorin e shëndetësisë. Vënia në fuqi e procedurave të përshpejtuara administrative, si që është dhënia e letërnjoftimeve, pasaportave dhe dokumenteve tjera, çoi në përparim të kufizuar. Te publiku ekziston perceptim i fuqishëm që korrupsioni është shumë i përhapur tek organet për zbatim të ligjeve[563].

NOTA E PËRGJITHSHME PËR SHTYLLËN: 51,3/100

DIMENSIONI	TREGUES	E DREJTA	PRAKTIKA
Kapaciteti 50/100	Burimet	/	50
	Pavarësia	75	25
Qeverisja 54,1/100	Transparenca	75	50
	Llogaridhënia	75	25
	Integritet	75	25
Roli 50/100	Ndjekja penale e korrupsionit	50	

[559] Ligji për polici. Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 114/2006, 6/2009, 45/2012, 41/2014, 33/2014 dhe Ligji për punë të brendshme, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 42/14, 116/14, 22/2015.
[560] Komisioni Evropian, 2014: http://ec.europa.eu/enlargement/countries/strategy-and-progress-report/index_en.htm
[561] Komisioni Evropian, 2015: f. 18 „Reformat më të mëdha policore filluan para 15 vitesh dhe akoma vazhdojnë në sfera të posaçme".
[562] Në vitin 2004.
[563] https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/corruption/Corruption_report_fYR_Macedonia_FINAL_web.pdf, f. 12, 23.

Vlerësimi për shtyllën sipas të drejtës dhe praktikës



STRUKTURA DHE ORGANIZIMI

MPB-ja është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe është një nga tre ministritë më të mëdha në Maqedoni sa i përket numrit të të punësuarve.[564] Reformat strukturore në polici (nën mbikëqyrje të Byrosë për Siguri Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme) u zbatuan me ndihmë të Komisionit Evropian në periudhën prej vitit 2002 deri më 2007. Modeli për punën e policisë u zhvillua në partneritet me ekspertë gjermanë të policisë, në bazë të praktikave më të mira evropiane nga BE-ja. Parimet e Marrëveshjes së Ohrit u integruan në konceptin e ri për punë të policisë dhe u vu prioritet për decentralizimin e organizimit të policisë, si dhe transparencës.

Bazat ligjore për organizimin dhe punën e policisë gjenden në Ligjin për polici dhe në Ligjin për punë të brendshme.[565] Ligji për punë të brendshme i rregullon raportet ndërmjet njësive të ndryshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si dhe statusin e nëpunësve policorë dhe të punësuarit tjerë në ministri.

Ligji për punë të brendshme i përcakton përgjegjësitë e Byrosë për Siguri Publike, që është kompetente për policinë. Policia e ruan rendin publik dhe është përgjegjëse për kryerjen e hetimeve penale, duke përfshirë edhe aktivitetet e forcave speciale të policisë. Policia gjithashtu është përgjegjëse për rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit që janë brenda juridiksionit të Seksionit për Luftë kundër Krimit të Organizuar dhe të Rëndë.[566] Prokurori publik bashkëpunon me Seksionin për Luftë kundër Krimit të Organizuar dhe të Rëndë.[567] Shërbimi i policisë punon në tërë territorin e vendit.[568] Modeli për punën e policisë bazohet në dekoncentrim në vend të decentralizimit.

[564] Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Shëndetësisë.
[565] Ligji për polici. Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 114/2006, 6/2009, 45/2012, 41/2014, 33/2014 dhe Ligji për punë të brendshme, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 42/14, 116/14, 22/2015.
[566] Ligji për polici. Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 114/2006, 6/2009, 45/2012, 41/2014, 33/2015, neni 17 dhe 18.
[567] Ligji për polici. Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 114/2006, 6/2009, 45/2012, 41/2014, 33/2015, neni 18, paragrafi 3.
[568] Ligji për polici. Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 114/2006, 6/2009, 45/2012, 41/2014, 33/2015, neni 17.

Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK) është përgjegjëse për sigurinë dhe kundërzbulimin.[569] Drejtoria ka autorizim policor, si dhe mundësi për përdorim të MPH-së, që i vë në pozitë më të lartë në raport me policinë kriminalistike.

VLERËSIMI

KAPACITETI

MPB-ja ka më shumë se 11.000 të punësuar që përfshin nëpunës policor dhe nëpunës shtetërorë.[570]

Ligji për punë të brendshme i rregullon raportet ndërmjet njësive të ndryshme në Ministri, si dhe statusin e nëpunësve policorë dhe të punësuarve tjerë. Megjithatë, pjesë e konsiderueshme e kapitujve nga ky ligj janë zhvendosur në Ligjin më të ri për polici. Pjesa më e madhe e vendeve tjera në rajon e zëvendësuan Ligjin për punë të brendshme me Ligjin për polici, por Maqedonia, tani për tani, i zbaton të dy ligjet pa konflikte mes tyre.

5.1.1 BURIMET (PRAKTIKA)

Nota **50**

Deri në çfarë shkalle agjencitë për zbatim të ligjeve kanë nivele përkatëse të burimeve financiare, të të punësuarve dhe infrastrukturës për punë efektive në praktikë?

Ministria e Punëve të Brendshme e merr njërën nga pjesët më të mëdha të mjeteve financiare nga buxheti shtetëror. Pa marrë parasysh qëllimin e procesit të reformave policore për zvogëlim të numrit të personave që janë të punësuar në shërbimin policor, akoma mbetet perceptimi që në MPB-ja ka punësim të tepërt, së pari me kandidatë që i përmbajnë partitë politike në pushtet.[571]

Nëpunësit policorë marrin trajnime intensive nëpërmjet kurseve ose punëtorive speciale në vend, si dhe jashtë vendit. Në vitet e fundit (2012 – 2014) trajnimet përqendrohen në legjislacionin e ri të të drejtës penale[572] që ka të bëjë me rolin e ri të prokurorit publik në procedurën penale dhe ndryshimet e rëndësishme në rolin e policisë në procedurën e mëparshme[573].

Në vitin 2015, MPB-së i janë dhënë 5,86% nga buxheti shtetëror (155.607 milionë EUR nga tërë buxheti prej 2.654 miliardë EUR) që i mbulon shpenzimet për 10.925 të punësuarit e planifikuar (mesatare prej 12.341 EUR për person).[574] Në vitin 2014, MPB-ja ka marrë 6,23% nga buxheti (160.346 milionë EUR nga gjithsej 2.573 miliardë EUR) me 10.859 të punësuar (mesatare prej 12.552 EUR për person)[575]. Buxheti dhe pagat janë adekuate për tërheqje të personelit të kualifikuar dhe të dedikuar.

[569] Komisioni Evropian, 2014: http://ec.europa.eu/enlargement/countries/strategy-and-progress-report/index_en.htm [qasur më 15 gusht 2015]
[570] Deklaratë e shpallur më 02.03.2015 http://vesti.mk/read/news/4776957/1791589/stavreski-do-jankulovska-nie-sme-ludaci-troshime-na- chokolado-a-nemame-leb [qasur më 15 gusht 2015]
[571] Intervistë me nëpunës të mëparshëm policorë në nivel të lartë në Akademinë Policore.
[572] Intervistë me profesor nga Fakulteti për Siguri, i cili ka qenë i përfshirë në trajnimin për zbatim të ligjeve në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë në periudhën nga 2012 deri më 2014
[573] Ligji për procedurë penale, që ka hyrë në fuqi më 1 dhjetor të vitit 2013, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 150/2010.
[574] http://www.finance.gov.mk/files/u6/BUDZET_2015_ZA_OBJAVUVANJE_21-10-2014.pdf, f.30 [qasur më 27 korrik 2015]
[575] http://finance.gov.mk/files/BUDZET%202014%20FINALNA%20VERZIJA%2019.12.2013.pdf, f.29 [qasur më 27 korrik 2015]

Pagat e nëpunësve policorë janë të rregulluara me ligj, që përfshin kategori të pagave në bazë të nivelit dhe llojit të përgjegjësive.[576] Nëpunësit policorë, gjithashtu mund të marrin bonuse për punë jashtë orarit të punës, kur punojnë më gjatë se 40 orë në javë.[577]

Megjithatë, pa marrë parasysh buxhetin e konsiderueshëm, mungojnë pajisje bazike dhe materiale të infrastrukturës, si'ç që janë automjete, kompjuterë dhe pajisje për komunikim.[578]

Sa i përket kapacitetit kundër korrupsionit, Raporti i KE-së për përparimin e arritur për vitin 2014 thotë që "Njësia për Luftë Kundër Korrupsionit pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme u avancua në Sektor për Luftë Kundër Korrupsionit, por statusi i saj mbeti i dobët; vetëm 19 vende janë të parapara për këtë, prej të cilave më shumë se një e treta mbeten të zbrazëta. Akoma nevojiten burime të konsiderueshme njerëzore dhe materiale për prokurorinë, që të sigurohet zbatim i plotë i Ligjit të ri për procedurë penale. Ligji e jep bazën për krijimin e njësive të policisë gjyqësore, të cilat janë të përbëra nga të punësuar në agjencitë tjera për zbatim të ligjeve".[579] Në bazë të raportit të KE-së për vitin 2015, në Njësinë për Luftë Kundër Korrupsionit pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, personeli vazhdon të rritet me 10 persona të ri të punësuar[580].

5.1.3 PAVARËSIA (E DREJTA)

Nota **75**

Deri në çfarë shkalle agjencitë për zbatim të ligjeve janë të pavarura në bazë të ligjit?

Pavarësia e agjencive për zbatimin e ligjeve është garantuar me ligj. Ligji për polici (LP) i rregullon lidhjet e nëpunësve policorë me aktivitetin politik.[581] Në pajtim me ligjin, nëpunësi policor nuk mund të themelojë, të udhëheqë ose të jetë anëtar i kryesisë së një partie politike, por nuk i ndalohet të jetë anëtar i një partie politike. Nëpunësve policorë nuk u lejohet të organizohen dhe të veprojnë në mënyrë partiake, të shpalosin simbole partiake në lokalet e policisë dhe nuk mund të marrin pjesë në demonstrata politike me uniformë, përveç nëse nuk janë në detyrë zyrtare.

Është themeluar sistem modern për udhëheqje të personelit me të cilin zbatohet sistem për punësim dhe avancim që bazohet në merita dhe kompetencën profesionale. Sistemi hollësisht i rregullon procedurat e punësimit, avancimit, vlerësimit dhe shkarkimit nga puna. Zgjidhja bëhet në konkurs të hapur. Përvoja në kurse për trajnim që janë të organizuara nga organizatat ndërkombëtare konsiderohet si përparësi.

Drejtori i BSP-së, në pajtim me ligjin, duhet të posedojë certifikatë të pranuar ndërkombëtarisht për njohje aktive të gjuhës angleze dhe duhet të ketë kaluar testin psikologjik dhe testin për integritet.[582] Këto kushte seriozisht mund të kufizojnë fondin e kandidatëve të mundshëm, edhe pse janë për promovim të profesionalizmit.

---

[576] Sqarim që është përgatitur dhe përmirësuar nëpërmjet procesit për reforma policore (viti 2007).
[577] Ligji për polici. Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 114/2006, 6/2009, 45/2012, 41/2014, 33/2015, neni 102.
[578] Në disa intervista me funksionarë policor në nivel të lartë dhe ekzekutiv në vitin 2013 dhe 2014 përmendet mungesa e mjeteve buxhetore për benzinë dhe që patrullat janë të ose intervenimet e policisë janë të pezulluara ose të kufizuara vetëm në vendet urbane: nuk ka buxhet për ngrohje të lokaleve të policisë, inventari në stacionet policore është duke u shkatërruar, cilësia e dokumenteve të shtypura zakonisht është e dobët pasi që nuk ka toner për printerin, etj.
[579] Komisioni Evropian, 2014: f. 43.
[580] Komisioni Evropian, 2015: f. 64.
[581] Ligji për polici, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 114/2006, 6/2009, 45/2012, 41/2014, 33/2015, neni 10$_{5.}$
[582] Ligji për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për polici Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 41/2014, neni 1.

Drejtori i BSP-së dhe drejtori i DSK-së emërohen nga Qeveria sipas propozimit të Ministrit të Punëve të Brendshme.[583] Drejtori mund të shkarkohet me kërkesë të tij, kur është i dënuar me burgim prej së paku gjashtë muajsh ose për shkak të kryerjes joparimore dhe joprofesionale të punës.

5.1.4 PAVARËSIA (PRAKTIKA)

Nota **25**

Deri në çfarë shkalle agjencitë për zbatim të ligjit janë të pavarura në praktikë?

Pavarësia e policisë është e kërcënuar nga lidhjet e ngushta ndërmjet partive politive në pushtet dhe nëpunësve policorë.[584] Mbisundon perceptimi që policia është nën ndikimin e liderëve partiakë. Ndikimi politik në aksionet policore është i dukshëm kur policia merret me kundërshtarët politikë të partive në pushtet. Në raste kur roli i policisë është t'u ndihmojë organeve publike administrative në kryerjen e përgjegjësive të tyre (për shembull, DHP), policia shpesh merr rol dominues.[585] Raporti i Amnesty International për Maqedoninë në periudhën 2014-2015 thotë që „...struktura e momentit në pushtet ka ndikim tepër të madh mbi policinë dhe gjyqësorin".[586]

Nga bisedat e përgjuara u zbulua që ministrja e mëparshme e Punëve të Brendshme, znj. Gordana Jankulloska, e cila ishte në këtë post për 9 vite, dhe drejtori i tanishëm i DSK-së kanë pasur ndikim mbi organe tjera administrative dhe gjyqësore për kryerje të veprave të caktuara ose për marrje të vendimeve të caktuara.[587] Mbisundon perceptimi që për tu bërë nëpunës policor, kandidati duhet të ketë rekomandim nga partitë në pushtet.[588]

Marrëveshja kornizë e Ohrit e konfirmoi nevojën urgjente për sigurim të përfaqësimit të barabartë të të gjitha komuniteteve në Maqedoni në forcat policore. U përcaktua orar rigoroz kohor për punësim të shqiptarëve etnikë në forcat policore. Partitë politike të shqiptarëve etnikë i siguruan emrat e kandidatëve. Kërkesa e Marrëveshjes së Ohrit për përfaqësim të barabartë të minoriteteve në administratën shtetërore, edhe pse përfaqëson reformë të domosdoshme post konflikte për sigurim të paqes, e nxiti ndikimin politik në proceset për punësim në polici dhe çoi në situatë ku nëpunësit policorë janë më besnikë ndaj partive politike/liderëve sesa ndaj udhëheqësve të vet policorë.[589]

QEVERISJA

5.2.1 TRANSPARENCA (E DREJTA)

Nota **75**

Deri në çfarë shkalle janë themeluar dispozita për sigurim me të cilat publiku mund të ketë qasje në informatat relevante për aktivitetet e agjencive për zbatim të ligjit?

[583] Ligji për punë të brendshme, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 42/14, 116/14, 22/2015, neni 14 dhe 17, dhe Ligji për polici, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 114/2006, 6/2009, 45/2012, 41/2014, 33/2015, neni 16.
[584] http://composite-project.eu/ [qasur më 25 korrik 2015]
[585] http://www.dw.de/ [qasur më 15 korrik 2015]
[586] Utrinski vesnik, 26 shkurt 2015, f. 2.
[587] http://sdsm.org.mk/default.aspx?articleId=11768&mId=55&agId=5 [qasur më 18 korrik 2015]
[588] Intervistë me profesor të mëparshëm në Akademinë Policore në Shkup.
[589] 32 Intervistë me drejtorin e mëparshëm të Akademisë policore.

Ligji për polici përmban disa nene lidhur me transparencën e punës së policisë. Me reformat policore në periudhën 2003-2007 u themelua funksioni i zëdhënësit në të gjithë tetë sektorët e punëve të brendshme, si dhe në policinë kufitare, në përpjekjet për të rritur transparencën e punës së policisë.

Në pajtim me Ligjin për parandalimin e korrupsionit, Ministria e Punëve të Brendshme[590] dhe drejtorët në suaza të ministrisë[591], si dhe udhëheqës tjerë të sektorëve, funksionarë ose persona përgjegjës janë të detyruar të paraqesin deklarata të hollësishme për pasuritë në KSHPK dhe në DHP. Nëpunësit policorë, gjithashtu, duhet të paraqesin deklarata për pasuritë. Deklaratat e nëpunësve policorë në nivel të lartë shpallen publikisht nga KSHPK-ja.[592]

MPB-ja është subjekt i Ligjit për qasje të lirë në informata me karakter publik[593]. Megjithatë, nuk ekzistojnë dispozita që i mundësojnë publikut të marrë informata relevante për organizimin dhe për funksionimin e policisë ose agjencive tjera për zbatim të ligjit. Nuk ka dispozita ligjore që i mundësojnë publikut të marrë informata për vendimet për zbatimin e ligjit që i prek dhe për atë se si janë marrë këto vendime. Nuk ekzistojnë dispozita të posaçme që u mundësojnë viktimave të veprave penale të kenë pasqyrë në dosjet e lëndëve të tyre.

5.2.2 TRANSPARENCA (PRAKTIKA)

Nota **50**

Deri në çfarë shkalle ekziston transparenca në praktikën e aktiviteteve dhe proceseve për vendimmarrje në agjencitë për zbatim të ligjeve?

Në ueb faqen e MPB-së shpallen dokumente strategjike dhe informata të përditësuara.[594] MPB-ja është njëra nga institucionet e para shtetërore që hapi profil në Fejsbuk për komunikim me qytetarët, që u vlerësua si hap pozitiv nga publiku dhe policia.[595] Megjithatë, informatat janë të kufizuara dhe profili i MPB-së në Fejsbuk vizitohet shumë pak.

Ka mungesë të transparencës lidhur me procedurat e punësimit në polici. Vende të caktuara të punës nuk shpallen publikisht dhe procedurat për zgjidhje nuk janë transparente.

Lidhur me mundësimin e qasjes së lirë në informata për publikun, MPB-ja konsiderohet si një nga institucionet shtetërore më të papërgjegjshme.[596] Në bazë të Raportit vjetor për heshtjen e institucioneve lidhur me qasjen e lirë në informata me karakter publik për vitin 2014 janë dorëzuar 1.620 kërkesa për informata tek institucionet shtetërore në Maqedoni, prej të cilave 223 (13,7%) kanë qenë të adresuara te MPB-ja, por nuk ka informata për numrin e informatave të kërkuara[597].

Ministri i Punëve të Brendshme dhe drejtori i DSK-së ishin të përzier në skandalin me përgjimet që ndodhi në shkurt të vitit 2015, kur lideri i opozitës zbuloi që mijëra qytetarë kanë

[590] http://dksk.org.mk/imoti_2/detail.php?detail=9250&search=&ime=%D0%93%D0%BE%D1%80%D0%B4%D0%B0%D0%B-D%D0%B0&prezime=&funkcija=&institucija [qasur më 18 korrik 2015]
[591] http://dksk.org.mk/imoti_2/detail.php?detail=1826&search=&ime=%D0%A1%D0%B0%D1%88%D0%BE&prezime=&funkcija=&institucija [qasur më 17 korrik 2015]
[592] Ligji për parandalimi të korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, neni 33.
[593] http://www.stat.gov.mk/pdf/SlobodenPristapDoInformacii/zakon_za_informacii.pdf, neni 1 [qasur më 17 korrik 2015]
[594] http://www.mvr.gov.mk/ [qasur më 2 gusht 2015
[595] https://www.facebook.com/pages/Ministerstvo-Za-Vnatreshni-Raboti/600356086757609 [qasur më 27 korrik 2015]
[596] Utrinski vesnik, 18 shkurt 2015, f. 2.
[597] Në bazë të Raportit vjetor për heshtjen e institucioneve lidhur me qasjen e lirë në informata me karakter publik për vitin 2014 janë dorëzuar 1.620 kërkesa për informata tek institucionet shtetërore në Maqedoni, prej të cilave 223 (13,7%) kanë qenë të adresuara te MPB-ja, por nuk ka informata për numrin e informatave të kërkuara, f. 21

qenë të nënshtruar ndaj ndjekjes së komunikimeve të tyre, duke përfshirë edhe politikanë, gazetarë dhe akademikë.[598]

Agjencitë për zbatim të ligjeve nuk ishin të përpikta në dhënien e raportit tek Avokati i Popullit ose te Komisioni Parlamentar.[599]

Deklaratat për pasuritë të funksionarëve të caktuar të lartë policorë konsideroheshin si të paplota dhe KSHPK-ja ka filluar procedurë për kontrollim të gjendjes së pasurive.[600] Megjithatë, është përfunduar që nuk ekziston asgjë që nuk është deklaruar si duhet.

5.2.3 LLOGARIDHËNIA (E DREJTA)

Nota **75**

Deri në çfarë shkalle janë themeluar dispozita me të cilat agjencitë për zbatim të ligjeve duhet të japin raporte dhe përgjegjësi për veprimet e veta?

Dispozitat për llogaridhënien lidhur me policinë e përfshijnë edhe llogaridhënien e brendshme[601] dhe të jashtme[602].

Mbikëqyrja e brendshme e policisë së pari kryhet nga njësia e posaçme në suaza të MPB-së: Sektori për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale.[603] Ky sektor është përgjegjës për hetime për kryerjen e autorizimeve policore, veçanërisht në raste kur përdoret forcë vdekjeprurëse. Njësia e posaçme sipas organizimit është vendosur në kabinetin e ministrit, por prap se prapë është e detyruar të kryejë detyrimet e veta në mënyrë të pavarur. Ajo ka detyrë të kryejë hetime për cilësinë e standardeve profesionale dhe korrupsionit në polici.

Nëse ndonjë qytetar dëshiron të ankohet nga sjellja e policisë, ai/ajo mund të parashtrojë ankesë për sjelljen e policisë te MPB-ja, që është e detyruar të hetojë rastin dhe të përgjigjet me shkrim në afat prej 30 ditësh.

Mbikëqyrja e jashtme kryhet nga Parlamenti dhe nga Avokati i Popullit. Parlamenti, nëpërmjet Komisionit Parlamentar, kryen mbikëqyrje mbi Drejtorinë për Siguri dhe Kundërzbulim. Komisioni ka për detyrë t'i japë raport Parlamentit për punën e vet së paku një herë në vit. Komisioni e shqyrton raportin dhe i dërgon konkludimet e veta te Qeveria. [604]

Çdo katër vite, me kërkesë të drejtorit, nëpunës më të lartë policorë e rishikojnë strukturën organizative dhe metodologjinë e punës së policisë.[605]

Nëpunësit për zbatim të ligjeve nuk gëzojnë imunitet nga procedurat penale.

---

[598] Lënda është në fazat fillestare të hetimit në prokurori http://sdsm.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=5&articleId=11701 [qasur më 2 gusht 2015]
[599] Z. Tito Petkovski http://www.ereporter.com.mk/mk-mk/Details.aspx?Title=18803 [qasur më 25 korrik 2015]
[600] Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Publikimi i gjetjeve, http://www.dksk.org.mk/index.php?option=com_content&task=view&id=228&Itemid=36 [qasur më 25 korrik 2015]
[601] Ligji për punë të brendshme, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 42/14, 116/14, 22/2015, neni 38.
[602] Ligji për punë të brendshme, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 42/14, 116/14, 22/2015, neni 39 dhe 40.
[603] Sektori për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale.
[604] Ligji për punë të brendshme, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 42/14, 116/14, 22/2015, neni 39.
[605] Ligji për polici, neni 15.

5.2.4 LLOGARIDHËNIA (PRAKTIKA)

Nota **25**

Deri në çfarë shkalle agjencitë për zbatim të ligjit duhet të japin raporte dhe përgjegjësi për veprimet e veta në praktikë?

Ka ndikim të papërshtatshëm politik mbi mekanizmat e mbështetjes së llogaridhënies së policisë dhe organeve tjera për zbatim të ligjit. Policia u kritikua për shkeljen e parimit për prezumimi të pafajësisë për shkak të gatishmërisë së saj të raportojë dhe të zbulojë hollësi për lëndë që kanë të bëjnë me politikanë opozitarë dhe kundërshtarë politikë të pushtetit të tanishëm. Komisioni Parlamentar që kryen mbikëqyrje të punës së shërbimit për kundërzbulim ishte krejtësisht e pamundësuar të kryejë funksionin e vet mbikëqyrës për shkak të përzierjes politike.[606]

Komisioni për Parandalim të Torturës e vizitoi dhe e shqyrtoi situatën në Maqedoni 11 herë, që rezultoi me mbikëqyrje dhe shqyrtim të sjelljes së policisë dhe me reforma pozitive në praktikat e policisë[607].

Vendndodhja e sektorit për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale në kabinetin e ministres së Punëve të Brendshme e hap çështjen për pavarësinë e sektorit. Shpallja e bisedave të përgjuara zbuloi se udhëheqësja e sektorit, znj. Stançeska dhe Ministrja e Punëve të Brendshme, znj. Jankulloska, gjoja i kanë abuzuar kompetencat policore gjatë zgjedhjeve.[608]

Parlamenti është joefektiv në sigurimin e mbikëqyrjes së jashtme të policisë. Nuk ekziston institucion efektiv i pavarur që vepron si mekanizëm i jashtëm për kontroll të policisë.[609]

Në praktikë, funksionarët nga organet për zbatim të ligjeve nuk kanë imunitet për ndjekje penale. Në vitin 2004, Sektori për Kontroll të Brendshëm ka ngritur 17 kallëzime penale kundër 25 të punësuarve për vepra penale që përfshijnë abuzim të kompetencave zyrtare dhe korrupsion. [610]

5.2.5 MEKANIZMI PËR INTEGRITET (E DREJTA)

Nota **75**

Deri në çfarë shkalle integriteti i agjencive për zbatim të ligjeve sigurohet me ligj?

Ligji për polici e rregullon integritetin e policisë. Gjatë punësimit në polici, nëpunësi policor duhet të nënshkruajë deklaratë me të cilën obligohet që do të respektojë Kushtetutën, ligjet e Republikës së Maqedonisë dhe standardet e etikës policore, si dhe që në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të përpiktë do të kryejë punët policore.[611]

---

606 Kush kë e kontrollon në arenën e inteligjencës në Maqedoni, http://www.analyticamk.org/images/stories/newsletters/2012/1201_ final.pdf, Analitika, Buletin, 2012, Shkup, 2012 [qasur më 25 korrik 2015]

607 http://www.cpt.coe.int/documents/mkd/2008-31-inf-eng.pdf, f.18 [qasur më 25 korrik 2015]

608 http://b2.mk/news/barabite-od-snimkite-na-jankulovska-tepale-za-vreme-na-izbori-vo-ohrid?newsid=STTg, [qasur më 2 gusht 2015]

609 Kodeksi maqedonas i etikës policore bazohet në Kodeksin e etikës të Këshillit të Evropës (2001) dhe zyrtarisht është promovuar në vitin 2004, http://www.legislationline.org/documents/action/popup/id/5719 [qasur më 2 gusht 2015]

610 Raport vjetor për vitin 2014 i Sektorit për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale, http://www.mvr.gov.mk/ DesktopDefault.aspx?tabindex=0&tabid=130 [qasur më 17 korrik 2015]

611 Ligji për polici, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 114/2006, 6/2009, 45/2012, 41/2014, 33/2015, neni 100.

Në përputhje me nenin 104 të Ligjit për polici, nën kushte të caktuara, nëpunësit policorë mund të kryejnë punë të caktuara dhe të realizojnë të ardhura shtesë përveç punës së tyre në polici. Kjo punë nuk duhet të jetë në kundërshtim me punët e policisë. Ekziston Kodeks i etikës policore që i rregullon konfliktet e interesave dhe i avancon ndershmërinë dhe punën profesionale dhe shërbyese policore.[612] Në legjislativ nuk ka rregulla që përcaktojnë konflikt të interesave për nëpunësit policorë dhe konfliktet e interesave janë të përfshira me Kodeksin për etikë policore, që nuk është dokument detyrues. Kodeksi përmban rregulla për dhurata dhe mikpritje, por nuk ekziston procedurë e përcaktuar qartësisht për deklarim të dhuratave dhe mirëpritjes ose për mbikëqyrje të procesit. Ekzistojnë kufizime të caktuara pas shkarkimit nga puna, duke marrë parasysh natyrën konfidenciale të punës policore.[613]

Nëpunësit e lartë policorë që emërohen nga Qeveria janë lëndë e regjimit të njëllojtë për deklarim të pasurive, si dhe funksionarët tjerë publikë.

5.2.6 MEKANIZMI PËR INTEGRITET (PRAKTIKA)

Nota **25**

Deri në çfarë shkalle integriteti i pjesëtarëve të agjencive për zbatim të ligjeve sigurohet në praktikë?

MPB-ja në mënyrë aktive mbështet projekte për trajnim dhe edukim të nëpunësve policorë.[614]

Policia publikisht i shpall masat disiplinore që ka marrë kundër nëpunësve policorë. Në bazë të raportit vjetor për vitin 2014, janë ngritur 188 procedura disiplinore dhe katër (4) funksionarë janë suspenduar deri në përfundim të procedurave. Vetëm 64 nëpunës janë dënuar me të holla, kurse 19 prej tyre kanë marrë paralajmërim me shkrim. Konsiderohet që mekanizmi disiplinor nuk është i pavarur.

Nuk është arritur përparim lidhur me parandalimin e veprimit politik në lokalet policore. Ekzistojnë tregues që disa nëpunës policorë akoma përdoren për promovim dhe për kryerje të qëllimeve të partive politike gjatë zgjedhjeve.[615]

U tregua që policia ka fshehur parregullsitë në punën e vet, si’ç mund të shihet në rastet “Neshkovski” nga viti 2011 dhe “Gjorçe Petrov” nga viti 2014.[616] U konstatua që sigurimi i politikanëve e shkel rendin dhe qetësinë publike, pa u ballafaquar me procedurë disiplinore ose sanksione tjera.[617]

ROLI

5.3.1 NDJEKJA PENALE E KORRUPSIONIT

Nota **50**

[612] Kodeksi maqedonas i etikës policore bazohet në Kodeksin e etikës të Këshillit të Evropës (2001) dhe zyrtarisht është promovuar në vitin 2004, http://www.legislationline.org/documents/action/popup/id/5719 [qasur më 15 korrik 2015]
[613] Ligji për polici, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 114/2006, 6/2009, 45/2012, 41/2014, 33/2015, neni 114. [qasur më 15 korrik 2015]
[614] Raport vjetor i MPB-së dhe Qendrës për Trajnim.
[615] http://www.dailymotion.com/video/x2lkqrs [qasur më 2 gusht 2015]
[616] http://fokus.mk/kako-mvr-se-obiduvashe-da-ja-sokrie-vistinata-za-ubistvoto-na-martin-neshkoski/
http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/700/2014_1.pdf [qasur më 5 gusht 2015]
[617] http://www.dnevnik.mk/?ItemID=7397DC17DAD1D24AB1CDEC97DC10E553 [qasur më 15 korrik 2015]

Deri në çfarë shkalle agjencitë për zbatim të ligjeve i zbulojnë dhe i hetojnë rastet e korrupsionit në vend?

Ekziston kornizë shumë e mirë ligjore dhe institucionale për hetim të korrupsionit. Megjithatë, edhe pse agjencitë për zbatim të ligjeve kanë hetime për raste të korrupsionit, puna e tyre rrënjësisht është përgjegjëse në vend që të jetë proaktive dhe përqendrohet në numër të vogël të rasteve, e rrallë rezulton me akuza dhe dënime të suksesshme.

Korniza legjislative për parandalim të korrupsionit u bë në përputhje dhe u zhvilluan MPH për përforcim të kompetencave policore në kryerjen e hetimeve për korrupsion. Megjithatë policia nuk i përdor kompetencat e veta në mënyrë efektive, veçanërisht kur bëhet fjalë për korrupsionin ku janë të përfshira partitë politike.

Në vitin 2013, Prokuroria Themelore Publike për Ndjekje të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit ka pranuar 136 akuza të reja penale kundër 478 personave që kanë kryer veprat penale.[618] Në bazë të të dhënave statistikore të Gjykatës Themelore Shkupi 1, në vitin 2012, gjykata ka punuar vetëm me 97 raste lidhur me korrupsion, nga gjithsej 1.768 raste të krimit të organizuar dhe korrupsionit.[619]

REKOMANDIME

P1. Ministria e Punëve të Brendshme duhet të themelojë rregulla efektive lidhur me konfliktin e interesave për nëpunësit policorë.

P2. Ministria e Punëve të Brendshme duhet të sigurojë mekanizma efektivë kontrollues për zbatim të Kodeksit të etikës policore dhe rregullat për dhurata dhe mikpritje.

P3. Ministria e Punëve të Brendshme duhet të themelojë mekanizma efektivë për paraqitje të parregullsive, për parandalim të aktiviteteve politike në lokalet e policisë për të përforcuar aftësinë e nëpunësve policorë për kundërshtim të përzierjeve të papërshtatshme politike dhe aftësinë për kundërshtim të përdorimit të tyre si mjet të partive politike gjatë zgjedhjeve.

[618] QMBN, *Raport për ndjekje të rreziqeve nga korrupsioni dhe krimi i organizuar,* (Shkup: QMBN, 2014), f. 12
[619] Njëlloj.

6. PROKURORIA PUBLIKE

PËRMBLEDHJE

Ligji për procedurë penale (LPP) i vitit 2010 ka ndryshuar sistemin ligjor në Maqedoni, nga sistem inkuizitori, në të cilin hetimin për lëndë e udhëheq gjykatësi hetimor, në sistem prokurorie, në të cilin prokuroria përballet me mbrojtjen. Prokuroritë duhet të ndërmarrin një rol tërësisht të ri. Megjithatë, sistemit të prokurorisë i mungojnë resurse për zbatimin e plotë të ligjit të ri që prokurorët të mund të zbatojnë detyrat e tyre të reja. Sistemi i prokurorisë, gjithashtu përballet me sfida që janë të lidhura me transparencën dhe integritetin.

Në praktikë, sistemi i prokurorisë nuk është i pavarur. I ashtuquajturi, rasti "Grusht[620]", si dhe zbulimet nga skandali me përgjimet, tregoi që prokuroria është lëndë e ndikimeve të pakëndshme nga partitë politike në pushtet. Ka një mosbesim publik në integritetin e Prokurorit Publik Shtetëror dhe ka kërkesa për dorëheqjen e tij. Prokuroria akuzohet për zbatim[621] përzgjedhës të ligjeve, si dhe që vendimet e prokurorisë u nënshtrohen ndikimeve politike. Më 15 shtator 2015 është themeluar Prokuroria Speciale për hetim të veprave të paligjshme dhe korrupsion në nivel të lartë.

NOTA E PËRGJITHSHME PËR SHTYLLËN: **42,3/100**

DIMENSIONI	TREGUES	E DREJTA	PRAKTIKA
Kapaciteti 56,2/100	Resurset	75	50
	Pavarësia	50	50
Qeverisja 45,8/100	Transparenca	50	25
	Llogaridhënia	50	50
	Integriteti	75	25
Roli 25/100	Roli	25	

[620] http://www.time.mk/c/5c4850a18a/sudbinata-na-slucajot-puc-neizvesna.html Kundër liderit të partisë më të madhe opozitare në Maqedoni ishte parashtruar kallëzim penal nga policia në janar 2015 për marrëveshje sekrete me shërbim të huaj për kundërzbulim për rrëzim të pushtetit. Zoran Zaev, lideri i Lidhjes Demokrate, ka mohuar akuzimet, duke pohuar që pushteti kot ka tentuar të ndalojnë publikimin e asaj që ia thotë janë dëshmi ndezëse për sjelljen kriminele të qeverisë konservatore të kryeministrit Nikolla Gruevski.

[621] Intervistë me prof. Gordan Kalajxhiev, http://novatv.mk/index.php?navig=8&cat=16&vest=21103 http://www.independent.mk/articles/13918/EU+Voices+Concern+about+Macedonia's+Political+Situation+after+Espionage+Arrests [qasur më 5 qershor 2015]

Vlerësimi për shtyllën sipas të drejtës dhe praktikës



STRUKTURA DHE ORGANIZIMI

Puna e Prokurorisë Publike (PP) në Republikën e Maqedonisë është e rregulluar me Ligjin për Prokurori Publike[622] dhe Ligjin për Këshillin e Prokurorëve Publikë[623]. Prokuroria Publike është organ i pavarur shtetëror që ka për qëllim të ndjekë kryerësit e veprave kriminale. Këshilli i Prokurorëve Publikë është themeluar në vitin 2007 për sigurim dhe garantim të pavarësisë së prokurorëve publikë në kryerjen e funksionit të tyre. Këshilli është i përpiluar nga 11 anëtarë që zgjidhen në mënyrë të ndryshme. Anëtarët e Këshillit me detyrë zyrtare janë Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë dhe ministri i Drejtësisë. Një anëtar të Këshillit e zgjedhin prokurorët publikë të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë nga radhët e tyre; nga një anëtar zgjidhet nga prokurorët publikë të prokurimeve publike nga rajonet e prokurorive publike epror të radhëve të tyre; një anëtarë i Këshillit zgjidhet nga radhët e anëtarëve të komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë; dhe tre anëtarë të Këshillit zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

Struktura organizative e prokurorisë e ndjek strukturën e gjykatave. Prokurori Publik në Republikën e Maqedonisë vepron vetëm para Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë. Prokuroria e Lartë Publike ka të drejtë të veprojë para gjykatave të apelit dhe është organizuar në nivel rajonal në katër rajonet e njëjta, si dhe në gjykatat e apelit. Prokuroria Themelore Publike vepron para gjykatës themelore.

Prokuroria Themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsion është themeluar për ndjekje të krimit të organizuar ose raste të korrupsionit në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe vepron para një Seksioni special për krim të organizuar në Gjykatën Themelore në Shkup. Prokurori Publik e udhëheq procedurën para hetimore dhe ka në dispozicion persona zyrtarë në polici, polici financiare dhe Drejtorinë e Doganave[624].

[622] Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 150 nga 12.12.2007 dhe nr. 150 nga 3.09.2008
[623] Rekomandim i Këshillit të Ministrave, nr. (2009) 119, Roli i Prokurorëve Publikë në sistemin e ligjvënies penale.
[624] Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 150/2007,11/2008, Neni 30.

VLERËSIMI

KAPACITETI

6.1.1. RESURSET (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle ka ligje me të cilat sigurohen rroga përkatëse dhe kushte të punës për prokurorët?

Buxheti dhe rrogat e Prokurorisë Publike janë rregulluar me Ligjin për Prokurori Publike[625]. Rrogat dhe kompensimet tjera të prokurorëve publikë janë në nivelin e njëjtë si për gjykatësit tjerë. Ligji parashikon, nga ana tjetër, që rrogat e prokurorëve publikë nuk mund të zvogëlohen, përveç në raste të përcaktuara me ligj. Ministri i Drejtësisë i përcakton shumën dhe mënyrën e pagesave të rrogës për Prokurorinë[626]. Shuma e rrogave përcaktohet në bazë të përvojës së punës, llojit të prokurorisë publike, okupacionet shkencore-profesionale, niveli i kompetencës, arsimi dhe trajnimi[627]. Nuk ka mekanizëm për sigurim të përputhjes së rrogave, por ligji parashikon rroga përkatëse që do të mbrojnë prokurorin nga ndikime për veprimet dhe vendimet[628]. Në kuadër të reformave në gjyqësor në Maqedoni, rrogat e gjykatësve dhe prokurorëve ishin përmirësuar në krahasim me nëpunësit tjerë shtetërorë si masë për parandalimin e korrupsionit.

Prokuroria Publike ka një pjesë të posaçme buxhetore në buxhetin shtetëror[629]. Pjesa e mjeteve buxhetore propozohet nga MF-ja, që ka për obligim, para se të dorëzojë propozimin në Kuvend, të kërkojë mendim nga Prokuroria Publike[630]. Prokuroria Publike ka obligim ligjor të marrë pjesë në procesin[631]. Shpërndarja e mjeteve që janë aprovuar me buxhetin bëhet nga Prokuroria Publike në bashkëpunim me Këshillin e Prokurorëve Publikë.

6.1.2. RESURSET (PRAKTIKA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle prokurorët publikë kanë nivele adekuate të resurseve financiare, të punësuar dhe infrastrukturë për punë në praktikë?

Në përputhje me Raportin vjetor të punës së PP-së, buxheti i Prokurorisë Publike është i pamjaftueshëm për të kryere punën përkatëse[632]. Niveli i rrogave për prokurorët është në nivel të kënaqshëm.

Në prokuroritë publike ka një mungesë të resurseve njerëzore, jo vetëm në kuptim të prokurorëve, por edhe në kuptim të këshilltarëve, bashkëpunëtorëve dhe punonjësve, punëtorë administrativë-profesionistë dhe staf teknik ndihmës. Prokuroritë publike përballen

[625] Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 150/2007,11/2008, Neni 88 dhe Neni 52.
[626] Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së Nr. 150/2007,11/2008, Neni 54.
[627] Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 150/2007,11/2008, Neni 52.
[628] Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 150/2007,11/2008, Neni 52, Parag. 3.
[629] Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 150/2007,11/2008, Neni 88.
[630] Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 150/2007,11/2008, Neni 88, Parag. 3
[631] Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 150/2007,11/2008, Neni 88, Parag. 2.
[632] JO, *Raporti vjetor për punën e PP-së për 2013,* (Shkup: PP, 2013), f. 65.

me probleme dhe mungesë të literaturës profesionale, ndonëse ka në nivel pajisje kompjuterike.[633]

Prokurorët nuk kanë mjaft përvojë dhe njohuri, që manifestohet me anë të mungesës së qasjes proaktive në ndjekjen e rasteve. Autoritetet politike kryejnë ndikim mbi ndjekjen e rasteve. Në të gjitha aspektet, Prokuroria Publike një kohë të gjatë margjinalizohet dhe injorohet nga shteti.[634]

Në bazë të Raportit të BE-së mbi përparimin e RM-së për vitin 2015: "Qendra hulumtuese në kuadër të PP-së për luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, e themeluar në mënyrë formale në vitin 2011, është përforcuar me kapacitet administrativ, përfshirë edhe 9 persona në vitin 2014 dhe 13 në 2015 dhe me mjete ndihmëse audio-vizuale dhe pajisje TI".[635]

Skandali i fundit me përgjime masive në mënyrë dramatike ka hapur çështjen e kapacitetit të PP-së për përballim me situatën. PP-ja ka kërkuar monitorim ndërkombëtar nga Komisioni Evropian dhe mbështetje në zgjedhjen e rastit "Grusht" dhe rastet e përgjimit, duke menduar që kjo ndihmë do të sigurojë transparencë në procesin e akuzimit[636]. Kjo kërkesë, ndonëse përshëndet nga partia në pushtet[637], dhe nga opozita[638], ishte refuzuar me sqarimin që gjyqësori maqedonas dhe prokuroria janë të vetmit kompetenët për zgjedhjen e rasteve të cilat dalin nga skandali.[639]

Prokurori Publik është lëndë e kritikave të rrepta nga organizata të shoqërisë qytetare, në medie dhe opozita për promovimin e procesit "Grusht" dhe për shtypjen e proceseve që janë të lidhura me përgjimin. Ka kërkesa të shumta për dorëheqjen e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë nga publiku dhe nga opozita.[640]

6.1.3. PAVARËSIA (E DREJTA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle prokurori publik është i pavarur në kuptim të drejtësisë?

Janë në vend dispozita të caktuara që kanë të bëjnë me pavarësinë e prokurorit publik, por nuk janë gjithëpërfshirëse. Ndonëse pavarësia e prokurorit publik nuk është përcaktuar në mënyrë eksplicite në Kushtetutë, vlerësimi i Prokurorisë Publike nga ana e GREKO-s pranon që pavarësia e saj institucionale dhe pavarësia funksionale garantohen me Kushtetutë dhe ligj[641]. Roli i qeverisë në propozimin e kandidatit për prokuror publik të R. së Maqedonisë pas shqyrtimit të mendimit të Këshillit të Prokurorëve Publikë paraqet kërcënim për pavarësinë e prokurorit publik të R. së Maqedonisë[642], të cilin e emëron dhe shkarkon Kuvendi për periudhë prej 6 viteve, me të drejtë të riemërimit [643]. Prokurorët tjerë publikë i zgjedh

[633] JO, 2013 : f. 65.
[634] Prof. Gordan Kalajxhiev, *Mbrojtja efektive në procedurat penale në Republikën e Maqedonisë, Analiza e Law Watch* (Shkup, FOS, Maqedoni, 2014).
[635] Komisioni Evropian, 2015: f. 64.
[636] http://www.telegraf.mk/aktuelno/makedonija/258313-obvinitelstvoto-dobi-odgovor-od-brisel [qasur më 15 maj 2015]
[637] BDI, partia kryesore e shqiptarëve etnikë në koalicionin në pushtet, e para propozoi monitorim ndërkombëtar
[638] Utrinski Vesnik, 16 mars 2015
[639] http://www.mkdnews.com/2015/03/evropskata-komisija-go-odbi-baranjeto-na-zvrlevski/ [qasur më 17 maj 2015]
[640] Vest, Utrinski Vesnik, 16 mars 2015
[641] GREKO, 2014 : f. 42.
[642] Kushtetuta e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 52/91, Neni 106.
[643] Kushtetuta e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 52/91, Neni 106.

Këshilli i Prokurorëve Publik, pa asnjë kufizim të afatit të mandatit të tyre.

Këshilli i Prokurorëve Publikë është organ i pavarur që garanton pavarësinë e prokurorëve publikë në kryerjen e funksioneve të tyre. Këshilli ishte themeluar në vitin 2007 me Ligjin mbi Këshillin për Prokurorë Publikë[644]. Përgjegjësitë që ish sistemi inkuizitor kishte në fushën e kompetencave të gjykatësve, tani u janë dhënë prokurorëve publikë. Ky sistem është në përputhje me sistemet e prokurorëve të vendeve tjera të Evropës Juglindore.

Në përputhje me LPP-në[645], PP-ja është një organ i pavarur nga i cili kërkohet të bëjë punën në mënyrë ligjore, të paanshme, duke respektuar dhe mbrojtur liritë dhe të drejtat e njeriut, gjatë së cilës për qëllim ka ndjekjen e kryerësve të veprave penale[646]. LPP-ja i përcakton kriteret për punësim dhe avancim të prokurorëve publikë në bazë të njohurisë profesionale, pjesëmarrjes në edukimin e vazhduar dhe mentorim.[647]

Në përputhje me LPP-në, Këshilli ka për obligim të përgatsë dhe të zbatojë Rregullore për përcaktim të mënyrës së vlerësimit të punës së prokurorëve publikë. Vlerësimin e punës së prokurorit publik për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit e kryen vetëm Prokurori Publik i R. së Maqedonisë. Prokuroria Publike Themelore për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit e parashtron Raportin vjetor te prokurori publik i R. i Maqedonisë, i cili më tutje prezanton raportin para Kuvendit.

Ligji parashikon që asnjë person ose organ nuk e ka të lejuar të urdhërojë prokurorët të ndjekin ose të pushojnë me ndjekjen e një rasti të caktuar[648]. Përveç kësaj, prokurorëve publikë u është ndaluar të jenë pjesëmarrës në organizata politike dhe të marrin pjesë në aktivitete politike.

6.1.4. PAVARËSIA (PRAKTIKA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle prokurori publik punon pa përzierjen e qeverisë ose aktorëve tjerë?

Ndonëse korniza ligjore është përmirësuar, ka shqetësime në kuptim të pavarësisë së PP-së dhe ndikimit politik në praktikë. Kriteret për emërimin e PP-ve janë të qarta dhe të përcaktuara në LPP (nenet 40-47), por ka ndikim politik mbi procesin e emërimit.[649]

Nga prokurorët publikë kërkohet të jenë të pavarur në kryerjen e funksioneve të tyre. Megjithatë, ka pasur raste të gjoja ndikimit të padrejtë të jashtëm dhe politik mbi prokurorët publikë. Në një lëndë penale, zëvendëskryetari i Qeverisë ishte akuzuar për keqpërdorimin e detyrës zyrtare. Stenogramet e bisedave të përgjuara telefonike që ishin zbuluar nga opozita sugjerojnë që ministrja e Punëve të Brendshme gjoja ka intervenuar për rastin me kërkesë te prokurori publik të ndalojë ngritjen e akuzës kundër zëvendëskryetarit të Qeverisë. Prokurori publik ka vendosur që mos e shqyrtojë rastin.[650]

[644] Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 150/2007.
[645] Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 150/2007,11/2008, Neni 5.
[646] Vlera identike janë përcaktuar në Kodin për Etikë të Prokurorëve Publik në Republikën e Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 194 nga 25.12.2014
[647] Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 150/2007,11/2008, Neni 45.
[648] Ligji përProkurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 150/2007,11/2008, Neni 5.
[649] Në incizimet audio që ishin prezantuar nga partia opozitare, prokurori publik i RM-së e bind ministrin e Punëve të Brendshme të kërkojë nga partneri i koalicionit BDI të pajtohet për një person të caktuar me kombësi maqedonase të emërohet në funksionin e prokurorit epror në PP në Shkup, https://www.youtube.com/watch?v=mhZI6wQdvnI [qasur më 8 maj 2015]
[650] Incizime të publikuar në shkurt 2015. https://www.youtube.com/watch?v=bEdyLTATg9g [qasur më 7 maj 2015].

Në një rast tjetër, lideri i opozitës ka akuzuar kryetarin e Qeverisë për korrupsion. Kryetari i Qeverisë ka parashtruar procedurë qytetare kundër liderit të opozitës për fyerje. Prokurorët publikë nuk kanë nisur asnjë procedurë penale në lidhje me pohimet për korrupsion.[651]

QEVERISJA

6.2.1 TRANSPARENCA (E DREJTA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle janë përcaktuar dispozita për siguri me të cilat publiku mund të ketë qasje në informatat relevante për aktivitetet dhe proceset e vendimmarrjes së prokurorit publik?

Ligji për Prokurori Publike e përcakton strukturën organizative të sistemit të Prokurorisë Publike. Megjithatë, ka mekanizma të dobët për sigurimin e transparencës në sistemin e Prokurorisë Publike. Prokurori publik për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsion (si dhe prokurorët tjerë) [652] është i obliguar të sigurojë qasje në informata të publikut dhe mjeteve të informimit publik për gjendjen e nivelit të krimit dhe çështje tjera që janë kompetencë e Prokurorisë Publike.

Prokurorët kanë obligim të paraqesin fleta anketuese për paraqitjen e gjendjes së tyre pronësore që publikohen nga KSHPK-ja[653]. Gjithashtu, prokurorët obligohen të përditësojnë fletat e tyre anketuese për gjendjen e tyre pronësore me ndryshimet e gjendjes së tyre pronësore[654]. Ngjashëm me sistemin e përpiluar për gjykatësit, fletat anketuese dorëzohen te KSHPK-ja dhe në DHP-ja. Procedura për ndjekjen dhe shqyrtimin është e njëjtë[655]. Deklaratë, e regjistruar në noter, deponohet bashkë me fletën anketuese, me theksimin e hollësishëm të llogarive në bankë dhe nga heqja dorë nga fshehtësia e llogarive bankare në bankat vendore dhe të jashtë vendit.

Me Ligjin për procedurë penale (LPP) kërkohet nga Prokuroria Publike të punojë më tepër në promovimin publik.[656]

Kodi etik[657] i prokurorëve publikë përfshin obligime për transparencë. Prokurorët publikë kanë për obligim që medieve tu japin sa më shumë informata të lejueshme, duke marrë parasysh të drejtat e viktimave të veprës penale, gjegjësisht, të dëmtuarit, si dhe të drejtat e të dyshuarve, gjegjësisht të akuzuarve.[658]

Të drejtat e të akuzuarve dhe të avokatëve të mbrojtjes për shqyrtim të shkresave të lëndëve të tyre është e kufizuar në mënyrë të padrejtë. Neni 79 Parag. 1 i LPP-së u jep të drejtë avokatëve të mbrojtjes të shqyrtojnë shkresat dhe dëshmitë gjatë procedurës. Megjithatë, me

[651] Rasti "Makedonska Banka", Nikolla Gruevski kundër Zoran Zaev, http://novatv.mk/index.php?navig=8&vest=16477&cat=2; http://www.24vesti.mk/javnoto-obvinitelstvo-nema-da-pokrene-postapka-za-sluchajot-%E2%80%9Emakedonska-banka%E2%80%9C [qasur më 15 maj 2015].

[652] Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 150/2007,11/2008, Neni 8.

[653] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, Neni 33.

[654] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, Neni 33 – a (1).

[655] Shikoni faqen: http://www.dksk.org.mk/images/Drzavni_Programi/%D0%93%D0%9E%D0%94%D0%98%D0%A8%D0%95%D0%9D%20%D0%98%D0%97%D0%92%D0%95%D0%A8%D0%A2%D0%90%D0%88-2014-%D0%94%D0%9A%D0%A1%D0%9A.pdf [qasur më 25maj 2015]

[656] http://meta.mk/?p=54922&upm_export=doc [qasur më 28 maj 2015]

[657] Kodi etik i prokurorëve publikë në Republikën e Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 194/2014.

[658] Kodi etik i prokurorëve publikë në Republikën e Maqedonisë, Neni 15.

nenin vijues kufizohet e drejta e qasjes vetëm në materiale që i posedon Prokuroria Publike, që kanë të bëjnë me procedurat në të cilat ka marrë pjesë mbrojtja. Mbrojtja nuk ka qasje në shkresat dhe dëshmitë e Prokurorisë në lidhje me marrjen në pyetje të dëshmitarëve.[659]

LPP-ja bën një hap pozitiv duke obliguar organet e shtetit të shpalosin dëshmitë që janë në dobi të mbrojtjes, si dhe dëshmitë kundër tyre.[660]

6.2.2 TRANSPARENCA (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle në praktikë publiku ka qasje në informata për aktivitetet dhe proceset e vendimmarrjes së prokurorit publik?

Prokuroria Publike konsiderohet një prej institucioneve më pak transparente të Republikës së Maqedonisë.[661]

Në raste të ndjeshme politike, Prokuroria nuk siguron informata të qarta për publikun. Gjatë miratimit të Raportit vjetor të Prokurorisë Publike për vitin 2014, deputetët në Parlament kanë shprehur shqetësimin për mungesën e transparencës në punën e Prokurorisë Publike dhe kanë deklaruar që as Kuvendi, as publiku nuk kanë informata për mënyrën e kryerjes së detyrave të prokurorëve publikë[662]. Kryetari i Këshillit të Prokurorëve Publikë ka deklaruar që Raporti i tyre vjetor nuk është vetëm analitik, por edhe në mënyrë statistikore paraqet aktivitetet e Këshillit.[663]

Fletat anketuese për gjendjen pronësore janë publikuar në ueb faqen e KSHPK-së, megjithatë nuk është përcaktuar mekanizëm që mundëson ndjekjen precize të ndryshimeve të gjendjeve pronësore për faktitn që pas datës së parashtrimit, fleta anketuese nuk ndryshohet për përfshirje të ndryshimeve.[664] Megjithatë, prokurorët kryesisht e respektojnë obligimin e shpalosjes së gjendjeve të tyre pronësore.[665]

Në lidhje me rastin "Grusht" dhe projektin e opozitës të njohur si "E vërteta për Maqedoninë" ose "Bomba", prokurori publik i R. së Maqedonisë ka publikuar një deklaratë ku ka paralajmëruar mediet për pasojat e mundshme ligjore nga publikimi i informatave, që do të mund të përdoren si dëshmi nga institucionet e ligjvënies penale. Prokurori publik i R. së Maqedonisë u ka publikuar gazetarëve që ata do të përballen me gjoba nëse materialet që publikojnë "bëhen lëndë e procedurave të mëtutjeshme penale"[666]. Kjo deklaratë ishte kritikuar nga mediet, aktivistët për të drejtat e njeriut, dhe ekspertët nga fusha e ligjvënies penale si tentim për ndalimin e lirisë së medieve. Ambasada e SHBA-ve në Maqedoni ka lëshuar një deklaratë në të cilën ka shprehur "shqetësim" për paralajmërimin dhe ka theksuar rolin e medieve në prezantimin e informatave që janë në interes publik: "Jemi të shqetësuar që mediet në Maqedoni mund të interpretojnë deklaratën e Prokurorisë Publike në mënyrë që do të nënkuptonte se nuk duhet të luajnë këtë rol të rëndësishëm në këtë proces", theksohet në deklaratën, duke i ftuar pushtetin të sqarojnë "rrethanat kufizuese" në të cilat informatat

[659] Kalajxhiev, 2014 : f. 85.
[660] Kalajxhiev, 2014 : f. 56.
[661] Raporti i QMBN-së.
[662] Pavle Trajanov, 03.07.2014.
[663] http://sitel.com.mk/sobranieto-go-usvoi-godishniot-izveshtaj-za-rabotata-na-sovetot-na-javnite-obviniteli [qasur më 15 maj 2015]
[664] KSHPK, qaset në http://www.dksk.org.mk/imoti_2/ [qasur më 15 maj 2015]
[665] Intervistë me Millka Ristovën (Intervistë personale), 24.02.2014
[666] http://www.reuters.com/article/2015/02/06/us-macedonia-opposition-usa-idUSKBN0LA28420150206 [qasur më 15 maj 2015]

mund të përdoren si fshehtësi zyrtare[667]. OSBE-ja gjithashtu ka shprehur shqetësime në lidhje me këtë çështje.[668]

Pa marr-parasysh atë, Radio Televizioni Maqedonas (RTM) e përmendi deklaratën si shkak që të mos informojë mbi përmbajtjen e konferencave për shtyp të opozitës në lidhje me rastin "Bomba".

Lloji dhe niveli i informatave që u sigurohen mbrojtjes dhe të akuzuarve janë përcaktuar në LPP. Rezultatet nga hulumtimi anketues tregojnë se vetëm 11% nga të anketuarit konsiderojnë se informata në detaje janë siguruar, 21% prej tyre nuk janë informuar, kurse 68% nga të anketuarit konsiderojnë se janë siguruar informata të përmbledhura.[669]

PP e R. Maqedonisë ka Seksionin për Marrëdhënie me Publikun që është përgjegjës për grumbullimin e të gjitha informatave nga prokuroritë dhe për dorëzimin me kohë të tyre te mediet.[670]

Informatat që shpallen në internet faqen e PP-së[671] janë të kufizuara, kryesisht të përgjithshme dhe nuk janë të përditësuara.

Në Raportin vjetor KSHPK-së për vitin 2014 theksohet se masat në strategjinë kombëtare për luftën kundër korrupsionit mbi transparencën e Prokurorisë Publike ende nuk janë zbatuar.[672]

6.2.3 LLOGARIDHËNIA (E DREJTA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle janë themeluar dispozita për sigurim që prokurori publik duhet të dorëzojë raporte dhe të mbajë përgjegjësi për veprimet e veta?

Prokuroria Publike, Kuvendi, pushteti ekzekutiv dhe gjyqësori kanë obligimin që të kërkojnë llogaridhënie nga prokurori publik.

Prokurorët publikë në nivel të lartë kryejnë mbikëqyrje të punës së prokurorëve në nivel të ulët, kurse Prokuroria për Ndjekje për Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit është nën mbikëqyrjen e prokurorit publik të R. së Maqedonisë.[673] Procedura për kryerjen e mbikëqyrjes është përcaktuar me rregulloren që është miratuar nga Këshilli i Prokurorëve Publikë. Këshilli, gjithashtu, ka miratuar rregulla për vlerësimin e punës së prokurorëve publikë, ku prokurorët në nivele më të larta i vlerësojnë prokurorët në nivele më të ulëta.[674]

Këshilli i Prokurorëve Publikë gjithashtu miratoi rregullore për përcaktimin e përgjegjësisë së prokurorëve. Shkeljet disiplinore shqyrtohen nga Komisioni i përbërë prej 5 anëtarëve të formuar nga prokurori publik i R. së Maqedonisë.[675] Megjithatë, nuk ka organ të pavarur për hetim të ankesave kundër prokurorëve, dhe prokurorët publikë nuk kanë imunitet prej

667 http://www.reuters.com/article/2015/02/06/us-macedonia-opposition-usa-idUSKBN0LA28420150206 [qasur më 8 maj 2015]
668 http://libertas.mk/ [qasur më 8 maj 2015]
669 Kalajxhiev, 2014 : f. 138.
670 http://www.mkd.mk/makedonija/politika/javnoto-obvinitelstvo-dobi-oddelenie-za-odnosi-so-javnosta [qasur më 5 maj 2015]
671 http://www.jorm.org.mk/ [qasur më 5 maj 2015]
672 http://www.akademik.mk/wp-content/uploads/2015/04/GODISHEN-IZVESHTAJ-2014-DKSK.pdf [qasur më 27 maj 2015], f. 18.
673 Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 150/2007, Neni 21.
674 Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 150/2007, Neni 21.
675 Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 150/2007, Neni 72.

ndjekjeve penale[676].

LPP-ja përcakton një sërë rrethanash që mund të sjellin te shkarkimi i prokurorëve publikë që përfshijnë dënimin e prokurorëve me vendim të efektshëm gjyqësor, për vepra penale me dënime me burgim prej së paku gjashtë muajsh ose me sanksione penale tjera që i bëjnë prokurorët të padenjë për kryerje të funksionit të prokurorit publik.[677]

Prokurori publik i R. të Maqedonisë përgjigjet para Kuvendit për punën e vet edhe për punën e përgjithshme të Prokurorisë Publike.[678] Prokurori publik shtetëror i dorëzon raport vjetor për gjendjen me kriminalitetin në Maqedoni në Kuvend. Nuk ka obligim ligjor për shqyrtim të Raportit nga Kuvendi.[679]

6.2.4 LLOGARIDHËNIA (PRAKTIKA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle prokurorët dorëzojnë raporte dhe përgjigjen për veprimet e veta në praktikë?

Prokuroria Publike konsiderohet si një prej institucioneve më jotransparente. Numër i madh i institucioneve tjera, përfshirë Avokatin e Popullit[680], KSHPK-në[681], deputetët në Kuvend[682], grupet e organizatave të shoqërisë civile që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe mediet kanë shprehur pakënaqësinë e tyre nga Prokuroria Publike. Janë dorëzuar edhe disa kallëzime penale kundër prokurorit publik të R. së Maqedonisë për keqpërdorimin e funksionit zyrtar.[683]

Prokurori publik i R. së Maqedonisë një herë në vit u përgjigjet pyetjeve të Kuvendit për punën e Prokurorisë Publike, por zakonisht, nuk jepen përgjigje të plota dhe të besueshme.[684]

Sipas GREKO-s, duhet të rishqyrtohet regjimi i përgjegjësisë disiplinore që zbatohet për prokurorët. Disa prej bazave për shkarkim të prokurorëve, siç janë "sjellja e pahijshme ndaj individëve, organeve shtetërore ose subjekteve tjera ligjore në lidhje me kryerjen e funksioneve ose në ndonjë mënyrë tjetër" ose "lëndim të parimit të mos-diskriminimit në çfarëdo baze" janë formular në mënyrë të paqartë dhe shkeljet duhet të përcaktohen më qartë. Gjithashtu, GREKO rekomandon të zgjerohet shtrirja e sanksioneve me qëllim të arritjes së propocionaliteit më të madh, veçanërisht të sigurohet shkarkimi i prokurorëve të bëhet vetëm për rastet më serioze të shkeljeve.[685]

Në bazë të Nenit 271 të Ligjit mbi procedurën penale, Kuvendi ka obligim ligjor të shqyrtojë

---

676 Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 150/2007, Neni 65.
677 Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 150/2007, Neni 65.
678 Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 150/2007, Neni 20.
679 Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 150/2007, Neni 24.
680 Ixhet Memeti ka dërguar letra te Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK), Agjencia për Komunikime Elektronike, Prokuroria Publike dhe Kuvendi me kërkesë për informata në lidhje me aferat "Grusht" dhe "Bombë" http://www.utrinski.mk/?ItemID=1340CFE228DB2C46A40386FB3C82D988&commentID=631311&pLikeVote [qasur më 2 mars 2015]
681 http://24vesti.mk/drzhavnata-komisija-za-sprechuvanje-korupcija-so-zabeleshki-za-rabotata-na-instituciite [qasur më 15 mars 2015]
682 http://www.utrinski.mk/?ItemID=1340CFE228DB2C46A40386FB3C82D988&commentID=631311&pLikeVote=1 [qasur më 15 mars 2015]
http://www.sakam.info/liljana-popovska-pobara-odgovor-od-marko-zvrlevski-za-napadite-na-lgbti-zaednicata-25-12-2014.html?utm_content=buffer46089&utm_medium=social&utm_source=facebook.com&utm_campaign=buffer [qasur më 15 mars 2015]
683 http://www.time.mk/c/577ef565d8/stojance-angelov-ke-podnese-krivicna-prijava-protiv-zvrlevski.html [qasur më 27 mars 2015]
684 http://plusinfo.mk/vest/9384/popovska-do-zvrlevski-dali-obvinitelite-znaat-shto-se-covekovi-prava [qasur më 5 maj 2015]
685 GREKO, 2014 : f. 52.

përdorimin e MPH-së. Prokurori Publik i R. së Maqedonisë ka dorëzuar raportin mbi MPH-në të përdorur për vitin 2014.[686]

Ka ndikime politike mbi procesin e emërimit të prokurorëve publikë. Kur një ish prokuror i R. së Maqedonisë ishte pyetur për bisedat e tij me ministrin e Punëve të Brendshme në lidhje me emërimin e birit të një gjykatësi për prokuror publik, ai deklaroi që Prokuroria është organ i mëvetësishëm, por jo organ edhe i pavarur dhe që bashkëpunimi me pushtetin ekzekutiv në këtë kuptim është absolutisht legjitim.[687]

Me këtë konfirmohen pohimet për zbatim të përzgjedhur dhe ndikim politik mbi vendimet e Prokurorisë.[688]

6.2.5 INTEGRITETI (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle janë vendosur mekanizma për sigurimin e integritetit të prokurorëve?

Nuk ka gjatë kohë që është miratuar Kodi etik i prokurorëve publikë[689]. Në këtë janë përfshirë dispozita për transparencë të fletave anketuese për gjendjen pronësore[690], politika të konfliktit të interesit dhe parandalimit të korrupsionit.[691] Gjithashtu, Kodi përmban rregulla për pranimin e dhuratave dhe shërbimeve falas, si dhe udhëzime kundër prokurorëve për sjellje të pahijshme në ngjarje publike.[692] Ka një kufizim për prokurorët, pas përfundimit të marrëdhënies së punës për respektim të fshehtësisë profesionale pas përfundimit të funksionit në PP-së.[693]

Rroga e prokurorëve publikë është përcaktuar me ligj në shumë që prokurorit i siguron mbrojtje nga shtypjet dhe ndikimet gjatë veprimit dhe vendimmarrjes.[694]

Gjithashtu, ka rregulla edhe për konfliktin e interesave.[695]

6.2.6 INTEGRITETI (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle sigurohet integriteti i anëtarëve të gjyqësorit në praktikë?

Me vështirësi mund të vlerësohet efektiviteti i Kodit etik të prokurorëve publikë ekzistues sepse nuk është vendosur mekanizëm për zbatimin përkatës. Ngjashëm me atë, nuk ka mekanizëm për zbatimin ose mbikëqyrjen e rregullave për pranimin e dhuratave, fletave anketuese për gjendjen pronësore ose deklaratave për konflikt të interesave.[696]

---

686 http://sky.mk/makedonija/432392-pavle-trajanov-pobara-oddrzhuvanje-na-sobraniska-sednica-na-koja-kje-se-rasprava-za-aktuelnata-kriza [qasur më 27 mars 2015]
687 http://plusinfo.mk/vest/19103/shvrgovski-za-dojce-vele-obvinitelstvoto-e-samostoen-organ-no-ne-e-nezavisen [qasur më 27 mars 2015]
688 Ministri i Drejtësisë pak para publikoi që ka pësuar shtypje politike, Utrinski Vesnik 16 mars 2015
689 Kodi etik i prokurorëve publikë në Republikën e Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 194/2014
690 Kodi etik i prokurorëve publikë në Republikën e Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 194/2014, nenet 3 dhe 4.
691 Kodi etik i prokurorëve publikë në Republikën e Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 194/2014, Neni 4.
692 Kodi etik i prokurorëve publikë në Republikën e Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 194/2014, Neni 6.
693 Kodi etik i prokurorëve publikë në Republikën e Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 194/2014, Neni 9.
694 Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 150/2007, Neni 52.
695 Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 150/2007, Neni 62.
696 GREKO, 2014 : f. 6.

Këshilli i Prokurorëve Publikë ka shkarkuar një prokuror publik në bazë të shkeljes disiplinore dhe në bazë të një vepre penale të kryer[697]. Në vitin 2014, KSHPK-së përcaktoi një rast në të cilin prokurori nuk ka paraqitur interesat në përputhje me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave.[698]

Prokurorisë Publike i mungon integriteti dhe konsiderohet që nuk është e aftë t'i përgjigjet skandalit për përgjimin e paligjshëm.[699]

ROLI

6.3.1 ROLI

Nota **25**

Në çfarë shkalle prokurori publik i heton dhe ndjek rastet e korrupsionit në vend?

Miratimi i LPP-së së re në dhjetor 2013 ka sjellë ndryshime të rëndësishme në role përkatëse dhe relacione ndërmjet gjithë pjesëmarrësve në procedurën penale, përfshirë edhe një rol aktiv dhe udhëheqës të prokurorit publik në procesin para dhe gjatë hetimit, me kontrollin e policisë dhe organeve tjera të zbatimit të ligjeve.

Prokurori publik ka autorizime ligjore të udhëheqë hetime për rastet e korrupsionit dhe nuk ka nevojë aprovim nga institucionet tjera për ndjekjen dhe udhëheqjen e rasteve të caktuara të korrupsionit. Autorizimet e prokurorëve në lidhje me rastet e korrupsionit janë adekuate (p.sh. urdhra për kontroll, arrestim, qasje në informata personale, përdorim të MPH-së). Ka një sërë kriteresh të qarta për vendimmarrje nga ana e prokuroreve nëse duhet ose jo të ndjekin rastet e korrupsionit.

Megjithatë, për shkak të mungesës së transparencës, prokurori publik është kritikuar publikisht që nuk është përgatitur të fillojë procedura për korrupsion.[700] Ka një perceptim që pas rasteve që nisen nga policia "Grusht" ose nga opozita "Bomba" veprohet në mënyrë më energjetike. Organizatat e shoqërisë civile që bashkëpunojnë në kuadër të "Platformës për luftë kundër korrupsionit" kanë ftuar prokurorinë publike të fillojë hetime dhe të ndjekë personat që kanë autorizuar përgjimin e paligjshëm të bisedave telefonike.[701]

REKOMANDIME

R1. Këshilli i Prokurorëve Publikë duhet të vendosë mekanizëm efektiv për zbatimin e Kodit etik.

R2. Prokuroria Publike duhet të sigurojë informata të sakta dhe me kohë në lidhje me ndjekjen e rasteve të korrupsionit, si dhe për rastet që janë të lidhura me bisedat e përgjuara telefonike në mënyrë të paligjshme.

---

[697] Këshilli i Prokurorëve Publikë i Republikës së Maqedonisë, *Raporti vjetor për 2014 ,* f. 5.
[698] Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, *Raporti vjetor për 2014 ,* (Shkup: Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 2015).
[699] Partia Politike "Lidhja Demokratike", Pavle Trajanov.
[700] Nova TV, intervistë me prof.. Gordan Kalajxhiev http://novatv.mk/index.php?navig=8&cat=16&vest=21103 [qasur më 27 mars 2015].
[701] http://alsat.mk/News/13527/nevladini-organizacii-baraat-istraga-za-aferata-so-prislushuvawe [qasur më 27 mars 2015]

7. KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

PËRMBLEDHJE

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) është organ i pavarur përgjegjës për kryerjen e mbikëqyrjes së zgjedhjeve. Megjithatë, me këtë vlerësim ishte përcaktuar që roli në mbikëqyrjen e zbatimit të proceseve zgjedhore është mjaft i kufizuar. Anëtarët e KSHZ-së, në përputhje me ndryshimet e reja të Kodit zgjedhor nga 10 nëntori 2015, emërohen në përputhje me rregulloren e re, që do të thotë tre anëtarë të partive në pushtet, tre anëtarë të opozitës dhe tre ekspertë[702]. Mbi punën, pavarësinë, integritetin dhe përgatitjen e KSHZ-së për të hetuar parregullsitë zgjedhore, në masë të madhe ndikon përbërja e anëtarëve, që ka rezultuar me politizim të fuqishëm të punës së KSHZ-së. Transparenca dhe llogaridhënia në punën e KSHZ-së gjatë zgjedhjeve të fundit ishin shumë më të dobëta në krahasim me ciklet paraprake zgjedhore.

Vlerësimi i plotë që bazohet me treguesit është shumë i ultë.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur notat sipas treguesit që në mënyrë përmbledhëse japin notën e KSHZ-së në kuptim të kapacitetit, drejtimin e brendshëm dhe roli në kuadër të sistemit maqedonas për integritet. Në vazhdim të kësaj pjese jepet një analizë sasiore për secilin tregues.

NOTA E PËRGJITHSHME PËR SHTYLLËN: 40,2/100

DIMENSIONI	TREGUES	E DREJTA	PRAKTIKA
Kapaciteti 50/100	Resurset		50
	Pavarësia	75	25
Qeverisja 45,8/100	Transparenca	50	50
	Llogaridhënia	50	50
	Integriteti	50	25
Roli 25/100	Rregullimi i fushatës	25	
	Krahasimi i zgjedhjeve	25	

[702] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 196/2015, neni 5 dhe 6.

Nota për shtyllën sipas të drejtës dhe praktikës.



STRUKTURA DHE ORGANIZIMI

Maqedonia ka pesë nivele të organeve të zbatimit të zgjedhjeve: KSHZ, Komisione Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) dhe Komisioni i Zgjedhjeve i Qytetit të Shkupit (KZQSH), këshillat zgjedhorë dhe këshilla zgjedhorë për votim në përfaqësitë diplomatike-konsullore.[703] Rregullat formale, autorizimet dhe përgjegjësitë e organeve për zbatim të zgjedhjeve janë përcaktuar në mënyrë të hollësishme në Kodin zgjedhor. KSHZ-ja i përgatit dhe zbaton zgjedhjet për Kryetar të Republikës, deputetë në Kuvend, kryetarë të komunave dhe anëtarë të këshillave të komunave dhe zbaton referendume, përpilon udhëzime dhe standarde për zbatim të zgjedhjeve dhe trajnon dhe mbikëqyr organet zgjedhore. Anëtarët e KSHZ-së zgjidhen me dy të tretën e shumicës së votave në Kuvend nga numri i plotë i deputetëve[704]. KSHZ-ja përbëhet nga kryetari, nënkryetari dhe shtatë anëtarë[705], të cilët zgjidhen për mandat prej pesë viteve dhe kanë të drejtë për rizgjedhje. Duhet të ketë përfaqësim të drejtë dhe përkatës të të gjitha komuniteteve. Gjithashtu, duhet të ketë përfaqësim të drejtë të qytetarëve në KKZ, KZQSH dhe këshillat zgjedhorë në komunat në të cilat 20% të qytetarëve u përkasin komuniteteve të ndryshme. Me shërbimin profesional të KSHZ-së udhëheq sekretari i përgjithshëm që është përgjegjës për kryerjen e punëve administrative dhe teknike. Të punësuarit në shërbimin profesional të KSHZ-së kanë status të nëpunësve shtetërorë.

VLERËSIMI

KAPACITETI

7.1.1 RESURSET (PRAKTIKA)

Nota **50**

[703] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 17.
[704] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 27.
[705] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 196/2015, neni 5.

Në çfarë shkalle KSHZ-ja posedon resurse përkatëse për arritjen e qëllimeve në praktikë?

KSHZ-ja posedon resurse përkatëse njerëzore dhe teknike[706]. Shërbimi profesional i KSHZ-së ishte rritur me 7 të punësuar pas themelimit[707], deri më 26 të punësuar në qendër dhe 72 të punësuar në njësitë rajonale[708]. Sipas bashkëfolësve, OSBE-ja ka dhënë donacion të pajisjes së cilësisë së lartë për mundësimin e arkivimit elektronik të të dhënave[709], megjithatë nuk ka pasur raport zyrtar për donacionin.

KSHZ-ja financohet me anë të shpërndarjes së mjeteve nga Buxheti Shtetëror, por shuma e buxhetit të tyre dallohet varësisht nëse ka zgjedhje. Siç është prezantuar në Tabelën 1, gjatë tre viteve të fundit buxheti i KSHZ-së është zvogëluar për 2.4%[710]. Sipas nënkryetarit dhe një prej anëtarëve të KSHZ-së, mjetet që shpërndahen për zgjedhjet janë të mjaftueshme, ndërsa nga buxheti i rregullt për punën e përditshme nuk i mbulon aktivitetet e planifikuar që janë përcaktuar në planin strategjik[711].

Tabela nr.1

	GJITHSEJ	ZGJEDHJE	KSHZ
2014	4.923.024 EUR	3.990.731 EUR	932.292 EUR
2013	3.189.593 EUR	2.252.682 EUR	936.910 EUR
2012	955.430 EUR	/	955.430 EUR

Zbulimet e misionit ndërkombëtar për vëzhgim të zgjedhjeve të OSBE-ODHIR, që ishte zbatuar për zgjedhjet e parakohshme presidenciale dhe parlamentare në Maqedoni në vitin 2014, kanë qenë "duhet të shqyrtohet çështja e përforcimit të resurseve të shërbimit profesional të KSHZ-së për të siguruar që do të ketë kapacitete të mjaftueshme për kryerjen e detyrave në mënyrë efikase".[712]

7.1.2 PAVARËSIA (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle KSHZ-ja është e pavarur në bazë të të drejtës?

KSHZ-ja ka veçorinë e personit të veçantë juridik[713] dhe anëtarët zgjidhen nga Kuvendi[714]. Anëtarët e KSHZ-së që janë propozuar nga partitë politike mund të jenë anëtarë të partive politike, por nuk mund të jenë anëtarë të organeve udhëheqëse të partive politike. Anëtarët e KSHZ-së që nuk zgjidhen me propozim të partive politike nuk mund të jenë anëtarë të

[706] Intervistë me Aleksandar Novakoskin, ish kryetar i KSHZ-së në periudhën prej 2009-2011, intervistë (intervistë ballë për ballë) 7.4.2014
[707] Intervistë me Aleksandar Novakoskin, ish kryetar i KSHZ-së në periudhën prej 2009-2011, intervistë (intervistë ballë për ballë) 7.4.2014
[708] Struktura organizative e KSHZ-së http://www.sec.mk/files/Vnatresna_organizacija_DIK_PT.pdf [qasur më 28 mars 2015].
[709] Intervistë me Aleksandar Novakoskin, ish kryetar i KSHZ-së në periudhën prej 2009-2011, intervistë (intervistë ballë për ballë) 7.4.2014
[710] Buxheti zyrtar i KSHZ-së.
[711] Intervistë me Subhi Jakupin, nënkryetar i KSHZ-së dhe Violeta Duma-n, anëtare e KSHZ-së, më 23.4.2015
[712] Republika e Maqedonisë, Zgjedhje presidenciale dhe të parakohshme parlamentare, 13 dhe 27 prill 2014 , Misioni i OSBE/ODHIR për vëzhgimin e zgjedhjeve, Raporti Final, f. 26.
[713] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 26, parag. 6.
[714] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 27.

partisë politike së paku 2 vitet e fundit dhe nuk mund të jenë bartës ose kandidatë për bartës së funksionit publik në shtet ose në pushtetin lokal[715]. Emërimi i sekretarit të përgjithshëm të KSHZ-së rregullohet me Ligjin për nëpunës administrativë[716]. Mandati i sekretarit të përgjithshëm përfundon në kohën e njëjtë me mandatin e kryetarit të KSHZ-së[717]. Punësimi bëhet në mënyrë transparente dhe bazohet mbi meritat dhe parimet e përfaqësimit të drejtë të anëtarëve të komuniteteve.[718]

Kodi zgjedhor thekson që kryetari dhe anëtarët e KSHZ-së i kryejnë funksionet e tyre pavarësisht, me vetëdije dhe me përgjegjësi në përputhje me kompetencat e tyre që janë përcaktuar me kodin[719]. Plani strategjik i KSHZ-së thekson që vendimi i KSHZ-së duhet të jetë i paanshëm, faktik dhe i pavarur.[720]

Të punësuarit në KSHZ obligohen të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të vetëdijshme, profesionale, efikase, të rregullt dhe me kohë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet.[721]

7.1.3 PAVARËSIA (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle KSHZ-ja funksionon pavarësisht në praktikë?

Sipas Subhi Jakupit, nënkryetar i KSHZ-së dhe Violeta Duma-s, anëtare e KSHZ-së, pavarësia e KSHZ-së është më tepër e rrezikuar gjatë zgjedhjeve për shkak të mundësive për ndikim nga partitë politike, kur KSHZ-ja merr vendime në lidhje me ankesat për procesin zgjedhor[722]. Para zgjedhjeve në vitin 2014, z. Jakupi ka vërejtur se ka pasur raste të përzierjes politike[723]. Në vitin 2011, Këshilli i Evropës ka paralajmëruar për rrezikun e politizimit të punës së KSHZ-së dhe ka theksuar rëndësinë e paanësisë dhe qasjes jo-partiake ndaj punës së KSHZ-së.[724]

Sipas mendimit të asociacionit qytetar MOST, gjatë procesit zgjedhor në vitin 2014, anëtarët e KSHZ-së kanë dhënë komente partiake politike dhe kanë shkelur obligimet e tyre që të mbeten të paanshëm[725]. Megjithatë, shefi i misionit vëzhgues i OSBE-ODHIR, z. Gert-Hajnrih Arens[726], ndonëse ka kritikuar njoftimin e anshëm të medieve gjatë kohës së zgjedhjeve në

[715] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 196/2015, neni 5 и 6.
[716] Ligji për nëpunës administrativë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 27/2014, neni 23, parag. 7.
[717] Ligji për nëpunës administrativë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 27/2014, neni 23, parag. 9.
[718] Ligji për nëpunës shtetërorë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 59/2000, 112/2000, 34/2001, 103/2001, 43/2002, 98/2002, 17/2003, 40/2003, 85/2003, 17/2004, 69/2004, 81/2005, 61/2006, 36/2007, 161/2008, 06/2009, 114/2009, 35/2010, 167/2010, 36/2011, 6/2012, 24/2012, 15/2013, 82/2013, 106/2013 и 132/2014 si dhe vendime të Gjykatës Kushtetuese, Ligji për nëpunës publikë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/2010, 36/2011, 6/2012, 24/2012, 15/2013, 82/2013, 106/2013 и 132/2014. vendime të Gjykatës Kushtetuese, U. nr. 83/2010 të 8 qershor 2011, nr. 86/2011; U. nr. 77/2011 të 2 shtator 2011, nr. 132/2011; U. nr. 184/2011 të 15 shkurt 2012 , botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 27/2012, U. nr. 221/2011 të 11 mars 2012 , botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 53/2012; U. nr. 42/2012 të 9 maj 2013 , botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 70/2013, U nr. 55/2012 të 24 prill 2013 , botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 75/2013; dhe U. nr. 63/2013 të 8 tetor 2014 , botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 156/2014.
[719] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 19, parag. 1.
[720] KSHZ; *Plani strategjik i Komisionit Shtetëror Zgjedhor për periudhën 2012 deri 2016,* (Shkup, KSHZ, 2012).
[721] Ligji për Nëpunës Administrativë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 27/2014.
[722] Intervistë me Subhi Jakupin, nënkryetar i KSHZ-së dhe Violeta Duman, anëtare e KSHZ-së, më 23.4.2015
[723] http://www.balkaneu.com/ibna-interviewsec-ready-elections-parties-respect-electoral-code/ [qasur më 28.3.2015].
[724] Vëzhgimi i zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Republikën e Maqedonisë (5 qershor), *Ad hok* Komisioni i Byrosë së Kuvendit, Raportues: Zhan-Sharl GARDETO, Grupi i Partisë Popullore Evropiane, f. 4.
[725] MOST, *Monitorim vendos i zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare të parakohshme në 2014,* (Shkup: MOST, 2014), f. 11.
[726] http://www.independent.mk/articles/3841 ODIHR+Presidential+Elections+Efficiently+Administered%2C+Final+Assessment+after+Runoff [qasur më 31.03.2015].

vitin 2014, si dhe për mosndarjen e aktiviteteve shtetërore dhe partiake, sërish ka pasur fjalë pozitive për punën e suksesshme të KSHZ-së gjatë zgjedhjeve[727]. Misioni vëzhgues ka deklaruar që zgjedhjet ishin zbatuar në mënyrë "efikase", mes tjerash, ndonëse ka pasur mungesa siç janë parregullsitë dhe paqartësitë e ligjeve zgjedhore, shqetësime në lidhje me saktësinë e listave zgjedhore dhe jo-efikasitetin e mekanizmit për zgjedhjen e kontesteve zgjedhore.[728]

Ish kryetari i KSHZ-së, Aleksandar Novakoski, në mënyrë eksplicite ka kritikuar ndikimin e partive politike në punën e KSHZ-së: "KSHZ-ja mund të punojë në mënyrë profesionale dhe jo-partiake, sepse anëtarët zgjidhen me shumicë të dy të tretave të votave në Kuvend. Për fat të keq, KSHZ-ja punon sipas drejtimeve partiake". Sipas gjykatëses Violeta Duma, anëtare e KSHZ-së, e propozuar nga opozita, "anëtarët e KSHZ-së çdoherë votojnë duke ndjekur interesat e partisë së tyre politike, në vend që të jenë të bazë të fakteve". Novakoski përmendi raste kur prania e anëtarëve të KSHZ-së në selitë partiake i ka gropuar pavarësinë e paanësinë në punë[729]. Sipas mendimit të të gjithë bashkëfolësve, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të KSHZ-së u mundëson partive politike të kryejnë ndikime në punën e tyre.[730]

QEVERISJA

7.2.1 TRANSPARENCA (E DREJTA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle janë caktuar dispozita për sigurimin që publiku të mund të ketë qasje në informatat relevante për aktivitetet dhe proceset e vendimmarrjes së KSHZ-së?

Në përputhje me Kodin zgjedhor[731], puna e organeve zgjedhore është publike. Nuk ka asnjë dispozitë tjetër që rregullon transparencën e KSHZ-së ose që parashikon kërkesa për njoftim, siç janë kërkesat për parashtrim ose publikim të raporteve vjetore.

Rregullat ekzistuese për transparencën kanë të bëjnë vetëm gjatë periudhës zgjedhore. Në përputhje me Rregulloren e KSHZ-së, puna e KSHZ-së është publike dhe përfaqësuesit e parashtruesve të listave dhe vëzhguesve të akreditaur kanë të drejtë të marrin pjesë në seancat e punës së KSHZ-së[732]. Gjatë zgjedhjeve, KSHZ-ja mban procesverbale për seancat dhe procesverbalet e aprovuar i publikon në internet faqen e saj në afat prej 48 orësh nga koha e miratimit[733].

Akti për shpalljen e zgjedhjeve miratohet nga kryetari i Kuvendit dhe dorëzohet te KSHZ-ja, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Drejtësisë[734]. Qytetarët njoftohen për zgjedhjet me anë të thirrjes publike dhe KSHZ-ja siguron theksimin e afisheve në vende të

[727] Njëlloj.
[728] Rezolucioni i Parlamentit Evropian të 11 marsit 2015 për Raportin e përparimit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2014 (2014/2948(RSP)), parag. 15, http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-//EP//TEXT+TA+P8-TA-2015-0064+0+DOC+XML+V0//EN [qasur më 31.03.2015].
[729] Intervistë me Aleksandar Novakoskin, ish kryetar i KSHZ-së në periudhën prej 2009-2011, intervistë (intervistë ballë për ballë) 7.4.2014
[730] Intervistë me Aleksandar Novakoskin, ish kryetar i KSHZ-së në periudhën prej 2009-2011, intervistë (intervistë ballë për ballë) 7.4.2014
[731] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14 neni 24, parag. (1) dhe (2).
[732] Rregullore e KSHZ, vendim i KSHZ-së prej 4 korrikut 2016, neni 51.
[733] Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit zgjedhor, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 14.2014, neni 31, parag. 43-б.
[734] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 12, parag. (1) dhe (2).

dukshme.[735]

KSHZ-ja duhet të publikojë adresat e vendeve zgjedhore në shtypin ditor[736] dhe të sigurojë të dhënat për shtypin publik në lidhje me numrin e votuesve të cilët janë regjistruar në Listën zgjedhore[737]. KSHZ-ja ka për obligim të përditësojë dhe mirëmbajë të dhënat në Listën zgjedhore në bazë të të dhënave nga librat amë, evidencën e vendbanimit dhe shtetësisë, evidenca tjera zyrtare dhe me kontrollin e drejtpërdrejtë[738]. Ministria e Punëve të brendshme, gjithashtu, dorëzon të dhëna në KSHZ për qytetarët që duhet të përfshihen në Lisën zgjedhore[739]. KSHZ-ja nuk ka të drejta ligjore për intervenim në listën e parashtruar zgjedhore dhe është obliguar vetëm të vendosë në kontroll publik Listën zgjedhore të spastruar në departamentet rajonale dhe në zyrat lokale më së voni 15 ditë nga shpallja e zgjedhjeve[740]. KSHZ-ja duhet të informojë qytetarët me anë të gazetave publike për vendin dhe për kohëzgjatjen e kontrollit, mënyrën me të cilën kryet kontrolli dhe mundësia për shënimin, plotësimin ose fshirjen e të dhënave nga Lista zgjedhore[741].

Pjesëmarrësi në fushatën zgjedhore është i obliguar që menjëherë, dhe në afat prej 30 ditëve nga dita e përfundimit të fushatës zgjedhore të parashtrojë në KSHZ raport të plotë financiar për fushatën zgjedhore[742]. Raporti financiar duhet të dorëzohet në ESHR dhe në KSHPK, të cilat duhet të publikojnë raportin në internet faqet e tyre.[743]

Vendimet pas vërejtjeve dhe padive në lidhje me procesin zgjedhor duhet të publikohen në internet faqen e Gjykatës Administrative, KSHZ, Komisioni Komunal i Zgjedhjrve dhe Komisioni i Zgjedhjeve i qytetit të Shkupit.[744]

KSHZ-ja është e autorizuar të publikojë rezultatet fillestare nga zgjedhjet e fituara në mënyrë elektronike[745], dhe pastaj të publikojë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve menjëherë, dhe më së voni 24 orë nga dita e përfundimit të tyre.[746]

7.2.2 TRANSPARENCA (PRAKTIKA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle raportet dhe vendimet e KSHZ-së publikohen në praktikë?

KSHZ-ja ka internet faqet publike me informata në lidhje me procesin zgjedhor, zgjedhjet, konferencat për shtyp. Nuk ka informata relevante për punën e përditshme të KSHZ-së në periudhën ndërmjet zgjedhjeve[747]. Raportet vjetore nuk publikohen në internet faqen e

[735] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 13.
[736] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 31, parag. 28.
[737] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 31, parag. 31.
[738] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 42.
[739] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 43, parag. 1.
[740] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 51.
[741] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 51.
[742] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 85, parag. 1.
[743] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 85, parag. (3) dhe (4).
[744] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 150, parag. 4.
[745] Komisione Komunale Zgjedhore, gjegjësisht Komisioni Zgjedhor i qytetit të Shkupit.
[746] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14; neni 135.
[747] http://www.sec.mk/index.php?lang=mk [qasur më 31.03.2015].

KSHZ-së pas miratimit të tyre nga Kuvendi. Vetëm, procesverbalet e seancave të punës së KSHZ-së, që janë të lidhura me zgjedhjet dhe vendimet relevante publikohen në internet faqen.

Sipas mendimit të një ish kryetari të KSHZ-së, seancat e KSHZ-së zhvillohet vetëm për formalitet, kanë ndikim nga partitë politike dhe nuk ka diskutim të vërtetë në sajë të procesit të vendimmarrjes.[748]

Organizatat e shoqërisë civile e analizojnë transparencën e punës së KSHZ-së gjatë dy cikleve të fundit zgjedhore dhe kanë arritur konkluzionin që transparenca në punën e KSHZ-së është në rënie, duke marrë parasysh që gjatë ciklit të fundit zgjedhor, 16 prej gjithsej 46 seancave të KSHZ-së janë zhvilluar pa praninë e përfaqësuesve të gaztave publike dhe vëzhguesve të akreditуar[749]. Ndonëse kjo, në raportin e OSBE/ODHIR vërehet që "rezultatet fillestare të dy cikleve të zgjedhjeve në vitin 2014 ishin publikuar në internet faqen e KSHZ-së menjëherë pas marrjes së tyre, me pasqyrë analitike sipas komunave dhe vendeve zgjedhore, që paraqet një masë të rëndësishme për përmirësimin e transparencës".[750]

Lista zgjedhore është publikuar në internet faqen e KSHZ-së dhe përditësohet me të dhëna të reja që sigurohen nga Enti Shtetëror i Statistikës.[751]

7.2.3 LLOGARIDHËNIA (E DREJTA)

Nota 50

Në çfarë shkalle janë vendosur dispozita për sigurimin me të cilat KSHZ-ja duhet të dorëzojë raporte dhe përgjegjësi për veprat e tyre?

Në bazë të Kodit Zgjedhor, KSHZ-ja parashtron përgjegjësi para Kuvendit[752], por ligji nuk përmban dispozita adekuate në lidhje me llogaridhënien politike dhe financiare të komisionit zgjedhor.

Kodi Zgjedhor e zgjeron të drejtën e të gjithë kandidatëve në zgjedhjet të paraqesin ankesa në fazat e ndryshme të procesit, përfshirë edhe në lidhje me regjistrimin e votuesve, regjistrimin e kandidatëve, udhëheqjen e fushatës, mbulimin në medie, votimin dhe numërimin e votave. Votuesit kanë të drejtë të parashtrojnë ankesa, vetë, në lidhje me regjistrimin në listë dhe për shkeljet e të drejtave të tyre zgjedhore në ditën e zgjedhjeve.[753]

Ka disa dispozita zgjedhore që mundësojnë kontrollin e vendimeve të KSHZ-së.

Më së voni 15 ditë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, KSHZ-ja e vendos Listën zgjedhore të spastruar për kontroll publik në departamentet rajonale dhe zyrat lokale[754] dhe vendos për kërkesat e qytetarëve për regjistrim, plotësim ose fshirje të të dhënave nga listat. Qytetarët mund të parashtrojnë padi kundër vendimit para Gjykatës Administrative në afat prej 24

[748] Intervistë me Aleksandar Novakoskin, ish kryetar i KSHZ-së në periudhën prej 2009-2011, intervistë (intervistë ballë për ballë) 7.4.2014
[749] MOST, 2014 , f. 11.
[750] *Raporti përfundimtar i Misionit OSBE/ODHIR për vëzhgimin e zgjedhjeve, Republika e Maqedonisë, zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare të parakohshme*, 13 dhe 27 prill 2014 , (Shkup: OSBE/ODHIR, 2014), f. 3.
[751] http://izbirackispisok.gov.mk/ [qasur më 15.4.2015].
[752] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14 neni 31, parag. 25.
[753] OSBE/ODHIR, 2014 , f. 19.
[754] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14; neni 49.

orësh nga pranimi i vendimit[755]. Vendimi i Gjykatës Administrative i miratuar pas padisë për regjistrim, ndryshim ose fshirje të të dhënave është pjesë përbërëse e Listës zgjedhore të nënshkruar nga KSHZ-ja[756].

Kodi zgjedhor e zgjeron të drejtën e të gjithë pjesëmarrësve në zgjedhje të parashtrojnë ankesa në fazat e ndryshme të procesit, përfshirë edhe në lidhje me regjistrimin e votuesve, regjistrimin e kandidatëve, udhëheqjen e fushatës, mbulimit në medie, votimin dhe numërimin e votave. KSHZ-ja ka kompetenca të shqyrtojë pohimet dhe të veprojnë sipas ankesës në afat që nuk është më i gjatë se 7 ditë nga dita e parashtrimit të ankesës.[757]

Gjithashtu, KSHZ-ja ka për obligim të dorëzojë pasqyra financiare dhe raporte për zgjedhjet e zbatuara para Kuvendit dhe të publikojë në internet faqen e saj[758]. Megjithatë, nuk ka dispozita ligjore në kuptim të përfshirjes së plotë të raportit që duhet të parashtrohet në Kuvend.

KSHZ-ja, ESHR dhe KSHPK kanë firmosur Memorandum të mirëkuptimit[759] që rregullon zbatimin e dispozitave të financimit të fushatave zgjedhore.

Në kuadër të KSHZ-së ka një njësi për revizion të brendshëm që bën revizion financiar, por nuk ka kërkesë ligjore që KSHZ-ja të zbatojë revizion të pavarur. Institucionet janë lëndë e revizionit nëse ky revizion është planifikuar në programin vjetor të ESHR-së.[760]

7.2.4 LLOGARIDHËNIA (PRAKTIKA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle KSHZ-ja duhet të dorëzojë raporte dhe përgjegjësi për procedurat në praktikë?

Sipas z. Jakupit, KSHZ-ja ka për obligim të thirrë seancë në propozim të ndonjë anëtari të KSHZ-së.

KSHZ-ja përgatit raporte për rezultatet e çdo cikli zgjedhor dhe raport për punën e KSHZ-së në periudhën zgjedhore. Raporte duhet të dorëzohen në Kuvend dhe publikohen në internet faqen e KSHZ-së.[761]

Llogaridhënia e KSHZ-së në periudhën ndërmjet aktiviteteve zgjedhore është në nivel tepër të ultë. Qytetarët kanë kritikuar KSHZ-në që nuk u përgjigjet në mënyrë efikase ankesave dhe vërejtjeve, si në periudhën parazgjedhore ashtu edhe pas tyre.[762] KSHZ-ja i publikon vendimet në lidhje me ankesat në internet faqen e saj.

Partia Demokratike Shqiptare (PDSH) dhe GROM kanë parashtruar padi para Gjykatës Administrative, por janë përjashtuar[763]. Rekomandimi kryesor i OBSE/ODHIR për zgjedhjen e

[755] Gjykata Administrative vendos për padinë që përmendet në parag. 2 të këtij neni në afat prej 24 orëve pas pranimit të ankesës.
[756] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 51, parag. 4.
[757] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 69-a.
[758] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 31, parag. 25.
[759] Ligji për ndryshim dhe plotësim të Kodit zgjedhor, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 142/2012.
[760] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/10, 145/2010, 12/2014, 43/2014.
[761] KSHZ, 2012: f. 8.
[762] Intervistë me Aleksandar Novakoskin, ish kryetar i KSHZ-së në periudhën prej 2009-2011, intervistë (intervistë ballë për ballë) 7.4.2014
[763] MOST, *Monitorim vendos i zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare të parakohshme në 2014,* (Shkup: MOST: 2014 , MOST), f. 21.

ankesave gjatë zgjedhjeve të fundit në vitin 2014 ishte që "KSHZ-ja duhet të zgjidhë të gjitha ankesat dhe vërejtjet në mënyrë të paanshme, pa ndikime politike "[764].

7.2.5 INTEGRITETI (E DREJTA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle janë vendosur mekanizma për sigurimin e integritetit të KSHZ-së?

Në Maqedoni nuk ka Kod të sjelljes së funksionarëve zgjedhorë: Kodi etik për nëpunës shtetërorë zbatohet për nëpunësit e KSHZ-së[765]. Në të janë përcaktuar parimet themelore për sjellje dhe punë të nëpunësve shtetërorë. Të punësuarit në KSHZ nuk kanë obligim të nënshkruajnë deklaratë për respektim të parimeve etike dhe për ata nuk ka obligime në lidhje me parimin e neutralitetit politik. Ka Kod të sjelljes të vëzhguesve zgjedhorë[766].

Çështjet në lidhje me fletat anketuese për gjendjen pronësore dhe rregullat që përcaktojnë konflikt të interesave që janë rregulluar me ligjet[767] që zbatohen për anëtarët e KSHZ-së dhe të punësuarit në shërbimin profesional që kanë status të nëpunësve shtetërorë.[768]

KSHZ-ja, me dy të tretën e shumicës nga numri i plotës i anëtarëve, mund të japë propozim në Komisionin për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve në Kuvend, për shkarkimin e anëtarit për kryerje të padrejtë dhe jo-profesionale të funksionit[769]. Anëtarët e KSHZ-së nuk guxojnë të jenë anëtarë të organeve udhëheqëse të partive politike.[770]

Nuk ka rregulla të veçanta për dhurata të funksionarëve të KSHZ-së, por ato duhet të respektojnë rregullat që zbatohet për nëpunësit shtetërorë[771]. Nëse ndonjë nëpunësit i ofrohet dhuratë për kryerjen e funksionit, ai është i obliguar të refuzojë dhuratën, të përcaktojë identitetin e ofruesit dhe nëse bëhet fjalë për dhuratë që nuk mund të kthehet, ta paraqesë tek autoritetet kompetente në afat prej maksimum 48 orësh.[772]

Në lidhje me kufizimet pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës, personi zyrtar, gjatë kohës së mandatit dhe në afat prej pesë viteve nga ndërprerja e punës dhe autorizimeve zyrtare, nuk mund të marrë pjesë ose të punësohet në shoqëri tregtare në të cilën ka bërë mbikëqyrje ose ka pasur ndonjë marrëdhënie pune gjatë kryerjes së autorizimeve publike ose detyrave.[773]

7.2.6 INTEGRITETI (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle sigurohet integriteti i KSHZ-së në praktikë?

[764] OSBE/ODHIR, 2014 , f. 26.
[765] Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 129/2011; Vendim prej 19.09.2011 , Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.
[766] KSHZ, 27.2.2014 , http://www.sec.mk/files/kodeks2014.PDF [qasur më 31.03.2015].
[767] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave dhe Ligji për ërdorimin dhe tjetërsimin e gjerave në pronësi shtetërore.
[768] Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.70/2007, 114/2009, 128/2009.
[769] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 28, parag. 2.
[770] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 27, parag. 1.
[771] Ligji për përdorimin dhe tjetërsimin e gjerave në pronësi shtetërore, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 8/05, 150/07, 35/11 dhe 166/12.
[772] Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.70/2007, 114/2009, 128/2009.
[773] Njëlloj.

Integriteti i anëtarëve të KSHZ-së nuk është siguruar në mënyrë adekuate dhe ka informata të kufizuara në lidhje me të punësuarit në KSHZ në nivelin lokal. Ka një Kod të sjelljes për vëzhguesve zgjedhorë por jo edhe për nëpunësit zgjedhorë.

Bisedat e publikuara dhe të përgjuara në mënyrë të paligjshme kanë zbuluar që në zgjedhjet lokale në komunën Qendër në Shkup janë vjedhur listat zgjedhore për tu realizuar jehona e votuesve.[774]

ROLI

7.3.1 RREGULLIMI I FUSHATËS

Nota **25**

A e rregullon në mënyrë efektive KSHZ-ja financimin e kandidatëve dhe partive politike?

Ligji parashikon më tepër mekanizma për rregullimin e fushatës, në të cilën një pjesë prej tyre janë kompetencë e KSHZ-së. Rregullimi i fushatës ka qenë efektive në praktikë.

Një numër i caktuar i dispozitave të Kodit zgjedhor ishin ndryshuar në janar 2014, duke marrë parasysh rekomandimet e SOBE/ODHIR[775]. OSBE/ODHIR i fton autoritetet të shqyrtojnë parregullsitë para dhe gjatë kohës së zgjedhjeve.[776]

Pragu për donacionet në fushata nga personat juridikë pak para ishte përcaktuar në 50.000 EUR, duke ndryshuar pragun paraprak prej 5% të të ardhurave vjetore të donatorit të realizuar në vitin paraprak. Kjo është në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODHIR dhe MOST. Por, mangësia në ligj është ajo që nuk është përcaktuar në afatin e fundit për mbyllje të llogarisë së fushatës zgjedhore. Kjo lejon hapësirë për keqpërdorime.[777] KSHZ-ja mund të fillojë procedura për parregullsi në financimin e fushatës.[778]

Mekanizmi i monitorimit të financimit të fushatës është i dobët[779]. ESHR-ja u bë autoriteti themelore për mbikëqyrjen e financimit të partive politike në vitin 2011 si rezultat i rekomandimeve të GREKO-s. Raportet që publikohen nga ESHR-ja për financimin zgjedhor nuk është në përputhje me ligjet dhe standardet për revizion. Ligji, gjithashtu, jep autorizime të ESHR-së dhe KSHPK-së për të kontrolluar transaksionet bankare të partive dhe kandidatëve. Megjithatë, dy institucionet nuk i plotësojnë në mënyrë adekuate detyrat e tyre për kontrollin e financimit politik.[780]

7.3.2 ZBATIMI I ZGJEDHJEVE

Nota **25**

[774] http://novatv.mk/index.php?navig=8&cat=2&vest=20819
[775] OSBE/ODHIR, 2014 , f. 25-26.
[776] Rezolucioni i Parlamentit Evropian të 11 marsit 2015 për Raportin e përparimit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2014 (2014/2948(RSP)), parag. 15. 15 http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-//EP//TEXT+TA+P8-TA-2015-0064+0+DOC+XML+V0//EN [qasur më 23 mars 2015].
[777] MOST, 2014 : f. 9.
[778] Intervistë me Aleksandar Novakoskin, ish kryetar i KSHZ-së në periudhën prej 2009-2011, intervistë (intervistë ballë për ballë) 7.4.2014
[779] GREKO, *Raporti për vlerësimin e Republikës së Maqedonisë në ciklin e tretë të vlerësimit.*
[780] Taseva, 2013 : f. 54.

A siguron KSHZ-ja integritetin e procesit zgjedhor?

Në përputhje me ligjin, KSHZ-ja ka për obligim të informojë dhe të edukojë publikun për mënyrën e votimit dhe realizimin e të drejtës zgjedhore[781]. Përveç kësaj, KSHZ-ja zbaton fushata dhe printon materiale promovuese që shpërndahen mes qytetarëve[782]. Megjithatë, KSHZ-ja nuk është në gjendje të sigurojë integritetin e procesit zgjedhor. Në hulumtimin anketues të UNDOC në vitin 2011 për korrupsionin në Maqedoni, qytetarët ishin pyetur nëse kanë qenë të ekspozuar në blerjen e votave, ku të dhënat kanë dëshmuar që mesatarisht 5 për qind e qytetarëve në zgjedhjet e fundit lokale dhe 5 për qind e qytetarëve në zgjedhjet parlamentare u është kërkuar të votojnë për një kandidat të caktuar ose parti politike në shkëmbim të ofertës përkatëse me të holla, mallra ose shërbime.[783]

E drejta për monitorim të zgjedhjeve u takon vëzhguesve të akreditуar zgjedhorë, me akreditime që jepen nga KSHZ-ja[784]. Akreditimet për vëzhgim të zgjedhjeve mund tu jepen organizatave qytetare që janë regjistruar së paku një vit para zgjedhjeve[785]. Shpeshherë, parregullsia e paraqitur nga vëzhguesit e MOST-it gjatë zgjedhjeve të vitit 2014 ka qenë praktika e leximit të emrave të votuesve me zë dhe regjistrimi i votuesve para vendvotimeve nga vëzhguesit partiakë. Rrethi i dytë i zgjedhjeve të vitit 2014 veçohej me përpjekje më të mëdha të partive politike për të mobilizuar trupin votues, që në disa raste ka rezultuar me kryerjen e shtypjeve mbi votuesit për jehonën e tyre.[786]

Gjithashtu, ishte shprehur shqetësim për drejtimin dhe saktësinë e Lista zgjedhore. Në sajë të KSHZ-së ishte formuar grupi i punës për kontrollimin e Listës Zgjedhore për qëllimet e përditësimit në lidhje me personat e vdekur dhe qytetarët që jetojnë jashtë shtetit dhe që posedojnë pasaporta të vlefshme. Përveç anëtarëve të KSHZ-së, grupi i punës ka përfshirë edhe përfaqësues të institucioneve shtetërore, partive më të mëdha politike, si dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe kombëtare.[787]

Një prej pasojave të përditësimit të Listës zgjedhore ishte dallimi ndërmjet numrit të votuesve në Listën zgjedhore për zgjedhjet presidenciale dhe Listën zgjedhore të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Numri i votuesve të regjistruar në Listën zgjedhore për zgjedhjet presidenciale ishte 1.779.572 persona, ndërsa, numri i tyre në Lista zgjedhore të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare ishte 1.780.128 persona[788]. Pyetjet në lidhje me shtrirjen dhe saktësinë e Lista zgjedhore në Maqedoni janë lëndë e diskutimit për shumë vite, ndërsa në vitin 2014, debati publik ndër-institucional ka shqyrtuar më seriozisht çështjen për atë se kush është përgjegjës për listë të përditësuar të votuesve.[789] Por, nëse KSHZ-ja përcakton parregullsi në Listën zgjedhore, ka për obligim të dorëzojë raport te Ministria e Punëve të Brendshme, që mund të dorëzojë vendime për të bërë fshirjen e të dhënave nga Lista Zgjedhore.[790]

Asociacioni qytetar CIVIL i ndjek rastet e denoncuara gjatë zgjedhjeve në vitin 2014, kur në

[781] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 31, parag. 15.
[782] http://www.sec.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=229&catid=39&Itemid=1262&lang=mk
[783] UNODC, *Korrupsioni në ish republikën jugosllave të Maqedonisë: Ryshfeti, si përjetohet nga popullata,* Vjenë: UNODC, 2011), f. 5.
[784] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 162-a.
[785] Kodi zgjedhor i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 161.
[786] MOST, 2014 : f. 7.
[787] Grupi i punës përcaktoi që Lista zgjedhore e qytetarëve që posedojnë letërnjoftime të vlefshme, më së voni deri më 24 shkurt 2013, përmban 1.743.403 qytetarë, ose 77.719 qytetarë më pak në krahasim me 2011. KSHZ-ja ka emetuar një fushatë me anë të servisit publik për informim të qytetarëve që nuk kanë letërnjoftime të vlefshme që nuk do të mund të votojnë pa dokumente të vlefshme.
[788] MOST, 2014 , f. 11.
[789] CIVIL, *Zgjedhje 2014: Demokraci e diskualifikuar,* (Shkup; CIVIL, 2014), f. 27.
[790] Intervistë me Subhi Jakupin, nënkryetar i KSHZ-së dhe Violeta Duma-n, anëtare e KSHZ-së, më 23.4.2015

vendvotime janë sjellë persona me furgona dhe me autobusë.

Ka disa pohime që një numër i caktuar i votuesve nga Pusteci në Shqipëri, që kanë votuar si anëtarë të diasporës kanë votuar edhe në zgjedhjet në Maqedoni.[791]

Më 10 mars 2014 lideri i opozitës Zoran Zaev kërkoi nga Qeveria të japë dorëheqje menjëherë pas publikimit të incizimeve nga bisedat ndërmjet funksionarëve më të lartë partiakë[792] për shtypjen e letërnjoftimeve, dërgimin e personave për të votuar në gjithë vendin, vjedhjen e materialeve zgjedhore madje edhe për shkyçje të ashensorëve në ndërtesa, që personat më të moshuar të mos mund të dalin për votime.[793]

REKOMANDIME

P1. KSHZ-ja duhet të marrë autorizime dhe kapacitete për përgatitjen dhe zhvillimin efektiv të Listës zgjedhore.

P2. Duhet të miratohet Kod për sjelljen e nëpunësve zgjedhorë dhe mekanizma për zbatimin përkatës.

[791] http://www.balkaninsight.com/en/article/polls-close-in-macedonia-s-double-elections [qasur më 15.4.2015].

[792] Në një prej bisedave dëgjohen zërat e shefit të policisë sekrete dhe ministrit të Transportit si bëjnë plane për vjedhjen e materialeve të mbyllura zgjedhore në periudhën ndërmjet dy rretheve të zgjedhjeve, si dhe në një bisedë tjetër për shtypjen e letërnjoftimeve në të cilën merr pjesë ministri i punëve të brendshme. Materialet përmbajnë edhe biseda për shpërndarjen e votuesve në gjithë territorin e Maqedonisë, duke përdorur emrat e votuesve të vdekur, si dhe [pranime të ministrit të Financave dhe ministrit të Punëve të Brendshme që këtë që bën partia “nuk është normale“.

[793] http://www.balkaninsight.com/en/article/macedonia-awaits-more-evidence-of-election-trickery [qasur më 15.04.2015].

8. ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT

PËRMBLEDHJE

Ka një bazë të fortë ligjore për institucionin suprem të revizionit, Entin Shtetëror të Revizionit (ESHR), por autorizimet nuk janë të integruara në Kushtetutë. Ligji i rregullon funksionet e ESHR-së dhe përcakton autorizime të gjera për kryerjen e revizioneve të rregullsisë dhe suksesit, si dhe qasje në të gjitha informatat e nevojshme. Në praktikë, ESHR-ja ka liri të vendosë për lëndën e revizionit dhe përmbajtjes, dhe gjatë punës të respektojë standardet ndërkombëtare profesionale. Në lidhje me drejtimin e ESHR-së ka të vendosura procedura për sigurim të transparencës, llogaridhënies dhe integritetit. Në praktikë, raportet janë faktikisht të sakta dhe të gjitha raportet përgatiten dhe dorëzohen me kohë. Përveç kësaj, ESHR-ja ka zhvilluar mekanizma për monitorimin e rekomandimeve për sigurim dhe për zbatimin përkatës të rekomandimeve që janë dhënë në raportet e revizionit.

Në tabelën më poshtë janë prezantuar notat për tregues që në mënyrë përmbledhëse japin notën për ESHR-në në kuptim të kapacitetit të saj, drejtimin e brendshëm dhe rolin në kuadër të sistemit maqedonas për integritet. Në vazhdim të kësaj pjese jepet analiza sasiore për secilin tregues.

NOTA E PËRGJITHSHME E SHTYLLËS: **73,6/10**

DIMENSIONI	TREGUES	E DREJTA	PRAKTIKA
Kapaciteti 75/100	Resurset	/	75
	Pavarësia	75	75
Qeverisja 83,3/100	Transparenca	100	75
	Llogaridhënia	75	75
	Integriteti	100	75
Roli 62,5/100	Revizionet efektive financiare	50	
	Zbulimi dhe sanksionimi i parregullsive	75	

Vlerësimi i shtyllës sipas të drejtës dhe praktikës



STRUKTURA DHE ORGANIZIMI

ESHR-ja është themeluar në 1997 dhe pas emërimit të revizorit të parë shtetëror në vitin 1998, filloi me punë në vitin 1999. Sot, ESHR-ja është institucioni qendror për revizion të brendshëm në vend që është përgjegjëse për revizion të shpenzimeve publike në të gjitha nivelet e pushtetit. Ligji për revizion shtetëror[794] i përcakton funksionet e ESHR-së dhe shtrirjen e punës së revizionit.

Struktura organizative e ESHR-së është me orientim hierarkik dhe tematik. ESHR-ja jep përgjegjësi para Kuvendit, i cili, gjithashtu e zgjedh revizorin kryesor shtetëror për mandat prej nëntë viteve, pa të drejtë për ri-zgjedhje. Niveli më i lartë drejtues në ESHR është revizori kryesor shtetëror dhe zëvendësi i revizorit kryesor shtetëror. Njësitë që janë drejtpërdrejtë nën drejtimin më të lartë janë kabineti i revizorit kryesor shtetëror, Seksioni për Revizion të Brendshëm dhe Sekretariati për Marrëdhënie me Publikun.

Përveç kësaj, ESHR-ja ka shtatë sektorë, prej të cilëve pesë janë përgjegjës për kryerjen e revizioneve financiare në përputhje me programin vjetor për punë. Përveç shtatë sektorëve për revizion, ESHR-ja ka sektorë për metodologji revizori dhe kontroll të cilësisë, për revizion të sistemeve informative, për punë ligjore dhe të përgjithshme dhe marrëdhënie me publikun dhe sektori për punë financiare, si dhe dy departamente që raportojnë drejtpërdrejtë revizorit kryesor shtetëror ose sekretarit të përgjithshëm të ESHR-së (Seksioni për Revizion të Brendshëm – deri më tani nuk është mbushur me kuadër – dhe Seksioni për drejtim me resurse njerëzore – vetëm me një të punësuar). Shpërndarja e detyrave të punës për njësitë individuale organizative rregullohet me planin e përgjegjësive.

[794] Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14.

VLERËSIMI

KAPACITETI

8.1.1 RESURSET (PRAKTIKA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle institucioni i revizionit posedon resurse përkatëse për arritjen e qëllimeve të tij në praktikë?

ESHR-ja ka resurse përkatëse për arritjen e qëllimeve të saj në praktikë. Enti ka buxhet të mjaftueshëm dhe personel kompetent. Puna e ESHR-së financohet nga buxheti i RM-së. Vetë ESHR-ja përgatit propozim-buxhetin dhe e dorëzon në Kuvend për miratim, ndërsa Kuvendi e voton pjesën e buxhetit që është dedikuar për ESHR-në[795] në mënyrë të posaçme. Ligji për revizion shtetëror parashikon që buxheti përgatitet në sajë të kufizimeve të përcaktuara vjetore në përputhje me strategjinë e miratuar fiskale[796]. Procedura në këtë formë i mundëson Kuvendit në mënyrë të posaçme të vendosë për buxhetin e ESHR-së dhe sipas kësaj, i jep mundësi ESHR-së të sqarojë dhe arsyetojë kërkesat buxhetore. Në këtë mënyrë, pavarësia buxhetore është siguruar në nivel të kënaqshëm[797].

Para miratimit të Ligjit të ri për revizion Shtetëror në vitin 2010, Trupi i Revizionit për revizion të instrumentit për ndihmë paraaderuese ka funksionuar në kuadër të ESHR-së. Pas miratimit të Ligjit të ri për Revizion Shtetëror në maj 2010 ishte miratuar edhe Ligji për revizion të Instrumentit për Ndihmë Paraaderimit[798] dhe Trupi i Revizionit ishte ndarë nga ESHR-së si subjekt i pavarur juridik me buxhet të veçantë. Nga kjo, prej vitit 2011 deri sot, mjetet e aprovuara në buxhetin e ESHR-së janë rritur[799].

	BUXHETI I PLOTË I ESHR -SË	NGA BUXHETI QENDROR I RM-SË	NGA DONACIONE
2012	1.493.365 EUR	1.493.365 EUR	/
2013	1.473.430 EUR	1.473.430 EUR	95.008 EUR
2014	1.542.764 EUR	1.542.764 EUR	54.796 EUR
2015	1.909.024 EUR	1.534.634 EUR	309.349 EUR

Buxheti i plotë i ESHR-së në vitin 2015 ka qenë 1.909.024 EUR. Rreth 80% të mjeteve janë siguruar nga buxheti qendror i shtetit, ndërsa 20% të mjeteve janë nga donacionet.

Gjatë punës së saj 15 vjeçare, ESHR-ja ka marrë ndihmë teknike në kuadër të projektit të binjakëzimit me Gjykatën Holandeze për Revizion me anë të një projekti të financuar nga Banka Botërore. Planifikohet një projekti i ri i binjakëzimit për periudhën që do të fillojë në vitin 2015[800].

[795] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 12, parag. (1) dhe (2)
[796] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 12, parag. (3).
[797] OECP/SIGMA, 2012 : f. 49.
[798] Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14.
[799] Përgjigje të pyetësorit nga Tanja Tanevska, revizore kryesore shtetërore, 22.6.2015
[800] OECP/SIGMA, 2012 : f. 45.

Përveç kësaj, ESHR-ja ka bashkëpunuar me Zyrën e Revizorit Suprem Shtetëror të Norvegjisë për përmirësim të efikasitetit dhe cilësisë së revizioneve me anë të zbatimit të sistemit për menaxhim me revizionin (sistemi AMS).

Sipas znj. Tanja Tanevska[801], revizori kryesor shtetëror[801], në vitin 2015 ESHR-ja ka pasur 93 të punësuar, revizorë të autorizuar shtetëror, revizorë shtetërorë dhe personal për mbështetje administrative-teknike. Revizionet shtetërore bëhet nga 82 revizorë, prej të cilëve 70 kanë marrë certifikatë për revizorë shtetërorë të autorizuar. Shumica e të punësuarve (96%) kanë të kryer arsimin e lartë, ndërsa përqindja e të punësuarve me magjistraturë është në rritje.[802]

Trajnimi i të punësuarve në ESHR bëhet në përputhje me programin vjetor të ESHR-së. Në vitin 2014, ESHR-ja ka organizuar trajnim për bazat e revizionit shtetërorë, revizionet e suksesit dhe kuadri për kontrollin publik financiar të brendshëm, përforcimi i etikës, si dhe për ndryshimet e fundit të Ligjit për prokurime publike dhe përdorimi i TI infrastrukturës së përforcuar të ESHR-së.[803]

Z-nja. Tanja Tanevska, revizorja kryesore shtetërore, ka deklaruar që "në kuptim të zhvillimit të kapaciteteve profesionale të punësuarve, ESHR-ja ka organizuar disa trajnime për buxhetet dhe përdoruesit e buxhetit, fondeve publike dhe për njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe ndërmarrjet publike"[804].

Sipas ESHR-së, të punësuarit mesatarisht kanë përvojë pune prej 5 viteve dhe qarkullimi i të punësuarve është në nivel shumë të ulët. ESHR-ja pothuaj nuk ka pasur raste kur të punësuarit kanë ndryshuar vendin e punës për ndonjë tjetër në sektorin publik[805]. Megjithatë, ka shqetësim në lidhje me kapacitetin e ESHR-së për kryerjen e revizioneve të suksesit dhe aftësisë për kryerjen e kontrollit të financimit të partive politike. Duke marrë parasysh mandatin për kryerjen e gjitha llojeve të revizionit dhe për faktin që revizioni i suksesit me ngadalë zhvillohet, resurset e ESHR-së nuk janë të mjaftueshme për mbulimin e plotë të mandatit.[806]

8.1.2 PAVARËSIA (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle ka pavarësi formale operative të institucionit të revizionit?

ESHR-ja vazhdimisht bën përpjekje për ndryshim të Kushtetutës për garantim të rolit në strukturën shtetërore[807]. Më 27 qershor 2014, Qeveria i propozoi Kuvendit një pako prej shtatë amendamente kushtetuese, që kanë përfshirë mbrojtje të pavarësisë së ESHR-së. Megjithatë, kjo pako me amendamente ishte përgatitur për një kohë të shkurtë dhe pa zbatimin e nevojshëm ligjor. Përputhja me Ligjin e BE-së dhe standardet evropiane ende vlerësohet[808]. Komisioni i Venedikut vëren që ndryshimet e Kushtetutës janë propozuar në mungesë të opozitës në Kuvend dhe sipas kësaj, nuk është momenti më i mirë për

[801] Z-nja Tanja Tanevska, revizore kryesore shtetërore, përgjigje të pyetësorit të NSI , 22.6.2015
[802] Njëlloj.
[803] EShHR, 2014 : f. 1 http://www.dzr.mk/en/Uploads/2013_SAO_Annual%20Report.pdf [qasur më 15.6.2015].
[804] EShHR, 2013 : f. 6.
[805] Komisioni Evropian, 2014: f. 42.
[806] Komisioni Evropian, 2014: стр. 42.
[807] OECP/SIGMA, 2012 : f. 16.
[808] Komisioni Evropian, 2014: f. 5.

prezantimin e ndryshimeve politike[809]. Përveç kësaj, Komisioni i Venedikut ka treguar që në lidhje me ndryshimin XXXVI, duhet të shmanget politizimi i funksionit të "revizorit kryesor shtetëror" dhe do të ishte mirë të mendohet për zgjedhjen dhe shkarkimin me vota të shumicës së kualifikuar[810].

Pavarësia e ESHR-së ishte siguruar me Ligjin e parë për revizion shtetëror që ishte miratuar në vitin 1997[811]. Gjatë viteve, ligji ishte lëndë e disa ndryshimeve dhe plotësimeve. Ligji i ri për revizion shtetëror ishte miratuar në 2010, për përputhje me Deklaratën e Meksikos për pavarësinë e institucioneve supreme të revizionit[812] dhe Deklaratës nga Lima për udhëzimet e parimeve udhëheqëse të revizionit[813]. Ligji përforcon pozitën dhe rolin e ESHR-së si institucion i pavarur suprem i revizionit në Maqedoni, përgjegjëse për kryerjen e revizioneve shtetërore. Në fakt, ligji i ri tërësisht është përputhur me standardet ndërkombëtare, ligjet evropiane dhe praktikën më të mirë ndërkombëtare[814]. Megjithatë, Kushtetuta nuk e rregullon relacionin ndërmjet ESHR-së dhe pushtetit ligjvënës. ESHR-ja është e pavarur në punën e saj[815], dhe kjo pasqyrohet në dispozitat për miratimin e programit të punës dhe kompetencave tjera të revizorit kryesor shtetëror[816]. Në përputhje me ligjin, ESHR-ja dorëzon Programin vjetor për punë në Kuvend për informim dhe asnjë trup ose institucion nuk mund të ndikojë mbi programin e punës së ESHR-së[817]. Përveç kësaj, ESHR-ja ka lirinë të vendosë për subjektet e revizionit dhe ka zhvilluar mekanizma për ndjekjen e rekomandimeve për sigurimin e zbatimit të drejtë të rekomandimeve që janë dhënë në raportet e revizionit[818]. Programi vjetor për punë përmban Planin e veprimit për realizim, si dhe pasqyrë të subjekteve që janë lëndë e revizionit.[819]

ESHR-ja synon të arrijë pavarësi të plotë nga pushteti ligjvënës dhe ekzekutiv, si dhe të sigurojë mjete të mjaftueshme si parakusht për realizimin efikas të autorizimeve përkatëse[820]. Në bazë të Kodit për etikë afariste dhe sjellje[821] të ESHR-së, pavarësia e subjektit që është lëndë e revizionit dhe grupeve tjera të interesuara të jashtme janë me rëndësi të çmueshme për revizorët.

ESHR-ja ka pavarësi financiare dhe autorizime për të menaxhuar me mjetet personale[822]. Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për revizion shtetëror[823] ka tre nene të reja dhe një pjesë për të punësuarit e ESHR-së, që parashikon që në ESHR ka dy kategori të të punësuarve: nëpunës shtetërorë që kryejnë punë të specializuar në fushën e revizionit, planifikimit, financat, kontabilitetin, TI dhe punë tjera nga fusha e kompetencave të ESHR-së; dhe të punësuarve që nuk kanë status të nëpunësve shtetërorë dhe kryejnë punë ndihmëse[824]. Në përputhje me Ligjin për Nëpunës Shtetërorë, punësimit duhet të bëhet sipas një procedure transparente në bazë të kualifikimeve dhe kompetencave dhe me zbatimin e

[809] Komisioni Evropian për Demokraci me anë të Drejtësisë (Komisioni i Venedikut), 2014 : f. 4.
[810] Komisioni Evropian për Demokraci me anë të Drejtësisë (Komisioni i Venedikut), 2014 : f. 11.
[811] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 65/97.
[812] http://www.intosai.org/issai-executive-summaries/view/article/issai-10-the-mexico-declaration-on-sai-independence-eger.html [qasur më 15.6.2015].
[813] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/2010.
[814] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14 neni 18; Rregullore për mënyrën e kryerjes së revizionit shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 158/2011, neni 2.
[815] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 3, parag. 4.
[816] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14 neni 9.
[817] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14 neni 23.
[818] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14 neni 2, parag. 2.
[819] Rregullore për mënyrën e kryerjes së revizionit shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 158/2011, neni 3.
[820] Enti Shtetëror i Revizionit, *Strategjie për Zhvillim 2013-2017,* (Shkup: ESHR, 2012) f. 6.
[821] Kodi i etikës afariste dhe sjelljes, Enti Shtetëror i Revizionit, dhjetor 2006 , Pavarësi, f. 3.
[822] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14 neni 12.
[823] Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 145/10.
[824] Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 145/10, neni 13-a.

parimit të përfaqësimit të drejtë të anëtarëve të komuniteteve[825]. Revizori kryesor shtetëror i përcakton kërkesat dhe organizon testimin për revizor të autorizuar shtetëror.[826]

Revizori kryesor shtetëror dhe zëvendësi zgjedhën dhe shkarkohen nga Kuvendi[827]. Revizori kryesor shtetëror duhet të plotësojë kërkesa të veçanta për sigurim të pavarësisë: ai/ajo nuk guxon të bëjë ndonjë funksion tjetër publik ose profesion, nuk guxon të jetë anëtarë në ndonjë prej organeve të partive politike, nuk guxon të jetë anëtar i Këshillit Drejtues, Këshillit Mbikëqyrës ose ndonjë organ në ndonjë subjekt tjetër ligjor dhe të mos ketë ndonjë sanksion penal për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.[828]

Mandati i revizorit kryesor shtetëror dhe zëvendësit është nëntë vite, pa të drejtë për ri-zgjedhje[829]. Ata janë të mbrojtur me ligj nga shkarkimi pa arsyetim përkatës[830]. Ato nuk mund të thirren për përgjegjësi penale ose të arrestohen për qëndrime të shprehura, mendime, dhe rekomandime në lidhje me revizionet[831].

8.1.3 PAVARËSIA (PRAKTIKA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle është liruar institucioni i revizionit nga ndikimi i jashtëm në kryerjen e punës në praktikë?

Revizori kryesor shtetëror në raportin e fundit vjetor ka theksuar që "mbeten prioritetet për ndryshimin e Kushtetutës, me çfarë do të garantohet pavarësia e ESHR-së dhe do të vendoset një mekanizëm i rregullt dhe efektiv për shqyrtimin e raporteve të revizionit nga Kuvendi".

Gjatë periudhës prej 2009 deri 2015, ESHR-ja ka zbatuar dy revizione të Qeverisë (në vitin 2009 dhe 2012), si dhe një revizion të Sekretariatit për Ligjvënie të Qeverisë në vitin 2014.

Ka shqetësime që ndonëse nuk ka përzierje të drejtpërdrejtë të Qeverisë në punën e ESHR-së, ka lidhje të ngushta mes revizionit shtetëror dhe Qeverisë[832]. Në procesin e zgjedhjes së revizorit kryesor shtetëror në vitin 2007, opozita kishte shpresuar që angazhimi i saj i mëhershëm si këshilltar në kabinetin e ish kryeministrit, nuk do të dëmtojë aftësinë e saj për punë objektive dhe shqyrtim të shpenzimit qeveritar të mjeteve publike për fushata reklamuese.[833]

Sipas raportit vjetor të ESHR-së për vitin 2013, zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare për Institucione Supreme të Revizionit (ISSAI) është një prej qëllimeve më kryesore strategjike të ESHR-së. Raporti për vlerësimin e përputhjes me ISSAI ishte përgatitur dhe përdorur si bazë për përgatitjen e strategjisë për zbatimin e ISSAI (gjatë vitit 2014). Në kuptim të Udhëzimit për sigurim të cilësisë së revizioneve, gjatë vitit 2013, një ekip ekspertësh i revizorëve të autorizuar shtetëror kanë zbatuar sigurim të cilësisë për tre revizionet e vitit paraprak[834],

[825] Ligji për nëpunës administrativë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 27/2014.
[826] Pjesa „II-a Të punësuar në Entin Shtetëror i Revizionit", Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14.
[827] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14 neni 4 (3).
[828] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 12, parag. (4) dhe (5).
[829] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 4, parag. 4.
[830] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14 neni 6 dhe 7.s
[831] Ligji për revizion Shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14 neni 11.
[832] Intervistë me Malinka Risevska – Jordanovën (interviste personale), 12.11.2014
[833] HTTP://UTRINSKI.MK/DEFAULT.ASP?ITEMID=402516FB7FC8254D9FF519811800A653 [qasur më 12.6.2015].
[834] ESHR, 2013: f. 15.

ndërsa në vitin 2014 ESHR-ja ka zbatuar katër revizione për sigurim të cilësisë[835]. Raportet janë vetëm për përdorim të brendshëm.

Revizori kryesor shtetëror ka theksuar që nuk ka shembuj të ndikimit politik ose përzierje në punën e ESHR-së dhe revizionet shtetërore, dhe që ka shembuj të përfshirjes së politikës nga stafi i ESHR-së.

QEVERISJA

8.2.1 TRANSPARENCA (E DREJTA)

Nota 100

Në çfarë shkalle janë vendosur dispozitat me të cilat sigurohet qasje të publikut në informata relevante për aktivitete të ndërmarra nga ESHR-ja?

ESHR-ja përgatit Program vjetor të ESHR-së, propozim dhe Raport të fundit të revizionit, si dhe Raport të hollësishëm vjetor për revizionet që janë zbatuar gjatë vitit, si dhe informata për punën e ESHR-së.

Programi vjetor për punën e ESHR-së prezantohet para Kuvendit për qëllime informative[836]. Raporti vjetor për revizionet e zbatuara dorëzohet dhe revidohet nga Kuvendi me debat dhe miratim të konkluzioneve të fundit[837], ndërsa, raportet tjera të revizionit gjithashtu dorëzohen, por nuk diskutohen në Kuvend.[838]

ESHR-ja ka strategjinë e komunikimit,[839] që ka qëllime primare të rriten interesi dhe motivimi i deputetëve në revizionet, të jepet informata kthyese në Komisionet për financim dhe buxhet për aktivitetet e zbatuara në kuptim të raporteve të revizionit[840]. Revizori kryesor shtetëror ka për obligim të publikojë raportet e fundit të revizionit dhe komentet në internet faqen e ESHR-së[841]. ESHR-ka për obligim të punojë në mënyrë transparente dhe të informojë publikun për punën e saj, veçanërisht në kuptim të buxhetit shtetëror dhe në kuptim të raporteve financiare të partive politike. ESHR-ja përgatit Raport revizioni për buxhetin shtetëror dhe e dorëzon në Kuvend.[842]

Më tutje, ESHR-ja është përgjegjëse edhe për mbikëqyrje të financimit të partive politike[843], dhe me atë është obliguar të publikojë raporte vjetore financiare për partitë politike, përfshirë edhe detaje të plota për donacionet.[844]

8.2.2 TRANSPARENCA (PRAKTIKA)

Nota 75

[835] ESHR, 2014: f. 15.
[836] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 23.
[837] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 33, parag. (3) dhe (4).
[838] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 33.
[839] Strategjia për Komunikim të Entit Shtetëror për Revizion për periudhën 2008-2012, http://www.dzr.mk/en/Uploads/ENG%20-%20Communication%20Strategy%20of%20SAO%202008%20-2012.pdf [qasur më 26.06.2015].
[840] Strategjia për Komunikim të Entit Shtetëror për Revizion për periudhën 2008-2012, f. 8.
[841] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 30, parag. 2.
[842] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 34, parag. 4.
[843] Kodi zgjedhor i RM, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 85.
[844] Kodi zgjedhor i RM, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 85-б.

Në çfarë shkalle ka transparencë në aktivitetet e ESHR-së në praktikë?

ESHR-ja gëzon reputacion pozitiv për shkak të praktikave transparente dhe prodhimtarinë[845]. Publikimi i raporteve finale të revizionit në internet faqen e ESHR-së luan rol kryesor në përparimin e transparencës. Në vitin 2014 janë regjistruar gjithsej 202.536 vizita të internet faqes së ESHR-së, prej të cilave pjesa më e madhe kanë qenë për qasje në raporte finale të revizionit.[846]

Në praktikë, të gjitha dokumentet e parashikuara me ligj që janë përgatitur nga ESHR-së dhe janë të gatshme. Informatat vijuese janë të gatshme në internet faqen e ESHR-së: raporte vjetore[847], programe vjetore,[848] revizione të rregullsisë dhe revizione të suksesit,[849] informata për ESHR-në, rregullore dhe standarde të zbatimit, raporte për partitë politike, procedura për prokurime publike dhe lidhjet me institucionet relevante ndërkombëtare[850]. Gjithashtu, ka një mekanizëm që qytetarët të mund të parashtrojnë pyetje dhe të japin propozime.

Një i punësuar është përgjegjës për relacionet me publikun dhe rregullimin e internet faqes[851]. ESHR-ja publikon shkresa dhe komente për punën në gazetat dhe mediet tjera. Megjithatë SIGMA raportet për vlerësim në vitin 2012 kanë theksuar që "deri më tani ESHR-ja nuk ka aktivitete për tërheqjen e vëmendjes së publikut për raportet e revizionit nga frika që kjo vëmendje do të shkaktojë shtypje dhe reagime të politizuara, pa ndikim pozitiv mbi ESHR-në dhe mbi raportet".[852]

Raportet vjetore për revizionet e zbatuara dhe punën e ESHR-së dorëzohen me kohë por edhe shqyrtohen nga Kuvendi, ndërsa raportet tjera të revizionit gjithashtu dorëzohen por nuk janë të shqyrtuara nga Kuvendi.[853]

ESHR-ja ka për obligim të zbatojë revizione të financave të gjitha partive politike. Në kuptim të zgjedhjeve lokale të vitit 2013 dhe zgjedhjeve të parakohshme parlamentare dhe presidenciale të vitit 2014, të gjitha revizionet e raporteve financiare të partive politike, përfshirë edhe donacionet në fushatat, ishin publikuar në internet faqen e ESHR-së[854]. Në raportin vjetor të vitit 2014, ESHR-ja thekson që "në mënyrë efektive i ndjek raportet financiare të partive politike me anë të mbikëqyrjes së procesit të dorëzimit të raporteve vjetore, llogarive vjetore dhe raporte të regjistrit të donacioneve"[855]. Megjithatë, GREKO jep një vlerësim skeptik për rolin e ESHR-së në mbikëqyrjen e financave të partive politike me arsyetimin që "ky organ ende nuk është pajisur mirë për të marrë rolin kryesor në mbikëqyrjen efektive, hetimin dhe zbatimin e rregullores për financim të partive politike, më konkretisht, resurse njerëzore dhe financiare"[856].

(Shikoni më hollësisht: shtylla e partive politike).

---

[845] Bundesrechnungshof, *Recension,* në lidhje me raportin final të ESHR të Maqedonisë. gz. 15-2007-1009, (Shkup: Bundesrechnungshof, 2007), f. 56.
[846] ESHR, 2014: f. 93, http://www.dzr.mk/Uploads/DZR_GI_2014.pdf [qasur më 29.6.2015].
[847] http://www.dzr.mk/DesktopDefault.aspx?tabindex=0&tabid=1099 [qasur më 24.6.2015].
[848] http://www.dzr.mk/DesktopDefault.aspx?tabindex=0&tabid=1098 [qasur më 24.6.2015].
[849] http://www.dzr.mk/DesktopDefault.aspx?tabindex=0&tabid=1092 [qasur më 26.6.2015].
[850] http://www.dzr.mk/en/DesktopDefault.aspx [qasur më 26.6.2015].
[851] Përgjigje të pyetësorit nga Tanja Tanevska, revizore kryesore shtetërore, 22.6.2015 dhe Raporti vjetor i ESHR-së për 2014, f. 93 http://www.dzr.mk/Uploads/DZR_GI_2014.pdf [qasur më 29.6.2015].
[852] OECD/SIGMA, 2012: f. 51.
[853] http://www.dzr.mk/DesktopDefault.aspx?tabindex=0&tabid=1 [qasur më 29.6.2015].
[854] http://www.dzr.mk/DesktopDefault.aspx?tabindex=0&tabid=1073 [qasur më 26.6.2015].
[855] ESHR, 2014: f. 15.
[856] GREKO,2014: f. 6.

8.2.3 LLOGARIDHËNIA (E DREJTA)

Nota 75

Në çfarë shkalle ka dispozita për sigurim që ESHR-ja duhet të njoftojë dhe merr përgjegjësi për veprimet e saj?

ESHR-ja ka për obligim të dorëzojë programin vjetor të punës për vitin rrjedhës në Kuvend, jo më vonë se në dhjetor të vitit rrjedhës[857]. Programi vjetor përmban plan të veprimit, si dhe listë të subjekteve që do të jenë lëndë e revizionit.[858]

ESHR-ja ka për obligim të përgatisë Raport vjetor për revizionet e zbatuara dhe për punën e ESHR-së, por nuk ka obligime ligjore për përmbajtjen e raportit. ESHR-ja duhet të dorëzojë Raportin për vitin paraprak në Kuvend, jo më vonë se 30 qershor të vitit rrjedhës[859]. Kuvendi ka për obligim të shqyrtojë Raportin dhe të miratojë konkluzione, për të cilat ESHR-ja i dorëzon raportet e fundit të revizionit[860]. ESHR-ja gjithashtu përgatit raporte revizioni për buxhetin shtetëror dhe raportin e dorëzon në Kuvend.[861]

Revizioni i llogarive të ESHR-së bëhet nga ndërmarrje private revizioni, e zgjedhur dhe paguar nga Kuvendi[862]. Ndërmarrja revizore ka qasje në të dhënat e plota kontabël të ESHR-së[863]. Raporti vjetor duhet të dorëzohet në Kuvend dhe në ESHR jo më vonë se 30 qershor të vitit rrjedhës[864]. Kuvendi e shqyrton raportin nga revizioni i ESHR-së i zbatuar nga ndërmarrja revizore.[865]

Nuk ka dispozita ligjore që i lejojnë një autoriteti administrativ të reviduar nga ESHR-ja të dorëzojë ankesë kundër rezultateve të revizionit. Megjithatë, ka mundësi të kontestohen rezultatet e revizionit para se të finalizohen. ESHR-ja dorëzon Propozim-raportin e revizionit te përfaqësuesit ligjorë të subjektit të reviduar. Vërejtjet mund të jepen në afat prej 30 ditëve pas pranimit të raportit dhe shqyrtohen nga ekipi për revizion, para se të përgatitet raporti i fundit.[866]

Në kuptimin e brendshëm, në kuadër të ESHR-së, ka procedura me të cilat sigurohet një qasje e përputhur dhe e koordinuar. Secili raport është lëndë e diskutimit në mbledhje, të kryesuar nga këshilltari i revizorit kryesor shtetëror, dhe që përbëhet nga tre ndihmës, revizorë kryesorë shtetërorë; njëri është udhëheqësi i Departamentit për Revizion, njëri udhëheqës i Departamentit për Metodologji të Revizionit, si dhe një që nuk ka qenë i përfshirë në përgatitjen e revizionit.[867] Kjo përbërje e diskuton Propozim-raportin e fundit, komentet e dhëna nga subjekti i reviduar si dhe reagimet e revizorëve për komentet.[868]

---

857 Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 23.
858 Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 3, Rregullore për Mënyrën e Kryerjes së Revizionit Shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 158/2011, neni 23.
859 Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 33, parag. (1).
860 Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 33.
861 Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 34.
862 Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 145/2010.
863 Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 38, parag. (4).
864 Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 38, parag. (5).
865 Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 38, parag. (6)
866 Rregullore për mënyrën e kryerjes së revizionit shtetëror, 22.6.2015
867 OECD/SIGMA, 2012: f. 49 http://dx.doi.org/10.1787/5jz2rqlfx68q-en [qasur më29.6.2015].
868 Njëlloj.

8.2.4 LLOGARIDHËNIA (PRAKTIKA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle ESHR-ja duhet të njoftojë dhe të marrë përgjegjësi për procedurat e saj në praktikë?

Raporti vjetor i ESHR-së përfshin informata të plota për aktivitetet e ESHR-së, përfshirë edhe buxhetin, dokumentet dhe zbatimin e tyre, standardet e revizionit dhe informata për metodologjinë e revizionit, bashkëpunimin me institucionet shtetërore dhe aktivitetet revizionin (numri i revizioneve, raporte të revizionit, lëndë të revizionit, rekomandime për raporte të revizionit dhe zbatimn e tyre, të ardhurat publike të reviduara dhe shpenzimet dhe zbulimet për prokurimet publike).[869]

Në vitin 2014, si obligim ligjor, ESHR-ja në Kuvend ka dorëzuar të gjitha raportet e fundit të revizionit[870]. Raporti vjetor për vitin 2014 jep një pasqyrë të mbulimit, mendimeve dhe llojeve të revizionit, si dhe përmbledhje të revizionit të buxhetit vjetor shtetëror dhe revizione tjera më të rëndësishme. Raporti, gjithashtu, përmban përmbledhje të aktiviteteve të ESHR-së dhe llogaritë e reviduara të ESHR-së.[871]

Kuvendi shqyrton dhe aprovon raportin vjetor të ESHR-së për vitin 2013. Gjithashtu, Kuvendi ka përfunduar që ESHR-ja kryen aktivitetet e saj në përputhje me standardet ndërkombëtare[872]. Përveç kësaj, Kuvendi ka rekomanduar që subjektet e reviduara të miratojnë rekomandimet e ESHR-së dhe të përforcojnë sistemet e tyre të kontrollit. Kuvendi i mbështet rekomandimet e propozuara nga pushtetit ekzekutiv me raportet e revizionit për përmirësim të dobësisë sistematike të institucioneve të reviduara dhe përputhje me dispozitat ligjore, atje ku nuk përputhen ose që krijohet ndonjë huti.[873]

Relacioni i ESHR-së me Kuvendin është një çështje që krijon shqetësim, sepse raportet nuk marrin vëmendjen e merituar sistematike. Në qershor 2013 ishte nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet ESHR-së dhe Kuvendit, që duhet të kontribuojë për themelimin e një mekanizmi të gjatë, për shqyrtim të raporteve të revizionit nga komisioni përkatës në Kuvend.[874]

Ndonëse ka mangësi në shqyrtimin e revizioneve nga Kuvendi, institucionet e reviduara mendojnë që raportet janë të dobishme, ndërsa raportet e revizionit kanë ndikim të drejt-përdrejtë te subjektet e reviduar[875]. Mendimet e revizorëve konsiderohen të themeluara dhe rekomandimet konsiderohen të dobishme[876].

8.2.5 MEKANIZMAT PËR INTEGRITET (E DREJTA)

Nota **100**

[869] Përgjigje të pyetësorit nga Tanja Tanevska, Revizore kryesore shtetërore, 22.6.2015
[870] ESHR, 2014: f. 15.
[871] ESHR, 2014: f. 33.
[872] Ligji për revizion shtetëror, Deklarata nga Meksiko për pavarësinë e ISR-së dhe Deklarata e Limës për udhëzime mbi parimet e revizionit.
[873] ESHR, 2014: f. 15.
[874] ESHR, 2013: f. 6.
[875] QMBN, 2014: f. 57.
[876] OECD/SIGMA, 2012: f. 49/50.

Në çfarë shkalle ka mekanizma për sigurim të integritetit të institucionit të revizionit?

ESHR-ja ka miratuar Kodin e etikës në vitin 2006.[877] Kompetencat e ESHR-së, organizimi dhe procedurat për kryerjen e revizioneve janë në përputhje me standardet e revizionit të INTOSAI dhe rregullat e kodit etik të INTOSAI[878].

Kodi etik vlen për çdo revizor individual, për revizorin kryesor të ESHR-së, zbatuesit dhe të gjithë personat që punojnë në ESHR dhe që janë të angazhuar në punën e revizionit.

Revizorët kanë për obligim të zbatojnë dispozitat e Kodit[879]. Kodi i potencon integritetin, pavarësinë dhe objektivitetin, besueshmërinë dhe kompetencën[880]. Kodi obligon personelin e ESHR-së të mirëmbajë standarde të mira për sjellje dhe veprim profesional, vendimmarrje, vendime që marrin parasysh interesin publik dhe zbatimin e sinqeritetit absolut në kryerjen e punës.[881]

ESHR-ja ka për obligim të jetë neutrale në kuptimin politik. Meqë ESHR-ja mban lidhje të ngushta pune me institucionet politike, përfshirë edhe pushtetin ekzekutiv, partitë politike, dhe Kuvendin, me rëndësi është që revizorët të mbajnë pavarësinë e tyre dhe të kundërshtojnë ndikimin politik, me qëllim që të plotësojnë përgjegjësitë e revizionit në mënyrë të paanshme.[882]

Gjithashtu, ka rregulla që përcaktojnë konfliktin e interesave. Sipas kodit etik, revizorët duhet të mbrojnë pavarësinë e tyre dhe të shmangin çdo lloj të konfliktit të interesit me refuzimin e dhuratave ose shpërblimeve, që do të mund të ndikojnë ose do të vështroheshin si ndikim mbi pavarësinë dhe integritetin e tyre.[883]

Kodi etik kërkon nga të gjithë revizorët të shmangin çdo lloj lidhje me menaxherët dhe stafin e subjektit të reviduar dhe palë tjera që do të mund të kenë ndikim, të kompromet ojnë ose rrezikojnë aftësinë e revizorëve të veprojnë ose të shihet që veprojnë pavarësisht[884]. Revizorët nuk duhet të përdorin detyrën e tyre zyrtare për qëllime private dhe duhet të shmangin lidhje që përfshijnë rrezik nga korrupsioni ose që do të mund të venin në pikëpyetje objektivitetin dhe pavarësinë e tyre.[885]

8.2.6 MEKANIZMAT PËR INTEGRITET (PRAKTIKA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle është siguruar integriteti i institucionit të revizionit në praktikë?

ESHR-ja është anëtare e grupit të punës për revizion dhe etikë të EUROSAI, që synon promovimin e rëndësisë së veprimit etik dhe integritetit në kuadër të institucioneve supreme të revizionit. Në praktikë, të punësuarit e ESHR-së respektojnë parimet etike të vendosura në Kodin etik.[886]

[877] Kodi etik, ESHR, dhjetor 2006, dispozita të përgjithshme f. 2.
[878] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 18.
[879] Kodi etik, ESHR, dhjetor 2006, dispozita të përgjithshme f. 2.
[880] Njëlloj.
[881] MOVRI 30, Integritet, parag. 12, f. 5.
[882] Kodi etik, Pavarësi, f. 3.
[883] Kodi etik, ESHR, dhjetor 2006, konflikt i interesave, f. 6.
[884] Kodi etik, ESHR, dhjetor 2006, konflikt i interesave, f. 3.
[885] MOVRI 30, konflikt i interesave, parag. 23, f. 6.
[886] Komunikimi i mirë dhe i suksesshëm është përgjegjësi e çdo të punësuari në Entin Shtetëror të Revizionit, 2008-2012, f. 5.

ESHR-ja është lider në rajonin me organizimin e punëtorive për integritet dhe mënyrën në të cilën ESHR-ja mund të zbatojë dhe të respektojë Kodin etik[887]. Ka dy raste të shkeljes së Kodit etik, gjegjësisht konflikt të interesave. Në dy rastet, sanksionet kanë qenë zvogëlimi i rrogës për një periudhë të caktuar.[888]

Megjithatë, përveç kësaj, nuk ka autoritet përgjegjës për mbikëqyrje dhe kontroll të mekanizmave për integritet, me çfarë është dobësuar efektiviteti i masave parandaluese të kundër korrupsionit.[889]

ROLI

8.3.1 REVIZIONET EFEKTIVE FINANCIARE

Nota **50**

Në çfarë shkalle institucioni i revizionit kryen revizione efektive të shpenzimeve publike?

ESHR-ja kryen revizione të rregullsisë dhe revizione të suksesit[890] të subjekteve shtetërore/institucioneve të parashikuara me ligj[891]. Pas procedurës së revizionit, revizori shtetëror përgatit dhe parashtron propozim raport të revizionit te përfaqësuesi ligjor i subjektit të reviduar dhe personi përgjegjës për subjektin e reviduar në periudhën e revizionit[892] në afat prej 30 ditëve për parashtrimin e komenteve. [893] Revizori shtetëror, pastaj, përgatit raport final, që dërgohet te subjekti i reviduar, dorëzohet në Kuvend dhe publikohet në internet faqen e ESHR-së[894]. Raporti i përmban komentet e subjektit të reviduar. Përfaqësuesi ligjor i subjektit të reviduar dërgon njoftim në ESHR dhe në organin përgjegjës për mbikëqyrje dhe kontroll të masave të ndërmarra, në kuptim të zbulimeve dhe rekomandimeve të raporteve të revizionit, në afat prej 90 ditëve nga dita e pranimit të raportit final.[895]

Nëse revizori i autorizuar shtetëror gjatë revizionit vlerëson që subjekti i reviduar ka kryer shkelje ose vepër penale, ai/ajo menjëherë duhet të informojë organet kompetente[896].

Në vitin 2014, ESHR-ja ka zbatuar 103 revizione (numri i njëjtë sikur në vitin 2013) – 17 revizione financiare dhe revizione për përputhje, 6 revizione të suksesit, si dhe revizione të suksesit të Sistemit për Kontroll të Brendshëm Publik Financiar (SKBPF). Janë lëshuar 116 raporte revizioni (155 raporte revizioni në vitin 2013) – 30 raporte financiare të revizionit, 80 raporte për revizion të suksesit të SKBPF dhe 6 raporte të revizionit për sukses.[897]

---

[887] Përgjigje të pyetësorit nga Tanja Tanevska, Revizore kryesore shtetërore, 22.6.2015
[888] Njëlloj.
[889] Neda Korunovska, *Mekanizmi për njoftimin e pavarur Maqedoni: Raporti për përparimin 2012-13* (Shkup: Reaktor, hulumtimi në veprim, 2013), f. 11. http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Macedonia_OGP_IRM_Public_ Comment_(English)_0.pdf [qasur më 17.6.2015].
[890] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 18 (2).
[891] Revizioni shtetëror do të zbatohet për Parlamentin e RM-së, Kryetarin e RM-së, Buxhetin e RM-së dhe buxhetet komunale, përdoruesit buxhetorë, njësitë që përdorin buxhetin, ndërmarrjet publike, shoqëritë tregtare në të cilat shteti është aksionar kryesor, agjencitë dhe institucionet tjera të themeluara me ligj, institucione tjera të financuara nga mjete shtetërore, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, partitë politike të financuar me mjete buxhetore, Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 22 (1).
[892] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 30 (1).
[893] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 30 (2).
[894] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 31.
[895] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 32.
[896] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 35.
[897] ESHR, 2014: f. 19.

Raportet e zbulimeve revizioneve janë gjithëpërfshirëse. Në vitin 2014, ESHR-ja ka bërë vlerësim të përputhjes së akteve metodologjike të ESHR-së dhe praktikës në vend, me kërkesat dhe standardet e vendosura nga ISSAI. Rezultatet kanë treguar një shkallë të lartë të përputhjes (71%).[898] Z-nja Tanja Tanevska, revizore kryesor, ka theksuar që "për të përmirësuar shkallën e përputhjes, ESHR-ja ka përgatitur dy doracakë – për rregullsi dhe revizion të suksesit – ndërsa shkalla e fundit është doracaku i ri për ndjekjen e rekomandimeve".

Nëse ndonjë organ i autorizuar kërkon prezantim të Raportit të revizionit të dorëzuar në Kuvend, ESHR-ja me kohë do të bëjë prezantimin.[899]

Pushteti ekzekutiv është lëndë e revizionit të ESHR-së, ndërsa raporti është lëndë e shqyrtimit në Kuvend. Ka një ndjekje të kufizuar nga pushteti ekzekutiv të rekomandimeve të raporteve të ESHR-së.[900]

Në përputhje me programin vjetor për vitin 2014, ESHR-ja ka zbatuar 86 revizione të suksesit në të cilat janë përfshirë 147 subjekte[901]. Numri i revizioneve të suksesit të zbatuar në nivelin vjetor është rritur dukshëm gjatë viteve[902]. Të gjitha revizionet e suksesit përqendrohen në cilësinë dhe sasinë e resurseve publike dhe shërbimet në fushat në të cilat janë përcaktuar rreziqe financiare. Rekomandimet nga revizionet janë orientuar në përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve, të siguruara nga institucionet shtetërore. Rekomandimet duhet të jenë konstruktive, të orientuara kah zgjidhja e arsyeve të problemeve të përcaktuar, dhe në kohën e njëjtë edhe ndaj palëve që kanë përgjegjësi për zbatimin e masave. Për të kryer mbikëqyrje të ndjekjes së rekomandimeve në raportet e revizioneve, secili revizion shqyrton veprën e subjektit të reviduar me rekomandimet nga revizioni paraprak.[903]

ESHR-ja nuk ka autorizime për sanksionim. Sipas ISSAI 10, ESHR-ja duhet të ndjekë aktivitetet që janë ndërmarrë nga personi përgjegjës, si përgjigje e çështjeve të ngritura në raportet e revizionit.

Në vitin 2014, ESHR-ja ka kryer revizione të njëpasnjëshme të gjendjes së zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportet finale të revizionit nga vitet 2013 dhe 2014, me qëllim të përcaktimit të zbatimit të tyre. Shqyrtimet kanë mbuluar 53 subjekte të reviduara (37 të reviduara në vitin 2013) dhe rekomandime nga 70 raporte finale të revizionit (57 raporte të revizionit në 2013).[904] Në revizionet e vitit 2014, ESHR-ja ka dhënë 833 rekomandime dhe ka përcaktuar që zbatimi ka qenë rreth 65%.[905]

Gjatë viteve të fundit, ESHR-ja ka përforcuar mbikëqyrjen e financave të partive financiare. Sipas Kodit zgjedhor, ESHR-ja ka për obligim të kryejë revizion të raporteve të financimit në afat prej 60 ditë nga dorëzimi i tyre[906]. Ka një shqetësim për kapacitetet e ESHR-së për revizione të suksesit dhe kontrollit të financimit politik. Raporti i përparimit të KE-së (viti 2013) ka theksuar që "ESHR-ja ende nuk posedon resurse përkatëse njerëzore dhe financiare për zbatimin efikas të funksioneve të reja për mbikëqyrjen financiare të partive politike dhe fushatave zgjedhore".

[898] Përgjigje të pyetësorit nga Tanja Tanevska, revizore kryesore shtetërore, 22.6.2015
[899] Përgjigje të pyetësorit nga Tanja Tanevska, revizore kryesore shtetërore, 22.6.2015
[900] Komisioni Evropian, 2014: f. 9.
[901] ESHR, 2014: f. 50.
[902] Prej tre në 2007-2009 deri në gjashtë në 2010 dhe shtatë në 2011-2013, numri i njëjtë është parashikuar, SIGMA 2012, f. 47.
[903] OECD/SIGMA, 2012: f. 49.
[904] ESHR, 2014: f. 22.
[905] Njëlloj.
[906] Kodi zgjedhor i RM, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 и 32/14, neni 85.

8.3.2 ZBULIMI DHE NDËSHKIMI I SJELLJES SË PAHIJSHME

Nota **75**

A ka zbuluar dhe hetuar institucioni i revizionit sjellje të pahijshme të bartësve të funksioneve publike?

Ligji për revizion shtetëror përmban dispozita që u mundësojnë revizorëve qasje në të gjitha dokumentet e nevojshme dhe të dhënat, qasje në lokalet e subjektit të reviduar, e obligon subjektin e reviduar të bashkëpunojë me revizorët, madje edhe në afate të ngushta, por edhe parashikon ndëshkime për personat ligjorë dhe personat përgjegjës në subjektin e revizionit, nëse nuk dorëzojnë dokumente ose në ndonjë mënyrë e pengojnë punën e revizorëve[907].

Në përputhje me ligjin, ESHR-ja ka autorizime të shqyrtojë dokumente dhe raporte, si dhe procedura kontabël dhe financiare dhe të dhëna elektronike dhe sisteme informatike, për të përcaktuar nëse raportet financiare paraqesin gjendjen e saktë financiare dhe aktivitetet financiare[908]. Kjo në praktikë do të thotë që ESHR-ja, gjithashtu, ka autorizime të shqyrtojë raporte për kontrollin e brendshëm dhe publik dhe qasje në raporte për kontrolle, të zbatuar nga sistemi për drejtim financiar dhe kontroll. ESHR-ja, gjithashtu, mund të shqyrtojë transaksionet financiare të përcaktuara si të ardhura publike dhe të shpenzimet publike dhe mund të bëjë vlerësim të përdorimit të mjeteve në kuptim të ekonomisë së arritur, efikasitetit dhe efektivitetit, si dhe masat e ndërmarra nga subjekti i reviduar[909]. Sipas raportit të vlerësimit të SIGMA-s, "revizorët e ESHR-së nuk hasin probleme me marrjen e informatave të nevojshme dhe bashkëpunimit".[910] Mos respektimi mund të sanksionohet me gjobë në të holla.[911]

Korniza institucionale e ESHR-së për mbikëqyrje të financimit të fushatave politike ishte krijuar në vitin 2012. Financimi i fushatave zgjedhore të partive politike, si dhe financimi vjetor janë lëndë e mbikëqyrjes së jashtme nga ESHR-ja. Nëse ESHR-ja zbulon parregullsi në raportet financiare për fushatën zgjedhore, që është në kundërshtim me Kodin zgjedhor, ka të drejtë të kërkojë nisje të procedurës penale ose denoncim nga prokurori publik kompetent në afat prej 30 ditëve nga dita e përcaktimit të parregullsive.[912]

Në vitin 2014, ESHR-ja ka pranuar 33 raporte financiare vjetore, 32 llogari vjetore dhe 33 raporte nga Regjistri i donacioneve prej gjithsej 55 partive politike.[913] Për ato parti politike që nuk kanë dorëzuar raporte financiare për 2013, ESHR-ja ka rekomanduar që ministri i Drejtësisë të ndërpret financimin buxhetor vjetor të partive politike. Ministri i Drejtësisë e ka ndërprerë, dhe si rezultat, disa parti politike kanë dorëzuar raporte financiare[914].

ESHR-ja është nënshkruese e Protokollit për bashkëpunim të parandalimit dhe shtypjes

[907] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, nenet 24 dhe 25.
[908] QMBN, 2014: f. 57.
[909] Përgjigje të pyetësorit nga Tanja Tanevska, revizore kryesore shtetërore, 22.6.2015
[910] OECD/SIGMA, 2012: f. 46.
[911] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10,145/10, 12/14, 43/14, neni 30 (3).
[912] Kodi zgjedhor i RM, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni 85 (7).
[913] Për partitë politike që nuk kanë dorëzuar raportet financiare për vitin 2013, ESHR-ja ka dorëzuar propozim te ministri i Drejtësisë në bazë të cilës ministri ka marrë vendim të largojë financimin e rregullt vjetor për këto parti politike. Vendimi kishte ndikim dhe si pasojë, disa parti politike kanë dorëzuar raportet financiare. Vendimi fillimisht ka mbuluar 35 parti politike që nuk kanë respektuar obligimet për njoftim financiar për vitin 2013, gjegjësisht nuk kanë dorëzuar raporte nga Regjistri i ndryshimit të donacioneve, llogari vjetore ose raport financiar vjetor. (ESHR, 2014: f. 38)
[914] Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 189/2014, http://www.slvesnik.com.mk/Issues/a17ac0e2f2c243c1bdf936f059bf66fe.pdf

së korrupsionit dhe konfliktit të interesave.[915] KSHZ-ja, ESHR -ja dhe KSHPK-ja nuk kanë të drejtë të imponojnë sanksione, por rastet mund t'i dërgojnë te gjykatat kompetente me nisjen e procedurave ndëshkimore ose penale.[916] ESHR-ja mund të dorëzojë iniciativë për procedurë penale ose të dorëzojë raport te prokurori publik kompetent, nëse përcaktohet që ka pasur parregullsi në raporte.

REKOMANDIM

R1. Kuvendi duhet të mbështesë revizionin nga ESHR-ja dhe të fillojë mekanizma për sanksionimin dhe zbatimin e rekomandimeve, me qëllim të përforcimit të rolit dhe efektivitetit të mbikëqyrjes së shpenzimeve publike.

KOMENT:

ESHR-ja duhet të merret si shembull për shumicën ose për të gjitha shtyllat tjera. ESHR-ja mund të shërbejë si model i krahasimit të të gjitha kapaciteteve institucionale (në kuptim të resurseve) dhe zhvillimit të drejtimeve të përgjithshme për atë se çfarë është e nevojshme për zbatimin përkatës dhe të drejtë të detyrave.

[915] Nënshkruar më 25 dhjetor 2007 nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtoria për të Hyrave Publike, Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë, Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë, Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Enti Shtetëror të Revizion, Drejtoria e Doganave, Policia Financiare, Drejtoria për Parandalimin e Larjes së Parave dhe Enti Shtetëror për Punë Gjeodezies

[916] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 66/10, 145/2010, 12/2014, 43/2014.

9. AVOKATI I POPULLIT

PËRMBLEDHJE

Avokati i Popullit ka një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave themelore të qytetarëve.

Baza ligjore dhe institucionale e Avokatit të Popullit është mirë e organizuar. Nga vlerësimi i NSI-së del që Avokati i Popullit është një prej shtyllave më të fuqishme të NSI-së maqedonase dhe ka nivel të lartë të transparencës dhe llogaridhënies. Megjithatë, në praktikë, Avokati i Popullit ka vështirësi me resurse dhe personel që duhet të zgjidhen me qëllim të kryerjes së detyrave përkatëse.

Në tabelën më poshtë janë dhënë vlerësimet e treguesve që përmbledhin notën e Zyrës së Avokatit të Popullit në kuptim të kapacitetit, drejtimit të brendshëm dhe rolit në sistemin maqedonas të integritetit. Në vazhdim të kësaj pjese është dhënë analiza cilësore e secilit tregues.

NOTA E PËRGJITHSHME PËR SHTYLLËN: 76,3/100

DIMENSIONI	TREGUESI	E DREJTA	PRAKTIKA
Kapaciteti 66,6/100	Resurset	/	50
	Pavarësia	75	75
Qeverisja 87,5/100	Transparenca	100	100
	Llogaridhënia	100	75
	Integriteti	75	75
Roli 75/100	Hetimi	75	
	Promovimi i praktikave të mira	75	

Nota për shtyllën sipas të drejtës dhe praktikës.



STRUKTURA DHE ORGANIZIMI

Zyra e Avokatit të Popullit është themeluar në vitin 1997 ndërsa zyra dhe pavarësia e Avokatit të Popullit është garantuar me Kushtetutë[917]. Në përputhje me obligimet kushtetuese të bazuara mbi Marrëveshjen kornizë të Ohrit[918], Ligji i ri për Avokatin e Popullit ishte miratuar në vitin 2003[919], sipas të cilit institucioni është decentralizuar dhe janë hapur zyra rajonale. Organizimi i Avokatit të Popullit është përcaktuar në përputhje me Ligjin për Avokatin e Popullit dhe aktet tjera nënligjore.[920]

Selia e Avokatit të Popullit është në Shkup, ndërsa ka gjashtë zyra rajonale në Manastir, Kërçovë, Strumicë, Kumanovë, Tetovë dhe në Shtip. Pas ndryshimeve të ligjit në vitin 2009[921], ishin themeluar departamente të posaçme për mbrojte të të drejtave të fëmijëve dhe personave me nevoja të posaçme; mbrojtje të qytetarëve kundër diskriminimit dhe sigurimit të përfaqësimit të drejtë, si dhe mbrojtje nga tortura dhe veprat tjera çnjerëzore, mizore ose poshtëruese ose ndëshkuese. Secili zëvendës është përgjegjës për seksione të veçanta tematike: të drejta qytetare dhe liri dhe të drejta të anëtarëve të komuniteteve; të drejtat për mbrojtje sociale dhe siguri sociale; të drejta ekonomike dhe rregullore; të drejtë e punës, të drejtat e mjedisit jetësor dhe të drejtat e konsumatorëve.

Sipas Kushtetutës në Amendamentin XII,[922] Avokati i Popullit është emëruar sipas propozimit të anëtarëve të Komitetit për Marrëdhënie ndërmjet Komuniteteve, nëse nuk ka përfaqësues, siç është përcaktuar në Kushtetutë. Emërimet bëhen pas konsultimit me përfaqësuesit relevantë të këtyre komuniteteve.[923]

[917] Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/91, neni 77.
[918] Marrëveshja kornizë e Ohrit, e miratuar më 13.8.2001.
[919] Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003.
[920] Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 7/1997, Rregullore për Avokatin e Popullit dhe akte nënligjore për formën, përmbajtjen dhe procedurën e dhënies, përdorimit dhe konfiskimit të kartelave zyrtare të Avokatit të Popullit, zëvendësit dhe të punësuarit në shërbimin profesional të Avokatit të Popullit. http://ombudsman.mk/EN/ competence/rulebook.aspx
[921] Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 114/2009.
[922] Amendamenti XII, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 91/2001.
[923] Kushtetuta e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/91.

Me ratifikimin e Protokollit fakultativ ndaj Konventës kundër torturës në vitin 2008[924], Avokati i Popullit ka marrë autorizime për të ndërmarrë rolin e Mekanizmit Kombëtar Parandalues (MKP), që ka filluar me punë në vitin 2011.

Komiteti Ndërkombëtar Koordinues për Institucionet Kombëtare për Promovim dhe Mbrojtje të Drejtave të Njeriut[925] ka akreditуar Avokatin e Popullit me status B në tetor 2011, që do të thotë se ky institucion është në përputhje të pjesshme me Parimet e Parisit[926] në lidhje me statusin e institucioneve kombëtare në lidhje me institucionet kombëtare, të emëruara me kompetencë për mbrojtje të të drejtave të njeriut.[927]

VLERËSIMI

KAPACITETI

9.1.1 RESURSET (PRAKTIKA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle Avokati i Popullit ka resurse përkatëse për arritjen e qëllimeve në praktikë?

Avokati i Popullit financohet nga buxheti shtetëror në baza vjetore. Në tre vitet e fundit, buxheti i Avokatit të Popullit ishte rritur për 19%. Në vitin 2013, Avokati i Popullit ka fituar 1.045.048 EUR; në 2014, buxheti është rritur për 9,8% në 1.160.260 EUR, ndërsa, buxheti i parashikuar për 2015 është 1.183.349 EUR. Megjithatë, në raportin vjetor të Avokatit të Popullit theksohet që "buxheti i Avokatit të Popullit nuk ka siguruar mjete për të avancuar të të drejtat dhe liri të njeriut. Avokati i Popullit përballet me vështirësi për sigurimin e përkthimeve dhe publikimeve të raporteve për shkak të mungesës së financave".[928]

Avokati i Popullit nuk merr pjesë në përgatitjen e buxhetit ndonëse në ligj është parashikuar që Avokati i Popullit e sqaron bazën e mjeteve të kërkuara në seancë të Kuvendit.[929]

Sipas Raportit vjetor të Avokatit të Popullit në vitin 2014, mjetet e aprovuara nuk janë të mjaftueshme dhe ajo e kufizon punën e institucionit në përparimin e të drejtave dhe lirive të njeriut[930]. Iniciativat për përparimin e të drejtave të njeriut deri më tani ishin financuar nga Instrumenti për Ndihmë Teknike dhe Shkëmbim të Informatave i Komisionit Evropian, Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Maqedoni, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (ODHIR) dhe Misioni i OSBE-së në Shkup, por asnjëherë me mbështetje buxhetore[931]. Kompetencat e Avokatit të Popullit në kuptim të mekanizmit kombëtar të parandalimit që e zbaton Konventa kundër torturës nuk mund të bëhen sepse nuk është

[924] Ligji për ratifikimin e Protokollit fakultativ ndaj Konventës kundër torturës dhe veprimit ose ndëshkimit tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtërues (OPKAT), Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 165/2008.
[925] http://nhri.ohchr.org/EN/AboutUs/ICCAccreditation/Pages/default.aspx [qasur më29.06.2015]
[926] http://nhri.ohchr.org/EN/AboutUs/ICCAccreditation/Documents/Chart%20of%20the%20Status%20of%20NHRIs%20%2823%20May%202014%29.pdf [qasur më1.6.2015].
[927] http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/StatusOfNationalInstitutions.aspx Miratuar nga kuvendi me rezolucionin 48/134 të 20 dhjetorit 1993.
[928] Avokati i Popullit – Institucion shtetëror për mbrojtje të të drejtave të njeriut, *Raport vjetor për nivelin e respektimit, përparimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirove të njeriut 2013 (*Shkup: Avokati i Popullit , 2013), f. 132.
[929] Njëlloj.
[930] Avokati i Popullit , *Raporti vjetor i avokatit të popullit për vitin 2014*, (Shkup: Avokati i Popullit , 2014), f. 115 http://ombudsman.mk/upload/Godisni%20izvestai/GI-2014/GI%202014.pdf
[931] Njëlloj.

tërësisht i plotësuar ose nuk është financuar puna përkatëse.[932]

Në praktikë, mjetet financiare të aprovuara për Avokatin e Popullit çdoherë janë më të ulta nga ajo që është kërkuar. Në vitin 2015 ishin mbuluar shpenzimet themelore, por nuk ka pasur mjete për trajnime profesionale, publikime, përkthime, etj. Një shtypje tjetër financiare bëhet kur Qeveria, në zbatimin e masave kundër krizës, mundohet të përdorë shkurtime tjera të buxhetit vetëm për mjetet e dhëna.[933]

Gjatë vitit 2013 ishin punësuar shtatë zëvendës të avokatit të popullit në selinë dhe në gjashtë zyrat rajonale. Shërbimi profesional i Avokatit të Popullit ka 78 të punësuar[934]. Sekretari i përgjithshëm i Avokatit të Popullit drejton me Shërbimin Profesional. Të punësuarit posedojnë shkathtësi përkatëse dhe profesionalizëm.

Megjithatë, Avokati i Popullit përballet me mungesë të resurseve njerëzore[935]. Gjatë viteve të fundit, tendenca është që nuk jepet aprovim për plotësimin e vendeve të lira dhe për krijim të vendeve të reja të punës. Numri i të punësuarve në administratën e zyrës vazhdimisht zvogëlohet. Kompensimet janë të papërshtatshme, dhe ka vështirësi të punësohet dhe të përmbahet personali i specializuar dhe profesional.[936]

9.1.2 PAVARËSIA (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle Avokati i Popullit është i pavarur sipas ligjit?

Korniza ligjore parashikon një numër të madh të mekanizmave në drejtim të sigurimit të pavarësisë së Avokatit të Popullit, por ka mangësi që do të mund të rrezikojnë pavarësinë dhe paanësinë. Gjithashtu, ka kufizime në kuptim të llojeve që mund të hetojë Avokati i Popullit.

Avokati i Popullit është bazuar me Kushtetutën e vitit 1991. Përveç kësaj, në përputhje me kornizën ligjore, Avokati i Popullit është i pavarur dhe i veçantë në kryerjen e funksionit.[937]

Avokati i Popullit i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve për shkeljet nga organet e administratës shtetërore dhe organet tjera dhe organizatat që kanë autorizime publike[938]. Kuvendi ka miratuar Ligjin e parë për Avokat të Popullit në vitin 1997, por me qëllim të largimit të mangësive dhe të krijohen garanci për pavarësinë e institucionit, ligji ishte ndryshuar dhe plotësuar në vitin 2003.[939]

Avokati i Popullit zgjidhet nga Kuvendi, por me emërim nga komisioni përkatës kuvendor, me shumicë të votave nga numri i plotë i deputetëve[940]. Avokati i Popullit ka mandat prej tetë viteve, me të drejtë për një zgjedhje të plotë[941]. Pozita nuk mund të lidhet me kryerjen e

[932] Njëlloj.
[933] Intervistë me Ixhet Memetin, Avokati i Popullit i RM-së, (interviste ballë për ballë), 3.7.2015
[934] Në përputhje me strukturën e kualifikimeve të të punësuarve, 63 kanë arsim të lartë, ndërsa 12 kanë arsim të mesëm. Prej tyre, 45 janë gra dhe 30 burra. Në institucionin Avokati i Popullit janë punësuar: 31 maqedonas, 31 shqiptarë, 2 romë, 3 serb, 2 boshnjak dhe nga një turk dhe kroat.
[935] Intervistë me Ixhet Memetin, Avokati i Popullit i RM-së zbatuar nga dr. Sllagjana Taseva më 3 korrik 2015.
[936] Intervistë me Ixhet Memetin, Avokati i Popullit i RM-së, (interviste ballë për ballë), 3.7.2015
[937] Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003, 114/2009, neni 3.
[938] Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/91, neni 77.
[939] Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003.
[940] Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003, 114/2009, neni 5.
[941] Njëlloj.

funksionit tjetër publik ose profesion ose anëtarësim në parti politike.[942]

Avokati i Popullit zgjidhet në bazë të kritereve të qarta profesionale, përfshirë edhe në bazë të përvojës paraprake të punës në fushën e mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve[943]. Ka kritere të ngjashme të zgjedhjes së zëvendësve të Avokatit të Popullit[944]. Personat e zgjedhur si zëvendës të Avokatit të Popullit duhet të zgjidhen nga të gjitha komunitetet në Republikën e Maqedonisë, por edhe sipas plotësimit të kritereve profesionale[945]. Rroga e Avokatit të Popullit është në nivel të njëjtë me rrogën e anëtarit të Qeverisë.[946]

Të punësuarit/stafi në zyrën e Avokatit të Popullit kanë status të nëpunësve shtetërorë dhe punësimi i tyre organizohet nga Agjencia e Administratës[947]. Avokati i Popullit ka të drejtë të vendosë për mënyrën e zbatimit të procedurës.[948]

Avokati i Popullit mund të largohet nga funksioni nëse ai vetë e kërkon atë; nëse është dënuar për vepër penale që rezulton me vuajtje me burg së paku prej gjashtë muajve; nëse në mënyrë mjekësore konfirmohet që ka humbur aftësinë psiko/fizike për kryerjen e funksionit të Avokatit të Popullit; nëse përfiton të drejtën për pension ose nëse i kryen punët në mënyrë joprofesionale, me anësi ose në mënyrë të papërgjegjshme.[949]

Avokati i Popullit ka për obligim të mbrojë qytetarët nga vonesa e pa arsyetueshme e procedurave gjyqësore ose veprimi joprofesional i gjykatave, por nuk guxon të ndalojë pavarësinë dhe individualitetin e gjykatësit. Avokati i Popullit nuk do të ndërmarr aktivitete në rastet për të cilat vijojnë procedura në gjyq, përveç në rastet e përmendura më lartë.[950]

9.1.3 PAVARËSIA (PRAKTIKA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle Avokati i Popullit është i pavarur në praktikë?

Sipas Raportit për përparim nga KE-ja për vitin 2013, Avokati i Popullit punon si organ i pavarur për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.[951]

Avokati i Popullit ishte kritikuar nga grupet për të drejtat e njeriut për shkak të shqyrtimit të incidentit nga 24 dhjetori 2014, kur gazetarë dhe deputetë ishin larguar nga seanca mbi buxhetin e Kuvendit[952]. Pasi Shoqata e Gazetarëve ka parashtruar ankesë, Avokati i Popullit ka deklaruar që nuk ka kompetencë për të vepruar, por ka reaguar në medie duke dënuar këtë lloj të sjelljes ndaj gazetarëve. Komiteti i Helsinkut, gjatë shqyrtimit të situatës, ka menduar që Avokati i Popullit ka pasur kompetencë dhe nuk ka arritur të mbrojë të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve. Pas incidentit, pavarësia e Avokatit të Popullit është

[942] Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003, 114/2009, neni 8.
[943] Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003, 114/2009, neni 6.
[944] Njëlloj.
[945] Njëlloj.
[946] Si dhe kryetari Trupit Punue të Kuvendit, kryetar i Gjykatës Supreme, Prokuror Publik, gjykatës në Gjykatën Kushtetuese, guvernator i Bankës Popullore të RM, Prokuror Publik, sekretar i Kuvendit dhe sekretar i Qeverisë.
[947] Ligji për Administratë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 27/2014, neni 14.
[948] Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003, 114/2009, neni 38.
[949] Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003, 114/2009, neni 9.
[950] Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003, 114/2009, neni 12.
[951] Komisioni Evropian, 2013: f. 9.
[952] Komiteti i Helsinkut për të Drejta të Njeriut i RM-së, *Raport special për seancën e 49-të të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, zhvilluar më 24.12.2012 – „Zhvillimet para dhe brenda Kuvendit,* (Shkup: Komiteti i Helsinkut për të Drejta të Njeriut i RM-së, 2013), f. 2 http://www.mhc.org.mk/reports/100# [qasur më1.6.2015].

vënë në pikëpyetje.[953]

Sipas Komitetit Ndërkombëtar Koordinues të Institucioneve Kombëtare për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Avokati i Popullit është në përputhje të pjesshme me Parimet e Parisit[954]. Gjashtë kriteret kryesore për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (IKDNj) që dalin nga Parimet e Parisit janë këto më poshtë: 1. „Sa më të gjera të mundshme" autorizime në bazë të standardeve për të drejta universale të njeriut përfshirë edhe përgjegjësinë e dyfishtë për promovimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut që i mbulojnë të gjitha të drejtat e njeriut; 2. Pavarësi nga Qeveria; 3. Pavarësi e garantuar me Kushtetutë ose me ligj; 3. Autorizime përkatëse për hetime; 5. Pluralizëm, përfshirë me anë të anëtarësimit dhe/ose bashkëpunim efektiv; dhe 6. Resurse përkatëse njerëzore dhe financiare.

Deri më tani, asnjë Avokati i Popullit në R. e Maqedonisë nuk është larguar nga funksioni para skadimit të mandatit, ndërsa vetëm Avokati i Popullit ekzistues është i ri zgjedhur. Nuk ka raste ku Avokati i Popullit është përfshirë në aktivitete politike ose në kryerjen e funksioneve tjera të ndaluara me ligj ose mbajtje të pozitave që do të mund të rrezikojnë institucionin.

QEVERISJA

9.2.1 TRANSPARENCA (E DREJTA)

Nota **100**

Në çfarë shkalle janë vendosur dispozitat me të cilat sigurohet gatishmëri e publikut për informata relevante për aktivitetet dhe procesin e vendimmarrjes së Avokatit të Popullit?

Avokati i Popullit është i obliguar të respektojë privatësinë dhe besueshmërinë e personave që dorëzojnë parashtresa.[955]

Avokati i Popullit paraqet raport vjetor në Kuvend më së voni deri më 31 mars çdo vit[956], me të cilin e informon Kuvendin për avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve dhe për respektimin e parimeve të mos-diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe përkatës të anëtarëve të komuniteteve[957]. Me ligjin është parashikuar që raporti vjetor duhet të publikohet dhe dorëzohet në medie, duke marrë parasysh faktorët e konfidencialitetit[958], ndërsa për çështjet e veçanta në punën mbi kompetencat, Avokati i Popullit mund të përgatit raporte të veçanta[959].

Avokati i Popullit përgatit raport vjetor për Mekanizmin Kombëtar të Parandalimit dhe ka për obligim të publikojë dhe shpërndajë[960]. Raporti vjetor ka të bëjë me kompetencat e mekanizmit kombëtar të parandalimit për vizitë, raporte dhe dhënie të rekomandimeve për

[953] Komiteti i Helsinkut për të Drejta të Njeriut i RM-së, *Raport vjetor për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë, janar 2013,* (Shkup: Komiteti i Helsinkut për të Drejta të Njeriut i RM-së, 2013), f. 3. E gatshme në: http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/306/Monthly_Report_JANUARY_2013.pdf [qasur më1 qershor 2015]

[954] Akreditimi nga Komiteti Ndërkombëtar Koordinues i Institucioneve Shtetërore për Promovim dhe Mbrojtje të të Drejtave të Njeriut, statusi i akreditimit nga 28 janar 2014 http://www.ohchr.org/Documents/Countries/NHRI/Chart_Status_NIs.pdf [qasur më5 qershor 2015

[955] Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003, 114/2009, neni 18.

[956] Rregullore për Punë e Avokatit të Popullit, neni 56.

[957] Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003, 114/2009, neni 36.

[958] Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003, 114/2009, neni 36.

[959] Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003, 114/2009, neni 37.

[960] Rregullore për punë e Avokatit të Popullit, neni 20.

organet kompetente, organizata dhe institucione në lidhje me kushtet për realizimin e të drejtave të personave të cilët lirinë e kanë të kufizuar.[961]

Avokati i Popullit ka për obligim të njoftojë publikun për aktivitetet e tij me anë të internet faqes, në formë të deklaratave për publik dhe konferenca për shtyp, raporte vjetore dhe mënyrave të tjera[962]. Informatat duhet të publikohen duke respektuar të drejtat e mbrojtjes së privatësisë së parashtruesve të parashtresave dhe tjerave.[963]

Në internet faqen e Avokatit të Popullit publikohen informata me karakter të përgjithshëm, siç janë: korniza ligjore, struktura organizative, kompetenca dhe metoda të punës, shërbime të qytetarëve, kontakt, drejtime si të parashtrohen parashtresat dhe informata për punë të lëndëve.[964]

Avokati i popullit dhe zëvendësavokati i Popullit duhet të dorëzojnë fletë të hollësishme për gjendjen pronësore[965]. Nuk ka dispozita ligjore në lidhje me përfshirjen e publikut në aktivitetet e Avokatit të Popullit (për shembull, me anë të konsultimeve publike ose me anë të themelimit të këshillave publikë ose komisioneve këshillimore).

9.2.2 TRANSPARENCA (PRAKTIKA)

Nota 100

Në çfarë shkalle ka transparencë në aktivitetet dhe procesin e vendimmarrjes së Avokatit të Popullit në praktikë?

Avokati i Popullit siguron qasje në informata të llojit të ndryshëm për publikun, siç janë: informata të përgjithshme për institucionin dhe aktivitetet përkatëse. Në faqen e internetit janë publikuar informata për shtrirjen e punës së tyre[966], raporte vjetore[967], raporte të veçanta[968] dhe mendime. Informatat publikohen në faqen e internetit të tre gjuhë, maqedonisht[969], shqip[970] dhe anglisht[971]. Internet faqja rregullisht përditësohet me informata për punën me parashtresa[972], mekanizmin kombëtar parandalues[973] dhe aktivitete promovuese dhe ndërkombëtare[974].

Avokati i Popullit me kohë publikon informata, ndonëse nuk ka obligim ligjor për atë[975], dhe publike janë edhe të dhënat për numrin e parashtresave të pranuara, ato ekzistuese dhe të përpunuara si dhe përshkrim i rasteve.

Sipas "*Raportit në hije për mosdiskriminimin",* disa përfaqësues të zyrave rajonale besojnë që themelimi i zyrave rajonale e ka afruar Avokatin e Popullit te publiku dhe kjo ka mundësuar

961 Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003, 114/2009, neni 31-б.
962 Rregullore për punë e Avokatit të Popullit, neni 54
963 Rregullore për punë e Avokatit të Popullit, neni 54.
964 Rregullore për punë e Avokatit të Popullit, neni 55.
965 Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008 dhe 145/2010, neni 33 dhe 34.
966 http://ombudsman.mk/EN/ombudsman_work/field_of_work.aspx [qasur më 15 qershor 2015].
967 http://ombudsman.mk/EN/annual_reports.aspx [qasur më 15 qershor 2015].
968 http://ombudsman.mk/EN/special_reports.aspx [qasur më 15 qershor 2015].
969 http://ombudsman.mk/MK/default.aspx [qasur më 15 qershor 2015].
970 http://ombudsman.mk/SQ/default.aspx [qasur më 15 qershor 2015].
971 http://ombudsman.mk/EN/default.aspx [qasur më 15 qershor 2015].
972 http://ombudsman.mk/EN/ombudsman_work/practice/information.aspx [qasur më 15 qershor 2015].
973 http://ombudsman.mk/EN/submit_a_complain.aspx [qasur më 15 qershor 2015].
974 http://ombudsman.mk/EN/default.aspx [qasur më 15 qershor 2015].
975 Intervistë me Ixhet Memetin, Avokati i Popullit i RM-së, (interviste ballë për ballë), 3.7.2015

që të rritet numri i parashtresave[976]. Megjithatë, nuk është e qartë nëse rritja e numrit të parashtresave është për shkak të rritjes së pranisë së zyrave të Avokatit të Popullit, ose për shkak të përkeqësimit të drejtave dhe lirive të njeriut.

Avokati i Popullit dhe zëvendësit i publikojnë fletat e tyre të anketimit në internet faqen e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK)[977].

9.2.3 LLOGARIDHËNIA (E DREJTA)

Nota **100**

Në çfarë shkalle ka dispozita për sigurim që Avokati i Popullit duhet të njoftojë dhe të merr përgjegjësi për veprat e tij?

Avokati i Popullit është përgjegjës para Kuvendit, që duhet të shqyrtojë raportin në seancë publike në të cilën marrin pjesë përfaqësues të Qeverisë[978]. Raporti vjetor është dokument publik dhe i përmban zbulimet në kuptim të respektimit të të drejtave dhe lirive të qytetarëve, përshkrim të problemeve kryesore, të dhënave statistikore, informata për procedura të përpunuara dhe ekzistuese të parashtresave, përshkrim të rasteve të veçanta të shkeljeve, si dhe raportim mbi aktivitetet tjera të Avokatit të Popullit.[979] Gjithashtu, Avokati i Popullit mund të parashtrojë raporte të veçanta tek organet e autoriteteve lokale.

Aktivitetet e Avokatit të Popullit nuk janë lëndë e procedurave gjyqësore.

Mekanizmat për llogaridhënie të institucioneve publike vlejnë për personelin e Avokatit të Popullit[980], përfshirë edhe Ligjin për mbrojtje të informatorëve.

9.2.4 LLOGARIDHËNIA (PRAKTIKA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle Avokati i Popullit duhet të njoftojë dhe të bartë përgjegjësi për procedurat e veta në praktikë?

Avokati i Popullit me kohë i dorëzon raportet e veta në Kuvend, nëse raportet diskutohen në seanca të Kuvendit me përfaqësues qeveritar.[981]

Përveç raporteve vjetore, Avokati i Popullit publikon mbi 30 raporte tematike që kanë të bëjnë me diskriminim dhe mungesë të përfaqësimit të drejtë, burgje, shëndet, fëmijë, arsim, mbrojtje sociale, sigurim pensional dhe invalidor dhe policinë.[982]

Avokati i Popullit parashtron informata në çdo tre muaj në Qeveri për numrin dhe llojin e kërkesave të dorëzuara nga Avokati i Popullit tek organet e pushtetit. Kjo kontribuon me përshpejtimin e procedurave të caktuara të Avokatit të Popullit. Megjithatë, ka organe

[976] Qendra për Hulumtim dhe Krijim të Politikave (QHKP), *Raporti në hije për mos-diskriminim* (Shkup: QHKP, 2012), f. 27.
[977] http://www.dksk.org.mk/imoti_2/index. [qasur më 15 qershor 2015].
[978] Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003, 114/2009, neni 36.
[979] Rregullore për punë e Avokatit të Popullit, neni 56.
[980] Ligji për Parandalimin e Korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010.
[981] Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Komisioni për Sisteme Politike dhe Marrëdhënie Ndëretnike, nr. 12-2429, 1 korrik, 2014 , http://www.sobranie.mk/materialdetails.nspx?materialId=e1297e5b-14f9-4591-88ec-b0c07a39e3ba [qasur më1 qershor 2015].
[982] Ixhet Memeti, 2012, *Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë: Karakteri Institucional,* (Shkup: Avokati i Popullit i RM-së, 2012), f. 209. http://studiorum.org.mk/evrodijalog/16/pdf/Evrodijalog_br_16_4_I-Memeti_ENG.pdf [qasur më1 qershor 2015].

qeveritare që nuk bashkëpunojnë ose nuk pengojnë punën e Avokatit të Popullit.[983]

Avokati i Popullit rregullisht e informon publikun për punën e tij dhe takohet me qytetarë, që kontribuon për mbikëqyrjen publike mbi aktivitetet e Avokatit të Popullit.[984]

Deri më tani nuk ka raste të "informatorëve" në kuadër të Zyrës së Avokatit të Popullit[985]. Ligji për mbrojtjen e informatorëve nga nëntori 2015 parashikon kompetencë për Avokatin e Popullit në kuptim të paraqitjes së jashtme të mbrojtur.[986]

9.2.5 MEKANIZMI PËR INTEGRITET (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle janë vendosur dispozita për sigurim të integritetit të Avokatit të Popullit?

Nuk ka kod të shkruar të veprimeve për Zyrën e Avokatit të Popullit, por në përputhje me ligjin, Avokati i Popullit deklaron që funksionin do të zbatojë në mënyrë të vetëdijshme dhe me përgjegjësi dhe do të respektojë Kushtetutën dhe ligjet[987]. Më tutje, funksioni i Avokatit të Popullit nuk mund të ndërlidhet me funksion tjetër publik, profesion ose me anëtarësim në parti politike.[988]

Personeli i Avokatit të Popullit, që ka statusin e nëpunësit shtetëror, është lëndë e Kodit etik të nëpunësve shtetërorë[989]. Kodi përmban rregulla të gjera që kanë të bëjnë me parimet e drejtësisë, integritetit profesional, efikasitetin, efektivitetin dhe dedikimin e kryerjes së detyrës së tyre zyrtare. Shkeljet e Kodit janë bazë për ndërprerje të marrëdhënies së punës[990]. Në Kodi janë përfshirë parimet që kanë të bëjnë me konfliktin e interesave, që vlejnë për stafin e Avokatit të Popullit[991]. Personat e zgjedhur zyrtarë dhe personat e emëruar (përfshirë edhe Avokatin e Popullit dhe zëvendësit) janë lëndë e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave. Nuk ka rregulla të veçanta për dhurata për personalin e avokatit të Popullit, por ata duhet të respektojnë rregullat për dhurata të përcaktuara për nëpunësit shtetërorë[992]. Ngjashëm me këtë, stafi i Avokatit të Popullit është lëndë e kufizimeve të njëjta pas punësimeve sikur te nëpunësit tjerë shtetërorë.[993]

Avokati i Popullit është i obliguar të respektojë privatësinë dhe besueshmërinë e informatave nga parashtresat[994]. Avokati i Popullit është i obliguar të veprojë sipas parashtresave në mënyrë të paanshme, efikase dhe me përgjegjësi.[995] Avokati i Popullit duhet të dërgojë njoftim te parashtruesi i parashtresës në afat prej 15 ditëve pas pranimit të parashtresës, pa dallim a do të fillojë procedurë për rastin përkatës.[996]

983 Avokati i Popullit , 2014: f. 150.
984 Intervistë me Ixhet Memetin, Avokati i Popullit i RM-së, (interviste ballë për ballë), 3.7.2015
985 Njëlloj.
986 Ligji për mbrojtjen e informatorëve, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 196/2015.
987 Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003, 114/2009, neni 7.
988 Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003, 114/2009, neni 8.
989 Kodi i sjelljes së nëpunësve shtetërorë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 129/2011.
990 Kodi i sjelljes së nëpunësve Shtetërorë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 129/2011, 1, neni 1 (1).
991 Kodi i sjelljes së nëpunësve shtetërorë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 129/2011, neni 9.
992 Nëse personit zyrtar i është ofruar një dhuratë lidhur me kryerjen e detyrës publike, personi zyrtar është i obliguar të refuzojë, të regjistrojë identitetin e ofruesit, dhe nëse dhurata është që nuk mund të kthehet, duhet të paraqitet tek organi kompetent në afat prej 48 orësh", Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 70/2007, 114/2009, 128/2009, neni 16.
993 "Personi zyrtar nuk guxon që në afat të mandatit të tij dhe në afat prej pesë viteve pas përfundimit të mandatit të përfitojë të drejta mbi subjektin që ka qenë në mbikëqyrje të tij/saj ose marrëdhënie të kontaktuar".
994 Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003, 114/2009, neni 18.
995 Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003, 114/2009, neni 17.
996 Ligji mbi Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003, 114/2009, neni 20 dhe 22.

9.2.6 MEKANIZMA PËR INTEGRITET (PRAKTIKA)

Nota 75

Në çfarë shkalle është siguruar integriteti i Avokatit të Popullit në praktikë?

Integriteti i Avokatit të Popullit është siguruar me anë të procesit të emërimit nga ana e Kuvendit. Në praktikë, nëse një zëvendësi të Avokatit të Popullit nuk i lejohet të veprojë për ndonjë proces për shkak të konfliktit të interesave, Avokati i Popullit merr vendimin se cili prej zëvendësve tjerë të Avokatit të Popullit do të përpunojë rastin[997].

Mekanizmat për integritet funksionojnë mirë, ndërsa rregullat që përcaktojnë konflikt të interesave dhe pranim të dhuratave respektohen tërësisht nga të punësuarit në zyrën e Avokatit të Popullit[998]. Nuk ka shembuj për shkelje të Kodit të veprimit nga të punësuarit e Avokatit të Popullit.[999]

Rastet e mbyllura klasifikohen sipas llojit të rastit dhe sipas numrit të dosjes në skeda të posaçme. Sipas kësaj, Avokati i Popullit çdo vit miraton akt të brendshëm me të cilin rregullohet se cilit raste kanë vlerë të përhershme, dhe cilat duhet të ruhen deri në periudhë të caktuar kohore[1000].

ROLI

9.3.1 HETIMI

Nota 75

Në çfarë shkalle Avokati i Popullit është aktiv dhe efektiv në përballimin e parashtresave nga publiku?

Procedura për parashtrimin e parashtresave te Avokati i Popullit është e thjeshtë. Secili qytetar mund të parashtrojë parashtresë tek Avokati i Popullit (personalisht ose me anë të përfaqësuesit)[1001]. Parashtresa mund të dorëzohet personalisht ose me postë, faks ose postë elektronike në Zyrën e Avokatit të Popullit ose të dorëzohet gojarisht në zyrë. Parashtrimi i parashtesave është falas. Parashtresa duhet të jetë e kuptueshme dhe lehtë të lexohet dhe të plotësojë disa kushte të caktuara[1002], mund të jetë në çdo gjuhë ose alfabet që përdor qytetari[1003]. Ka një formular të gatshëm për parashtrimin e parashtresave dhe përdorimi i formularit nuk është i obligueshëm[1004]. Nëse parashtresa nuk mund të kuptohet, dhe nuk i përmban faktet dhe dëshmitë e nevojshme, Avokati i Popullit nga parashtruesi i parashtesës

997 Intervistë me Ixhet Memetin, Avokati i Popullit i RM-së, (interviste ballë për ballë), 3.7.2015
998 Intervistë me Uranija Pirovskën, drejtore ekzekutive e Komitetit të Helsinkut të Republikës së Maqedonisë, ish e punësuar në Zyrën e Avokatit të Popullit (interviste ballë për ballë), 10.11.2015
999 Intervistë me Ixhet Memetin, Avokati i Popullit i RM-së, (interviste ballë për ballë), 3.7.2015
1000 Intervistë me Uranija Pirovskën, drejtore ekzekutive e Komitetit të Helsinkut të Republikës së Maqedonisë, ish e punësuar në Zyrën e Avokatit të Popullit (interviste ballë për ballë), 10.11.2015
1001 Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003, 114/2009, neni 13, parag. 1.
1002 Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003, 114/2009, neni 16. Parashtresat duhet të jetë nënshkruar dhe të përmbajë informata për parashtruesin (emri, mbiemri, adresa, telefoni, etj.); Gjithashtu, duhet të përmbajë rrethanat, faktet dhe dëshmitë në të cilat bazohet (shkarkim, vendim, ankesë, konkluzion, deklaratë, vërtetim, mendim, etj.); organi, gjegjësisht organizata, si dhe personi zyrtar për të cilin vlen; Gjithashtu, duhet të theksohet akti (vendim, deklaratë, miratim, etj.) me të cilën është thyer e drejta; Në fund, parashtresa duhet të përmbajë barna ligjore që i ka zbatuar parashtruesi, nëse janë.
1003 Rregullore për punë e Avokatit të Popullit, neni 33.
1004 http://ombudsman.mk/en/search/673/how_can_i_submit_a_complaint_.aspx [qasur më9 qershor 2015].

do të kërkojë sqarim në periudhë prej 8 deri 30 ditë.[1005]

Avokati i Popullit duhet të respektojë besueshmërinë dhe fshehtësinë e të dhënave të parashtruesit të parashtresës si dhe të sigurojë që asnjë prej aktiviteteve nuk do të shkaktojë pasoja negative për parashtruesin e parashtresës nga organi që ai/ajo pohon se ka shkelur të drejtat e tij/saj.[1006]

Avokati i Popullit, çdo vit, pranon gjithnjë e më shumë parashtresa.[1007]

Numri i parashtresave të pranuara *Burim: Raporte vjetore*						
2008	**2009**	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**
3.022	3.632	4.043	4.256	4.346	3.780	4.249

Në vitin 2014, Avokati i Popullit ka pranuar 4.995 parashtresa, prej të cilëve 746 janë transferuar nga viti paraprak[1008]. Në 72, ose 1.77% të rasteve, Avokati i Popullit ka ndërmarrë aktivitete ligjore, 72 ose 1.77% të rasteve janë zgjedhur në mënyrë tjetër ndërsa me 6 ose 0.14% të rasteve kanë qenë anonime[1009]. Numri më i madh i ankesave kanë pasur lidhje me sistemin gjyqësor (901 ose 21.20%); të drejta të konsumatorëve që kanë lidhje me komunale dhe shpenzime tjera (486 ose 11.43%) dhe financa dhe operacione financiare (407 ose 5.58%). [1010]Sipas vendbanimit, pjesa më e madhe e parashtresave janë dorëzuar në Shkup[1011]. Jashtë kryeqytetit, numri më i madh i parashtresave vijnë nga vendet që gjenden zyrat rajonale të Avokatit të Popullit.[1012]

Zyra e Avokatit të Popullit ka rol aktiv si Mekanizëm Kombëtar i Parandalimit sipas Protokollit fakultativ ndaj Konventës kundër torturës

Niveli i ndjekjes së rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga organet shtetërore është i lartë, diku rreth 80%.

Zyra e Avokatit të Popullit mund të fillojë procedura edhe me iniciativë personale nëse vlerëson që janë shkelur të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve ose janë shkelur parimet e mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe ligjore të anëtarëve të komuniteteve në organe[1013]. Megjithatë, sipas raportit vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2014, nga gjithsej 4.249 raste, vetëm 27 ose 0.6% të rasteve janë hetuar në iniciativë të Avokatit

[1005] Rregullore për Punë e Avokatit të Popullit, neni 34.
[1006] Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003, 114/2009, neni 18.
[1007] http://www.independent.mk/articles/15789/Macedonian+Ombudsman+More+and+More+Citizens+Ask+for+Institution%27s+Help#sthash.8mWx19aF.dpuf [qasur më9 qershor2015].
[1008] Nga procedurat e zbatuara për 4.062 parashtresa, në 878 parashtresa ose 21,61% të rasteve nuk është filluar procedurë, për 1.920 raste ose 47,27% të rasteve procedura është pezulluar, ndërsa për 1.114 ose 27,42% të parashtresave, Avokati i Popullit ka përcaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive, ndërsa intervenimet e Avokatit të Popullit janë pranuar.
[1009] Avokati i Popullit , 2014: f. 149.
[1010] Pastaj vijojnë: të marrëdhënieve për punë 299 ose 7,04%; mbrojtje sociale 279 ose 6,57%; të institucioneve ndëshkimore-përmirësuese dhe institucioneve përmirësuese për të mitur 274 ose 6,45%; të fushës pronësore-ligjore 239 ose 5,62%; sigurim pensioni ose invalidor 221 ose 5,20%; nga fusha e mbrojtjes së të drejtave në procedura policore 173 ose 4,07%; urbanizëm dhe ndërtimtari 168 ose 3,95%; mbrojtje shëndetësore 125 ose 2,94%; mbrojtje të të drejtave të fëmijëve 124 ose 2,92%; statusi i qytetarëve dhe të drejtave tjera të brendshme 85 ose 2,00%; të drejta zgjedhore 78 ose 1,84%; mos-diskriminim dhe përfaqësim i drejtë dhe përkatës 66 ose 1,55%; çështje banesore 36 ose 0,85%; mjedis jetësor 26 ose 0,61%; arsim, shkencë dhe kulturë 21 ose 0,49%; persona me aftësi të kufizuar 11 ose 0,26%; si dhe fusha tjera për të cilat Avokati i Popullit i ka pranuar 230 ose 5,41% të parashtresave. Avokati i Popullit , *Raporti vjetor për respektimin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirove të njeriut 2014,* f. 123, 124.
[1011] Ose 1.665, pastaj janë parashtresa nga parashtrues nga: Manastiri, Kumanova, Kërçova, Tetova, Shtipi, Ohri dhe komunitete tjera urbane si dhe nga vendet tjera.
[1012] Avokati i Popullit , 2014: f.143
[1013] Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 60/2003, 114/2009, neni 13, parag. 2.

të Popullit[1014]. Avokati i Popullit ka deklaruar që ka nisur procedurë, me iniciativë personale, për rastin e përgjimit të paligjshëm, për të cilën ka dorëzuar pyetje te Zyra e Prokurorit Publik, Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK), Agjencia për Komunikime Elektronike dhe në Kuvend, përfshirë edhe se kush ka dhënë urdhërin, kush ka kryer mbikëqyrjen dhe nëse të punësuarit që kanë bërë përgjimin kanë respektuar dhe plotësuar ligjin për këtë aktivitet. Ende pritet përgjigje nga institucionet.[1015]

Sipas Komitetit të Helsinkut për të Drejta të Njeriut[1016], të anketuarit mendojnë që Avokati i Popullit (27%) është institucion në të cilin mund të drejtohen për mbrojtje të të drejtave të tyre[1017]. Ish deputetja, Suzana Saliu, në vitin 2013, kishte qëndrimin që rritja e numrit të parashtresave tek Avokati i Popullit e tregon besimin e qytetarëve në institucionin Avokati i Popullit .[1018] Mbetet çështja nëse kjo është e vërtetë ose ka një mbrapsje në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut?[1019]

Zyra e Avokatit të Popullit ka program në teren për rritjen e vetëdijes dhe punë arsimore dhe këshillimore.[1020]

9.3.2 PROMOVIMI I PRAKTIKAVE TË MIRA

Nota **75**

Në çfarë shkalle është aktiv dhe efektiv Avokati i Popullit në rritjen e vetëdijes te Qeveria dhe publiku për standardet e veprimit etik?

Gjatë viteve të fundit, Avokati i Popullit i ka dedikuar vëmendje të veçantë edukimit të administratës shtetërore për rëndësinë e respektimit të të drejtave të qytetarëve. Ishin organizuar disa punëtori për parashtresa të organeve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile.[1021]

Raportet vjetore dhe të posaçme përmbajnë detaje dhe në masë të madhe japin pasqyrë të punës së institucioneve që shqyrtohen. Në raste të veçanta, rekomandimet, si dhe vërejtjet e përgjithshme janë prezantuar para institucioneve relevante.[1022]

Rekomandimet në masë të madhe nuk zbatohen në mënyrë përkatëse, ndërsa Avokati i Popullit nuk posedon resurset e mjaftueshme për punë me institucionet me qëllim të ndihmojë në zbatimin e rekomandimeve. Avokati i Popullit dhe Kuvendi nuk bashkëpunojnë mirë në lidhje me raportet vjetore të parashtruara nga Avokati i Popullit. Nuk ka informata

[1014] http://ombudsman.mk/upload/Godisni%20izvestai/GI-2014/GI%202014.pdf [qasur më 15 qershor 2015].

[1015] http://www.independent.mk/articles/15789/Macedonian+Ombudsman+More+and+More+Citizens+Ask+for+Institution%27s+Help#sthash.8mWx19aF.dpuf [qasur më9 qershor 2015].

[1016] Hulumtim i zbatuar në sajë të projektit: Rritja e transparencës dhe promovimi i sundimit të së drejtës me mbikëqyrje dhe njoftim për shkelje të të drejtave të njeriut në RM të zbatuar nga Komiteti i Helsinkut për të Drejtat e Njeriut të RM dhe mbështetur nga Fondacioni Shoqëri e Hapur Maqedoni, instituti për Shkenca Shoqërore dhe Humaniste – Shkup, ka zbatuar hulumtim empirik mbi mendimin publik për banorët e tetë rajoneve të RM-së, nga 9 deri 30 dhjetor 2014.

[1017] Komiteti i Helsinkut për të Drejta të Njeriut në Republikën e Maqedonisë, *Hulumtim për kuptimin qytetar dhe vetëdije për të drejtat e njeriut dhe mekanizmat mbrojtës në rast të shkeljes së tyre*, (Shkup: Komiteti i Helsinkut për të Drejta të Njeriut në Republikën e Maqedonisë, 2015), f. 75. http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/903/Istrazuvanje_Razbiranje_na_covekovi_prava_MK_EN_AL.pdf [qasur më 15 qershor 2015].

[1018] Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Komisioni për Sisteme Politike dhe Marrëdhënie Ndëretnike, nr. 12-1813/, 9 maj 2013 file:///C:/Users/Dona/Downloads/izvestaj_naroden_pravobranitel.pdf [qasur më 15 qershor 2015].

[1019] Kenan Hasip, deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, Komisioni për Sisteme Politike dhe Marrëdhënie Ndëretnike, nr. 12-1813/, 9 maj 2013 http://www.sobranie.mk/materialdetails.nspx?materialId=e1297e5b-14f9-4591-88ec-b0c07a39e3ba

[1020] Ixhet Memeti, 2012: f. 209.

[1021] Ixhet Memeti, 2012: f. 209.

[1022] Avokati i Popullit , 2014: f. 132.

kthyese nga Kuvendi dhe nga trupat punuës të Kuvendit.[1023]

REKOMANDIME:

R1. Ligji për Avokatin e Popullit duhet të ndryshohet dhe plotësohet me qëllim që të sigurohet përputhje e plotë me Parimet e Parisit që kanë të bëjnë me organet e të drejtave të njeriut, veçanërisht zgjerimin e autorizimeve të Zyrës së Avokatit të Popullit për promovimin e të drejtave të njeriut.

R2. Janë të nevojshme resurse të mëdha njerëzore dhe financiare për Zyrën e Avokatit të Popullit për të realizuar kompetencat.

R3. Qeveria dhe Kuvendi duhet të krijojnë një dispozitë ligjore me të cilën ndjekja e rekomandimeve të Avokatit të Popullit do të jetë e detyrueshme, dhe të prezantojnë sanksione përkatëse për mosndjekjen e rasteve.

[1023] Intervistë me Ixhet Memetin, Avokati i Popullit i RM-së, (interviste ballë për ballë), 3.7.2015

10. KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

PËRMBLEDHJE

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) është përgjegjës për zbatimin e tre ligjeve më të rëndësishme kundër korrupsionit[1024], dhe në kohën e njëj të KSHPK-ja nuk ka mjete për realizimin e kompetencave të saj. Kodi për veprim i anëtarëve të KSHPK-së nuk është zhvilluar. Sipas ligjit, roli i KSHPK-së është të koordinojë me politikat kundër korrupsionit dhe mekanizmat parandalues të anti-korrupsionit. Në praktikë, nuk është kompetente për koordinim të aktiviteteve të plota të anti-korrupsionit dhe nuk ka fuqi të plotë për mbikëqyrje të institucioneve, siç janë Ministria e Punëve të Brendshme ose Zyra e Prokurorit Publik. KSHPK-ja konsiderohet si jo-transparente. Nuk ka aktivitet të mirë për ndjekjen e rasteve, ndërsa bashkëpunimi me palët e interesuara është i dobët.

Nuk ka kushte të posaçme për testimin plotësues të integritetit të anëtarëve të KSHPK-së dhe Sekretariatit. Kontrolli i fletave anketuese dhe mbikëqyrja e konfliktit të interesave janë aktivitete kryesore të KSHPK-së, por këto përgjegjësi bëhen në mënyrë të rastësishme. KSHPK-ja ndërmerr aktivitete të caktuara arsimore, por nuk e mat ndikimin e tyre. Besimi publik në pavarësinë dhe paanësinë e KSHPK-së është i ultë.

NOTA E PËRGJITHSHME E SHTYLLËS: 40,2/100

DIMENSIONI	TREGUESI	LIGJI	PRAKTIKA
Kapaciteti 37,5/100	Resurset	50	25
	Pavarësa	50	25
Qeverisja 41,6/100	Transparenca	50	50
	Llogaridhënia	25	25
	Integriteti	50	50
Roli 41,6/100	Parandalimi	50	
	Arsimi	50	
	Hetimi	25	

[1024] Ligji për parandalim të korrupsionit, Ligji për parandalim të konfliktit të interesave dhe Ligji për lobim.

Nota për shtyllën sipas të drejtës dhe praktikës.



STRUKTURA DHE ORGANIZIMI

KSHPK-ja është themeluar nga Kuvendi në nëntor 2002 si institucion i pavarur dhe autonom. Funksionet kryesore janë parandalimi i korrupsionit dhe arsimi mbi anti-korrupsionin si dhe ngritja e vetëdijes publike.

KSHPK-ja përbëhet nga 7 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi me mandat prej 4 viteve, me të drejtë të ri-zgjedhjes. Anëtarët e KSHPK-së gëzojnë status të nëpunësve të emëruar dhe përgjigjen para Kuvendit.

Sekretariati i KSHPK-së drejtohet nga Sekretari i përgjithshëm dhe përgjigjet për çështje administrative dhe teknike. Të punësuarit në Sekretariatin e KSHPK-së kanë status zyrtar të nëpunësve shtetërorë.

VLERËSIMI

KAPACITETI

10.1.1 RESURSET (E DREJTA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle janë vendosur dispozita që i sigurojnë agjencitë për anti-korrupsion me resurse përkatëse për zbatimin efektiv të obligimeve?

Resurset financiare për funksionimin e KSHPK-së janë të siguruara nga buxheti shtetëror[1025]. KSHPK-ja propozon buxhetin personal në MF[1026]. Buxheti shtetëror është fleksibil dhe kryen

[1025] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 46/2004, neni 48-b.
[1026] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, neni 49.

rishpërndarje gjatë vitit fiskal. Megjithatë, nuk ka garanci zyrtare për stabilitetin fiskal të KSHPK-së në afat më të gjatë.

10.1.2 RESURSET (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle KSHPK-ja ka resurse përkatëse për arritjen e qëllimeve në praktikë?

KSHPK-ja nuk ka resurse të mjaftueshme për realizimin e detyrimeve si fuqi udhëheqëse në luftën kundër korrupsionit[1027]. Mungesa e resurseve përkatëse mund të shënojë edhe mungesë të vullnetit politik për përforcimin e KSHPK-së.[1028]

Buxheti i KSHPK-së është rritur gjatë viteve, por është mjaft vetëm për rroga të punësuarve dhe shpenzime pune dhe nuk lejon zbatimin e mundësive tjera ligjore, siç janë vizita studimore dhe angazhimin e ekspertëve[1029], ndërsa organogrami i KSHPK-së është plotësuar nën 50%, me 16 të punësuar nga gjithsej 41 të parashikuar. Sipas kësaj, ka mendim që Qeveria duhet të japë më tepër mjete nëse dëshiron që lufta kundër korrupsionit të jetë në krye të agjendës.[1030]

Në vitin 2012, buxheti i KSHPK-së ka qenë 356.980 EUR.[1031]Në vitin 2013, pas rebalancimit të buxhetit, shuma ka qenë 400.681 EUR. Donatorët ndërkombëtarë, gjithashtu e plotësojnë buxhetin e KSHPK-së. Për shembull, mjete plotësuese për zbatimin e projektit arsimor për "aktivitetet e anti-korrupsionit për nxënësit e arsimit fillor" janë bërë nga UNDDP, OSCE, dhe nga KE-ja.[1032]

Punësimi i personelit të Sekretariatit të KSHPK-së bëhet në përputhje me Ligjin për nëpunës shtetërorë (LNSH) dhe procedura është e njëjtë edhe për të gjithë nëpunësit e organeve të administratës publike dhe komunave[1033]. Kandidatët obligohen të kalojnë një provim me gojë që përbëhet nga pyetje me zgjedhje të shumë përgjigjeve, që kanë të bëjnë me dispozitat themelore të tre ligjeve të janë kompetencë e KSHPK-së. Niveli adekuat i këtij testi është vënë në pikëpyetje nga ana e raporteve të përparimit të KE-së.[1034]

Për disa pozita të punës, nëpunësit shtetërorë obligohen të kalojnë teste psikologjike, që gjithashtu përfshijnë testim të integritetit të tyre[1035]. Përveç kësaj, nuk ka kontrolle të veçanta etike të kandidatëve që aplikojnë për punësim në KSHPK.

Të gjithë nëpunësit shtetërorë, përfshirë edhe ato të Sekretariatit të KSHPK-së, kanë të drejtë për trajnim profesional dhe përvetësim sipas nevojave të institucionit[1036]. Nëpunësit shtetëror marrin trajnime gjenerike[1037], por nuk ka program të veçantë për zhvillim të karrierës dhe trajnimit të nëpunësve shtetërorë në Sekretariatin e KSHPK-së.

[1027] KSHPK raport vjetor 2010, f. 4.
[1028] Njëlloj, f. 34.
[1029] Njëlloj.
[1030] Intervistë me Emina Nuredinoskën, shefe e Seksionit, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, intervistë me postë elektronike më 3.10.2014 .
[1031] KSHPK, Raporti Vjetor për 2012 (Shkup: KSHPK, 2012), f. 9. http://www.dksk.org.mk/images//godisenizvestaj2012.pdf [qasur më 3.10.2014].
[1032] Njëlloj.
[1033] Ligji për nëpunës shtetërorë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 59/2000, 112/2000, 34/2001, 103/2001, 43/2002, 98/2002, 17/2003,40/2003, 85/2003, 17/2004, 69/2004, 81/2005, 61/2006, 36/2007, 161/2008, 6/2009, 114/2009, 35/10, 167/10, 36/11, 6/12, 24/12, 15/13, 82/13 dhe 106/13.
[1034] Komisioni Evropian, 2014: f. 8.
[1035] Njëlloj.
[1036] Njëlloj.
[1037] Njëlloj.

10.1.3 PAVARËSIA (E DREJTA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle agjencitë e anti-korrupsionit janë të pavarura dhe të liruara nga nënshtrimi i aktorëve të jashtëm?

KSHPK-ja është organ i pavarur[1038], me kompetencë të përcaktojë masat që do të ndërmarrë për parandalimin e korrupsionit në trupat shtetërorë dhe të parandalojë konflikt të interesave. Ka një përgjegjësi të plotë për Programin shtetëror për parandalim dhe shtypje të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.[1039]

Anëtarët e KSHPK-së janë persona zyrtarë të emëruar nga Kuvendi me mandat prej katër viteve, me të drejtë të rizgjedhjes vetëm një herë. Anëtarët e KSHPK-së zgjedhjet nga rendi i personave të dalluar profesionistë në fushën e të drejtës, financave dhe luftës kundër korrupsionit. Nga anëtarët e tyre, KSHPK-ja zgjedh kryetarin me mandat prej një viti, me të drejtë të rizgjedhjes edhe një herë.[1040]

Në kuptim të përzgjedhjes së anëtarëve të KSHPK-së, Kuvendi publikon shpallje dhe gjatë procesit të emërimeve duhet të merret parasysh parimi i përfaqësimit të drejtë dhe përkatës i anëtarëve të komuniteteve të Republikës së Maqedonisë. Shpallja publikohet në Gazetë Zyrtare dhe në së paku dy gazeta ditore (një në gjuhën maqedonase dhe një në gjuhën të dytë që e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare tjetër përveç gjuhës maqedonase).[1041]

Sipas Rregullores për punë të Kuvendit, Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve duhet të shqyrtojë dhe të diskutojë për listën e kandidatëve dhe biografitë e tyre, por në praktikë kjo nuk ndodh shpesh[1042]. Shumica vendos sipas një liste të përgatitur paraprakisht, ndërsa procedura është e njëjtë për gjitha të emërimet e nëpunësve tjerë.[1043]

Një person mund të emërohet për anëtarë të KSHPK-së nëse është qytetar i Republikës së Maqedonisë, me vendbanim të përhershëm në shtet, me arsim të lartë në fushën e të drejtës dhe financave, përvojë në luftën kundër korrupsionit ne profesionin dhe së paku tetë vite përvojë pune.[1044]

Kryetari i KSHPK-së emërohet nga anëtarët e KSHPK-së dhe mund të shkarkohet para skadimit të mandatit me kërkesë personale. Në këtë rast, KSHPK-ja zgjedh kryetar për kohën e mbetur të mandatit[1045]. Funksioni në KSHPK është profesionale dhe nëse ndonjë person që është zgjedhur për anëtarë i KSHPK-së ka punësim tjetër, pozita e tij/saj ekzistuese do të ngrihet nga dita e emërimit deri në ditën e përfundimit të mandatit si anëtarë i KSHPK-së.[1046]

Anëtari i KSHPK-së mund të shkarkohet nga Kuvendi me kërkesë personale, nëse ka gjykim për vepër penale me dënim me burg më të gjatë se 6 muaj dhe nëse e humb aftësinë

[1038] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008 dhe 145/2010, neni 1.
[1039] Njëlloj.
[1040] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 145/2010.
[1041] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 145/2010, neni 48-b.
[1042] Intervistë me Goran Misovskin, ish deputet dhe anëtar i Komisionit për Zgjedhje dhe Emërim (intervistë ballë për ballë), 6.10.2014 .
[1043] Intervistë me Goran Misovskin, ish deputet dhe anëtar i Komisionit për Zgjedhje dhe Emërim (intervistë ballë për ballë), 6.10.2014 .
[1044] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 126/2006, neni 48-a
[1045] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 126/2006, neni 48-c.
[1046] Njëlloj.

për kryerje të detyrave[1047]. KSHPK-ja vendos nëse kushtet për shkarkim janë plotësuar me shumicë të votave të anëtarëve dhe në Kuvend dorëzon iniciativë për shkarkimin e anëtarit.[1048]

Nuk ka dispozita ligjore për kufizime të aktiviteteve politike dhe aktivitete tjera të kryetarit KSHPK-së që janë në drejtim të sigurimit të pavarësisë dhe paanësisë, dhe nuk ka dispozita të dhënies së imunitetit të anëtarëve të KSHPK-së.

Anëtarët e KSHPK-së marrin rrogën e njëjtë sikur nëpunësit tjerë të emëruar dhe caktuar me rend të njëjtë.[1049]

10.1.4 PAVARËSIA (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle ka pavarësi në KSHPK në praktikë?

Ndonëse në vitin 2011 anëtarët e KSHPK-së kanë marrë status profesional, "besimi në pavarësinë e tyre mbetet i ndjeshëm"[1050]. Statusi ligjor i KSHPK-së si person i pavarur juridik konsiderohet vetë si mekanizëm për mbrojtje të KSHPK-së nga ndikimi politik[1051]. Siç është përmendur më lart, ka dispozita ligjore për profesionalizëm dhe punë jo-partiake, por në praktikë, ka shumë mendime dhe analiza që shqyrtojnë zbatimin faktik të pavarësisë të përcaktuar me ligj[1052]. Tregues i qartë i ndikimit politik të KSHPK-së është mungesa e hetimeve për raste të korrupsionit në nivele më të larta.[1053]

Kryetari i KSHPK-së i zgjedhur në vitin 2007 ishte zgjedhur sërish për dy vite tjera, që ka paraqitur shkelje të dukshme të ligjit, por duke marrë parasysh që nuk ka pasur dispozitë në ligj për rizgjedhje të kryetarit të KSHPK-së[1054]. Në mars të vitit 2010, Partia Social-Demokrate e opozitës (LSDM) ka propozuar interpelancë të kryetarit të atëhershëm për shkak të rezultateve të dobëta në luftën kundër krimit dhe korrupsionit, që nuk ishte pranuar nga Kuvendi.[1055]

Besimi i publikut në pavarësinë dhe paanësinë e KSHPK-së është vlerësuar ulët[1056]. Për dallim nga mandati i parë i KSHPK-së[1057] në të cilin kanë filluar një pjesë e madhe e hetimeve, mandati i dytë pranon qasje reaktive dhe udhëheqësia ka humbur besimin[1058]. Konsiderohet që në punën e KSHPK-së ka ndikim të madh politik.[1059]

Ka shqetësim për "kriteret me të cilat shërbehet Kuvendi"[1060], gjatë zgjedhjes së anëtarëve

[1047] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 126/2006, neni 48-
[1048] Njëlloj.
[1049] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 145/2010.
[1050] Komisioni Evropian, Raporti i përparimit të RM, 2011 (Bruksel, Komisioni Evropian, 2012), http://ec.europa.eu/enlargement/ pdf/ key_documents/2011/package/mk_rapport_2011_en.pdf f.14 [qasur më 23.10.2014].
[1051] Intervistë me Dragan Malinovskin, ish kryetari i KSHPK (intervistë ballë për ballë), 8.10.2014
[1052] Intervistë me Goran Misovskin, ish deputet dhe anëtar i Komisionit për Zgjedhje dhe Emërim (intervistë ballë për ballë) 6.10.2014 .
[1053] Njëlloj.
[1054] Transparensi Interneshënal , Barometër për Korrupsion Global 2008, (Berlin: TI, 2008) http://www.transparency.org.mk/index. php?option=com_content&task=view&id=317&Itemid=78; [qasur më 23.10.2014].
[1055] Mangova, 2014: f. 85.
[1056] Komisioni Evropian, 2014: f. 15.
[1057] Mandati i parë nëntor 2002 – shkurt 2007
[1058] Mangova, 2014: f. 85.
[1059] Njëlloj.
[1060] http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/round4/GrecoEval4(2013)4_TheFYROMacedonia_EN.pdf, f. 54 [qasur më 23.10.2014].

të KSHPK-së. Në prill të vitit 2011, pa mbështetjen dhe praninë e opozitës, Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve ka zgjedhur 7 anëtarë të KSHPK-së. Nuk ka procedurë të qartë për emërimin e anëtarëve të KSHPK-së dhe emërimet kanë qenë kontroverse, duke marrë parasysh që disa prej anëtarëve vetëm më kanë punuar në KSHPK, ndërsa njëri nuk ka pasur përvojën që kërkohet me ligj. Gjatë mandatit në KSHPK, Kryetari ishte shkarkuar para skadimit të mandatit pa ndonjë arsyetim përkatës.[1061]

QEVERISJA

10.2.1 TRANSPARENCA (E DREJTA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle janë vendosur dispozita me të cilat publiku mund të fitojë informata relevante dhe me kohë për aktivitetet dhe proceset e agjencive të anti-korrupsionit?

Ligji parashikon që KSHPK-ja ka kompetencë të bëjë kontrolle në gjitha marrëveshjet, prokurime publike dhe marrëveshje tjera dhe duhet të dorëzojë raport në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë për inspektime të bëra në afat prej 30 ditëve. Gjithashtu, KSHPK-ja mund të dorëzojë raport të veçantë në Kuvend për keqpërdorim të mundshëm të mjeteve të buxhetit, fondeve publike dhe mjeteve nga ndërmarrjet publike dhe personave tjerë ligjorë që merren me kapital shtetëror në periudhë prej 3 muajve deri në ditën e zbatimit të zgjedhjeve.

Raporti duhet të vendoset në dispozicion të medieve.[1062]

KSHPK-ja ka për obligim të dorëzojë raport vjetor për punën në Kuvend, te Kryetari dhe Qeveria, tu vendos në dispozicion medieve, por edhe të dorëzojë masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga Kuvendi në kuptim të punës dhe rekomandimeve të KSHPK-së.

Ligji për qasje të lirë në Informata me karakter publik e përfshin KSHPK-në si bartës të informatave, mes organeve tjera (për më tepër informata shikoni pjesën për transparencë në shtyllën e sektorit publik) dhe në këtë kuptim, KSHPK-ja ka për obligim që kërkuesve të informatave të japë informata të veçanta me karakter publik[1063]. Meqë në ligj nuk është theksuar saktë se çfarë lloj informate mund të largohen nga publiku, KSHPK-ja mund të vendosë se cilat informata duhet të publikohen[1064].

10.2.2 TRANSPARENCA (PRAKTIKA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle ka transparencë në aktivitetet dhe në procesin e vendimmarrjes së KSHPK-së në praktikë?

KSHPK-ja është kritikuar për profilin e ultë në kuptim të dukshmërisë si fuqi udhëheqëse në

[1061] http://daily.mk/makedonija/voislav-zafirovski-razreshen-od-antikorupciska-1 "Voisllav Zafirovski i shkarkuar nga Komisioni i Anti-Korrupsionit" [qasur më 23.10.2014].
[1062] Njëlloj.
[1063] Ligji për qasje të lirë në informata me karakter publik, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 13/2006, 86/2008, 6/2010 dhe 42/2014.
[1064] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008 dhe 145/2010, neni 49 (2).

luftën kundër korrupsionit[1065]. Ishte rekomanduar rritja e dukshmërisë dhe të përmirësohet komunikimi me organizatat qytetare (OJQ) dhe të krijohen aleatë për përparimin e integritetit në gjithë shtetin.[1066]

KSHPK-ja është tërësisht pa bashkëpunim. Zëdhënësi jo shpesh përgjigjet në telefon, ndërsa numrat e telefonit të anëtarëve të KSHPK-së nuk janë të vendosur në internet faqen e tyre, dhe vështirë është të arrihet në kontakt me ta[1067]. Përvoja e Transparency Internacional –Maqedoni në lidhje me këtë studim dhe aktivitete tjera është negative dhe ka treguar që mënyra e vetme e komunikimit me KSHPK-në është me anë të letrës zyrtare, që do të shqyrtohet në mbledhje zyrtare të KSHPK-së dhe nuk ka mundësi për komunikim me anë të postës elektronike ose nëpërmjet telefonit.

Raportet vjetore, prej vitit 2003 dhe vijuese, publikohen në internet faqen pas miratimit të tyre nga Kuvendi[1068]. Ato përmbajnë informata për zbatimin e ligjit dhe Programin shtetëror për parandalim dhe shtypje të korrupsionit; aktivitete për parandalimin e korrupsionit; mbikëqyrje të pronës së nëpunësve zyrtarë; zbatimi i Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave; aktivitete të projektit; arsim; bashkëpunim ndërinstitucional; marrëdhënie me publikun dhe aktivitete në përputhje me përgjegjësitë e KSHPK-së sipas ligjit për PDI. Informatat e dhëna në raportet vjetore nga viti 2007 janë shpesh teknike; për shembull, kur njoftohet për aktivitetet e ndërmarra në raste të konfliktit të interesave dhe fletave anketuese, statistikat janë dhënë pa informata për profilin e personave që janë lëndë e hetimit (përfaqësues qeveritarë ose përfaqësues të opozitës).[1069]

Në Raportin vjetor janë dhënë vetëm informata të paqarta, të paplota për aktivitetet e marrëdhënieve me publikun të KSHPK-së. Për shembull, KSHPK-ja thekson që në internet faqen e saj ka publikuar 48 shtesa me informata për aktivitetet e tyre të përditshme, raste të korrupsionit dhe konfliktit të interesave[1070]. Megjithatë, pjesa më e madhe e informatave të publikuara në internet faqen kanë të bëjnë me konferenca, tryeza të rrumbullakëta, etj., dhe jo aktivitete të ndërmarra dhe iniciativa[1071]. Raporti vjetor gjithashtu përmban informata të paqarta për intervistat e dhëna në medie të ndryshme[1072], por në internet faqen janë publikuar vetëm tri intervista.[1073]

Numri i rendeve të ditës i seancave të KSHPK-së, si dhe numri i konferencave të shtypit aspak nuk përmendet në raportet vjetore, që nuk është rasti me raportet deri në vitin 2006, në të cilat ka informata të qarta për numrin e seancave. Publiku nuk ka pasqyrë të aktiviteteve të KSHPK-së dhe nuk është e vetëdijshme për kompetencat e tyre.[1074]

Në vitin 2013, prej 21 kërkesave për qasje të lirë në informata, 20 janë përgjigjur pozitivisht dhe një kërkesë është refuzuar. Janë parashtruar 4 ankesa, prej të cilave 3 janë pranuar dhe një është refuzuar si pa bazë.[1075] Ankesa mund të dorëzohet nëse pala nuk është e kënaqur nga përgjigja e dhënë. Tre vendimet e KSHPK-së janë ndryshuar pas ndërmarrjes së aktiviteteve nga Komisioni për Qasje të Lirë në Informata me Karakter Publik (KQLIKP).

[1065] OECD/SIGMA, Raporti për Integritet 2009 (Bruksel OECD 2009).
[1066] Njëlloj.
[1067] Njëlloj.
[1068] http://www.dksk.org.mk/index.php?option=com_content&task=blogcategory&id=18&Itemid=47 [qasur më 23.10.2014].
[1069] http://www.dksk.org.mk/images//godisen%20izvestaj%20dksk%202013.pdf KSHPK raport vjetor 2013 [qasur më 23.10.2014].
[1070] Njëlloj.
[1071] Njëlloj.
[1072] Njëlloj.
[1073] http://www.dksk.org.mk/
[1074] Intervistë me Goran Misovskin, ish deputet dhe anëtar i Komisionit për Zgjedhje dhe Emërim (intervistë ballë për ballë) 6.10.2014 .
[1075] http://www.dksk.org.mk/images//godisen%20izvestaj%20dksk%202013.pdf KSHPK raport vjetor i punës 2013 f. 49.

10.2.3 LLOGARIDHËNIA (E DREJTA)

Nota 25

Në çfarë shkalle ka dispozita për sigurimin që agjencitë për luftën kundër korrupsionit njoftojnë dhe të marrin përgjegjësi për veprimet e tyre?

Në përputhje me ligjin, KSHPK-ja është përgjegjëse për dorëzim të Raportit vjetor për punën në Kuvend, te Kryetari i Republikës së Maqedonisë, te Qeveria dhe te mediet[1076]. Gjithashtu, ligji parashikon që KSHPK-ja duhet të informojë publikun për masa dhe aktivitete të ndërmarra dhe rezultatet e tyre kur KSHPK-ja mendon që është e nevojshme të informohet publiku.[1077]

Në KSHPK ka një Departament për Revizion të Brendshëm[1078] për kryerjen e revizioneve financiare, revizione të rregullsisë, revizione të sistemeve të brendshme për kontroll, revizione të suksesit dhe TI revizione që bëhen një herë në vit.[1079] Nuk ka obligim ligjor që KSHPK-ja të bëjë revizion të pavarur.

Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) bën revizion të detyrueshëm të buxhetit të Republikës së Maqedonisë. Buxhetet e fondeve dhe institucionet mund të jenë lëndë e revizionit të rastësishëm/ parregullt, nëse ajo është parashikuar në programin vjetor të punës së ESHR-së.[1080]

Me ligjin nuk është parashikuar mundësi për qytetarët të parashtrojnë parashtresa për punën e KSHPK-së dhe nuk ka komitete qytetare mbikëqyrëse. Megjithatë, deputetët mund të përdorin seancat e Kuvendit për parashtrimin e pyetjeve në KSHPK, si institucion përgjegjës para Kuvendit, në lidhje me aktivitetet ditore dhe kompetencat.[1081]

Nuk ka mekanizma gjyqësorë për kontrollin e punës së KSHPK-së, ndërsa politika e "informatorëve" nuk është miratuar ende.

Në rastet e konfliktit të interesave, Gjykata për Shkelje është kompetente për zbatimin e procedurave të kallëzimeve.[1082]

10.2.4 LLOGARIDHËNIA (PRAKTIKA)

Nota 25

Në çfarë shkalle agjencitë për luftë kundër korrupsionit duhet të njoftojnë dhe të marrin përgjegjësi për procedurat e tyre në praktikë?

Udhëheqësi i KSHPK-së duhet të japë llogari për aktivitetet e të punësuarve, ndërsa pyetjet diskutohen në takimet e KSHPK-së. Përveç raporteve vjetore, KSHPK-ja ka të drejtë diskrecioni për të informuar publikun për aktivitete tjera.

Raportet vjetore diskutohen në Kuvend[1083]. Opozita zakonisht jep kritika të ashpra, por

[1076] Ndryshim dhe plotësim i Ligjit për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 46/2004, neni 48.
[1077] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, neni 49.
[1078] Gjendet në internet faqen e tyre http://dksk.org.mk/ [qasur më 1.10.2014].
[1079] Ligji për kontroll të brendshëm financiar, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.90/09, neni 30 [qasur më 23.10.2014].
[1080] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 66/10, 145/2010, 12/2014, 43/2014
[1081] Rregullore për punë të Kuvendit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 91/08, 119/2010, 130/2010, 23/2013, neni 37.
[1082] Ligji për parandalim të konfliktit të interesave, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 70/2007, 114/2009, 128/2009.
[1083] http://www.redup.mk/site/out/739706-godishniot-izveshtaj-na-antikorupciska-pred-pratenicite Raporti vjetor i KSHPK para deputetëve [qasur më 11.12.2014].

nuk ka ndjekje. Ato kritikojnë mungesën e transparencës së KSHPK-së, si dhe mungesa e informatave për punën.[1084]

Nuk ka politikë të "informatorëve", por në projektin ekzistues të binjakëzimit është parashikuar një politikë e "informatorëve".[1085] Përveç, në zhvillim është Ligji për "Informatorët".[1086]

Kryetari i KSHPK-së ishte thirrur vetëm një herë në vitin 2009 për tu përgjigjur pyetjeve nga Kuvendi[1087]. Pyetjet kanë qenë për mungesën e suksesit të KSHPK-së të shqyrtojë raportet e revizionit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Transportit dhe Lidjeve, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe revizione në disa komuna, si dhe konflikti i interesave të ish kryetarit të KSHPK-së.[1088] KSHPK-ja ka theksuar që punon në përputhje me ligjin dhe nuk ka pasur diskutim të mëtutjeshëm dhe rezultat.

10.2.5 MEKANIZMAT E INTEGRITETIT (E DREJTA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle janë vendosur mekanizma për sigurimin e integritetit të anëtarëve të agjencive për luftën kundër korrupsionit?

Për KSHPK-në nuk ka kod të veprimit. Megjithatë fletat anketuese, rregullat për përcaktimin e konfliktit të interesave dhe çështjet tjera të integritetit janë rregulluar me shumë ligje që zbatohen për anëtarët dhe stafin e KSHPK-së, gjegjësisht Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave, si dhe Ligji për përdorim dhe shfrytëzim të sendeve në pronësi shtetërore. Në rast të dyshimit për konflikt të interesave, në të cilin është përfshirë një anëtar i KSHPK-së, duhet mendim i Komisionit Parlamentar për Zgjedhje dhe Emërime.

Personat zyrtarë nuk guxojnë të pranojnë dhurata gjatë kryerjes së funksionit publik, përveç dhuratave personale në shumë deri më 200 EUR, të dhënë nga përfaqësues të shtetit të huaj, organ shtetëror ose organizatë ndërkombëtare, të dhënë si kujtim ose si akt i bashkëpunimit dhe solidaritetit ndërkombëtar.[1089]

Nëse personit zyrtar i është ofruar dhuratë lidhur me kryerjen e detyrës përkatëse, personi zyrtar duhet të refuzojë, të përcaktojë identitetin e ofruesit, dhe nëse dhurata nuk mund të kthehet, duhet të raportohet tek organi kompetent jo më vonë se në afat prej 48 orëve.[1090]

Në kuptim të kufizimeve pas punësimit, personi zyrtar nuk guxon që gjatë mandatit dhe në afat prej pesë viteve pas përfundimit të mandatit të përfitojë të drejta në subjektin që ka qenë nën mbikëqyrje të tij/saj ose marrëveshje kontraktuese[1091]. Personat zyrtarë obligohen të informojnë KSHPK-në nëse pas skadimit të mandatit të tyre ndërmarrin aktivitete të caktuara komerciale në fushën në të cilën kanë punuar më herët[1092]. Dispozitat për kufizime

[1084] Njëlloj.
[1085] "Mbështetje efektive të parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit" me instrumentin IPA, 2010, me Republikën Federale të Gjermanisë si partner i binjakëzimit që ka filluar më 23.9.2014 http://www.dksk.org.mk/index. php?option=com_ content&task=blogcategory&id=58&Itemid=154 [qasur më 23.10.2010].
[1086] Strategjia për reforma të administratës publike (misa.gov.mk).
[1087] http://www.dksk.org.mk/index.php?option=com_content&task=view&id=166&Itemid=33 pyetje deputetësh, 26.11.2009 [qasur më 23.10.2014].
[1088] Njëlloj.
[1089] Ligji për përdorim dhe shfrytëzim të sendeve në pronësi shtetërore, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 8/05, 150/07, 35/11 i 166/12.
[1090] Ligji për parandalim të konfliktit të interesave, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 70/2007, 114/2009, 128/2009.
[1091] Njëlloj.
[1092] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.

pas punësimit gjithashtu vlejnë edhe për anëtarët e KSHPK-së.

Testi psikologjik me aspekte të integritetit të personit është më tepër formal dhe kryhet nga Agjencia për Administratë, dhe parashikohet që vetëm tre më të mirë të zgjedhur prej kandidatëve për pozita të caktuara të pranohen në shërbim shtetëror. Rezultatet dhe mendimet e kandidatëve më vonë dorëzohen në institucionin përkatës që ka publikuar shpalljen.[1093] Megjithatë, nuk janë parashikuar kushte të veçanta për testime plotësuese të integritetit të anëtarëve të KSHPK-së dhe Sekretariatit të KSHPK-së.

10.2.6 MEKANIZMAT E INTEGRITETIT (PRAKTIKA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle është siguruar integriteti i agjencive për luftë kundër korrupsionit në praktikë?

Fletat anketuese të anëtarëve të KSHPK-së nuk janë publikuar.[1094] Megjithatë, duke marrë parasysh faktin që publiku ka të drejtë të dijë për pronën e personave zyrtarë, KSHPK-ja mendon që praktika ekzistuese e publikimit të informatave nga fletat anketuese vlen dhe mbështet në interes të publikut në tërësi[1095]. Mirëpo, fletat e tyre anketuese si bartës së funksioneve publike nuk janë të gatshme për publikun.[1096]

Nuk ka trajnime të rregullta për çështjet e lidhura me integritetin e stafit të KSHPK-së, por sigurohet ndihmë financiare dhe profesionale nga Instrumenti për Ndihmë Teknike dhe shkëmbim të informatave të Komisionit Evropian.[1097]

Deri sa ishte i punësuar me orar të plotë në KSHPK, ish kryetari i KSHPK-së u bë udhëheqës i Televizionit Maqedonas (MTV), që është ndërmarrje publike, dhe në kohën e njëjtë ka mbajtur pozitën e kryetarit të KSHPK-së[1098]. Duke marrë parasysh që ky rast, dhe për faktin që nuk ka kod të veprimit, regjistër të dhuratave dhe nuk publikohen fletë anketuese të anëtarëve të KSHPK-së, KSHPK-ja nuk i plotëson standardet etike.

ROLI

10.3.1 PARANDALIMI

Nota **50**

[1093] Ligji për nëpunës shtetërorë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 59/2000, 112/2000, 34/2001, 103/2001, 43/2002, 98/2002, 17/2003, 40/2003, 85/2003, 17/2004, 69/2004, 81/2005, 61/2006, 36/2007, 161/2008, 6/2009, 114/2009, 35/2010, 167/2010, 36/2011, 6/2012, 24/2012, 15/2013, 82/2013, 106/2013 i 132/2014. Vendime të Gjykatës së RM-së: U. nr. 186/2000 prej 4.4.2001, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 30/2001; U. nr. 132/2001 prej 18.12.2002, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 100/2002; U. nr. 37/2003 prej 17.12.2003, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 84/2003; U. nr. 37/2008 prej 10.9.2008, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 118/2008; U. nr. 66/2008 prej 24.9.2008, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 128/2008 i U. nr. 206/2008 prej 23.12.2009, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 1/2010. Ligji për plotësim dhe ndryshim të Ligjit për Qeverinë e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 10/2010.

[1094] Kemi parashtruar kërkesë për qasje në informata publike në Kuvend për fletat anketuese të dorëzuar të anëtarëve të KSHPK-së (kërkesa ishte dorëzuar më 2.10.2014).

[1095] "Shkolla Rajonale për Administratë Publike, *Studim Komparativ – Të ardhurat dhe fletat anketuese në praktikë, rrjeti i etikës dhe integritetit,* (Danilovgrad: Re SPA, 2013), f. 203. file:///D:/Local%20Disk%20C/Downloads/Comparative%20 study%20-%20 Income%20and%20asset%20declarations%20in%20practice%20-%20web.pdf

[1096] Transparency International – Maqedoni ka parashtruar kërkesa për qasje të lirë në informata me karakter publik në Kuvend për sigurim të fletave anketuese të anëtarëve të KSHPK.

[1097] http://www.dksk.org.mk/images/stories/pdf/prog_rab_2013.pdf KSHPK programi vjetor për punë 2013 f. 11.

[1098] http://utrinski.mk/?ItemID=A541DA7A8B53624383BE7C7986E0842D Mirjana Dimovska, drejtor i ri i Televizionit Maqedonas [qasur më 3.10.2014].

Në çfarë shkalle agjencitë për luftë kundër korrupsionit janë të angazhuar në aktivitete parandalimi në lidhje me luftën kundër korrupsionit?

Roli kryesor i KSHPK-së është të ndalojë korrupsionin. E miraton Programin shtetëror për parandalim dhe shtypje të korrupsionit dhe planin përkatës të veprimit; e miraton Programin vjetor për punë; jep mendime për propozim ligje që kanë të bëjnë me parandalimin e korrupsionit; bën kontrolle mbi punën financiare të partive politike, sindikatave dhe OJQ-ve; nis procedura për shkarkim, ulje ose masa tjera për përgjegjësi te personat zyrtarë dhe ata juridikë; vepron në raste të konfliktit të interesave; njofton dhe kryen mbikëqyrje për gjendjen e pronësisë së bartësve të funksioneve publike; bashkëpunon me organe tjera shtetërore për parandalimin e korrupsionit dhe bashkëpunon me organizata ndërkombëtare për parandalimin e korrupsionit.[1099]

Gjithashtu, KSHPK-ja miraton programin shtetëror për parandalimin e konfliktit të interesave dhe planin e veprimit; jep mendime për propozim-ligje që kanë të bëjnë me parandalimin e konfliktit të interesave; bën kontrollin e denoncimeve për konflikt të interesave; shqyrton raste të konfliktit të interesave dhe bashkëpunon me organet shtetërore për konflikt të interesave.[1100] Përveç kësaj, bën mbikëqyrjen e procesit të lobimit[1101] dhe grumbullon dhe publikon raporte financiare për partitë politike në procesin zgjedhor.[1102]

Në vitin zgjedhor 2014, KSHPK-ja ka pranuar rreth 400 fleta anketuese dhe ka nisur 50 procedura penale, dhe janë dorëzuar 60 kërkesa në Drejtorinë e të Hyurave Publike për shqyrtimin e gjendjes pronësore.[1103]

Bashkëfolësit theksojnë se ka mangësi në procedurën e emërimit të anëtarëve të KSHPK-së, mungon suksesi në përpunimin e rasteve të korrupsionit në nivel të lartë dhe ka përzgjedhje të dukshme të rasteve të zgjedhura për kontroll[1104]. Përveç kësaj, "KSHPK-ja gjatë viteve të fundit ishte ndaluar nga aktiviteti i pamjaftueshëm në përballjen me korrupsionin dhe ndihmën e kulturës së integritetit dhe shmangies së konfliktit të interesave".[1105]

Aftësia e KSHPK-së të sanksionojë bartës të funksioneve publike që nuk respektojnë rregullat që përcaktojnë konflikt të interesit është e dobët. Pasi që nga Gjykata Kushtetuese në vitin 2010 janë fshirë dispozita nga Ligji, KSHPK-ja nuk ka autorizime të përcaktojë dënime përveç të japë "vërejtje publike" për konflikte të interesave. Përveç kësaj, mungesa e regjistrit të interesave të bartësve të zgjedhur dhe të emëruar në funksione publike vazhdon të ndalojë kontrollin efektiv të mjeteve dhe konfliktit të interesave.[1106] KSHPK-ja ka vështirësi praktike në sigurimin e të dhënave të plota dhe duhet të bëjë përpjekje dhe resurse plotësuese për të realizuar kompetencat përkatëse në kuptim të mbikëqyrjes dhe sanksionimit të bartësve të funksioneve publike që kanë shkelur ligjin[1107]. Duhet, madje, edhe të prezantohen masa përkatëse për "sigurimin e shqyrtimit të hollësishëm të deklaratave për interes dhe fletat anketuese"[1108].

[1099] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008 dhe 145/2010.
[1100] Ligji për parandalim të konfliktit të interesave, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 70/2007, 114/2009, 128/2009.
[1101] Ligji për lobim, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 106/08.
[1102] Kodi zgjedhor, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 32/2014.
[1103] http://www.dksk.org.mk/images/Drzavni_Programi/%D0%93%D0%9E%D0%94%D0%98%D0%A8%D0%95%D0%9D%20%D0%98%D0%97%D0%92%D0%95%D0%A8%D0%A2%D0%90%D0%88-2014-%D0%94%D0%9A%D0%A1%D0%9A.pdf [qasur më 8 tetor, 2014].
[1104] Intervistë me Sashka Cvetkovskën, gazetare në internet-televizionin NOVA (novatv.mk) (intervistë personale), 2.10.2014
[1105] http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/round4/GrecoEval4(2013)4_TheFYROMacedonia_EN.pdf f. 54 [qasur më 23 tetor, 2014].
[1106] Njëlloj.
[1107] Re SPA, 2013: f. 203, f.100-101.
[1108] http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/round4/GrecoEval4(2013)4_TheFYROMacedonia_EN.pdf [qasur më 3.10.2014], f. 54.

Ndonëse KSHPK-ja mund të japë mendime për propozim-ligje që janë me rëndësi të veçantë në luftën kundër korrupsionit, Ministria e Drejtësisë ka përgjegjësinë për reforma ligjore në fushën e luftës kundër korrupsionit. KSHPK-ja thjeshtë është përfshirë në grupet e punës në përpilimin e akteve relevante ligjore dhe në procesin e konsultimeve.

Gjithashtu, KSHPK-ja bashkëpunon me organet relevante shtetërore dhe institucionet ndërkombëtare në lidhje me parandalimin e korrupsionit dhe nuk ka kompetencë të koordinojë me aktivitetet e plota për luftë kundër korrupsionit. KSHPK-ja merr dhe u përgjigjet kërkesave për këshilla për luftë kundër korrupsionit nga publiku ose organe tjera shtetërore. Në KSHPK nuk ka të punësuar me postin e kryerjes së hetimeve, ndërsa në kuptim të studimeve/raporteve, KSHPK-ja i përgatit vetëm raportet vjetore.

Në anketat e IRI-t për mendimin publik në Maqedoni, 22% të qytetarëve mendojnë që KSHPK-ja aspak nuk kontribuon në zgjedhjen e problemeve në vend, 24% mendojnë që nuk kontribuon, 23% janë neutrale, gjegjësisht nuk mendojnë që kontribuon ose jo, dhe 17% mendojnë që KSHPK-ja kontribuon për zgjedhjen e problemeve; 4% mendojnë që kontribuon shumë, ndërsa 11% tjerët nuk e dinë.[1109]

Kompetencat dhe aktivitetet e KSHPK-së duhet të përmirësohen dhe vendi i tij duhet të jetë mirë i përcaktuar në kontekstin e plotë të luftës kundër korrupsionit.[1110]

10.3.2 ARSIMI

Nota **50**

Në çfarë shkalle KSHPK-ja është përfshirë në aktivitete arsimore lidhur me luftën kundër korrupsionit?

KSHPK-ja është rregullisht e përfshirë në aktivitete arsimore që kryesisht janë bazuar në projekte dhe nuk janë përfshirë në programin vjetor.

Në vitin 2012, KSHPK-ja ka filluar projektin "Arsimi për luftë kundër korrupsionit për nxënësit e shkollave fillore". Prej atëherë, rekomandohet që të prezantohet material për luftë kundër korrupsionit në shkollat e gjithë vendit.[1111]

Në bashkëpunim me MSHIA, në vitin 2013, ishin zhvilluar tre trajnime për 67 nëpunës shtetërorë për temën "masa për luftë kundër korrupsionit dhe etikë në shërbimin shtetëror[1112]", ndërsa në 2014[1113] ishin zhvilluar dy trajnime për 22 nëpunës shtetërorë. Në 2013, KSHPK-ja dhe Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë kanë organizuar aktivitete për trajnim për luftë kundër korrupsioni, me mbi 700 pjesëmarrës. Përveç këtyre iniciativave, KSHPK-ja nuk bën vlerësimin e ndikimit të aktiviteteve arsimore dhe duhet të bëjë shumë në kuptim të ngritjes së kapaciteteve dhe ngritjes së vetëdijes te qytetarët.[1114]

Përveç kësaj, KSHPK-ja ka nënshkruar Memorandum për bashkëpunim të përbashkët në parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave me sektorin qytetar, me 21 organizata qytetare. Megjithatë, në praktikë, në procesin e fundit për krijimin e programit shtetëror për

[1109] Instituti Republikan Ndërkombëtar, 2014: f. 32.
[1110] QMBN, 2014: f. 63.
[1111] KSHPK, 2013: f. 44 [http://www.dksk.org.mk/images//godisen%20izvestaj%20dksk%202013.pdf].
[1112] Njëlloj.
[1113] Kontribut për Raportin e Përparimit të KE-së (kapitulli 23, të drejta gjyqësore dhe themelore), QAE.
[1114] KE, 2014: f. 43.

parandalim të korrupsionit, KSHPK-ja bashkëpunon në mënyrë zgjedhore me organizatat qytetare, gjegjësisht me ato që janë me pak kritike ndaj punës së tyre. Një shembull i qartë është mungesa e bashkëpunimit me Transparency International – Maqedoni.

10.3.3 HETIMI

Nota **25**

Në çfarë shkalle KSHPK-ja është përfshirë në hetimet në lidhje me aktivitetet e supozuara të korrupsionit?

KSHPK-ja, në praktikë, vepron më tepër reaktive, në vend që të jetë fuqia shtytëse në luftën kundër korrupsionit.

KSHPK-ja ka kompetencë të posaçme për të bërë hetime administrative. Fillon procedura para organeve kompetente në lidhje me punën financiare të partive politike, sindikatën dhe organizatat qytetare. Gjithashtu, nis procedura penale ku ka parregullsi në përdorimin e kapitalit shtetëror nga bartës të zgjedhur dhe të emëruar të funksioneve publike, persona përgjegjës në ndërmarrje publike dhe persona juridikë.[1115]

Në lidhje me hetimet e rasteve të profileve më të larta, KSHPK-ja në mandatin e parë[1116] ka dhënë 44 iniciativa për hetime penale, përbërja e dytë ka nisur 60 raste – përfshirë, për herë të parë, raste të korrupsionit në nivel të lartë, ndërsa përbërja e tretë e KSHPK-së nuk ka nisur asnjë rast të korrupsionit në nivel të lartë[1117]. Në vitin 2013, KSHPK-ja ka nisur 9 raste në Zyrën e Prokurorit Publik për nisje të procedurave penale, por këto raste nuk kanë rezultuar me akuzime të suksesshme. PP-ja duhet të sigurojë më tepër informata kthyese, me qëllim të sigurimit të shkallë më të lartë të suksesit në luftën kundër korrupsionit.[1118]

Gjithashtu, KSHPK-ja nuk ka reaguar mbi zbulimet e ESHR-së për llogarinë e palajmëruar në shumë prej 4 milion EUR të partisë në pushtet, VMRO-DPMNE, gjatë zgjedhjeve në vitin 2011, ndonëse në përputhje me ligjin, duhej të hapet rast.[1119]

REKOMANDIME:

R1. KSHPK-ja duhet të miratojë kod të brendshëm të veprimit për anëtarët e zgjedhur të Kuvendit dhe të themelohet një mekanizëm efektiv për zbatimin përkatës.

R2. Anëtarët e KSHPK-së duhet të sigurojnë që fletat e tyre anketuese janë publike, në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit.

R3. KSHPK-ja duhet të sigurojë publikim të praktikës dhe sqarimeve të vendimeve, veçanërisht vendimet lidhur me financimin politik, konfliktin e interesave dhe fletat anketuese.

R4. KSHPK-ja duhet të publikojë raporte tjera, në përputhje me ligjin, duhet të plotësojë obligimin ligjor për parashtrimin e raporteve në Kuvend, si dhe raportin për financim të fushatave politike.

[1115] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, neni 55.
[1116] Përbërja e parë e KSHPK-së ka punuar në periudhën prej nëntori 2003 deri shkurt 2007 .
[1117] Mangova, 2014, f. 83, 86 dhe 87.
[1118] KE, 2014: f. 42.
[1119] Intervistë ne Goran Misovskin, ish deputet dhe anëtar i Komisionit për Zgjedhje dhe Emërime (intervistë ballë për ballë) 6.10.2014 . (interviste ballë për ballë) 6.10.2014 .

11. PARTITË POLITIKE

PËRMBLEDHJE

Kushtetuta parashikon pluralizëm politik dhe garanton lirinë e shoqërimit për realizim dhe mbrojtje të të drejtave politike. Qytetarët lirshëm mund të themelojnë parti politike.

Në përputhje me Regjistrin unik gjyqësor të partive politike, në momentin në Maqedoni ekzistojnë 52 parti të regjistruara politike, ndërsa 4 janë në fazë të regjistrimit[1120]. Ka një ndarje të madhe të lojtarëve kryesorë politikë të dy blloqeve etnike, dhe gjithë partitë dominohen nga elita me përqendrim të lartë të fuqisë në liderët partiakë.

Me ndryshimet e Ligjit për financim të partive politike të vitit 2013, pjesërisht është përgjigjur rekomandimeve të GREKO-s dhe OSBE/ODHIR për përcaktimin e institucioneve të përfshira në mekanizmin kontrollues. Megjithatë, ligjet që kanë të bëjnë me partitë politike, veçanërisht transparencën e financimit të partive politike, nuk janë efektive.

Në vitin 2015, Maqedonia përballet me krizë të vështirë politike, kur ishte zbuluar një rast i madh i përgjimit.

Në tabelën më poshtë janë dhënë notat e treguesve që e përmbledhin vlerësimin e partive politike në kuptim të kapacitetit, drejtimin e brendshëm dhe rolit në NSI maqedonas. Në vazhdim të kësaj pjese është dhënë analizë cilësore e të secilit tregues.

NOTA E PËRGJITHSHME E SHTYLLËS: 45,8/100

DIMENSIONI	TREGUESI	E DREJTA	PRAKTIKA
Kapaciteti 50/100	Resurset	75	25
	Pavarësia	75	25
Qeverisja 50/100	Transparenca	75	25
	Llogaridhënia	75	50
	Integriteti	50	25
Roli 37,5/100	Agregimi i interesave dhe përfaqësimi	50	
	Përpjekja për luftë kundër korrupsionit	25	

[1120] Gjykata Themelore Shkupi 2 – Shkup, 27.5.2015

Nota për shtyllën sipas të drejtës dhe praktikës



VLERËSIMI

11.1.1 RESURSET (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle korniza ligjore siguron mjedis të volitshëm për formimin dhe funksionimin e partive politike?

Korniza ligjore siguron mjedis të volitshëm për formim dhe funksionim të partive politike. Kushtetuta e garanton plularizimin politik, ndërsa zgjedhjet e lira, të drejta dhe demokratike janë të rregulluar me ligj.[1121] Përveç kësaj, qytetarëve u është garantuar liria e shoqërimit me qëllim të realizimit dhe garantimit të të drejtave dhe bindjeve politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe të tjera. Qytetarët lirshëm mund të formojnë parti politike, të bashkohen ose të largohen. Në Maqedoni, parti politike mund të themelojnë së paku 1.000 qytetarë të Republikës së Maqedonisë që kanë të drejtë të zgjedhjes dhe që kanë nënshkruar deklaratë për themelimin e partisë politike[1122]. Nuk ekzistojnë kufizime ligjore në kuptim të ideologjisë partiake. Në përputhje me Kushtetutën, programet dhe veprimet e shoqërive të qytetarëve dhe partive politike, nuk mund të drejtohen me rrëzimin e dhunshëm të renditjes kushtetuese të Republikës dhe nxitje ose thirrje për agresion ushtarak ose nxitje të urrejtjes ose mosdurimit nacional rasor ose fetar[1123]. Anëtar i partisë politike mund të jetë çdo person i moshës së plotë dhe i aftë i Republikës së Maqedonisë që do të japë deklaratë për anëtarësim vullnetar në partinë politike[1124]. Partitë politike kanë për obligim të dorëzojnë nënshkrime të themeluesve të regjistruar në noter. Partia politike themelohet në Kuvend të themeluesve,

[1121] Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/1992, Neni8.
[1122] Ligji për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, Neni11 paragrafi (1).
[1123] Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 52/1992, Neni20.
[1124] Ligji për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, Neni11.

në të cilën merret vendim për themelim, program, status dhe zgjidhen organet përkatëse[1125]. Partitë politike kanë për obligim të shënojnë emrin, emrin e kryetarit dhe personave tjerë të autorizuar, si dhe adresën dhe selinë në Regjistrin Gjyqësor[1126]. Regjistrin unik gjyqësor të partive politike e udhëheq Gjykata Themelore Shkupi 2[1127]. Partia politike ka për obligim që në afat prej 30 ditësh nga dita e zhvillimit të kuvendit themelues të dorëzojë kërkesë për regjistrim në Regjistrin gjyqësor[1128], me dorëzimin e dokumenteve përkatëse[1129]. Nëse Gjykata konstaton që kërkesa për regjistrim në Regjistrin gjyqësor është e plotë, ka afat prej 15 ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës të dorëzojë zgjidhje për regjistrim të partisë në Regjistrin gjyqësor[1130]. Partia politike fillon me punë dhe përfiton të drejtën e një personi juridik në ditën e regjistrimit në Regjistritn gjyqësor.[1131]

Nëse Gjykata konstaton që kërkesa për regjistrim të partisë politike në Regjistrin gjyqësor është e paplotë, gjegjësisht programi dhe statuti nuk i përmbajnë çështjet e përcaktuara me ligj, do të thirër bartësin e kërkesës në afat prej 30 ditëve të plotësojë kërkesën për regjistrim në Regjistrin gjyqësor. Nëse parashtruesi i kërkesës për regjistrim në Regjistrin gjyqësor nuk siguron informata plotësuese, Gjykata do të marrë vendim me të cilin do të refuzojë kërkesën për regjistrim në Regjistrin gjyqësor.[1132]

Kundër vendimit me të cilin refuzohet kërkesa për regjistrim në Regjistrin gjyqësor lejohet ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit[1133]. Ligji përcakton edhe procedurën për shpërbërje të partisë politike[1134] si dhe mundësinë për ankesë.[1135]

Partitë politike financohen nga burime publike dhe private të financimit[1136]. Mjetet publike për financim të partive politike janë në shumë prej 0.06% të burimeve të plota të Buxhetit. Partitë politike mund të përdorin mjetet kryesisht për realizim të qëllimeve të përcaktuara me ligj, me status dhe akte tjera të partisë[1137]. Mjetet e financimit të partive politike, në shumë prej 30%, u shpërndahen në mënyrë të barabartë të gjitha partive politike që kanë fituar së paku 1% të votave të qytetarëve të dalë në zgjedhjet e fundit të deputetëve në Kuvend, në

[1125] Ligji për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, Neni14 paragrafi (1)p

[1126] Ligji për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, Neni17 paragrafi (1).

[1127] Ligji për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, Neni17-a.

[1128] Ligj për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, Neni18 paragrafi (1).

[1129] Me kërkesën për regjistrim të partisë politike në Regjistrin gjyqësor, dorëzohet edhe: procesverbal për punën e Kuvendit Themelues në të cilën shënon data dhe vendi i zhvillimit të Kuvendit Themelues; vendim për themelim; deklarata për themelim; program; statut; vendim për zgjedhje të organeve të partisë politike në të cilën do të theksohen emri personal i kryetarit të partisë politike gjegjësisht personi që do të përfaqësojë dhe prezantojë partinë politike dhe emri personal i personit, gjegjësisht personave përgjegjës për punën materiale-financiare; origjinale ose kopje të vendimeve për nënshtetësi të themeluesve të vërtetuar në noter dhe fotografi me ngjyrë të shenjës artistike-grafike të partisë politike.

[1130] Ligji për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, Neni21 paragrafi (1).

[1131] Ligji për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, Neni26 paragrafi (2).

[1132] Ligji për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, Neni20.

[1133] Ligji për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, Neni25 paragrafi (2).

[1134] Kur partia politike do të dorëzojë kërkesë për fshirje të Regjistrit Gjyqësor; në bazë të vendimit të plotë për parti politike ju është ndaluar veprim me vendim të plotë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji; kur organi i përcaktuar në përputhje me statutin ka marrë vendim për bashkim me parti tjetër politike; kur është zvogëluar numri i anëtarëve të partisë politike dhe kur Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë do të përcaktojë që programi ose statuti i partisë politike nuk janë në përputhje me Kushtetutën.

[1135] Ligji për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, Neni31 paragrafi (7).

[1136] Ligji për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, Neni7.

[1137] Ligji për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, Neni9.

nivel të gjithë Republikës, gjegjësisht zgjedhjet lokale në njësinë e vetëqeverisjes lokale. Të tjerat, 70%, u shpërndahen partive politike që kanë kandidatë të zgjedhur për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, proporcionalisht me numrin e deputetëve të tyre, gjegjësisht partive politike që kanë kandidatë të zgjedhur për këshilltarë në komunat e Republikës së Maqedonisë, proporcional me numrin e këshilltarëve të tyre[1138] Përveç kësaj, në përputhje me ndryshimet e ligjit të vitit 2015, buxheti shtetëror siguron 280.000 EUR për financimin vjetor të hulumtimeve në sajë të partisë.[1139]

Burimet e lejuara private të financimit të partive politike janë të ndryshme dhe përfshijnë mjete në të holla dhe tjera: anëtarësim, donacione (të holla, mallra materiale ose shërbime), dhurata, kontribute, dotacione, sponzorime, legate dhe shitje të materialit promovues dhe propagandë[1140]. Anëtarësia vjetore për parti nuk guxon të tejkalojë rrogën mesatare për vitin paraprak. Për vitin 2015, shuma ishte 21.104 denarë, gjegjësisht 343 EUR.[1141]

Partitë politike mund të pranojnë donacione në formë të paraave, mjeteve materiale ose shërbimeve[1142]. Partitë politike mund të pranojnë donacione në formë tjetër nëse ato, në përputhje me statutin e tyre, mund të përdoren për aktivitetet e tyre. Si donacion konsiderohet dhënia e shërbimeve falas partive politike, si dhe dhënia e shërbimeve për partitë politike që paguan person i tretë. Dhëniësi i shërbimit është i obliguar të njoftojë partinë politike për vlerën e shërbimit të dhënë[1143]. Si donacion, në përputhje me parimin e njëjtë, konsiderohet edhe shitja e mallrave dhe shërbimeve të partive politike me çmime më të ulëta nga ato të tregut. Dallimi ndërmjet vlerës së tregut dhe çmimit të paguar konsiderohet si donacion, dhe në përputhje me ndryshimet e vitit 2012, parashikohet që donatori t'i japë faturë partisë. Partia politike ka për obligim t'ia kthejë donatorit të gjitha mjetet që tejkalojnë kufizimin e donacionit. Përveç kësaj, ligji ndalon rreptësishtë donacione nga burime anonime ose të paidentifikuar. Nëse partitë politike përfitojnë mjete nga donator i paidentifikuar, ato mjete transferohen menjëherë në dobi të buxhetit shtetëror.[1144]

Fushata zgjedhore mund të financohet nga burime private në formë të anëtarësimit, donacioneve nga persona fizikë në shumë prej 5.000 EUR në vlerë me denarë, gjegjësisht jo më tepër se 5% e të ardhurave të plota të subjektit juridik nga vitit paraprak.[1145]

MF-ja, në përputhje me ndryshimet e ligjit, ka për obligim të sigurojë udhëzime dhe trajnim vjetor për partitë politike për rregulloren e vlefshme financiare.[1146]

11.1.2 RESURSET (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle mjetet financiare që janë në dispozicion të partive politike mundësojnë konkurrencë efektive politike?

Ndonëse partitë politike të Maqedonasë financohen nga burime të ndryshme, përfshirë

[1138] Ligji për financim të partive politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 76/04, 86/08, 161/08, 96/09, 148/11, 142/12, 23/13, Neni10p
[1139] Ligji për ndryshime të Ligjit për financimit të partive politike, nr.23/2013, neni10-a.
[1140] Ligji për financim të partive politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 76/04, 86/08, 161/08, 96/09, 148/11, 142/12, 23/13, neni13.
[1141] Enti Shtetëror i Statistikës, http://www.stat.gov.mk/ [qasur më8 maj, 2014].
[1142] Ligji për financim të partive politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 76/04, 86/08, 161/08, 96/09, 148/11, 142/12, 23/13, neni15.
[1143] Njëlloj.
[1144] Ligji për financim të partive politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 76/04, 86/08, 161/08, 96/09, 148/11, 142/12, 23/13, neni16.
[1145] Kodi Zgjedhor, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni83.
[1146] GREKO, 2014: paragrafi (27), f. 5.

edhe anëtarësimin dhe donacionet[1147], ka një dallim të madh në shpërndarjen ndërmjet dy partive në pushtet dhe opozitës. Partitë në koalicion me partitë në pushtet fitojnë më tepër donacione, ndërsa, partitë në opozitë kanë probleme financiare që seriozisht ndikojnë mbi funksionimin e tyre, aktivitetet operative dhe vënë në pikëpyetje ekzistimin e tyre[1148]. Kjo e gropon konkurrencën efektive politike.

Në bazë të raporteve të dhëna nga partitë politike tek Enti Shtetëror i Revizionit, partia në pushtet VMRO-DPMNE[1149] në vitin 2013 ka marrë donacione në shumë prej 185.040 EUR[1150], ndërsa, në vitin 2014, shuma ka qenë 1.656.719 EUR[1151]. Partneri i koalicionit nga blloku shqiptar BDI,[1152] në vitin 2013 ka marrë donacione në shumë prej 90.220 EUR[1153], ndërsa në vitin 204 kjo shumë ka qenë 36.851 EUR[1154]. Donacionet e partive politike janë më të vogla, për shembull, partia më e madhe opozitare LSDM[1155] ka fituar 5.185 EUR[1156] në vitin 2013, dhe 8.878 EUR[1157], në vitin 2014, ndërsa Partia Liberale e Maqedonisë ka fituar donacione prej vetëm 276 EUR[1158] në vitin 2013. Megjithatë, disa parti politike në vitin 2014 aspak nuk kanë fituar donacione[1159].

PARTI POLITIKE	DONACIONE 2013	DONACIONE 2014
VMRO-DPMNE	185.040 EUR	1.656.719 EUR
BDI	90.220 EUR	36.851 EUR
LSDM	5.185 EUR	8.878 EUR
Partia Liberale	276 EUR	715 EUR

Personat fizikë dhe përfaqësues të sektorit afarist kanë frikë tu japin donacione partive opozitare, frikë nga hakmarrja nga partia në pushtet dhe institucionet që janë në kontrollin e saj[1160]. Njihet mirë që ndërmarrjet që nuk bashkëpunojnë me partinë në pushtet përballen me shtypje[1161]. Bisedat e përgjuara telefonike që kanë dalë në publik zbulojnë keqpërdorim të pushtetit nga partia në pushtet, ku partia VMRO-DPMNE mbyll ndërmarrje private, restorante dhe kafeteri dhe dënon ndërmarrje që refuzojnë të bashkëpunojnë me pushtetin.[1162]

Burimet publike janë burimi i vetëm financimit të partive më të vogla politike. Donacionet private janë tërësisht të humbura. Disa parti kanë nisur me anëtarësime, por ajo nuk sjell të ardhura të mëdha, kryesisht për shkak të numrit të vogël të anëtarëve në partitë politike të opozitës[1163]. Mjetet publike janë të siguruara nga Buxheti dhe shpesh nuk paguhen me

[1147] Intervistë me Kire Buzlievin, zëvendës-kryetar i Partisë Liberale e Maqedonisë, 11.5.2015
[1148] Intervistë me Sonja Mirakovskën, Sekretare Organizative e NSDP-së, ish anëtare e Kuvendit në periudhën 2008-2011, 2011-2014 (interviste ballë për ballë)11.5.2015
[1149] Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike e Unitetit Kombëtar Maqedonas.
[1150] http://www.dzr.mk/Uploads/11_DONACII_2013_VMRO_DPMNE.pdf [qasur më13 maj, 2014].
[1151] http://www.dzr.mk/Uploads/6_VMRO_DPMNE_2014.pdf [qasur më14 mars, 2016].
[1152] Bashkimi Demokratik për Integrim
[1153] http://www.dzr.mk/Uploads/6_DONACII_2013_DUI.pdf [qasur më10 maj, 2014].
[1154] http://www.dzr.mk/Uploads/4_Demokratska_unija_integracija_DUI_komplet.pdf [qasur më14 mars, 2016].
[1155] Unioni Social Demokratik i Maqedonisë.
[1156] http://www.dzr.mk/Uploads/8_DONACII_2013_SDSM.pdf [qasur më10 maj, 2014].
[1157] http://www.dzr.mk/Uploads/5_SDSM_5.pdf [qasur më 14 mars, 2016].
[1158] http://www.dzr.mk/Uploads/9_DONACII_2013_Liberalna_partija.pdf [qasur më10 maj, 2014].
[1159] http://www.dzr.mk/Uploads/3_Demokratska_partja_Albancite_DPA_2014.pdf [qasur më 14 mars, 2016].
[1160] Intervistë me Sonja Mirakovskën, Sekretare Organizative e NSDP-së, ish anëtare e Kuvendit në periudhën 2008-2011, 2011-2014 (interviste ballë për ballë) 11.5.2015
[1161] http://libertas.mk/%D1%82%D1%80%D0%B0%D0%BD%D1%81%D0%BA%D1%80%D0%B8%D0%BF%D1%82-6-%D0%B1%D0%BE%D0%BC%D0%B1%D0%B0-22-%D0%BC%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%BD%D0%B8%D0%BA%D-0%BE-%D0%BF%D0%B5%D1%82%D1%80%D0%BE%D0%BB/ [qasur më12 maj, 2014].
[1162] http://telma.com.mk/vesti/zaev-vlasta-vleguva-od-laga-vo-laga-za-da-ja-sochuva-kozhata [qasur më13 maj, 2014].
[1163] Intervistë me Sonja Mirakovskaën, Sekretare Organizative e NSDP-së, ish anëtare e Kuvendit në periudhën 2008-2011, 2011-2014 (interviste ballë për ballë) 11.5.2015

kohë. Ligji nuk sqaron si duhet të shpërndahen mjetet për financim të hulumtimeve ndërmjet partive.[1164]

MF-ja ka publikuar dy manuale për përgatitje të raporteve financiare dhe vjetore nga fushata.[1165]

11.1.3 PAVARËSIA (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle ka masa ligjore mbrojtëse për të parandaluar përzierjen e padrejtë në punën e partive politike?

Organet e administratës publike kanë autorizim të urdhërojnë ndalim të veprimit të partisë politike. Fillimisht, nëse Gjykata Kushtetuese përcakton që programi ose statusi i partisë politike nuk është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, Gjykata Themelore Shkup, si gjykatë regjistrimi, në bazë të vendimit merr vendimin për përcaktim të ndalimit të partisë politike[1166]. Në bazë të vendimit, Gjykata e fshin partinë politike nga Regjistri Gjyqësor[1167]. E dyta, nëse veprimi i partisë politike është në kundërshtim me ligjin[1168], prokurori publik përgjegjës dorëzon propozim për ndalim të veprimit të partisë politike[1169]. Nëse partia politike është regjistruar në Regjistrin Gjyqësor në bazë të të dhënave të pasakta[1170], ose nëse emri dhe shenjat e partisë politike nuk janë në përputhje me ligjin[1171], prokurori publik përgjegjës jep propozim para Gjykatës për ngritje të procedurës për fshirje të partisë politike nga Regjistri Gjyqësor. Kundër vendimit mund të dorëzohet ankesë në Gjykatën e Apelit, që vendos për ankesën në afat prej tetë ditësh nga pranimi i ankesës. Vendimi me fuqi të plotë për ndalim të veprimit të partisë politike dorëzohet në Gjykatë për shkak të fshirjes së partisë politike nga Regjistri Gjyqësor.[1172]

Partive politike u garantohet liri dhe pavarësi në veprimtari[1173], dhe ndalohet që partitë politike të financohen nga burime të huaja (qeveri, institucione ndërkombëtare dhe organizata të shteteve të huaja dhe persona tjerë të huaj) dhe të pranojnë mjete nga banka të huaja ose institucione tjera financiare jashtë Republikës së Maqedonisë.[1174]

11.1.4 PAVARËSIA (PRAKTIKA)

Nota **25**

[1164] Njëlloj.
[1165] Publikuar në Gazetë Zyrtare nr. 21/2013.
[1166] Ligji për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, neni38.
[1167] Njëlloj.
[1168] Ligj për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, neni3 и Neni6 paragrafi (3).
[1169] Ligji për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, neni33.
[1170] Ligji për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, neni31.
[1171] Ligji për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, neni32.
[1172] Ligji për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, neni36.
[1173] Ligji për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, neni6.
[1174] Ligji për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, neni20.

Në çfarë shkalle partitë politike janë të liruara nga përzierja e papërshtatshme në punën e tyre në praktikë?

Nuk ka dëshmi që shteti shpërbën ose ndalon parti politike në Maqedoni, megjithatë, ekzistojnë dëshmi për keqtrajtim dhe sulme mbi partitë opozitare. Ka një shkallë të madhe të shqetësimit për ndikim të drejtë nga partia në pushtet VMRO-DPMNE. Partia tregon fuqi me anë të shtypjes mbi anëtarët e partive më të vogla të bashkohen me partinë në pushtet ose të përfshihen në koalicion[1175]. Disa politikanë[1176] nga partitë më të vogla janë qasur në VMRO-DMPNE. Sipas liderëve të këtyre partive, ky hap në kohën e njëjtë është pragmatik dhe i duhur për fitim të zgjedhjeve të ardhshme.[1177]

Bisedat e përgjuara, të publikuara nga lideri i LSDM-së, e kanë zbuluar shkallën e keqtrajtimit dhe sulmeve mbi kundërshtarët politikë. Incizimet zbulojnë biseda si të ndikohen mbi mediet dhe të bëjnë shtypje për arrestimin e Lube Boshkoskit (lider i partisë opozitare) shkarkim nga puna në institucionet publike të personave që nuk janë anëtarë të VMRO_DPMNE-së dhe ndalimi i aktivistëve të opozitës të arrijnë në mbledhje partiake[1178]. Në një incizim, Ministrja e Punëve të Brendshme Gordana Jankulloska thotë: “Ne duhet të përpilojmë listën dhe t’i shkatërrojmë. Nuk mund të paguajmë dikë që na keqtrajton gjatë fushatës. Ai që ka qenë sigurim nuk do të punojë në MPB“.

Gjatë periudhave zgjedhore ndodhin sulme fizike, dëmtime të selive të partive dhe kërcënime drejtuar anëtarëve partiakë, ndërsa partia në pushtet e keqpërdor fuqinë e institucioneve dhe medieve pro qeveritare për të manipuluar popullin[1179]. Bisedat e publikuara telefonike zbulojnë biseda ndërmjet drejtorit të DHP-së dhe drejtorit të Kanal 5 për gjetje të mënyrës së pagesës së donacionit nga TV kanali për partinë në pushtet.[1180]

Në Raportin e BE-së për përparimin në vitin 2013 është theksuar që “mediet në mënyrë të plotë e mbulojnë fushatën parazgjedhore, por radio-difuzerë të caktuar, përfshirë edhe servisin publik, nuk kanë siguruar mbulim të baraspeshuar të fushatës[1181]”. Ka një shqetësim serioz për lirinë e medieve si rezultat i faktorëve, siç janë fuqia mediale e shtetit, lidhjeve politike të pronarëve të medieve të mëdha, mbyllja e gazetave të pavarura, si dhe zgjerimi i kontrollit qeveritar mbi transmetimin[1182]. „Fridom Haus“ e rendit Maqedoninë si “pjesërisht e lirë”, ndërsa vitin e kaluar ka deklaruar që gjendjet në vend “janë keqësuar në krahasim me vitin 2006” në kuptim të “notës për demokraci” të organizatës. Sipas Indeksit të Censurës, Maqedonia është “vendi i vetëm në Evropën Juglindore me gazetarë të burgosur“.[1183]

Mediet ndërkombëtare, gjithashtu, kanë publikuar pohime për përzierje të gjerë të Qeverisë pothuaj se në gjitha fushat, përfshirë edhe të drejtën, mediet, sektorin afarist dhe institucionet private. Konsiderohet që sektori privat i është nënshtruar ndikimit qeveritar.[1184]

[1175] Intervistë me Sonja Mirakovskën, Sekretare Organizative e NSDP-së, ish anëtare e Kuvendit në periudhën 2008-2011, 2011-2014 (interviste ballë për ballë) 11.5.2015

[1176] Ljube Boshkovski (që ka themeluar partinë të Bashkuar për Maqedoninë), Marjan Gjorqev (Partia Bujqësore e Maqedonisë), Filip Petrovski (Partia Demokratike), Dosta Dimovska (Unioni Demokratik Republikan i Maqedonisë), Boris Zmejkovski (VMRO-E vërteta), Marjan Dodovski dhe Ljupço Georgievski (VMRO Partia Popullore).

[1177] Aleksandar Cekov dhe dr. Zhidas Daskallovski, Analiza e Demokracisë Brenda Partiake në Maqedoni, (Shkup: Fondacioni Konrad Adenauer, 2013), f. 16 http://www.kas.de/wf/doc/kas_33615-1522-2-30.pdf?130225094644 [qasur më13 maj, 2014].

[1178] http://meta.mk/en/tretata-bomba-mestele-se-zhivo-i-divo/ [qasur më13 maj, 2014].

[1179] ”Ka pasur situata në të cilat partia në pushtet ka marrë gjitha bilbordet e qytetit dhe ka lënë partitë tjera pa mundësi për marrje të një bilbordi”, thotë Sonja Mirakovska.

[1180] Intervistë me Sonja Mirakovskën, Sekretare Organizative e NSDP-së, ish anëtare e Kuvendit në periudhën 2008-2011, 2011-2014 (interviste ballë për ballë) 11.5.2015

[1181] Komisioni Evropian, 2014: f. 6.

[1182] http://www.bne.eu/content/story/macedonia%E2%80%99s-government-wins-double-election-victory [qasur më31 maj, 2014].

[1183] https://freedomhouse.org/report/freedom-press/2015/macedonia [qasur më 28 maj, 2014].

[1184] http://www.balkaninsight.com/en/article/eradicating-corruption-must-be-macedonia-s-priority [qasur më 13 maj, 2014].

QEVERISJA

11.2.1 TRANSPARENCA (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle ka rregulla në përputhje me të cilat partitë obligohen që informatat e tyre financiare të jenë të gatshme në publik?

Ligji nuk siguron punë transparente të partive politike. Dispozitat ekzistuese për transparencë kanë të bëjnë kryesisht me çështje financiare, dhe jo për aktivitete të partive. Në përputhje me ligjin, të ardhurat dhe shpenzimet e partisë politike janë publike[1185] dhe ligji e rregullon mënyrën e kryerjes së kontrollit të brendshëm të financimit të partisë politike.[1186]

Llogaria financiare e punës financiare të partive politike dorëzohet në ESHR, Regjistrin Qendror dhe DHP më së voni deri më 31 mars[1187]. Raportet vjetore përmbajnë të dhëna për të ardhurat dhe shpenzimet e plota të partisë politike[1188]. Nëse ESHR përcakton parregullsi në raportet financiare të partive politike, duhet të dorëzojë kërkesë për nisje të procedurës penale ose kallëzim te prokurori publik në afat prej 30 ditësh nga dita e përcaktimit të parregullsive[1189]. Partia politike ka për obligim që në mënyrë publike të publikojë llogarinë vjetore në internet faqen e saj.[1190]

Partitë politike mbajnë Regjistër të donacioneve. Regjistri i donacioneve për parti politike dhe kandidatë zgjedhorë i përmban emrin (gjegjësisht titullin e çdo donatori në veçanti), llojin dhe vlerën e donacionit dhe datën e marrjes së donacionit të subjekteve të lidhura, drejtpërdrejtë ose jo, me partitë politike ose nën kontrollin e tyre[1191]. Me ndryshimet e ligjit në vitin 2011, pjesërisht sqarohet obligimi për mbajtjen e Regjistrit të donacioneve dhe publikimit në internet faqen në çdo gjashtë muaj, gjegjësisht detyrimi që regjistri të bëhet publik në ndonjë mënyrë tjetër[1192]. Formularin për raportin e përcakton ministri i Financave, ndërsa ndryshimet e ligjit të vitit 2012 përmbajnë edhe udhëzimet për mënyrën e plotësimit.[1193]

Organizatorët e fushatave zgjedhore kanë për obligim të dorëzojnë tre raporte financiare për fushatat zgjedhore, me qëllim të sigurimit dhe respektimit të parimeve të transparencës dhe llogaridhënies. Megjithatë, ligji nuk obligon donatorët të dorëzojnë raportet për mbështetjen e tyre financiare për partitë politike.[1194]

Nëse partia politike nuk dorëzon raport vjetor në ESHR me kohë dhe nuk publikon të dhënat për donacionet e pranuara gjatë vitit paraprak, gjegjësisht nuk publikon raportin financiar para skadimit të afatit, pagesa e mjeteve për financim të rregullt vjetor nga Buxheti do të pezullohen për periudhë prej tre muajve[1195]. Në këto raste, ministri i Drejtësisë merr vendimin

[1185] Ligji për financim të partive politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 76/04, 86/08, 161/08, 96/09, 148/11, 142/12, 23/13, neni23.
[1186] Ligji për financim të partive politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 76/04, 86/08, 161/08, 96/09, 148/11, 142/12, 23/13, neni24.
[1187] Ligji për financim të partive politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 76/04, 86/08, 161/08, 96/09, 148/11, 142/12, 23/13, neni26.
[1188] Ligji për financim të partive politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 76/04, 86/08, 161/08, 96/09, 148/11, 142/12, 23/13, neni27.
[1189] Njëlloj.
[1190] Ligji për financim të partive politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 76/04, 86/08, 161/08, 96/09, 148/11, 142/12, 23/13, neni27-а.
[1191] Ligji për financim të partive politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 76/04, 86/08, 161/08, 96/09, 148/11, 142/12, 23/13, neni17.
[1192] Njëlloj.
[1193] Ligji për financim të partive politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 76/04, 86/08, 161/08, 96/09, 148/11, 142/12, 23/13, neni27.
[1194] Sllagjana Taseva, Blerja e ndikimit: Të hollat dhe politikat e Republikës së Maqedonisë (Shkup: Transparency International - Maqedoni, 2012), f. 12.
[1195] Ligji për financim të partive politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 76/04, 86/08, 161/08, 96/09, 148/11, 142/12, 23/13, neni27-б.

në bazë të propozimit të ESHR-së. Kundër vendimit mund të paraqitet padi[1196].

11.2.2 TRANSPARENCA (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle publiku mund të merrë të dhëna përkatëse financiare nga partitë politike?

Partitë politike në mënyrë formale e plotësojnë një pjesë të obligimeve ligjore në lidhje me transparencën e financave të tyre. Megjithatë, ato nuk publikojnë listë të donatorëve dhe nuk ka kontroll efikas të shpenzimit të tepruar. Ka dobësi në kuptim të transparencës së partive politike në Maqedoni, në kuptim të financimit të rregullt dhe financimit të fushatave zgjedhore.[1197]

ESHR-ja dhe DHP-ja publikojnë raporte vjetore financiare dhe të dhëna për donacionet e partive politike në internet faqet e tyre[1198]. Ka një përparim në lidhje me edukimin e partive politike për obligimet e tyre financiare[1199]. Bashkëpunimi ndërmjet subjekteve që janë të përfshira në mbikëqyrjen e financimit politik është përmirësuar, ndërsa përqindja e sanksioneve në kuptim të dorëzimit të raporteve të nevojshme financiare është në përmirësim.[1200]

Ndryshimet ligjore të vitit 2011 kanë zvogëluar obligimin e partive politike të publikojnë raportet në internet faqet e tyre, duke shtuar formulimin "të behet e gatshme për publikun në ndonjë mënyrë tjetër", që ka dy kuptime. Në fakt, pjesa më e madhe e raporteve financiare publikohen në internet faqet zyrtare[1201], por ndryshimet në ligjin ishin nxitur nga fakti që një numër i madh i partive nuk kanë internet faqe, dhe nuk kanë atë obligim. Nuk ka udhëzimet për mënyrën e kryerjes së obligimit të tyre partitë politike, dhe për shkak të mospublikimit mund të rezultojë gjobë në të holla[1202]. Pezullimi i të drejtës së partive politike për të marrë mjete financiare nga Buxheti ka siguruar publikim me kohë të raporteve financiare.

Nuk ka reagim të ashpër publik për mungesën e transparencës së partive politike.[1203]

11.2.3 LLOGARIDHËNIA (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle ka dispozita me të cilat rregullohet mbikëqyrja financiare e partive politike nga ndonjë organ i caktuar i administratës shtetërore?

Ligjet përmbajnë shumë dispozita në lidhje me llogaridhënien e financimit të partive politike. Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për financim të partive politike nga viti 2012 pjesërisht i ndjekin rekomandimet e GREKO-s dhe OSBE/ODHIR dhe i përcaktojnë kompetencat

1196 Ligji për financim të partive politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 76/04, 86/08, 161/08, 96/09, 148/11, 142/12, 23/13, neni27-б и 27-в.
1197 Taseva, 2012: f. 13.
1198 http://www.dzr.mk/DesktopDefault.aspx?tabindex=0&tabid=1073 [qasur më 14 maj, 2014]. http://www.ujp.gov.mk/s/vodic/category/865 [qasur më 14 maj, 2014]
1199 GREKO, 2014: f. 9.
1200 GREKO, 2014: f. 9.
1201 Intervistë me Kire Buzklievin, zëvendës-kryetar i Partisë Liberale të Maqedonisë, 11.5.2015
1202 Iskra Andreeva dhe Aleksandra Markovska, *Të hollat dhe politika: Raporti vjetor: transparenca e financimit të partive politike,* (Shkup: Transparencë Maqedoni, 2013), f. 14. http://www.transparentnost-mk.org.mk/Upload/ dokumenti/transparentnost%20vnatreshen%20del%20ANG%20za%20na%20web%2002.pdf [qasur më27 maj, 2014].
1203 Intervistë me Kire Buzklievin, zëvendës-kryetar i Partisë Liberale të Maqedonisë, 11.5.2015

e KSHZ-së, ESHR-së dhe të KSHPK-së gjegjësisht institucionet që bashkë e përbëjnë mekanizmin e kontrollit[1204]. Partitë kanë për obligim të dorëzojnë raport financiar tek institucionet kompetente që kanë për obligim ta publikojnë në internet faqet e tyre.[1205]

Kodi zgjedhor i sqaron obligimet e organizatorët e fushatave zgjedhore në lidhje me dorëzimin e raporteve dhe periudhave raportuese[1206]. Pjesëmarrësi në fushatën zgjedhore ka për obligim të dorëzojë tre raporte financiare për të siguruar respektimin e parimeve të transparencës dhe llogaridhënies[1207]. Në fakt, pjesëmarrësi në fushatën zgjedhore ka për obligim që në ditën e njëmbëdhjetë të fushatës zgjedhore të dorëzojë raporte financiare për të ardhurat dhe shpenzimet e gjiro-llogarisë për fushatën zgjedhore, nga dita e hapjes deri në fund të ditës së dhjetë të fushatës[1208]. Një ditë para zhvillimit të rrethit të dytë të votimit duhet të dorëzohet raporti i dytë financiar; dhe në fund, pas përfundimit të fushatës zgjedhore, përgatitet raporti i tretë për gjysmën e dytë të fushatës[1209]. Pjesëmarrësi në fushatën zgjedhore ka për obligim menjëherë, dhe në afat më së voni 30 ditë nga dita e përfundimit të fushatës zgjedhore, të dorëzojë raport të plotë financiar për fushatën zgjedhore.[1210]

Ministri i Financave përgatit formularin për raportin më të cilin përfshin të dhëna për emrin ose titullin e donatorit, llojin dhe shumën e donacionit, datën kur është pranuar donacioni dhe shpenzimet për çdo donacion, si dhe të ardhura dhe shpenzime për fushatën e plotë zgjedhore.[1211]

Kandidatët zgjedhorë kanë për obligim të regjistrojnë numrin unik tatimor dhe të hapin llogari të veçanta bankare me të cilat do të bëhen të gjitha transaksionet financiare të lidhura me fushatën zgjedhore. Personat fizikë mund të bëjnë donacione në mjete në shumë prej 5.000 EUR në kundërvlerë me denarë, ndërsa personat juridikë në shumë prej 50.000 EUR në kundërvlerë me denarë. Mallrat dhe shërbimet që shiten me lirim konsiderohen si donacione pa të holla dhe njehsohen sipas çmimeve të tregut. Ndalohen donacione nga burime anonime, si dhe donacione nga burime publike dhe të huaja, shoqata të qytetarëve dhe grupe fetare.[1212]

Në afat prej 60 ditëve nga dita e parashtrimit të raportit financiar, ESHR-ja ka për obligim të zbatojë revizionin[1213]. Revizioni zbatohet nga dita e hapjes së llogarisë së transaksionit për fushatën zgjedhore deri në përfundimin e transaksioneve në atë llogari. Nëse ESHR-ja konstaton parregullsi në raportin financiar të pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore, të cilat janë në kundërshtim me Kodin zgjedhor, dorëzon kërkesë për zbatimin e procedurës penale ose denoncim te prokurorin kompetent publik në afat prej 30 ditëve nga dita e përcaktimit të parregullsive.[1214]

KSHPK-ja është kompetente për monitorimin e aktiviteteve financiare të fushatës zgjedhore të partive politike, si dhe për monitorimin e raporteve të tyre financiare dhe aktivitetet me qëllim të përcaktimit nëse partitë politike përdorin burime të palejuara të financimit. Më së voni në afat prej tre muajve, KSHPK-ja duhet t'i dorëzojë Kuvendit raport të hollësishëm për

[1204] GREKO, 2014: f. 6.
[1205] Kodi zgjedhor, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 и 32/14, neni84-б (7).
[1206] GREKO, 2014: paragraf 13, f. 3.
[1207] Kodi zgjedhor, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 и 32/14, neni84-б.
[1208] Kodi zgjedhor, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 и 32/14, neni84-б (1).
[1209] Kodi zgjedhor, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 и 32/14, neni84-б (2).
[1210] Kodi zgjedhor, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 и 32/14, neni85 (1).
[1211] Kodi zgjedhor, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 и 32/14, neni84-b, (3).
[1212] Kodi zgjedhor, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 и 32/14 neni83.
[1213] Kodi zgjedhor, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 и 32/14 neni85.
[1214] Kodi zgjedhor, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 и 32/14 neni86 (6).

keqpërdorimet e mundshme të mjeteve buxhetore, fondet publike dhe mjetet e ndërmarrjeve publike dhe personave juridikë që disponojnë me kapital shtetëror.[1215]

KSHZ-ja merr raporte financiare nga partitë politike që marrin pjesë në fushatën zgjedhore dhe ka për obligim të publikojë në internet faqen e saj.[1216]

Nëse shuma e donacionit e tejkalon shumën e përcaktuar me ligj, partia politike nuk mund ta përdorë dhe ka për detyrë që menjëherë, dhe më vonë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit, të kthejë dallimin ndërmjet vlerës së lejuar dhe të dhënë nga donatori. Nëse origjina e donacionit nuk mund të përcaktohet, partia politike duhet menjëherë, dhe në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të donacionit, të transferojë shumën e dhënë në buxhetin shtetëror.[1217]

Ligji parashikon gjoba në të holla në forma të ndryshme që parashikojnë humbje të kompensimit të shpenzimeve për fushatë zgjedhore[1218], gjoba për keqpërdorim të mjeteve buxhetore, gjegjësisht padi penale për partinë politike ose koalicionin, nëse nuk i kthejnë mjetet në afatin e përcaktuar të donatorëve në rast të mosdorëzimit të listës së kandidatëve. Gjobë në shumë prej 4.000 deri 5.000 EUR në kundërvlerë me denarë do të shqiptohet për shkelje të partisë politike, koalicionit, bartësit të listës së pavarur nga grup i votuesve, gjegjësisht persona që kanë pasur qëllim të paraqesin kandidaturë nëse donacionet e dhëna nuk u kthehen dhënësve në afatin e parashikuar[1219]. Ka një dobësi të ligjit, sepse ligji nuk obligon donatorët të dorëzojnë raporte për mbështetjen e tyre financiare për partitë politike. Kjo konsiderohet si mangësi e ligjit.[1220]

11.2.4 LLOGARIDHËNIA (PRAKTIKA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle ka mënyrë efikase të mbikëqyrjes financiare të partive politike në praktikë?

Sistemi ekzistues, në të cilin realizimi i kontrollit financiar është shpërndarë nëpërmjet institucioneve të ndryshme, është njollosur me dobësinë e mekanizmave të revizionit dhe verifikimit.

Ndonëse ka obligim për dorëzimin e raporteve periodike që duhet të publikohen nga trupi qendror kontrollues, ka dobësi në kuptim të llogaridhënies së partive politike në drejtim të financimit të tyre të rregullt dhe financimit të fushatave zgjedhore[1221]. Përveç mos publikimit të listës së donatorëve, ka edhe një problem serioz që ka të bëjë me shpenzimin e tepërt nga partitë gjatë fushatave zgjedhore, sepse shpesh harxhohen shuma që që tejkalojnë depozitat e llogarive të veçanta bankare. Ka raste kur partitë politike që paraqesin shuma të mëdha të shpenzuara prej disa milion denarësh, ndërsa llogaritë nuk janë paguar para mbylljes së llogarisë së veçantë[1222]. Megjithatë, kjo nuk është reviduar dhe konfirmuar në mënyrë efikase nga personat përgjegjës.

[1215] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, neni12.
[1216] Kodi zgjedhor, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni85 (8).
[1217] Ligji për financim të partive politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 76/04, 86/08, 161/08, 96/09, 148/11, 142/12, 23/13.
[1218] Kodi zgjedhor, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni177-a.
[1219] Kodi zgjedhor, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, neni188-a.
[1220] Taseva, 2012: f. 12.
[1221] Taseva, 2012: f. 13.
[1222] Njëlloj.

Bashkëpunimi ndërmjet ESHR-së dhe subjekteve tjera të përfshira në mbikëqyrjen e financimit politik është përmirësuar, ndërsa përqindja e sanksioneve është në përmirësim.

Autorizimet dhe resurset e ESHR-së duken të pamjaftueshme për të mundësuar kontroll efektiv të origjinës së donacioneve[1223]. Mbikëqyrja nga ESHR-ja është kufizuar në revizion të informatave që dorëzohen nga kandidatët zgjedhorë, ndërsa ESHR-ja nuk ka mjete për të përcaktuar nëse janë të dhënat e sakta[1224]. Një prej rekomandimeve të Misionit të OSBE/ODHIR për vëzhgimin e zgjedhjeve në vitin 2014 është që "duhet të merret parasysh përcaktimi i autorizimeve plotësuese për ESHR-në për të bërë revizion të plotë të financimit të fushatës zgjedhore, përfshirë edhe autorizimin për të kërkuar dokumentacion plotësues dhe dëshmi nga partitë për të siguruar revizion të plotë të çdo shkeljeje"[1225]. Përveç kësaj, donacionet nga personat fizikë duhet të jenë lëndë e kontrollit dhe me rëndësi kryrsore për të themeluar një mekanizëm për përcaktimin e origjinës së këtyre donacioneve, siç është pagesa e mjeteve nga llogaria e donatorit.[1226]

Raporti i përparimit i KE-së për vitin 2014 gjithashtu thekson nevojën e përforcimit të rregullave për verifikim të shpenzimeve. Mbyllja e llogarive bankare nga fushatat dhe trajtimi i borxheve nga fushata ende duhet të rregullohet për të ndaluar keqpërdorimin. Gjoba për shkelje të ligjvënies relevante kanë filluar të zbatohen në praktikë, por evidenca e drejtë në këtë fushë duhet të zhvillohet, ndërsa mungesa e transparencës dhe llogaridhënies së partive politike në lidhje me financimin e partive politike edhe më tutje paraqet problem.[1227]

Me rëndësi është që përveç asaj që ESHR-ja mund të kërkojë nga KSHZ-ja të pezullojë pagesën e shpenzimeve për kandidatët zgjedhorë të fondeve shtetërore, pjesërisht ose tërësisht, nëse zbulohen parregullsi, nuk ka sanksione efikase për mos dorëzimin e raporteve financiare. Gjithashtu, mund fillohet procedurë penale ose të dorëzohen raporte te Prokurori Publik në afat prej 30 ditëve. Megjithatë, nuk ka afate për gjykatat për të vendosur për këto shkelje, ndërsa palët në fjalë nuk kanë të drejtë të dorëzojnë parashtresa për shkelje financiare, në kundërshtim me praktika të mira ndërkombëtare.[1228]

Përgatitja e formularëve dhe udhëzimeve për plotësim të formularëve nga MF-ja është hap pozitiv që duhet të përmirësojë informatat që i jepen votuesve në lidhje me financimin e fushatave dhe të promovojë gatishmëri në plotësimin e formularëve për zbardhje financiare.[1229]

11.2.5 INTEGRITETI (E DREJTA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle ka rregullore organizative në lidhje me udhëheqjen demokratike brenda partisë të partive kryesore politike?

Rregullorja e udhëheqjes demokratike të partive politike është e kufizuar. Partitë politike kanë për obligim të përcaktojnë zgjedhjen e udhëheqjes së partisë[1230]. Ato kanë për obligim

[1223] Komisioni Evropian, 2014: f. 43.
[1224] OSBE/ODHIR, 2014: f. 15 dhe 16.
[1225] Njëlloj.
[1226] Andreeva dhe Markovska, 2013: f. 36.
[1227] Komisioni Evropian, 2014: f. 43.
[1228] OSBE/ODHIR Raporti final i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve, 2014: f. 16.
[1229] Komisioni i Venedikut, Mendim i përbashkët për Kodin zgjedhor të Republikës së Maqedonisë, miratuar nga Këshillin e për Zgjedhje Demokratike në mbledhjen e 45-të (Venedik, 13 qershor 2013) dhe nga ana e Komisionit të Venedikut në seancën plenare të 95-të (Venedik, 14-15 qershor 2013), paragrafi 28, f. 7.
[1230] Ligj për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, neni16.

të rregullojnë kushtet dhe mënyrën e anëtarësimit dhe ndërprerjes ts anëtarësisë dhe të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e partisë politike, mënyrën e zgjedhjes së tyre dhe tërheqjes, si dhe mënyrën e vendimit.[1231]

As statuti i partisë politike, as Kodi zgjedhor nuk parashikojnë rregullore për zgjedhje të kandidatëve nga partitë politike. Kjo çështje trajtohet në statutin partiak, ndërsa përzgjedhja e kandidatëve është nën kontrollin e komiteteve qendrore.

Në VMRO-DPMNE, Kongresi është organi më i lartë në parti. Kongresi zgjedh kryetarin e partisë dhe anëtarët e trupave përkatës, komisione dhe organe tjera[1232]. Kandidatët për kryetarë mund të propozojnë së paku tridhjetë kandidatë në kongres. Për kryetar të partisë është zgjedhur kandidati që ka fituar shumicën e votave nga numri i plotë i kandidatëve[1233]. Mandati i kryetarit të partisë zgjat katër vite[1234]. Kryetari i partisë në kohën e njëjtë është edhe kryetar i Komitetit Qendror dhe Komitetit Ekzekutiv[1235]. Ai përfaqëson dhe prezanton partinë, kryeson seancat e organeve dhe në mënyrë aktive merr pjesë në krijimin e politikave partiake.

BDI-ja është parti e centralizuar dhe personalizuar me marrëdhënie në hierarki mes organeve qendrore dhe lokale. Kryetari i BDI-së vendos përfaqësim me anë të verifikimit të themelimit të tyre[1236]. Organet qendrore të partisë janë: kongresi, këshilli i përgjithshëm, këshilli drejtues, kryetari, kryesia, komisioni i statutit, këshilli mbikëqyrës dhe gjykata e nderit.[1237]

11.2.6 INTEGRITETI (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle ka drejtim efektiv demokratik brenda partisë në praktikë?

Partitë politike nuk kanë mekanizma efikase për demokraci të brendshme. Lideri i partisë është figurë dominuese që merr vendime.[1238]

Pothuaj se të gjitha partitë politike janë organizuar në mënyrë të ngjashme: organizim komunal në nivelin lokal dhe një trup më të gjerë përfaqësues dhe trup ekzekutiv në nivelin qendror[1239]. Në kuptimin formal, në përputhje me dispozitat ligjore, programe dhe platforma, ka demokraci brenda partiake me të cilën garantohet liria e shprehjes së mendimit, madje edhe kur ajo është në kundërshtim me qëndrimet zyrtare të partisë[1240]. Në disa parti, kritika është parashikuar me statutet partiake, por në praktikë, kritikuesit janë margjinalizuar dhe të shkëputur nga partitë.[1241]

Në çdo parti, roli i kryetarit të partisë është pozitë kryesore me të cilën emërohet kryesia e

[1231] Ligj për partitë politike, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 76/04, 5/07, 8/07, 5/08, 23/13, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.. 57/07, 60/07, neni16.
[1232] Statuti i VMRO-DPMNE, neni 18.
[1233] Statuti i VMRO-DPMNE, neni 20.
[1234] Statuti i VMRO-DPMNE, neni 20.
[1235] Statuti i VMRO-DPMNE, neni 21.
[1236] Statuti i BDI nga 2009, neni 18.
[1237] Statuti i BDI nga 2009, neni 20.
[1238] Ademi, Gashi, Siljanovska, Popsimonova dhe tjerë http://www.dw.de15816584.
[1239] Hofmajster dhe Grabov, Funksione të partive politike dhe organizimi në shoqëri demokratike, (Shkup: Fondacioni Konrad Adenauer, 2013), Hofmajster dhe Grabov, 2013: f. 109.
[1240] Hofmajster dhe Grabov, 2013: f. 107.
[1241] Cvetkov dhe Daskallovski, 2013: f. 49.

partisë në nivelin qendror dhe lokal[1242]. Formalisht, LSDM-ja ka model të decentralizuar të organizimit, ndërsa VMRO-DPMNE dhe BDI kanë model të centralizuar të organizimit[1243]. Megjithatë, në pjesë të madhe të rasteve, fraksionet partiake nuk përmenden në mënyrë eksplicite në statutet e partisë.[1244]

Në VMRO-DPMNE, programi zgjedhor përgatitet nga ekipe ekspertësh, qytetarë, me anë të shpalljeve publike, si dhe nga ekipe të Komitetit Ekzekutiv, Komitetit Qendror dhe komiteteve rajonale[1245]. Programi zgjedhor pastaj aprovohet nga Komiteti Qendror.

Në LSDM, organizimit komunal dhe organeve përkatëse u garantohet pjesëmarrje në krijimin dhe zbatimin e politikës së partisë, theksimit të kandidaturave të organeve dhe emërim të kandidatëve për deputetë dhe këshilltarë në nivelin lokal. Vendime/rregulla në lidhje me themelimin dhe ndërprerjen merren nga Bordi Qendror i LSDM-së[1246]. Statuti i LSDM-së nuk parashikon se cili organ përgatit programin partiak[1247]. Programi zgjedhor i LDP-së përgatitet nga ekspertët e partisë dhe miratohet nga Komiteti Qendror.

Përjashtim mes partive politike në Maqedoni është NSDP-ja që ka zhvilluar demokraci të brendshme në praktikë[1248]. Megjithatë, vendimet në kuadër të partisë merren sipas qasjes *nga lartë poshtë,* pa përfshirje të madhe të anëtarëve në proces. Tendencat autokratike të liderëve janë praktikë mirë e vendosur në funksionimin e përditshëm të partive politike[1249]. Shpesh, zgjedhja e programit partiak bëhet vetëm me zgjedhje nga figura udhëheqëse[1250].

ROLI

11.3.1 AGREGIMI I INTERESAVE DHE PËRFAQËSIMI

Nota **50**

Në çfarë shkalle partitë politike i përfaqësojnë interesat relevante shoqërore në fushën politike?

Në aspektin formal, shumica e partive politike kanë platformë me të cilën përfaqësojnë interesa relevante shoqërore në fushën politike. Në realitet, ato veprojnë në mënyrë elite me anë të grupeve dominuese të interesit. Prandaj, roli i tyre në përfaqësimin e interesave relevante shoqërore në fushën politike manifestohet si populizëm në vend të politikës së vërtetë.

VMRO-DPMNE në vitin 2015 ka vazhduar me politikën e saj liberale ekonomike dhe njëkohësisht ka theksuar zhvillimin ekonomik dhe nevojën të tërhiqen investitorë të huaj[1251]. LSDM-ja është partia udhëheqëse opozitare që synon politikë liberale ekonomike, në përgjithësi për qasje pragmatike dhe për bashkëpunim me komunitetin ndërkombëtar. Ajo

[1242] Hofmajster dhe Grabov, 2013: f. 109.
[1243] Gordana, Siljanovska-Davkova, *Jeta e brendshme e partive politike në Ballkanin Perëndimor: mes tendave oligarkë dhe sfidave demokratike (*Shkup: Universiteti "Qirili dhe Metodi", Fakulteti Juridik Justiniani I, 2014), f. 9 http://www.jus.uio.no/english/research/news-and-events/events/conferences/2014/wccl-cmdc/wccl/papers/ws13/w13-siljanovska- davkova.pdf
[1244] Cvetkov dhe Daskallovski, 2013: f. 48.
[1245] http://www.vesti.mk/read/news/975877/343840/vmro-dpmne-gi-kani-gragjanite-da-davaat-idei-za-programata 27.5.2015
[1246] Siljanovska-Davkova, 2014: f. 9.
[1247] http://www.sdsm.org.mk/Default.aspx?mId=54 27.5.2015
[1248] Intervistë me Sonja Mirakovskën, Sekretare Organizative e NSDP-së, ish anëtare e Kuvendit në periudhën 2008-2011, 2011-2014 (interviste ballë për ballë) 11.5.2015
[1249] Cvetkov dhe Daskallovski, 2013: f. 48.
[1250] Hofmajster dhe Grabov, 2013: f. 110.
[1251] http://vmro-dpmne.org.mk/wp-content/uploads/documents/Manifest_za_reformi_i_razvoj.pdf 31.5.2015

synon fleksibilitet në kontestin me Greqinë për emrin e vendit, me qëllim që të mundësohet anëtarësim në NATO[1252]. BDI-ja është partia më e madhe e komunitetit etnik shqiptar dhe agjenda e tyre kryesore është zbatimi i plotë i Marrëveshjes së Ohrit të vitit 2001. Partia ka treguar konstruktivizëm në kuptim të problemit kryesor diplomatik të vendit – çështja e emrit që konteston Greqia. Por, një fraksion i partisë kërkon zgjedhje më të shpejtë të kontestit, me çfarë do të mundësohet anëtarësim në NATO dhe fillim të negociatave për anëtarësim me BE-në[1253]. Partitë më të vogla politike përballen me vështirësi në qasjen në medie për të prezantuar programet e tyre para qytetarëve.[1254]

Krijimi i politikave është nën kontrollin e grupeve të interesit dhe komunitetit afarist, bashkë me partinë në pushtet[1255]. Publiku është ndarë nga politika dhe nga besimi i partive politike, ndërsa jehona e votuesve shënon vazhdimisht rënie[1256]. Sipas hulumtimit të zbatuar nga Instituti Ndërkombëtar Republikan (IRI), 41% e anketuarve janë shprehur që nuk kanë besim në partitë politike, 37% kanë thënë që janë neutral ndërsa vetëm 20% kanë besim në 12 muajt e fundit të vitit 2014[1257]. Përveç kësaj, 60% e anketuarve mendojnë që organizatat qytetare janë nën ndikimin e partive, gjegjësisht programet e tyre dhe agjendat janë nën ndikim dhe financohen nga partitë politike në Maqedoni.[1258]

Akademikë të caktuar e përcaktojnë rolin e partive politike në Maqedoni si elitiste. Në Maqedoni, interesat personale të aktorëve kryesorë luajnë rolin kryesor në krijimin e politikave. Elitat partiake i marrin të gjitha vendimet kryesore dhe shpesh elitat afariste janë ato që ndikojnë më shumë si aktorë politikë[1259]. Korrupsioni është problem i madh sistematik në Maqedoni. Partitë politike sigurojnë tenderë, ndërsa bizneset që investojnë në partitë politike presin shërbime.[1260]

11.3.2 PËRPJEKJA PËR LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT

Nota **25**

Në çfarë shkalle partitë politike përpiqen për llogaridhënie publike dhe për luftë kundër korrupsionit?

Lufta kundër korrupsionit është në vend të lartë në të gjitha fushatat zgjedhore. Ndryshimet në udhëheqjen politike bëhen për shkak të votave kundër qeverive të korruptuara, dhe jo në dobi të programeve të mira politike. Mirëpo, praktika gjatë viteve tregon që partitë politike përpiqen për llogaridhënie publike dhe luftë kundër korrupsionit vetëm në fjalimet e tyre politike. Në Manifestin e VMRO-DPMNE-së 2011-2015, partia konfirmon përpjekjet e saj për luftë kundër korrupsionit dhe krimit, si dhe zbatimin efikas të të drejtës dhe me anë të reformave të thella në gjyqësor dhe administratë publike.[1261]

[1252] http://www.sdsm.org.mk/Default.aspx?mId=47&lId=1 31.5.2015
[1253] http://www.balkaninsight.com/en/article/who-is-who-political-parties-in-macedonia 31.5.2015
[1254] Intervistë me Sonja Mirakovska, Sekretar Organizativ e NSDP, ish anëtar e Kuvendit në periudhën 2008-2011, 2011-2014 (interviste ballë për ballë) 11.5.2015
[1255] Intervistë me Sonja Mirakovskën, Sekretare Organizative i NSDP-së, ish anëtare e Kuvendit në periudhën 2008-2011, 2011-2014 (interviste ballë për ballë) 11.5.2015
[1256] Instituti Ndërkombëtar Republikan, *Perceptimi i Kuvendit, përvoja me deputetë dhe pasqyrë e ditës së zgjedhjeve*, 2014: slajd 21.
[1257] Instituti Ndërkombëtar Republikan, *Perceptimi i Kuvendit, përvoja me deputetë dhe pasqyrë e ditës së zgjedhjeve*, 2014
[1258] Njëlloj.
[1259] Siljanovska-Davkova, 2014: f. 18.
[1260] Intervistë me Sonja Mirakovskën, Sekretare Organizative e NSDP-së, ish anëtare e Kuvendit në periudhën 2008-2011, 2011-2014 (interviste ballë për ballë) 11.5.2015
[1261] Manifesti i VMRO-DPMNE 2011-2014 http://vmro-dpmne.org.mk/wp-content/uploads/documents/Manifest_za_reformi_i_razvoj. pdf 13.5.2015

Megjithatë, në praktikë, ka krizë politike dhe institucionale si rezultat i korrupsionit, mungesës së pavarësisë në gjyqësor, shkelje të drejtave të njeriut, medie të kontrolluara nga politika dhe zbatim selektiv i ligjit.

Në vitin 2014, partia opozitare politike LSDM ka bërë kallëzim penal kundër kryeministrit për tre pika të aktit akuzues për marrje të ryshfetit dhe për mos pagimin e tatimit. LSDM-ja ka akuzuar Gruevskin që ka marrë ryshfet prej 1.5 milion EUR për të shpejtuar shitjen e Makedonska Bankës në vitin 2004. Opozita ka siguruar dokumente për transaksionet financiare, si dhe dokumente ligjore të Bankës Popullore me të cilat aprovohet shitja e aksioneve të bankës, duke theksuar që dokumentet përmbajnë dëshmi për keqpërdorime[1262]. Për këtë, lideri i opozitës ishte dënuar për shpifje.

Pak para Maqedonia sërish ka pësuar krizë politike në lidhje me korrupsionin masiv të pushtetit. Nga shkurti 2015, lideri i opozitës, Zoran Zaev, ka publikuar një varg të a.q. "bomba", gjegjësisht regjistrime audio me të cilat opozita pohon që janë incizuar në fshehtësi 670.000 biseda të më tepër se 20.000 numra telefonikë në vend. Në regjistrimet e publikuara, përfaqësues të lartë qeveritarë bëjnë komplot si të mashtrojnë me votat, të blejnë gjykatës dhe të dënojnë kundërshtarë politikë. Zoran Zaev deklaroi që incizimet janë bërë nga qeveria, ndërsa kanë rrjedhur të opozita[1263]. Në maj 2015, tre funksionarë të lartë qeveritarë kanë dorëzuar dorëheqje.

Kryeministri Gruevski ka mohuar pohimet për shkelje, duke qëndruar në thënien që incizimet janë të falsifikuara dhe që opozita në mënyrë joligjore ka përfituar materialin nga shërbime të huaja të paemëruara. Ai ka refuzuar të komentojë për përmbajtjen e incizimeve[1264]. Në debatin në Parlamentin Evropian më 10 mars 2015, njoftuesi në hije për Maqedoninë, parlamentari Britanik Evropian Riçard Hovit, ka deklaruar që "nuk ka dyshim" qe në Maqedoni ka pasur përgjime masive dhe që së paku një pjesë e incizimeve të rrjedhura janë autentike. "Ne nuk mund të injorojmë këtë dëshmi, ndërsa nuk mund as komisari" deklaroi Hovit[1265]. Gjithashtu, komisari për zgjerim të BE-së, Johanes Han, në Strasburg deklaroi që Maqedonia në mënyrë të drejtë duhet të analizojë pohimet për keqpërdorime në lidhje me bisedat e përgjuara nga opozita, pa dallim nga burimi i tyre. Komisari shtoi që "në kohë kur besimi i publikut në institucione është i ultë, të gjithë personat publik duhet të sillen në mënyrë të përgjegjshme dhe të marrin përgjegjësi për procedurat e tyre në interes personal". Duke theksuar që kriza politike në Maqedoni vetëm ka konfirmuar "shqetësimin e vazhdueshëm në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit" në vend, Han ka ftuar "të gjithë palët të respektojnë sundimin e të drejtës dhe pavarësisë së gjyqësorit dhe lirisë së shtypit[1266]". Për zgjedhje të krizës ishte nënshkruar e a.q. "Marrëveshje e Përzhinos"[1267] në bazë të të cilës janë bërë ndryshime në ligjvënien zgjedhore dhe në KSHZ dhe është themeluar Prokuroria Speciale Publike me kompetencë të shqyrtojë rastet që dalin nga bisedat e përgjuara, por janë miratuar edhe ligjet për mbrojtje të privatësisë[1268] dhe për mbrojtje të informatorëve[1269].

[1262] http://www.balkaninsight.com/en/article/criminal-charges-filed-against-macedonian-pm 31.5.2015
[1263] http://www.nytimes.com/2015/05/19/world/europe/macedonias-leaders-unable-to-resolve-festering-crisis.html?_r=0
[1264] http://www.balkaninsight.com/en/article/macedonia-s-embattled-pm-stands-resilient-before-party-faithful
[1265] http://www.balkaninsight.com/en/article/hahn-tells-macedonia-to-investigate-wrongdoing-allegations 31.5.2015
[1266] http://www.balkaninsight.com/en/article/hahn-tells-macedonia-to-investigate-wrongdoing-allegations 31.5.2015
[1267] http://makfax.com.mk/makedonija/politika/dui-go-objavi-dogovorot-od-2-juni, http://fokus.mk/tseliot-dogovor-shto-liderite-go-potpishaa-na-2-juni/
[1268] Gazeta Zyrtare Nr. 196/2015.
[1269] Gazeta Zyrtare Nr. 196/2015.

REKOMANDIME

R1. Partitë politike duhet të akordohen për të përfshirë dispozita për zgjedhje të kandidatëve.

R2. Kuvendi duhet të miratojë ndryshimet e Ligjit për parti politike dhe Kodit zgjedhor për përfshirje të dispozitave për zgjedhje të kandidatëve nga partitë politike.

R3. Partitë politike duhet të sigurojnë mekanizmat dhe zbatimin e tyre për integritet me anë të miratimit të kodeve ose ndryshimeve të statutit.

12. MEDIET

PËRMBLEDHJE

Me anë të reklamimit të pakufizuar qeveritar bëhet kontroll i fuqishëm i shtetit mbi mediet. Ka medie që janë favorizuar nga pushteti në raportin për përparimin e BE-së të vitit 2014, që përshkruan gjendjen e medieve në Maqedoni si lëndë e "kontrollit jo të drejtë të pushtetit[1270]". Ka shqetësim në lidhje me standardet e njoftimit gjatë zgjedhjeve dhe mungesës së pavarësisë redaktuese nga Servisi Publik Radiodifuz, TVM[1271]. Agjencisë për Shërbime Mediale Audio dhe Audiovizuale (ASHMAA) dhe Servisit Publik Radiodifuz (SPR) u mungon pavarësia. Reklamat qeveritare nuk janë të rregulluara dhe ka shqetësim në lidhje me rregullimin e tepërt ligjor të medieve të shtypura, përfshirë edhe dispozitën për përcaktim të gazetarit dhe gjobat e mëdha për shkelje. Në kohën e njëjtë, nuk ka Kod të barazuar të sjelljes për mediet në Maqedoni.

Më 1 korrik 2015, si rezultat i intervenimit ndërkombëtar në krizën politike, Qeveria shpalli moratorium të fushatave reklamuese të qeverisë në mediet kombëtare[1272]. Megjithatë, ndonëse ky raport është në fazën finale, partitë politike ende nuk kanë arritur marrëveshje në lidhje me ndryshimet ligjore me të cilat do të sigurohet pavarësi e TVM-së dhe medieve në përgjithësi në përputhje me "Marrëveshjen e Përzhinos"[1273].

Pronësia e medieve nuk është transparente. Pronarët e medieve dhe agjentët privatë reklamues përballen me rrezik nga hakmarrja nëse nuk mbështesin agjendën e partive të caktuara politike[1274]. Madje as financimi i medieve nuk është transparent, duke marrë parasysh faktin që mediet nuk i shpalosin burimet e financimit. Gazetarët nuk mund të bëjnë punën e tyre të lirë nga frika[1275]. Si rezultat, në Maqedoni pothuaj se as nuk ka hulumtim të vërtetë gazetaresk, ndërsa disa mediume kryesore nuk njoftojnë në mënyrë objektive.

NOTA E PËRGJITHSHME PËR SHTYLLËN: 36,1 /100

[1270] Komisioni Evropian, 2014 (Kritere Politike); f. 12. http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008- the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-progress-report_en.pdf [qasur më12.12.2014].
[1271] Njëlloj.
[1272] Ministri Ivo Ivanovski, 1 korrik 2015 , http://mrt.com.mk/node/24396
[1273] Shikoni fusnotën nr. 1265.
[1274] Komisioni Evropian, Republika e Maqedonisë: rekomandime të ekspertëve të lartë për sundimin sistematik të së drejtës në lidhje me përgjimin e komunikacioneve të zbuluar në pranverë 2015 (Bruksel: Komisioni Evropian, 2015).
[1275] Njëlloj.

DIMENSIONI	TREGUESI	E DREJTA	PRAKTIKA
Kapaciteti 50/100	Resurset	75	50
	Pavarësia	75	0
Qeverisja 41,6/100	Transparenca	75	25
	Llogaridhënia	50	25
	Integriteti	50	25
Roli 16,6/100	Hulumtimi dhe zbulimi i korrupsionit	25	
	Informimi i publikut për korrupsionin dhe efekti përkatës	0	
	Informimi i publikut për çështje lidhur me qeverisjen	25	

Nota për shtyllën sipas të drejtës dhe praktikës



STRUKTURA DHE ORGANIZIMI

Ka medie të ndryshme: gazeta të shtypura ditore (8), javore (3),[1276] transmetim (kanale televizive (65) dhe radio stacione (76), në nivel kombëtar dhe lokal), si dhe internet portale, dhe internet televizione. Gjithsej 200 medie, përveç radiodifuzerit publik/kombëtar TVM, janë në pronësi private.

Mediet konkurrojnë në treg të vogël dhe të shpërndarë prej dy milionë banorë dhe ajo mund të prezantohet si alibi dhe arsyetim i mirë për bashkëpunim me partitë në pushtet, qeverinë dhe biznese si dhe mjete për mbijetesë. Ndonëse ka burime të ndryshme mediale, janë lënë

[1276] http://www.avmu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=1154&Itemid=463&lang=mk [qasur më1.11.2014].

shumë çështje të rëndësishme dhe vitale të mbeten pa mbulim përkatës, sepse pjesa më e madhe e medieve janë pro-qeveritare.

Agjencia për Shërbime Medietike Audio dhe Audiovizuale (ASHMAA) është trup rregullatori i pavarur, jo profitabil me status të personit juridik me autorizime publike.[1277]

Ka tre shoqata të gazetarëve. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë SHGM) është shoqatë e pavarur, e vetëm, joqeveritare dhe jopartiake që ka për qëllim të jetë promovues dhe mbrojtës i standardeve profesionale dhe të lirisë së shprehjes[1278]. Asociacioni i Gazetarëve të Maqedonisë (AGM), që ka një numër të caktuar të anëtarëve dhe Asociacioni Medietik i Maqedonasë (AMM) i themeluar në vitin 2014 janë dy shoqatat tjera. Ka edhe Këshill të Nderit që ka detyrë themelore të kujdeset dhe të promovojë parimet e theksuara në Kodin e gazetarëve[1279]. Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punëtorëve Medietikë është organizatë e pavarur, demokratike, joprofitabile e gazetarëve dhe punëtorëve medietikë.

VLERËSIMI

12.1.1 RESURSET (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle korniza ligjore siguron mjedis të volitshëm për medie të ndryshme të pavarura?

RADIODIFUZERËT

Ka kufizime në lidhje me pronësinë dhe bashkëpronësinë e medieve[1280] në nivelin kombëtar dhe rajonal. Personi fizik ose ligjor që është aksionar shumicë në radiodifuzer, si dhe personi i lidhur me aksionarin në radiodifuzer nuk mund të themelojë, si bashkëpronar ose aksionar, gjegjësisht të marrë pjesë në pronësinë e lëshuesit të medieve të shtypura që publikojnë gazeta ditore, agjencive të lajmeve, shoqërive për reklama dhe propagandë, shoqërive për hulumtim të tregut dhe mendimit publik, shoqërive për shpërndarje të veprave audio-vizuele, shoqërive për produksion të filmave ose operatorëve të rrjeteve elektronike të komunikimit që sigurojnë ritransmetim ose transmetim të programeve të radios ose atyre televizive.[1281]

Përveç kësaj, partitë politike, organet shtetërore, organet e udhëheqjes shtetërore, ndërmarrjet publike, njësitë e vetëqeverisjes lokale, bartës të funksioneve publike dhe anëtarë të familjeve të tyre nuk mund të kryejnë veprimtari radiodifuzive, të jenë themelues, ose bashkë themelues dhe të përfitojnë pjesëmarrje në pronësinë e radiodifuzerëve.[1282]

Radiodifuzeri mund të bëjë transmetim televiziv ose të radios nëse është regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, me seli dhe bord drejtues në Republikën e Maqedonisë dhe nëse ka leje për transmetim televiziv dhe të radios.[1283]

1277 Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, Gazeta Zyrtare Nr.184/2013, neni 4.
1278 http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/en/node/121, Statuti i SHGM-së [qasur më31.10.2015].
1279 Njëlloj.
1280 Ligji për shërbime medietike audio dhe audiovizuele, Gazeta Zyrtare Nr.184/2013, neni 37.
1281 Njëlloj.
1282 Njëlloj.
1283 Njëlloj.

Lejen për transmetim televiziv ose radio e jep Agjencia për nivel të caktuar të shikueshmërisë ose dëgjimit (shtetëror, rajonal ose lokal), ndërsa bartësi i lejes përfiton të drejtën për të transmetuar program radio ose televizion në rajonin në të cilin ka marrë lejen.[1284]

ASHMAA mund të marrë lejen për transmetim televiziv ose të radios para skadimit të afatit për të cilin është dhënë dhe të fshijë radiodifuzerin nga Regjistri i radiodifuzerëve nëse radiodifuzeri nuk i ka plotësuar kushtet në të cilat është dhënë leja[1285]. Kundër vendimit për marrje të lejes, bartësi i lejes ka të drejtë të dorëzojë ankesë. Bartësi i lejes mund të paraqet padi në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.[1286]

MEDIET E SHTYPURA DHE ELEKTRONIKE

Rregullorja nuk përmban dispozita për licenca të medieve të shtypura dhe nuk ka kufizime ligjore për hyrje në profesionin gazetaresk. Ligji përmban një përcaktim mjaft kufizues për termin gazetar "person që grumbullon, analizon, përpunon, redakton dhe/ose klasifikon informata të publikuara në medie dhe është punësuar nga publikuesi dhe me atë ka marrëveshje punësimi, ose personi që siguron aktivitete gazetareske si profesion i pavarur (gazetarë honorarë)".[1287]

Internet portalet dhe internet televizioni nuk bëjnë pjesë në përfshirjen e ligjislacionit, sepse ka pasur vërejtje nga SHGM-ja që ajo do të thotë kontroll mbi hapësirën e internetit.[1288]

12.1.2 RESURSET (PRAKTIKA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle ka medie të ndryshme të pavarura që sigurojnë perspektiva të ndryshme?

Mediet konkurrojnë në një treg të vogël dhe të shpërndarë prej rreth dy milionë banorë që kanë një numër të vogël të ndërmarrjeve që mund të paguajnë për reklamim.

Për këtë shkak, qëndrueshmëria financiare e medieve është pothuajse e pamundshme. Ka burime të ndryshme medietike, por shumë çështje të rëndësishme vitale socio-politike janë lënë pa mbulim të caktuar, sepse një pjesë e madhe e medieve janë pro qeveritare[1289]. Gjendja negative në fushën e medieve është regjistruar nga OSBE/ODHIR që i ndjek mediet dhe punën e tyre gjatë periudhës parazgjedhore dhe zgjedhore. Raportet rregullisht përmbajnë: jo-baraspeshë në njoftimin, kohë të pabarabartë për partitë e dhëna për të prezantuar kandidatët e tyre dhe mesazhet, ton kritik në njoftimin për partitë opozitare dhe favorizim të partisë në pushtet, reklamim të fshehur dhe shumë tjera[1290]. Transparency International Maqedoni në raportin e saj arrin përfundimin: "Dominim plotë i partisë në pushtet në mbulimin medietik të fushatës - në lidhje me kapacitetet zyrtare dhe kandidatëve – do të thotë që

[1284] Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, Gazeta Zyrtare Nr. 184/2013, neni 68.
[1285] Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, Gazeta Zyrtare Nr. 184/2013, neni 82.
[1286] Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, Gazeta Zyrtare Nr. 184/2013, neni 84.
[1287] Njëlloj.
[1288] http://www.mkd.mk/makedonija/politika/ako-vladata-saka-da-se-definira-profesijata-novinar-prvo-neka-ja-definira „Qeveria dhe Shoqata e Gazetarëve janë akorduar që internet portalet mos të hyjnë në Ligjin për medie" [qasur më1 nëntor, 2014].
[1289] Njëlloj.
[1290] Mediet në Maqedoni: As fuqi e shtete, as pushtet i karter, por tigër nga letra http://novatv.mk/index.php?navig=8&cat=18&vest=25634

pjesëmarrësit nuk kanë marrë qasje të barabartë "[1291].

KE-ja ka shprehur "shqetësim serioz për kontroll qeveritar mbi institucionet dhe mediet qeveritare".[1292] Për shembull, "servisi publik radiodifuziv (TVM) ka siguruar përmbajtje të paplotë dhe të pabarazuar dhe informative, ndërsa anësia politike e servisit ishte shënuar nga OSBE/ODHIR gjatë zgjedhjeve të vitit të kaluar dhe të këtij viti[1293]. Konkluzionet e njëjta, veçanërisht për ato të servisit publik radiodifuziv, u konfirmun nga Transparency International – Maqedoni gjatë monitorimit sistematik të mbulimit medietik gjatë zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare në prill 2014.[1294]

Disa medie të caktuara nuk kanë resurse përkatëse dhe të qëndrueshme për të qenë efikase. Disa medie janë mbyllur për shkak të vështirësive financiare, për shembull, gazetat javore "Gragjanski" dhe "Globus" janë mbyllur për shkak të pamundësisë për të siguruar të ardhura nga reklama.[1295]

Deri më tani nuk janë zbatuar hulumtime për kompetencat, arsimin dhe shkathtësitë e gazetarëve, por vlerësimi i përgjithshëm është që niveli i kompetencave profesionale shënon rënie gjatë dekadës së fundit[1296]. Kjo tregon për tendencën e gazetarëve profesionistë të zëvendësohen me persona të dëgjueshëm.[1297]

Për gazetarë me arsim të ndryshëm, duhet arsim plotësues me qëllim që të fitohet një spektër i gjerë i shkathtësive, që të mund të "kapin momentin shoqëror" dhe "të kenë mundësi të shikojnë pamjen më të gjerë[1298]". Nevoja për arsim të vazhdueshëm të gazetarëve dhe redaktorëve është një prej përpjekjeve të Deklaratës për promovim të parimit të realizimit të lirisë së medieve të garantuar me kushtetutë dhe me ligj në Republikën e Maqedonisë, e miratuar në vitin 2014, në kuadër të projektit "Mbështetje të medieve të pavarura në Republikën e Maqedonisë", që zbatohet nga Transparency Internacional – Maqedoni dhe nga ERIS nga Mbretëria e Bashkuar, dhe është mbështetur nga BE-ja me anë të Instrumentit Evropian për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut (EIDHR).[1299]

Gazetarët kërkojnë fshirje të përcaktimit të gazetarit nga Ligji për medie sepse ajo i kufizon të drejtat dhe liritë e gazetarëve.[1300]

12.1.3 PAVARËSIA (E DREJTA)

Nota **75**

[1291] Vlerësimi i medieve maqedonase, f. 9. http://www.transparency.mk/en/index.php?option=com_content&task=blogsection&id=6&Itemid=36

[1292] Komisioni Evropian, 2014 (Kritere Politike); f. 5. http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008- the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-progress-report_en.pdf [qasur më15.10.2014].

[1293] Njëlloj.

[1294] http://www.transparency.mk/en/index.php?option=com_content&task=view&id=516&Itemid=35 „Mbulimi medietik nuk i paanshëm, thonë monitorët ndërkombëtar dhe lokal mediatik" [qasur më20.11.2014].

[1295] http://daily.mk/makedonija/zgasnuva-nedelnikot-gragjanski-5 Shuhet javorja "Gragjanski" [qasur më1 dhjetor 2014].

[1296] Snezhana Tërpevska dhe Igor Micevski, "Përse është i rëndësishëm integriteti i medieve – Kthimi i interesit publik në punën e medieve dhe gazetarisë" (Shkup: 2014, Instituti Maqedonas për Medie), f. 109.

[1297] Intervistë me Tamara Çausidisin, kryetare e Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punëtorëve Medietikë (interviste ballë për ballë) 10.11.2014

[1298] Zhaneta Trajkoska, drejtoreshë e Shkollës së Lartë për Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun (interviste ballë për ballë) 10.11.2014

[1299] „Deklaratë për promovim të qëndrimeve parimore për realizim të lirisë së garantuar me kushtetutë dhe me ligj të medieve në Republikën e Maqedonisë" nënshkruar më 4.11.2017 Dokumenti ishte nënshkruar nga gjashtë medie siç janë javorja "Fokus", internet portalet "Nova TV" dhe "Plusinfo", gazeta ditore "Sllooden Pecat" dhe TV 24 Vesti", radio rrejti "Kanal 77", si dhe përfaqësues të organizatave qytetare: Instituti Maqedonas për Medie, Qendra për Zhvillim të Medieve, Transparency International – Maqedoni, Shoqata e Gazetarëve dhe Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punëtorëve Mediatikë http://www.transparency.mk/images/stories/press/deklaracija.pdf

[1300] „Deklaratë për promovim të qëndrimeve parimore për realizim të lirisë së garantuar me kushtetutë dhe me ligj të medieve në Republikën e Maqedonisë " http://www.transparency.mk/index.php?option=com_content&task=view&id=1015&Itemid=57 [qasur më20.11.2014].

Në çfarë shkalle ka masa ligjore mbrojtëse për të parandaluar përzierjen e padrejtë të jashtme në punën e medieve?

Ligji e garanton lirinë e shprehjes dhe lirinë e medieve, dhe gjatë kësaj edhe pavarësinë e redaktorit, gazetarit, autorëve ose kreatorëve të përmbajtjeve ose bashkëpunëtorëve programuesve dhe personave tjerë, dhe në përputhje me rregullat e profesionit[1301]. Për të siguruar transparencë në punën e bartësve të informatave, personat fizikë dhe juridikë kanë të drejtë për qasje të lirë në informatat me karakter publik[1302]. Përveç kësaj, publikuesit e medieve të shtypura duhet të kenë politikë/zbatim të pavarur redaktimi dhe janë përgjegjës për punën e tyre.[1303]

Servisi Publik Radiodifuziv TVM-së është ndërmarrje publike e themeluar nga Kuvendi me ligj të posaçëm, që ka për obligim të mos përfaqësojë dhe të mos mbrojë qëndrime ose interesa të një partie të caktuar politike, grupeve politike, fetare ose tjera, ndërsa programet që krijon dhe i transmeton të mbrohen nga ndikimi i pushtetit, organizatat politike ose qendra tjera të fuqisë ekonomike dhe politike.[1304]

Me ligjin garantohet e drejta e burimit të informatat në mjetet për informim publik[1305]. Gazetarët kanë të drejtë të mos zbulojnë burimin e informatës, gjegjësisht të dhënat që mund të zbulojnë burimin në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe në përputhje me Kushtetutën[1306]. Gazetari ka për obligim, para se të publikojë informatën për të cilën nuk zbulon burimin, të njoftojë redaktorin përgjegjës[1307]. Me ligj rregullohet përgjegjësia qytetare për dëmin e bërë nderit dhe reputacionit të personi fizik ose ligjor me ofendim dhe shpifje[1308]. Nga gazetari nuk mund të kërkohet të zbulojë burimin sekret të informatave.[1309]

Procedura për dhënien e lejes për transmetim televiziv ose të radios është transparente dhe bëhet në mënyrë që sigurohet trajtim i barabartë, i njëjtë dhe jo-diskriminues për të gjithë pjesëmarrësit në procedurë.[1310]

12.1.4 PAVARËSIA (PRAKTIKA)

Nota **0**

Në çfarë shkalle janë të liruara mediet nga ndikime të padrejta të jashtme në praktikë?

Sipas ekspertëve për medie, ndonëse ka dispozita për sigurim të transparencës dhe objektivitetit në medie, këto obligime nuk plotësohen[1311]. Partitë politike kanë ndikim mbi mediet[1312] dhe ka një shqetësim serioz në lidhje me kontrollin qeveritar të medieve.[1313]

1301 Ligji për medie, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr.184/2013, neni 3.
1302 Ligji për qasje të lirë në informata me karakter publik, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr.13/06, 86/08, 6/2010.
1303 Njëlloj.
1304 Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr.184/2013, neni 110.
1305 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 16, http://www.sobranie.mk/ustav-na-rm.nspx [qasur më15.10.2014].
1306 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 52/1992, neni 16.
1307 Ligji për medie, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr.184/2013, neni 12.
1308 Ligji për përgjegjësi qytetare për ofendim dhe shpifje, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 143/2012p
1309 Ligji për përgjegjësi qytetare për ofendim dhe shpifje, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 143/2012.
1310 Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr.184/2013, neni 69.
1311 Snezhana Tërpevska dhe Igor Micevski, "Përse është i rëndësishëm integriteti i medieve – Kthimi i interesit publik në punën e medieve dhe gazetarisë" (Shkup: 2014, Instituti Maqedonas për Medie), f. 65.
1312 Njëlloj.
1313 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-progress-report_en.pdf [qasur më25.10.2014], f. 5.

Kemi raporte të vazhdueshme për mungesë të objektivitetit dhe paanësisë së rregullatorit medietik, ASHMAA[1314]. ASHMAA-ja nuk është e pavarur si në kuptimin politik ashtu edhe në atë ekonomik[1315]. Qeveria pak para ka zgjeruar kompetencat mbi mediet duke themeluar komision të posaçëm ndër-ministror prej shtatë anëtarëve, prej të cilëve vetëm njëri është nga ASHMAA-ja. Me atë mbaron aspekti i ASHMAA-së si trup rregullator i pavarur.[1316]

Pjesa më e madhe e gazetarëve nga mediet pro-qeveritare sërish kanë themeluar Asociacionin e Gazetarëve të Maqedonisë (AGM), që ishte themeluar më herët në vitin 2002, por nuk funksionoi tërësisht. Qëllimi i AGM-së nuk është vetëm të zbusë kritikën, por edhe të imponojë mbështetje artificiale të ligjeve të reja për mediet.[1317] AGM konsiderohet si një organizatë që "zvogëlon rolin e SHGM-së gjatë...përgatitjes së ligjeve për medie[1318]". Më saktë, SHGM dhe sindikata e pavarur shprehin shqetësim në lidhje me zvogëlimin e pluralizmit, zbatimin selektiv të ligjeve kundër gazetarëve që kritikojnë qeverinë dhe shtypjen e panevojshme që bëhet nga pronarët e medieve kundër anëtarëve të SHGM-së.[1319]

Përveç kësaj, përdorimi i shpifjes vazhdon të ndikojë mbi lirinë e shprehjes[1320]. Si plotësim, të drejtat e punëtorëve nuk zbatohen mirë, ashtu që kjo kontribuon për problemin e auto-censurimit[1321]. Një pjesë e madhe e gazetareve nuk mund të realizojnë të drejtat e tyre të parashikuara në Ligjin për marrëdhënie pune sepse punojnë pa marrëveshje, sigurim, pushim me pagesë, punë jashtë orarit dhe pushim për sëmundje, ndërsa rroga minimale nuk është rregulluar.[1322]

Në tetor të vitit 2013, Maqedonia u bë vendi i vetëm në rajon me gazetarë të paraburgosur, z. Tomisllav Kezharovski, që ishte dënuar me katër vite e gjysmë burg për gjoja zbulimin e identitetit të dëshmitarit të mbrojtur në një proces gjyqësor për vrasje në tekst gazetaresk në vitin 2008[1323]. Përveç kësaj, gazetari Kezharovski ishte në paraburgim për më tepër se 600 ditë[1324] dhe ishte arrestuar se gjoja ka zbuluar identitetin e dëshmitarit të mbrojtur[1325]. Ai ishte mjaft i njohur me bllogun e tij politik që ishte kritik ndaj Qeverisë.[1326]

Ka shqetësim në lidhje me raste të gjoja frikësimit nga ana e autoriteteve me anë të procedurave ligjore që vijojnë kundër medieve dhe gazetarëve që kritikojnë pushtetin[1327]. Në këtë mënyrë heshtën mediet që janë kritike ndaj pushtetit.[1328]

Një servis i rëndësishëm radiodifuz (A1) dhe tre gazeta ditore ishin mbyllur si pasojë e

[1314] http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-progress-report_en.pdf [qasur më25.10.2014], f. 29.
[1315] Njëlloj.
[1316] http://mdc.org.mk/wp-content/uploads/2014/11/CRM_Izvestaj_Monitoring-na-AVMU-MIOA-MRT-sobranie-i-mediumi_-Okt-2014.pdf [qasur më5.11.2014].
[1317] Njëlloj.
[1318] Intervistë me Tamara Çausidisin, kryetare e Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punëtorëve Mediatikë (interviste ballë për ballë) 10.11.2014
[1319] Njëlloj.
[1320] Njëlloj.
[1321] Njëlloj.
[1322] Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, *Pasqyrë e shkurtë e gjendjes së medieve në Maqedoni*, (Shkup: Shoqata e Gazetarëve e Maqedonisë, 2014), f. 4.
[1323] Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, 2014: f. 3.
[1324] Lajm: "Kezharovski po pëson 558 ditë në paraburgim", http://plusinfo.mk/vest/5923/kezarovski-cmae-558-dena-vo-pritvor, nëntor 2014
[1325] Njëlloj.
[1326] Njëlloj.
[1327] Kombet e Bashkuara, Kuvendi i Përgjithshëm, Raporti i njoftuesit special për avancim dhe mbrojtje të të drejtës për liri të mendimit dhe shprehjes, Frank La Ru, 16 maj 2011, f. 6. http://www2.ohchr.org/english/bodies/hrcouncil/ docs/17session/A.HRC.17.27_en.pdf [qasur më7.11.2014].
[1328] Njëlloj.

padisë për mashtrim tatimor dhe larje parash në korrik të vitit 2011[1329]. Në dhjetor të vitit 2010, pronari, vajza e tij dhe 17 tjerë të punësuar ose bashkëpunëtorë të "Plus Produksija" ishin arrestuar për mospagimin e tatimit në një operacion të madh policor, e kritikuar nga shoqëria qytetare si e padrejtë dhe fyerëse[1330]. Në qershor të vitit 2012, një ndërmarrje tjetër nga grup i njëjtë medietik ka qenë synim i një dënimi të padrejtë kur ASHMAA-ja i ka marrë lejen "Televizionit A2" për gjoja mosplotësimin e kritereve për format programor, gjatë së cilës më tepër se 65 për qind të transmetimit ka rënë në programe me karakter argëtues, me çfarë nuk është siguruar mjaft program me karakter arsimor dhe informativ.[1331]

Një prej shembujve më të dukshëm të kërcënimeve të drejtuara medieve ndodhi më 24 dhjetor 2012, kur gazetarët që kanë njoftuar për seancë parlamentare ishin përzënë nga Kuvendi nga forcat e sigurisë[1332]. Deri më tani, asnjë nëpunës publik nuk ka marrë përgjegjësi për shkelje të nenit 16 të Kushtetutës që qytetarëve u garanton të drejtën e informimit objektiv.[1333]

Raporti i KE-së për përparim në vitin 2014 ka theksuar që ka një kontroll të padrejtë shtetëror mbi mediet me anë të reklamave qeveritare dhe medie të favorizuara nga Qeveria[1334]. Prej vitit 2008 janë intensifikuar reklamat shtetërore, që ishte nxitje për pronarët e medieve të luftojnë për resurset publike që nga ana tjetër ka krijuar lidhje më të forta politiko-klientistike ndërmjet pushtetit dhe medieve[1335]. Qeveria është blerës i rëndësishëm për publicitet. Përfaqësuesit e shoqërisë qytetare e theksojnë mungesën e transparencës gjatë shpërndarjes së resurseve shtetërore ndërmjet grupeve mediatike dhe anësisë potenciale në shpërndarjen e mjeteve, gjatë së cilës favorizohen ndërmerrje të afërta me pushtetin[1336]. Shpenzimi për reklamat qeveritare është drejtuar vetëm ndaj medieve pro qeveritare, me çfarë atyre ju jepet përparësi e madhe financiare[1337]. Qeveria është në kulm të 50 shpallësve më të mëdhenj në vend për vitin 2012, ndërsa në vitin 2013 është në vend të parë me dyfish më shumë fushata në mediet private nga operatori lokal celular "T-Mobile".[1338]

Një shembull tjetër i mungesës së pavarësisë së medieve është fakti që 34 medie kanë dhënë mjete për partinë në pushtet (VMRO-DPMNE) gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2013[1339]. Një rast të ngjashëm kishte edhe në vitin 2011 kur tani më televizioni i mbyllur "A1" ka dhënë mjete për parti politike në opozitë.[1340]

Në lidhje me të drejtën e qasjes së lirë në informata me karakter publik (të përmendur më lartë), 77% të gazetarëve mendojnë që është vështirë të ketë qasje në informata.[1341]

E drejta e mbrojtjes së burimeve të informatës nuk respektohet. Në një rast (në rastin

1329 Njëlloj.
1330 Njëlloj.
1331 Njëlloj.
1332 http://globalvoicesonline.org/2012/12/25/journalists-opposition-thrown-out-of-macedonian-parliament-amid-street-protests/ [qasur më10.11.2014].
1333 Shoqata e Gazetarëve e Maqedonisë, *Pasqyrë e shkurtë e gjendjes së medieve në Maqedoni*, (Shkup: Shoqata e Gazetarëve e Maqedonisë, 2014), f. 4.
1334 Komisioni Evropian, 2014 (Kritere Politike); f. 12. http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008- the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-progress-report_en.pdf [qasur më15.10.2014].
1335 Tërpevska dhe Micevski, 2014: f. 89.
1336 http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/HRC/RegularSessions/Session26/Pages/ListReports.aspx, „ Raporti i njoftuesit special për avancim dhe mbrojtje të të drejtës për liri të mendimit dhe shprehjes, Frank La Ru ", f. 10.
1337 Komisioni Evropian, 2013: f. 23, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/mk_rapport_2013.pdf [qasur më25.10.2014].
1338 Njëlloj.
1339 Tërpevska dhe Micevski, 2014: f. 97.
1340 Raporti i Entit Shtetëror të Revizionit http://www.dzr.mk/Uploads/3_TRET_VKUPEN_SDSM.pdf
1341 http://freeinfo.mk/wp-content/uploads/2012/11/istrazuvanje-za-primena-na-pravoto.pdf „ Hulumtimi i realizimit të së drejtës për qasje të lirë në informata me karakter publik", Qendra për Komunikime Qytetare, f. 12 [qasur më20.11.2014].

Kezharovski), gjykatësi insistonte që identiteti i dëshmitarit të mbrojtur të zbulohet.[1342]

Nuk ka rregulla që i lejojnë qeverisë të kontrollojë informatat që i shpërndajnë mediet, ndërsa Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e garanton lirinë e të folurit, paraqitjes publike, informimit publik dhe themelimin e lirshëm të institucioneve për informim publik dhe ndalon censurimin.[1343]

Ligji për përgjegjësi qytetare për shpifje dhe ofendim dhe Ligji për mediet përmbajnë dispozita të dobëta ligjore për mjete ligjore, siç janë e drejta e përgjigjes ose përmirësimit dhe duhet të zhvillohet mekanizëm alternativ, më pak drakonik, për përballimin me çështjet e shpifjes.[1344]

QEVERISJA

12.2.1 TRANSPARENCA (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle ka dispozita me të cilat sigurohet transparencë në punën e medieve?

Ligji nuk përmban dispozita në lidhje me pronësinë e vërtetë të medieve[1345]. Ka rregullore ligjore në lidhje me transparencën e pronësisë mediatike. Ligji i obligon mediet e shtypura dhe difuzerët radio-televizivë të publikojnë të dhëna për strukturën e tyre pronësore dhe për burimet e financimit, si dhe të informojnë ASHMAA –në para ndryshimit të strukturës pronësore.[1346]

Publikues i mediumit ka për obligim të publikojë informata në lidhje me të punësuarit.[1347]

Publikuesi i mediumit ka për obligim të publikojë informata në vend të dukshëm, në lidhje me lajmet, përfshirë edhe identitetin e gazetarit, informatat për te drejtat e autorit dhe datës së prodhimit (muaji dhe viti). Nuk ka obligime për shpalosjen e informatave në lidhje me njoftimin dhe politikën redaktuese.

12.2.2 TRANSPARENCA (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle ka transparencë të medieve në praktikë?

Transparenca e medieve nuk është e mjaftueshme në praktikë dhe dispozitat ekzistuese për transparencë duhet të respektohen dhe të zbatohen.[1348]

Internet faqja e ASHMAA-së përmban regjistra të kanaleve televizive, radio stacioneve,

[1342] Fondacioni Shoqëri e Hapur Maqedoni, Pasqyra Mediatike, liria e medieve nën shtypje të lartë të Qeverisë, (Shkup: Fondacioni Shoqëri e Hapur Maqedoni, 2013) http://nvoinfocentar.mk/wp-content/uploads/2014/05/No5Mediumsko- ogledalo.pdf [qasur më20.11.2014].
[1343] Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, http://www.sobranie.mk/ustav-na-rm.nspx neni 16 [qasur më15.10.2014].
[1344] Komisioni Evropian, 2014 (Kritere Politike); f. 45. http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008- the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-progress-report_en.pdf [qasur më12.12.2014].
[1345] Komisioni Evropian, 2014 (Kritere Politike); f. 45. http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008- the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-progress-report_en.pdf [qasur më15.10.2014].
[1346] Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, Gazeta Zyrtare Nr.184/2013, neni 41.
[1347] Ligji për medie, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr.184/2013, neni 14.
[1348] Komisioni Evropian, 2014 (Kritere Politike); f. 45. http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008- the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-progress-report_en.pdf [qasur më15.10.2014].

medieve të shtypura, ndërsa regjistrimi bëhet sipas kërkesës. Megjithatë, pronësia e medieve zakonisht nuk është transparente[1349]. Në intervistë të zbatuar për këtë hulumtim, kryetari i Sindikatës së Gazetarëve e ndan mendimin që duke marrë parasysh që Qeveria është shpallësi më i madh, mund të supozohet që ajo i financon (dhe është pronar i fshehtë) i një pjese të madhe të medieve[1350]. Përveç kësaj, financimi i medieve nuk është transparente duke marrë parasysh që shtëpitë medietike nuk i shpalosin burimet e financimit.[1351]

Ka tre agjenci private gazetareske, por internet faqet e tyre nuk përmbajnë informata eksplicite për strukturën pronësore. Sektori i internetit është më pak transparent në kuptim të strukturës pronësore.[1352]

Mediet e shtypura dhe difuzerët radio-televizivë publikojnë të dhëna për ndërmarrjen dhe adresën e selisë, bordin redaktues, emrin e përfaqësuesit ligjor të publikuesit të medieve të shtypura, emrin dhe mbiemrin e redaktorit kryesor dhe përgjegjës dhe adresën e shtypshkronjës dhe datën e shtypjes ose ri-shtypjes, si dhe në raste të medieve të shtypura, numrin e kopjeve të shtypura.[1353]

12.2.3 LLOGARIDHËNIA (E DREJTA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle ka dispozita ligjore me të cilat do të sigurohej llogaridhënia e medieve për aktivitetet e tyre?

Në Maqedoni ka kornizë ligjore relativisht të fortë për rregullim të llogaridhënies së medieve, por ligjet e këtij sektori shpesh pësojnë ndryshime dhe plotësime.

Agjencia rregullatore në sektorin mediatik, ASHMAA, rregullatori më i vjetër i vendit, vepron si trup rregullator i pavarur dhe individual me autorizime publike[1354]. Radiodifuzerët kanë për obligim të dorëzojnë në ASHMAA raport me shkrim për zbatimin e obligimeve të përcaktuar në lejen për transmetim të radios ose televiziv[1355]. Në përputhje me ligjin, Agjencia kujdeset për sigurimin publik të punës së radiodifuzerëve, për mbrojtje dhe zhvillim të pluralizmit të shërbimeve audio dhe audiovizuele, merr masa në raste kur bëhet shkelje e dispozitave të këtij ligji ose dispozitat e ndërmarra për atë, vendon për shpërndarjen ose vazhdimin e lejeve për transmetim televiziv ose radio, kryen mbikëqyrje të punës së difuzerëve të radios ose atyre televizivë, e përcakton mënyrën e matjes dhe kryen matje të shikueshmërisë ose dëgjueshmërisë së programeve.[1356]

Kuvendi emëron anëtarët e Këshillit të ASHMAA-së, në propozim të propozuesve të autorizuar (SHGM, Konferenca Ndëruniversitare, Oda e Avokatëve e Republikës së Maqedonisë, Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve në Kuvend dhe Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale) për periudhë prej shtatë vitesh[1357]. Këshilli zgjedh drejtor të Agjencisë

[1349] Njëlloj.
[1350] Intervistë me Tamara Çausidisin, kryetare e Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punëtorëve Mediatikë (interviste ballë për ballë), 10.11.2014
[1351] Njëlloj.
[1352] Njëlloj.
[1353] Ligji për medie, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr.184/2013, neni 14.
[1354] Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, Gazeta Zyrtare Nr.184/2013, neni 4.
[1355] Njëlloj.
[1356] Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, Gazeta Zyrtare Nr.184/2013, prej: http://www.avmu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=1160&Itemid=32&lang=mk [qasur më15.10.2014].
[1357] Njëlloj.

me konkursi publik[1358]. Për punën e saj, ASHMAA-ja përgjigjet para Kuvendit duke dorëzuar raport.[1359]

Radiodifuzerët kanë për obligim të dorëzojnë tek ASHMAA-ja raport me shkrim për zbatimin e obligimeve të përcaktuar me lejen e transmetimit të radios ose televizionit, veçanërisht për zbatimin e konceptit programor, më së voni deri më 31 mars të vitit rrjedhës.[1360]

Rastet e shpifjes dhe ofendimit rregullohen me ligj. I dëmtuari ka të drejtë të dorëzojë kërkesë për publikim të përgjigjes, demantit ose përmirësimit në afat prej shtatë ditësh nga dita kur ka mësuar që është publikuar, por jo më vonë se një muaj nga publikimi përkatës[1361]. Në atë rast, mjeti për informim publik i publikon demantin, përgjigjen ose koregimin në afat prej dy ditëve nga dorëzimi i kërkesës, në numrin e parë vijues, nëse bëhet fjalë për publikime periodike ose në mjet tjetër për informim publik, nëse bëhet fjalë për publikim jo periodik[1362]. Publikimi i demantit, përgjigjes ose koregimit mund të refuzohen nëse kërkesa nuk është dorëzuar me kohë, nëse përmban ofendim ose shpifje ose shkel interesat e mbrojtura me ligj të personave të tretë.[1363]

12.2.4 LLOGARIDHËNIA (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle mediet kanë llogaridhënie në praktikë?

Ndonëse ka kornizë relative të fuqishme për rregullim të llogaridhënies së medieve, ligjet janë lëndë e ndryshimeve të shpeshta dhe zbatimit të pamjaftueshëm.[1364]

Si trup rregullator, ASHMAA i ndjek përmbajtjen e programeve, pronësinë në medie dhe koncentrimin e tregut, dhe përfshin edhe monitorimin e kanaleve televizive rajonale. Kontrolli i radiodifuzerëve është transparent, sepse agjencia publikon raporte të rregullta për punën e saj. Vendimet që përmbajnë masa kundër radiodifuzerëve që kanë shkelur ligjin, bashkë me informatat për mekanizmat e kontrollit të ASHMAA-së, mund të gjenden në internet.[1365]

Mediet shërbehen me bllogje, forume, letra nga lexues dhe forma të ndryshme të bashkëvepimit publik, të cilat përdoren mirë, veçanërisht ato të rrjeteve sociale dhe internet portaleve. Mungojnë përgjigje dhe reagime nga gazetarët dhe redaktorët, përveç në letrat nga lexuesit në mediet e shtypura, ku zakonisht ka reagim të personit përgjegjës.

Përfaqësuesit e medieve pohojnë se sigurojnë të drejtën e përgjigjes dhe përmirësimit të informatave në afat të duhur kohor. Megjithatë, përvoja e Transparency International – Maqedoni është tjetër. Gjatë qershorit dhe gushtit 2015, Transparency International – Maqedoni ishte akuzuar për publikim të fakteve të pasakta në lidhje me projektet edhe financimin përkatës. Mediet pro qeveritare (Dnevnik dhe Veçer) nuk kanë siguruar me kohë Transparency International –Maqedoni të drejtën e përgjigjes dhe përmirësimit të informatave të gabuara.

[1358] Njëlloj.
[1359] Njëlloj.
[1360] Ligji për medie, Gazeta Zyrtare Nr.184/2013, neni 15.
[1361] Ligji për përgjegjësi qytetare për ofendim dhe shpifje, Gazeta Zyrtare Nr. 143/2012, neni 14.
[1362] Njëlloj.
[1363] Njëlloj.
[1364] Tërpevska dhe Micevski, 2014: f. 51.
[1365] Sllobodan Tomiq, dr. Sllagjana Taseva, Ivana Popoviq, Aleksandar Jovanqiq, Zorica Vojinoviq, *Transparencë dhe Llogaridhënie e Agjencisë, analizë krahasuese e pesë sektorëve të rregulluar në Serbi dhe Maqedoni,* (Beograd, Programi rajonal për promovim të hulumtimit në Ballkanin Perëndimor (PRPHBP), 2015).

Transparency International – Maqedoni ka ngritur padi para Këshillit për Etikë të Medieve, që vendosi në dobi të Transparency International - Maqedoni.[1366]

12.2.5 MEKANIZMAT E INTEGRITETIT (E DREJTA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle ka dispozita me të cilat sigurohet integriteti i punëtorëve të medieve?

Korniza ligjore nuk siguron mjaftueshëm mbrojtje për të siguruar integritet të punëtorëve në medie.

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) është organizatë e pavarur, joqeveritare dhe jo-politike që ka për qëllim të jete mbrojtëse dhe promovuese e standardeve profesionale gazetareske dhe lirisë së shprehjes[1367]. Nga viti 2001, SHGM-ja ka Kod të etikës së gazetarëve të maqedonisë[1368]. Në përputhje me Kodin, detyra kryesore e gazetarëve është të respektojnë të vërtetën dhe të drejtën që publiku të jetë informuar në pajtim me nenin 16 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.[1369]

Këshilli për Etikë është përgjegjës për monitorimin e parimeve të Kodit.[1370] Ky është trupi i vetëm vetë-rregullues i gazetarëve në Maqedoni.[1371]

Këshilli i Etikës së Medieve (i themeluar nga pjesa më e madhe e medieve të shtypura dhe elektronike) është themeluar në fund të vitit 2013, si trup vetë-rregullues[1372]. Këshilli ka Komisionin për Ankesa të përbërë prej shtatë anëtarëve që vendosin për parregullsitë në tekstet gazetareske[1373]. Secili qytetar, trup publik dhe gazetar mund të dorëzojë ankesë kundër medieve (jo kundër gazetarëve individual) për shkelje të standardeve profesionale dhe etike.[1374]

Gazetarët mendojnë që dhuratat, përfitimet dhe shërbimi janë formë e shtypjes. Megjithatë, mediet nuk kanë kode të veta të sjelljes përveç Kodit të etikës së SHGM-së, ndonëse secila medie duhet të ketë kodin e sjelljes[1375] dhe duhet të kenë dispozita në ligjin të lidhura me etikën e medieve.[1376]

12.2.6 MEKANIZMA TË INTEGRITETIT (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle në praktikë sigurohet integriteti i punëtorëve në medie?

[1366] http://www.transparency.mk/en/index.php?option=com_content&task=view&id=532&Itemid=30 [qasur më15.10.2014]. Demant http://www.transparency.mk/index.php?option=com_content&task=view&id=1076&Itemid=57

[1367] http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/en/node/121, Statuti i SHGM-së [qasur më31.10.2015].

[1368] http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/en/node/441, Kodi i gazetarëve të Maqedonisë [qasur më1.11.2014].

[1369] Njëlloj.

[1370] Njëlloj.

[1371] Njëlloj.

[1372] http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=122013729567&id=9&setIzdanie=23057 [qasur më31.10.2014].

[1373] Njëlloj.

[1374] Njëlloj.

[1375] Intervistë me Tamara Çausidisin, kryetare e Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punëtorëve Mediatikë (interviste ballë për ballë) 10.11.2014 ; ZhanetaTrajkoska, drejtoreshë e Shkollës së Lartë për Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun (interviste ballë për ballë)10.11.2014, Biljana Petkovska, drejtoreshe e Institutit Maqedonas për Medie (interviste ballë për ballë) 10.11.2014

[1376] Njëlloj.

Mediet nuk kanë kode të sjelljes [1377] ndonëse ka obligim për atë ndërsa respektimi i parimeve etike është në nivel të ultë dhe gazetarët shpesh anojnë politikisht në njoftimin, sepse u janë nënshtruar ndikimit dhe kontrollit nga interesat politike dhe afariste (shikoni pavarësia (praktika[1378])). Gazetarët nuk kanë kapacitet të kundërshtojnë pushtetitn dhe nuk kryejnë rolin e tyre si kontroll demokratik i pushtetit.[1379]

Ndonëse disa gazetarë njoftojnë në mënyrë objektive, tjerët jo shpesh mbështeten në më shumë burime, ndërsa disa gazetarë janë informues të pushtetit[1380]. Nëse lajmi është lidhur me politikën ose marrëdhëniet ndëretnike, gazetarët kanë tendencë të përdorin vetëm një burim të informatave dhe të bazojnë lajmet e tyre vetëm mbi deklarata zyrtare qeveritare ose institucionale (për shembull, merren vetëm deklaratat e policisë, por jo të viktimës).[1381]

Dhuratat dhe përfitimet, siç tani më u diskutua në pjesën e pavarësisë (praktika), janë një formë e shtypjes dhe mjet për ndikim mbi gazetarët. Sipas anketës, 51% e gazetarëve marrin ftesa nga udhëtime luksoze ose përfitime tjera, ndërsa 49% ekspozohen në kërcënime për pushim nga puna për të njoftuar në një mënyrë, 24% janë lëndë e censurës së drejtpërdrejtë dhe 16% janë lëndë e frikësimit.[1382]

ROLI

12.3.1 HETIMI DHE ZBULIMI I RASTEVE TË KORRUPSIONIT NË PRAKTIKË

Nota **25**

Në çfarë shkalle mediet në mënyrë aktive hetojnë dhe zbulojnë rastet e korrupsionit?

Gazetaria hetimore që fokusohet në korrupsion dhe keqpërdorime në politikat dhe biznes pothuajse nuk ekziston në Maqedoni si rezultat i shtypjes së medieve[1383]. Disa programe informative janë tërhequr kohën e fundit pa sqarim, ndonëse arsyeja kryesisht është për shkak të kritikave të drejtuara pushtetit[1384]. Ndikimi i Qeverisë mbi politikën redaktuese të medieve është dukuri e përditshme[1385].

Donatorët ndërkombëtarë mundohen të mbështesin gazetarinë hetimore. Tre organizata kanë mbështetur gazetarinë hetimore gjatë viteve të fundit: Rrjeti Raportues Hetimor i Ballkanit (BIRN), Mbështetja e Gazetarisë Hetimore (SKUP) dhe Agjencia e ShBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID[1386]). BIRN dhe USAID kanë promovuar internet faqen për përforcim të gazetarisë hetimore[1387]. Transparency International – Maqedoni ka përdorur rezultate dhe të raste të Qendrës për Përfaqësim dhe Këshillim Ligjor (ALAC) në përpjekjet

[1377] Intervistë me Tamara Çausidisin, kryetare e Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punëtorëve Mediatikë (interviste ballë për ballë) 10.11.2014 ; ZhanetaTrajkoska, drejtoreshë e Shkollës së Lartë për Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun (interviste ballë për ballë)10.11.2014 , Biljana Petkovska, drejtoreshe e Institutit Maqedonas për Medie (interviste ballë për ballë) 10.11.2014

[1378] Njëlloj.

[1379] Tërpevska dhe Micevski, 2014: f. 58.

[1380] Intervistë me ZhanetaTrajkoskaën, drejtoreshë e Shkollës së Lartë për Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun (interviste ballë për ballë)10.11.2014

[1381] Intervistë me Snezhana Llupevskën, redaktore e "Kod" (interviste ballë për ballë), 11.11.2014

[1382] Anketë për gjendjen e gazetarisë, SHGM, shtator 2014 http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/sites/default/files/Anketa%20 novinari%20 ZNM%20September%202014.pdf [qasur më12.12.2014].

[1383] Tërpevska dhe Micevski, 2014: f. 110.

[1384] Njëlloj.

[1385] Ida Protugjer Velkoviq, gazetare http://mediapedia.mk/istrazuvanja/their-thoughts-media-ownership

[1386] Tërpevska dhe Micevski, 2014: f. 110.

[1387] http://prizma.birn.eu.com [qasur më15.10.2014].

për zbatim të politikave për mbrojtje të informatorëve[1388]. Ishte lansuar një internet faqe e re për hetim të strukturës pronësore të medieve[1389], që zbulon që ndërmarrjet "off-shore", që kanë pronarë jo transparentë, janë pronarë të internet portaleve.[1390]

Magazina Javore "Fokus" dhe gazeta ditore "Nova Makedonija" shpesh publikojnë lajme hetimore. "Fokus" i heton format e ndryshme të krimit të organizuar dhe korrupsion, por redaktorët përballen me padi për shpifje[1391]. Pas padisë për shpifje kundër "Fokus" në vitin 2006, pronari i "Fokus" ishte dënuar me 30.000 EUR për zbulim të informatave për llogari sekrete të bankave të ish kryetarit të shtetit[1392]. Në vitin 2011, redaktori kryesor i "Fokus" ishte dënuar me 15.000 EUR në procedurë padie të ngritur nga ish ministri i Punëve të Jashtme[1393]. Në vitin 2014, "Fokus" ishte dënuar me 9.300 EUR dhe SHGM-ja në shenjë solidariteti ka organizuar mbledhje të suksesshme të mjeteve financiare për të ndihmuar kolegët[1394]. Pronari i "Fokus" ka vdekur në një aksident trafiku në mars të vitit 2013 që ka shkaktuar kontrovers publik[1395]. Siç tanime është përmendur në pjesën e pavarësisë (praktika), ishte mbyllur një gazetar hetimor i gazetës "Nova Makedonija".

Ka një TV program hetimor "Kod", që në periudhë të caktuar hetimet e veta i kufizon vetëm në probleme sociale.

Disa raste me profil të lartë janë në hetim të gazetarëve. Organizatat qytetare shpesh organizojnë debate dhe lobojnë për ndryshime të ligjit.[1396]

Nuk ka shoqata të gazetarëve hetimorë ose katedra për gazetari hetimore në universitet.[1397]

12.3.2 INFORMIMI I PUBLIKUT PËR KORRUPSIONIN DHE NDIKIMI PËRKATËS

Nota **0**

Në çfarë shkalle mediet në mënyrë aktive dhe me sukses informojnë publikun për korrupsion dhe ndikimi mbi shtetin?

Nuk ka programe të veçanta për edukim të publikut në lidhje me korrupsionin dhe luftën kundër korrupsionit.[1398]

Ka dy medie kryesore elektronike "24 Vesti" dhe "Tv Telma", si dhe internet faqet "Nova", "Plusinfo" dhe "SKUP" dhe një medie e shtypur (magazina "Fokus"), që kanë kritikë ndaj pushtetit dhe publikojnë informata dhe lajme hetimore për korrupsionin dhe kritika për punën e pandërgjegjshme të pushtetit. Kjo krijon situatë të "errësirës" medietike ku pjesa më e madhe e qytetarëve madje as nuk kanë dëgjuar të a.q. "bombat" nga skandali i përgjimit.[1399]

[1388] http://www.transparency.mk/index.php?option=com_content&task=blogcategory&id=16&Itemid=69 [qasur më 5.10.2015].
[1389] http://mediapedia.mk/ [qasur më15.10.2014].
[1390] Intervistë me Tamara Çausidisin, kryetare e Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punëtorëve Medietik (interviste ballë për ballë) 10.11.2014
[1391] Tërpevska dhe Micevski, 2014: f. 111.
[1392] Njëlloj.
[1393] Njëlloj.
[1394] http://novatv.mk/index.php?navig=8&cat=2&vest=17519 "Aksion i suksesshëm për solidaritet me gazetarët".
[1395] Tërpevska dhe Micevski, 2014: f. 111
[1396] Intervistë me ZhanetaTrajkoskën, drejtoreshë e Shkollës së Lartë për Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun (interviste ballë për ballë)10.11.2014
[1397] Njëlloj.
[1398] Intervistë me Tamara Çausidisn, kryetare e Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punëtorëve Mediatikë (interviste ballë për ballë) 10.11.2014 ; ZhanetaTrajkoska, drejtoreshë e Shkollës së Lartë për Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun (interviste ballë për ballë)10.11.2014 , Biljana Petkovska, drejtoreshe e Institutit Maqedonas për Medie (interviste ballë për ballë) 10.11.2014
[1399] http://www.iri.org/sites/default/files/wysiwyg/2015-07-13_survey_of_macedonian_public_opinion_june_6-15_2015.pdf [qasur më 15.10.2014].

12.3.3 INFORMIMI I PUBLIKUT PËR ÇËSHTJET LIDHUR ME QEVERISJEN

Nota **25**

Në çfarë shkalle mediet në mënyrë aktive dhe me sukses informojnë publikun për aktivitetet e qeverisë dhe për subjektet tjera në drejtimin?

Mediet në baza ditore informojnë publikun për aktivitetet e Qeverisë por në mënyrë të njëanshme. Për publikun është shumë vështirë të marrin informata objektive dhe të paanshme për aktivitetet e Qeverisë nëpërmjet medieve. Gazetaria kritike është më tepër e përfaqësuar me mediet në internet (internet portalet dhe internet televizione), të themeluar nga gazetarë profesionistë, që më herët kanë punuar në institucione që kanë qenë lëndë e shtypjes serioze politike.[1400]

REKOMANDIME:

R1. Shoqata e Gazetarëve duhet të miratojë kod unik të sjelljes për mediet.

R2. Shoqatat e Gazetarëve duhet të propozojnë ndryshime të Ligjit për përdorim të sjelljes etike dhe integritetit të medieve dhe gazetarëve.

R3. Qeveria duhet të ndryshojë Ligjin për medie dhe të sigurojë që reklamat politike nuk lejohen në servisin publik që rregullohet në lejet kombëtare.

R4. Drejtoria të Hyrave Publike duhet të zhvillojë mekanizëm efektiv për monitorim të donacioneve të partive politike nga mediet.

[1400] Njëlloj.

13. SHOQËRIA CIVILE

PËRMBLEDHJE

Kushtetuta ju garanton qytetarëve të drejtën e shoqërimit të lirë. Ligjet për rregullimin e organizatave qytetare ekzistojnë që prej vitit 1998 dhe në vitin 2010 është miratuar Ligji për shoqëri dhe fondacionie[1401]. Procedura e regjistrimit të organizatave qytetare është relativisht e thjeshtë, e shpejtë dhe e lirë[1402]. Në dhjetor të vitit 2014 janë shënuar 13.654 regjistrime, prej të cilëve 4.156 janë regjistruar sërish ose për herë të parë. Organizatat qytetare lirshëm mund të shprehin dhe promovojnë qëndrimet dhe mendimet e tyre, të nisin iniciativë dhe të marrin pjesë në ndërtimin e mendimit publik dhe krijimit të politikave. Ndonëse i kanë këto veçori, ato sërish janë lëndë e shtypjes politike, përfshirë edhe padi të shpeshta për shpifje dhe ofendim.[1403] Organizatat qytetare janë ekspozuar edhe në dhunë dhe mostolerancë gjatë viteve të fundit, për shembull, kishte sulm ndaj qendrës LGBT ndërsa publikohen edhe shkresa homofobike në medie,[1404] dhe ato që kanë qenë kritikë ndaj pushtetit janë emëruar tradhtarë. Transparency International – Maqedoni[1405] ishte përballuar me sulm nga mediet pro qeveritare për shkak të fushatës për mbrojtje të informatorëve.[1406]

Organizatat qytetare kanë mungesë të mjeteve financiare, ndërsa ky është problem që paraqitet në raportet e përparimit të KE-së: “Orientimi i mjeteve shtetërore për organizatat qytetare ende nuk është tërësisht i rregulluar, duke lënë këtë sektor në masë të madhe të varur nga mjete të donatorëve” (raporti i KE-së për 2014, f. 10). Hulumtimi nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe nga Civikus tregon që pothuaj se 60% të organizatave mbështeten në donacione të huaja, ndërsa 25% nga ndihma e BE-së.

NOTA E PËRGJITHSHME PËR SHTYLLËN: 43,75/100

[1401] Ligji për shoqëri dhe fondacione, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 52/2010.
[1402] Intervistë me Zoran Stojkovski, drejtor ekzekutiv i OQ CIRA (interviste ballë për ballë) 27.1.2015 ; Intervistë me Emina Nuredinovskën, Udhëheqëse e Seksionit, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, (interviste ballë për ballë) 28.1.2015
[1403] Kire Vasilev, BE-ja dhe organizata të aktivistëve në Republikën e Maqedonisë, (Shkup: Instituti për Politika Evropiane, 2014), f. 7. http://www.epi.org.mk/docs/EU%20i%20aktivistickite%20organizacii%20vo%20Republika%20Makedonija.pdf (qasur më21.1.2015).
[1404] Njëlloj.
[1405] http://dnevnik.mk/?ItemID=64117EA064C3D64E90A1DAF69D0CB3FD (1.6.2015)
[1406] Mbrojtja e “informatorëve” do të ndihmojë në luftën kundër shtetit të drejtë“ http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=1014141053149&id=12&setIzdanie=23297

DIMENSIONI	TREGUESI	E DREJTA	PRAKTIKA
Kapaciteti 56,2/100	Resurset	75	50
	Pavarësia	75	25
Qeverisja 25/100	Transparenca	/	25
	Llogaridhënia	/	25
	Integriteti	/	25
Roli 50/100	Përgjegjësia e qeverisë	50	
	Reformat e politikave	50	

Nota për shtyllën sipas të drejtës dhe praktikës



STRUKTURA DHE ORGANIZIMI

Deri në miratimin e ligjit të ri në vitin 2010, numri i organizatave qytetare ishte 11.350.[1407] Deri në mars 2012, vetëm 3.732 organizata qytetare janë regjistruar sërish në përputhje me obligimet e përcaktuara me ligjin e vitit 2010.

Analiza e publikuar në vitin 2011 nga Civikus ka përshkruar shoqërinë civile si "të zhvilluar mesatarisht" në kuptim të vlerave dhe institucioneve e tij[1408]. Sipas të dhënave të publikuara nga Drejtoria për Kundërzbulim Financiar në lidhje me 11.350 organizata qytetare, buxhetet e tyre janë shumë të vogëla, dhe vetëm 5 organizata kanë buxhet vjetor që tejkalon 100.000.000 denarë (1.6 milion EUR).[1409]

[1407] Strategjia për bashkëpunim me OJQ (2012-2017). http://www.nvosorabotka.gov.mk/index.php?option=com_docman&task=cat_view&gid=22&Itemid=37
[1408] Njëlloj, f. 12.
[1409] Njëlloj, f. 13 Në bazë të Prezantimit të DKF 03 mars 2011, "Monitorimi i lëndëve dhe metoda të efikasitetit".

Në Maqedoni nuk ka traditë të donacioneve për organizatat qytetare. Gjithashtu, nuk ka traditë të vullnetarizmit. Konsiderohet që organizatat qytetare që merren me të drejtat e njeriut dhe barazinë kanë më tepër ndikim dhe shkallë më të vogël të korrupsionit. Thënë në përgjithësi, ka mungesë të resurseve njerëzore dhe financiare[1410].

Dialogu dhe bashkëpunimi ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë qytetare janë vendosur në nivelin formal.[1411]

Duke marrë parasysh gjendjen ekonomike dhe shkallën e lartë të papunësisë (28%), organizatat qytetare konsiderohen si mundësi për punësim. Nuk është zhvilluar praktika e organizatave qytetare të paguajnë anëtarësim në sektorin qytetar në Maqedoni. Organizatat qytetare i financojnë aktivitetet e tyre me anë të donacioneve. Në kuptim të organizimit strukturor, pjesa më e madhe e tyre nuk kanë struktura të vendosura mirë, përfshirë edhe ndarjen e strukturës ekzekutive nga ajo drejtuese.

Sfida më e madhe me të cilën përballen organizatat qytetare është tërheqja e donatorëve nga Maqedonia, duke marrë parasysh nivelin e ultë të financimit të shtetit, donacionet individuale dhe donacionet nga sektori privat[1412]. Në lidhje me buxhetin shtetëror, gjatë tre viteve të fundit, 4.2 milionë EUR janë dedikuar për organizatat qytetare, sindikatat, organizatat fetare dhe partitë politike[1413]. Mjetet nga lotaria janë një burim i rëndësishëm i të ardhurave të organizatave qytetare, por edhe ndonëse ligji tregon që 50% të të ardhurave nga lotaria duhet të dedikohen për këto organizata, gjegjësisht ndahen vetëm ndërmjet 7% dhe 12%.[1414]

VLERËSIMI

KAPACITETI

13.1.1. RESURSET (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle korniza ligjore siguron mjedis të volitshëm për shoqërinë qytetare?

Organizatat qytetare janë regjistruar në pajtim me Ligjin e ri për shoqëri dhe fondacione të miratuar në vitin 2010, ndonëse disa organizata të caktuara aktive janë regjistruar në pajtim me ligjin paraprak të vitit 1998[1415]. Procedura për regjistrim të organizatave qytetare është relativisht e thjeshtë, e shpejtë dhe e lirë[1416]. Sipas anketës së zbatuar nga MCMS-ja, procedura për regjistrim është e thjeshtë dhe e shpejtë në 84% të rasteve[1417]. Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë është përgjegjës për regjistrimin, me të cilin organizata fiton statusin e personit juridik.[1418]

[1410] Ndihmë Teknike për Organizatat Joqeveritare në vendet e IPA-s, Raporti për vlerësim të nevojave (Shkup: TAKSO, 2010), f. 9.
[1411] Internet-faqja e seksionit për bashkëpunim me organizata joqeveritare në Sekretariatin e Përgjithshëm të Qeverisë: http:// www.nvosorabotka.gov.mk/
[1412] Njëlloj.
[1413] Emina Nuredinovska dhe Simona Ognenovska, *Raporti për zona të volitshme për zhvillim të shoqërisë qytetare* (Shkup: MCMS, 2014), f. 19.
[1414] Njëlloj.
[1415] Intervistë me Zoran Stojkovskin, drejtor ekzekutiv i OQ CIRA (interviste ballë për ballë) 27.1.2015
[1416] Intervistë me Zoran Stojkovskin, drejtor ekzekutiv i OQ CIRA (interviste ballë për ballë) 27.1.2015 ; Intervistë me Emina Nuredinovskën, Udhëheqëse e Seksionit, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, (interviste ballë për ballë) 28.1.2015
[1417] Nuredinovska dhe Ognenovska, 2014: f. 19.
[1418] Njëlloj.

Nëse organizata qytetare është e ndaluar, mund të paraqesë ankesë në gjykatën kompetente të apelit.[1419]

Organizatat e paregjistruara nuk janë të ndaluara me ligji dhe janë funksionale në praktikë[1420]. Për shembull, pikërisht këto organizata kanë organizuar Marshin e tolerancës, si dhe Lëvizjen kundër rritjes së çmimeve të energjisë elektrike (AMAN).[1421]

Neni 20 (liria e shoqërimit) dhe Neni 21 (liria e mbledhjes së qetë) nga Kushtetuta e garantojnë lirinë e besimit, vetëdijes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit, fjalës, paraqitjes publike dhe informatat me karakter publik. Shteti i ka ratifikuar instrumentet relevante evropiane dhe ndërkombëtare ligjore me të cilat garantohet dhe rregullohet mbrojtja e lirisë së shprehjes, siç janë Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Marrëveshja e OKB-së për të drejtat qytetare dhe politike. Në këtë kuptim, organizatat qytetare lirshëm mund të përfaqësojnë qëndrime dhe të kritikojnë pushtetin. Ato lirshëm mund të shprehin dhe të promovojnë mendimet dhe qëndrimet e tyre, të nisin iniciativa dhe të marrin pjesë në ndërtimin e mendimit publik dhe krijimit të politikave.[1422]

Sistemi tatimor nuk është i volitshëm për organizatat qytetare. Lirimet/stimulimet tatimore mundësohen për organizatat qytetare që pranojnë donacione për avancimin e interesit publik, siç janë aktivitete nga fusha e të drejtave të njeriut, kultura, etika, arsimi, mjedisi jetësor, shkenca dhe tjera të ngjashme[1423]. Qeveria ka themeluar Komisionin për Organizata me Status të Interesit Publik që organizatave qytetare ju jep status të organizatave me interes publik. Megjithatë, procedura administrative për dhënien e këtij statusi është e ndërlikuar dhe krijon një ngarkesë plotësuese për organizatat qytetare dhe donatorët[1424]. Meqë nuk ka lehtësime tatimore, organizatat qytetare trajtohen në sistemi tatimor njëlloj sikur personat tjerë juridikë dhe nuk ka mbështetje jo-direkte shtetërore për organizatat qytetare[1425]. Tatimi mbi të ardhurat e shpenzimeve materiale dhe të rrugës për organizatat qytetare është i njëjtë sikur edhe për personat tjerë juridikë[1426]. Një aspekt pozitiv është që nuk ka kufizime të shumës së të ardhurave që organizata qytetare mund ta përfitojë nga aktivitetet ekonomike.[1427]

13.1.2 RESURSET (PRAKTIKA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle organizatat qytetare disponojnë me resurse përkatëse financiare edhe njerëzore për të punuar në mënyrë efikase?

Gjendja e organizatave qytetare në praktikë është pothuaj se ndryshe në kuptim të përdorimit të gjerë të padive për shpifje dhe ofendim dhe në kuptim të tendencës së medieve pro qeveritare aktive në etiketim të OQ-ve kritike.[1428]

Mungesa e resurseve të qëndrueshme financiare është një prej problemeve më të mëdha

[1419] Ligji për shoqëri dhe fondacione, (Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 52/2010).
[1420] Nuredinovska dhe Ognenovska, 2014: f. 19.
[1421] Intervistë me Zoran Stojkovskin, drejtor ekzekutiv i OQ CIRA (interviste ballë për ballë) 27.1.2015
[1422] Vasilev, 2014: f. 7.
[1423] Ligji për donacione dhe sponsorime, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 47/06, 86/08, 51/2011 dhe 28/14.
[1424] Intervistë me Emina Nuredinovskën, Udhëheqëse e Seksionit, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, (interviste ballë për ballë) 28.1.2015
[1425] Nuredinovska dhe Ognenovska, 2014: f. 27.
[1426] Njëlloj.
[1427] Njëlloj.
[1428] Njëlloj, http://www.epi.org.mk/docs/EU%20i%20aktivistickite%20organizacii%20vo%20Republika%20Makedonija.pdf [qasur më21.1.2015].

të organizatave qytetare. Pothuaj se 60% të organizatave qytetare për mjete financiare mbështeten në organizata të huaja, për shembull, BE-ja është një prej donatorëve më të mëdhenj të organizatave qytetare[1429]. Megjithatë, Instrumenti për Ndihmë Paraaderuese (IPA) nuk përdoret mjaft. Prej 622.5 milion EUR në dispozicion, është përdorur vetëm 1% e ndihmës së IPA-s për organizatat qytetare (vetëm 6.72 milion EUR).[1430] Burime tjera më të mëdha të financimit janë SDC Civica Mobilitas (6 milion EUR); OKB, USAUD (2.5 milion EUR); BE-ja në kuadër të IPA-s disponon me më tepër se 5 milion EUR në vit për aktivitetet e organizatave qytetare.[1431]

Pjesa më e madhe e organizatave qytetare nuk kanë staf të paguar ose kanë mungesë të stafit. Në vitin 2012 ka pasur 1.839 të punësuar në organizata qytetare, që është një ulje në krahasim me vitin 2006, ndërsa 88% e organizatave qytetare mbështeten në mbështetje vullnetare[1432]. Organizatat qytetare me mbështetje të fortë financiare mund të tërheqin kuadro profesionale[1433]. Pothuaj se gjysma e numrit të plotë të punësuarve dhe dy të tretat e mjeteve të plota u shpërndahen organizatave qytetare më të fuqishme financiarisht (rreth 100 organizatave).[1434]

Organizatat private filantropike u japin 1% të përqindjes së burimeve të tyre organizatave qytetare. 75 deri 80% të donacioneve për organizatat qytetare dalin nga donatorë ndërkombëtarë.[1435]

Organizatat qytetare kryesisht punojnë në projekte dhe si organizata joprofitabile. Nuk ka kufizime për të përfituar mjete plotësuese nga shërbimet, produktet ose dhënia me qira. Për shembull, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë i jep me qira një pjesë të lokaleve një ndërmarrje private që organizon ngjarje.[1436]

13.1. 3 PAVARËSIA (E DREJTA)

Nota **75**

Në çfarë shkalle ka masa mbrojtëse ligjore për të parandaluar përzierjen e jashtme joadekuate në punën e organizatave qytetare?

Ka mjaft mbrojtje ligjore për të parandaluar ndikime të padrejta të jashtme në aktivitetet e organizatave qytetare[1437]. Themelimi i organizatave është i ndaluar vetëm nëse programi i tyre është në lidhje me rrëzimin e dhunshëm të rendit kushtetues të shtetit, thirrje për agresion ushtarak, ose nxitje të mostolerancës dhe urrejtjes kombëtare, racore ose fetare. Organizata do të ndalohet nëse ndërmerr aktivitete terroriste, aktivitete në kundërshtim me Kushtetutën ose ligjin dhe nëse shkel liritë dhe të drejtat e të tjerëve.[1438]

Nuk ka dispozita për pjesëmarrje të përfaqësuesve shtetërorë në bordet e organizatave qytetare dhe nuk ka rregullore që mundëson pjesëmarrjen e detyrueshme të përfaqësuesve në takimet e organizatave qytetare. E drejta e privatësisë i përfshin edhe organizatat qytetare.

[1429] Kire Vasilev, 2014: f. 7.
[1430] Kire Vasilev, 2014: f. 16. http://www.epi.org.mk/docs/EU%20i%20aktivistickite%20organizacii%20vo%20Republika%20 Makedonija.pdf
[1431] http://www.tacso.org/documents/otherdoc/?id=7257 [qasur më21.1.2015].
[1432] Kire Vasilev, 2014: f. 7.
[1433] Intervistë me Zoran Stojkovskin, drejtor ekzekutiv i OQ CIRA (interviste ballë për ballë) 27.1.2015
[1434] Nuredinovska, Sazdevskin, Gjuzellov, 2014: f. 102.
[1435] Intervistë me Zoran Stojkovskin, drejtor ekzekutiv i OQ CIRA (interviste ballë për ballë) 27.1.2015
[1436] Njëlloj.
[1437] Ligji për shoqëri dhe fondacione, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 52/2010.
[1438] Njëlloj.

13.1.4 PAVARËSIA (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle shoqëria qytetare mund të ekzistojë dhe të funksionojë pa ndikimin e jashtëm joadekuat?

Në vend ka më tepër se 5.000 organizata qytetare që funksionojnë në rreth të sigurt, përfshirë edhe shembuj (të përmendur më poshtë) që tregojnë ndikimin e jashtëm të padrejtë në punën e organizatave qytetare. Megjithatë, disa aktivistë të shoqërisë qytetare e përdorin fjalën "ikebana" kur flasin për organizatat qytetare[1439], duke dhënë këtë arsyetim: "Qeveria u ka lejuar të ekzistoni, por u injoron, dhe përdor ekzistimin tuaj në pohimin që ky është një vend i lirë".

Ka raste të manipulimit të organizatave qytetare nga Qeveria në dobi të interesave të saj. Gjithashtu, ka organizata që janë "dora e vazhduar e Qeverisë[1440]". Për shembull, shoqata e re e organizuar për bashkimin shpirtëror të Setnikëve, Krushodarëve dhe Popadnikëve nga Lerini në Maqedoni nuk ka të punësuar, nuk ka mjete, as internet faqe por jep donacione në përmendore në vlerë prej miliona euro[1441]. Mediet pro qeveritare i kritikojnë organizatat qytetare. Organizatat qytetare që janë të financuara nga fondacioni Xhorxh Soros e kritikojnë Qeverinë dhe shqetësohen nga partia udhëheqëse politike dhe shpesh sulmohen nga mediet si tradhtarë dhe armiq shtetërorë[1442]. Ndodhin sulme të aktivistëve të shoqërisë qytetare dhe në këto raste, zakonisht institucionet e vonojnë procedurën dhe nuk bëhen hetime të drejta dhe të paanshme. Aktivistët e OJQ Parkobrani (mbrojtës të parkut) ishin paraburgosur. Ata kundërshtuan planet qeveritare për ndërtim të një ndërtese administrative në sipërfaqe të gjelbër në qendër të qytetit[1443]. Aktivistët e OJQ Ploshtad Slloboda ishin sulmuar gjatë protestave kundër ndërtimit të kishës dhe objekteve tjera në sheshin kryesor në qendër të qytetit[1444]. Qendra LGBT ishte sulmuar, ndërsa mediet kishin publikuar shkresa homofobike[1445].

QEVERISJA

13.2.1 TRANSPARENCA (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle ka transparencë në organizatat qytetare?

Organizatat qytetare nuk janë shumë transparente. Vetëm organizatat më të mëdha publikojnë informata për publikun në lidhje me aktivitetet e tyre në baza të rregullta. Gjithashtu, ato publikojnë raportet e tyre vjetore, si dhe përbërjen e bordeve të tyre dhe raportet financiare. Niveli i transparencës është i lidhur me kapacitetin dhe me resurset e organizatave qytetare. Shumica e organizatave të regjistruara nuk kanë internet faqe funksionale[1446].

1439 Suad Misini, Qendra Hulumtuese për Shoqëri Qytetare, mbledhje zyrtare me përfaqësues ndërkombëtarë, tetor 2015

1440 http://daily.mk/auto/riker-vladata-da-go-namali-vlijanieto-vrz-nvo-sektorot Qeveria të zvogëlojë ndikimin mbi OJQ sektorin, Intervistë me Ambasadorin e SHBA-ve, 2010 [qasur më21 janar 2015].

1441 http://inbox7.mk/archives/2207 [qasur më28.10.2015].

1442 http://sitel.com.mk/dnevnik/makedonija/vmro-dpmne-%E2%80%9Csorosoidi%E2%80%9D-ja-shpiuniraat-rabotata-na-sovetot-za-evrointegracii Sorosoidët spiunojnë punën e Këshillit për Euro Integrime.

1443 http://www.alfa.mk/News.aspx?ID=63053, dhjetëra aktivistë të Parkobrani të arrestuar në aksion politik në parkun Bristoll

1444 http://www.dw.de/ [qasur më21 janar 2015].

1445 Kire Vasilev, 2014 : f. 7.

1446 Intervistë me Dr. Simonida Kacarskën, kryetare e kuvendit të Institutit për Politika Evropiane, interviste ballë për ballë 28.01.2015

13.2.2 LLOGARIDHËNIA (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle organizatat qytetare janë përgjegjëse para përzgjedhësve të tyre?

Anëtarët e bordeve të organizatave qytetare zakonisht veprojnë në mënyrë pro-formë në sigurim të kontrollit të aktiviteteve organizative. Disa anëtarë të bordit janë të jashtëm, persona eminentë, por anëtarët e bordit janë të motivuar nga shpërblimet që do të marrin, por nuk i shërbejnë komunitetit në mënyrë *per se*[1447].

13.2.3 INTEGRITETI (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle është siguruar integriteti i organizatave qytetare në praktikë?

Organizatat qytetare bëjnë përpjekje për vetë-rregullim dhe ka pasur iniciativë për të përgatitur Kod të etikës për organizatat qytetare për promovim të qëndrueshmërisë së organizatave, mbrojtje të profesionalizmit të të punësuarve dhe për përmirësim të kredibilitetit të organizatave qytetare ndërmjet donatorëve dhe publikut[1448]. Gjithashtu, ka edhe Kod të praktikës së mirë për pjesëmarrje të organizatave qytetare në proceset e krijimit të politikave, që nuk zbatohet në mënyrë të drejtë, ndërsa organet shtetërore të administrimit nuk i kanë dedikuar vëmendje përkatëse[1449].

ROLI

13.3.1 LLOGARIDHËNIA E QEVERISË

Nota **50**

Në çfarë shkalle shoqëria qytetare është aktive dhe e suksesshme në lidhje me llogaridhënien e pushtetit për veprimet e saj?

Organizatat qytetare veprojnë si kontrollues i aktiviteteve dhe politikave qeveritare. Organizatat qytetare i shoqëruan fuqitë për të protestuar kundër ndjekjes penale dhe mbylljes së gazetarit Kezharovski (të përmendur në shtyllën Medie[1450]). Organizatat qytetare gjithashtu me sukses kanë vepruar për mobilizim të publikut në “Aksionin e Gjelbër” në Veles[1451]. Organizatat qytetare kanë mundësuar miratimin e Strategjisë për bashkëpunim me organizatat qytetare[1452], nostrifikimit të diplomave të huaja, Ligjin për ndërmjetësim, Ligjin për vullnetarizëm, si dhe Ligjin për donacione dhe sponzorime[1453].

1447 Intervistë me Zoran Stojkovski, drejtor ekzekutiv i organizatës qytetare Qendra për Zhvillim Institucional (CIRA) (interviste ballë për ballë, 27.01.2015

1448 http://www.gragjanskisvet.org.mk/index6f4c.html?ItemID=7DC8425E1AA9794B86CF1481966FB6FD

1449 Nuredinovska dhe Ognenovska, 2014: f. 31.

1450 http://www.telma.com.mk/vesti/kezharovski-privremeno-osloboden-kolegite-na-protest Kezharovski i liruar përkohësisht (qasur më21.1.2015].

1451 Intervistë me Zoran Stojkovskin, drejtor ekzekutiv i organizatës qytetare Qendra për Zhvillim Institucional (CIRA) (interviste ballë për ballë) 27.1.2015

1452 Intervistë me Emina Nuredinovskën, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, (interviste ballë për ballë) 28.1.2015 r

1453 Intervistë me Dr. Simonida Kacarskën, kryetare e kuvendit të Institutit për Politika Evropiane, interviste ballë për ballë) 28.1.2015

Megjithatë, Qeveria nuk bashkëpunon shpesh me organizatat qytetare. Organizatat qytetare kundërshtojnë, por pa sukses, tentimet qeveritare për reforma në arsimin e lartë, si dhe të projektin qeveritar "Shkupi 2014" që përdor mjete publike për përmendore dhe skulptura në shtetin qendror dhe në qendrën e kryeqytetit, ndryshon objekte të rëndësishme të kryeqytetit në stil barok dhe urbanizon sipërfaqe të gjelbra.

MCMS, Transparency International (TI) – Maqedoni dhe disa organizata tjera realizojnë fushata për përfaqësim, arsim publik dhe për aktivitete të fushës kundër korrupsionit.

13.3.2 REFORMA E POLITIKAVE

Nota **50**

Në çfarë shkalle shoqëria civile në mënyrë aktive është e përfshirë në iniciativat për reforma të politikave për luftë kundër korrupsionit?

Vetëm një përqindje e organizatave qytetare merren me aktivitete kundër korrupsionit. Përveç Transparency International – Maqedoni dhe Transparencë – Maqedoni, që merren me kundër korrupsion dhe konflikt të interesave, organizatat tjera qytetare merren me çështje sektoriale, siç janë prokurimet publike, procesi zgjedhor dhe financimi i partive politike (për shembull, Qendra për Komunikime Qytetare, MOST, Instituti për Demokraci "Societas Civilis", Koalicioni të Gjithë për Gjykim të Drejtë)[1454].

Organizatat qytetare për luftë kundër korrupsionit si dhe organizata qytetare Platforma për Luftë kundër Korrupsionit, e themeluar në dhjetor të vitit 2014, fokusohen në ndjekjen e korrupsionit me publikim të raporteve për transparencë, luftë kundërkorrupsionit, shpenzimit të buxhetit dhe zbatimit të politikave publike, si dhe me propozim të masave për përmirësim të ligjvënies[1455].

Në vend është themeluar një praktikë për përfshirjen e organizatave qytetare në përgatitjen e programeve shtetërore për parandalim dhe për shtypje të korrupsionit.

KSHPK-ja nënshkruar Memorandum për mbështetje të ndërsjellë për parandalim nga korrupsioni dhe konflikti i interesave me 21 organizata qytetare, por me këtë nuk u themelua ndonjë bashkëpunim i rëndësishëm[1456].

REKOMANDIME

R1. Qeveria duhet të përmirësojë dhe të bëjë më transparente procedurat për konsultime në lidhje me politikat e grupeve të organizatave qytetare.

R2. Qeveria duhet të financojë aktivitetet e organizatave qytetare me procedurë transparente dhe pjesëmarrëse, të liruar nga ndikimi i padrejtë.

R3. Organizatat qytetare duhet të vetërregullohen dhe të përgatitin Kod të etikës të organizatave qytetare me qëllim të promovimit të qëndrueshmërisë së organizatave, mbrojtjes së profesionalizmit të të punësuarve dhe përmirësimi të kredibilitetit të organizatave qytetare ndërmjet donatorëve dhe publikut.

R4. Qeveria duhet të prezantojë lehtësime tatimore për organizata qytetare.

[1454] Nuredinovska, Sazdevski, Gjuzellov, 2014
[1455] Njëlloj.
[1456] Njëlloj.

14. SEKTORI AFARIST

PËRMBLEDHJE

Korniza ligjore në përgjithësi është e volitshme për subjektet afariste. Regjistrimi është i thjeshtë dhe i shpejtë, ndërsa rregulloret qeveritare nuk ngarkojnë. Pavarësia e ndërmarrjeve private është siguruar me ligj. Në praktikë, mungesa e një modeli afarist tërësisht të zbatuar, të bazuar mbi sipërmarrjen dhe thellë të ngulitur me kulturë drejtuese, nuk lejon pavarësi të ndërmarrjeve të bazuar në treg konkurrues. Në kombinim me mungesën e gjyqësorit të pavarur, ka mbrojtje të pamjaftueshme të subjekteve afariste të përzierjes së padrejtë të qeverisë dhe shkelje të të drejtave të pronësisë. Integriteti i sektorit afarist nuk është siguruar as me ligj, as në praktikë. Sektori afarist për momentin nuk është përfshirë në politikat qeveritare kundër korrupsionit dhe nuk ka lidhje me shoqërinë qytetare.

Tabela më poshtë i prezanton notat sipas treguesve, që përmbledhin vlerësimin e sektorit afarist në lidhje me kapacitetin, drejtimin e brendshëm dhe rolin në sajë të sistemit maqedonas për integritet. Pjesa tjetër e këtij kapitulli jep një analizë cilësore për secilin tregues.

NOTA E PËRGJITHSHME PËR SHTYLLËN: 32,6/100

DIMENSIONI	TREGUESI	E DREJTA	PRAKTIKA
Kapaciteti 43,7/100	Resurset	75	25
	Pavarësia	50	25
Qeverisja 54,1/100	Transparenca	100	50
	Llogaridhënia	50	50
	Integriteti	50	25
Roli 0/100	Përfshirja në luftën kundër korrupsionit	0	
	Mbështetja për/ bashkëpunim me shoqërinë qytetare	0	

Nota për shtyllën sipas të drejtës dhe praktikës



STRUKTURA DHE ORGANIZIMI

Qeveria zyrtarisht ka zbatuar politika për çrregullim dhe zvogëlim të pengesave administrative për subjektet afariste. Megjithatë, politika qeveritare për sipërmarrje nuk nxit konkurrencën.

Ndërmarrjet e vogla janë modeli më i shpeshtë afarist në Maqedoni. Tre të katërtat e gjitha ndërmarrjeve janë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) në pronësi private[1457]. Ka 1.283 ndërmarrje të mëdha dhe të mesme prej gjithsej 70.659. Sipas direktoriumit on-line "Rrjeti Afarist[1458]", siç është publikuar në mediet ekonomike, 40 ndërmarrje vendore prej 100 më të mëdhave janë në pronësi private, i udhëheq kuadro udhëheqëse vendore. Te 46 ndërmarrje, në mesin e 100 më të mëdhave, kapitali dominues është i huaj, ndërsa 27 prej tyre në pozitën e drejtorit ekzekutiv kanë të vendosur person të huaj. Në 13 prej tyre janë të vendosur drejtues vendorë, ndërsa në 6 ndërmarrjet tjera në pozitat kryesore ka drejtim të përzier – vendor dhe të huaj[1459]. Në fund të vitit 2014, 116 ndërmarrje me kapitalizim të kombinuar tregtar prej 1.763.260.000 USD kanë dalë në Bursën Maqedonase[1460].

VLERËSIMI

KAPACITETI

14.1.1 RESURSET (E DREJTA)

Nota **75**

[1457] http://www.stat.gov.mk/Publikacii/PDFSG2015/12-DelovniSubj-BusinessEnt.pdf [qasur më25.3.2015].
[1458] http://www.fleetbusinessnetwork.co.uk/business-networking-in-fleet/
[1459] Kush e udhëheq ekonominë maqedonase? Kapital, publikuar më 28 tetor 2015 , 16.09 nga Igor Petrovski, ekonomi, http:// kapital.mk/koj-upravuva-so-makedonskata-ekonomija/
[1460] http://www.mse.mk/Repository/UserFiles/File/Godisni%20izvestai/GODISEN%20IZVESTAJ%20ZA%20RABOTA%202014.pdf [qasur më25.3.2015].

Në çfarë shkalle korniza ligjore siguron rrethim të volitshëm për formim dhe punë të subjekteve afariste?

Korniza ligjore në përgjithësi është e volitshme për subjektet afariste. Vendi është renditur në vendin e 30-të prej 189 ekonomive në hulumtimin e *Doing Business* të Bankës Botërore për vitin 2015[1461].

Sipas Bankës Botërore, Maqedonia është renditur në vendin e tretë në botë në lidhje me procedurat e thjeshta për fillim të biznesit, sepse procesi përfshin vetëm dy hapa në praktikë (në krahasim me mesataren prej 4.8 të OECP-së): (1) regjistrim në noter i veprimtarive të ndërmarrjes dhe anëtarëve të shoqërimit, dhe (2) regjistrim në Regjistrin Qendror dhe marrje e vulës së ndërmarrjes. Janë të nevojshëm 12[1462] hapa në pajtim me Ligjin[1463]. Ndërmarrje regjistrohen nga Agjencia Kombëtare e Regjistrit Qendror. Nëse Agjencia refuzon të regjistrojë një ndërmarrje të caktuar, vendimi mund të kontestohet në gjykatë[1464]. Ka disa mënyra të ndryshme për të filluar një biznes[1465], ndërsa vendimi duhet të regjistrohet nga agjencia e njëjtë. Mbyllja e ndërmarrjes mund të zgjasë deri më tre vite[1466]. Fondacioni Heritixh[1467] ka përshkruar ekonominë maqedonase si e mesme e lirë, me notë prej 67.1 për liri ekonomike, me çfarë ekonomia e saj është e 53-ta më e lira në krahasim me Indeksin për vitin 2015[1468].

Një numër i madh i aspekteve tjera të kornizës ligjore janë të volitshme për ndërmarrjet. Sipas Bankës Botërore, norma e plotë tatimore në Maqedoni është 7.39 për qind nga fitimi (në krahasim me 41.3 të OECP-së). Regjistrimi i pronës përfshin shtatë procedura (në krahasim me 4.7 të OECP-së), ndërsa për marrje të lejes për ndërtim janë të nevojshme 11 procedura (mesatarja e OECP-së është 11.9) [1469]. Ligji për veprimtarinë e inovacionit[1470] mundëson mbështetje shtetërore të investimeve me inovacion me grante financiare deri më 30.000 EUR. Agjencia për Investime të Huaja dhe Promovim të Eksportit është përgjegjëse për tërheqjen e investimeve të huaja në vend, si dhe mbështetje për zgjerimin e ndërmarrjeve të huaja[1471]. Me Ligjin për mbrojtje të konkurrencës[1472] është themeluar Komisioni për Konkurrencë që bën rregullimin dhe promovimin e konkurrencës.

Të drejtat pronësore garantohen me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, në të cilin theksohet që askush nuk mund të hiqet nga pronësia ose të kufizohet pronësia dhe të drejtat që dalin nga ajo, përveç kur bëhet fjalë për interes publik të përcaktuar me ligj[1473]. Shteti mund të bëjë ekspropriim të pronës nëse garantohet kompensim, por jo më të ultë se vlera e tregut të pronës[1474]. Nuk ka nevojë për urdhër gjyqësor për ekspropriim, por vendimi mund të kontestohet në gjykatë[1475]. Dispozitat ligjore për ekspropriim janë potencialisht problema-

[1461] Banka Botërore dhe Korporata Ndërkombëtare Financiare, Doing Business 2015, E thjeshta e udhëheqjes së biznesit në Maqedoni, Http://Www.Doingbusiness.Org/Data/Exploreeconomies/Macedonia-Fyr [qasur më23.3.2015].
[1462] http://mkd-news.com/kako-da-otvorite-firma-vo-makedonija-shto-vi-treba-12-detalno-objasneti-chekori/ [qasur më27.3.2015]
[1463] Ligji për sipërmarrës, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 28/04 (84/05; 25/07) 25/07, 87/08, 42/10,48/10,24/11, 166/12, 70/13, 119/13, 120/13, 182/13, 38/14, 41/14, 138/14.
[1464] Ligji për procedurë të përgjithshme administrative, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 38/05, 110/08, 51/11.
[1465] Ligji për sipërmarrës, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 28/04 (84/05; 25/07,) 25/07 87/08, 42/10, 48/10, 24/11,166/12, 70/13, 119/13, 120/13, 182/13, 38/14, 41/14, 138/14, Neni 265.
[1466] http://biznis101.com/razvivaj-biznis/promeni-vo-biznisot/98-zatvoranje-na-biznis.html [qasur më1.4.2015].
[1467] The Heritage Foundation, *2015 Index of economic freedom*, http://www.heritage.org/index/country/macedonia [qasur më1.4.2015].
[1468] Njëlloj.
[1469] The World Bank and the International Finance Corporation, Doing Business 2015, Ease of Doing Business in Macedonia, FYR http://www.doingbusiness.org/data/exploreeconomies/macedonia-fyr [qasur më27.3.2015
[1470] Ligji për veprimtarinë e inovacionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 79/13, 137/13 и 41/14.
[1471] http://www.investinmacedonia.com/about-us [qasur më1.4.2015].
[1472] Ligji për mbrojtjen e konkurrencës, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 04/05, 70/06 и 22/07.
[1473] Kushtetuta e RM-së, e miratuar nga Kuvendi më 17 nëntor 1991, ka hyrë në fuqi më 20 nëntor 1991 , Neni 30.
[1474] Njëlloj, f. 3.
[1475] Ligji për Eksproprijim, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 95/2012, 131/2012 и 24/2013, Neni 32.

tike, duke marrë parasysh ndikimin e tepërt të pushtetit ekzekutiv mbi gjyqësorin.

Me rrethin afarist sundojnë një numër i ligjeve të fuqishme. Ligji për procedurë kontestimore përmban dispozita të hollësishme me të cilat rregullohet e drejta e pronësisë[1476]. Të drejtat e pronësisë intelektuale mbrohen me një numër të ligjeve, përfshirë edhe Ligjin për të drejta të autorit dhe të drejta tjera[1477], Ligjin për pronësi industriale[1478] dhe aktin nënligjor "Rregullorja për markën tregtare"[1479].

Ligji për procedurë kontestimore gjithashtu u dedikon një vëmendje të madhe procedurave për zbatimin e marrëveshjeve[1480]. Renditja e Maqedonisë në hulumtimin e *Doing Business* të Bankës Botërore në lidhje me ligjin për zbatimin e marrëveshjeve është më e ulët (87) në krahasim me renditjen e përgjithshme të vendit, ndërsa numri i procedurave (38) është më i lartë nga mesatarja e OECP-së (31.5[1481]). Gjithashtu, Raporti për konkurrencë globale rendit Maqedoninë në vendin e 63-të prej gjithsej 143 ekonomive në kuptim të efikasitetit të kornizës ligjore për zgjedhjen e kontesteve[1482].

Ligji për shitje të tokës bujqësore në pronësi të shtetit[1483], i miratuar në qershor 2013, siguron një pozitë shumë të volitshme për blerësit ekzistues. Metodat e shitjes të përcaktuara me ligj shpesh nuk përfshijnë konkurs publik për blerje të tokës.

14.1.2 RESURSET (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle ndërmarrjet individuale mund të formohen dhe të punojnë në mënyrë efektive në praktikë?

Regjistrimi i ndërmarrjeve është praktikë e thjeshtë dhe e lirë në praktikë, ndërsa rregulloret qeveritare nuk ngarkojnë. Qeveria e paraqet regjistrimin e ndërmarrjeve si një proces të lehtë në dy hapa, por në fakt, përgatitja e të gjitha dokumenteve të nevojshme zgjat disa ditë dhe ka gjithsej 12 hapa[1484]. E drejta e pronësisë është e rregulluar në mënyrë objektive dhe respektohet, për dallim nga e drejta intelektuale për të cilën janë të nevojshme disa përmirësime në zbatimin praktik[1485].

Trupat për regjistrim janë mirë të pajisur në kuptimin teknik. Sipas një interviste të Transparency International – Maqedoni, procesi i regjistrimit është më i ndërlikuar në praktikë sesa në ligj[1486]. Një ekspert i intervistuar tha që dokumentet mund të përgatiten për tri ditë, përfshirë edhe regjistrimin e nevojshëm në noter, sigurimin e certifikatave bankare për kontributin themelor ose vlerësim të pronës, nëse ndërmarrja është hapur me procedurë të bazuar në vlerë[1487]. Banka Botërore gjithashtu ka theksuar që regjistrimi i subjektit afarist në

[1476] *Ligji për Procedurë kontestimore, tekst i spastruar,* Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 7/2011.
[1477] *Ligji për të drejta të autorit dhe të drejta tjera, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr*. 47/96, 98/2002 и 4/2005 (tekst integral nr. 23/2005).
[1478] Ligji për pronësi industriale, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 47/02, 42/03, 09/04, 39/06 и 79/07.
[1479] Akt nënligjor, Rregullore për narkën tregtare, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. *18/04*.
[1480] *Ligji për Procedurë Kontestimore, tekst i spastruar,* Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 7/2011.
[1481] The World Bank and the International Finance Corporation, Doing Business 2015, Ease of Doing Business in Macedonia, http://www.doingbusiness.org/data/exploreeconomies/macedonia-fyr [qasur më1.4.2015].
[1482] The Global Competitiveness Report 2014–2015, World Economic Forum, http://www3.weforum.org/docs/WEF_GlobalCompetitivenessReport_2014-15.pdf [qasur më1.4.2015].
[1483] Law on Sale of the Agricultural Land in State Ownership, Official Gazette of the RM, No.*87/13*.
[1484] http://mkd-news.com/kako-da-otvorite-firma-vo-makedonija-shto-vi-treba-12-detalno-objasneti-chekori/ [qasur më25.3.2015].
[1485] Intervistë me Biljana Kërstevskën, avokate, EURISK Consulting, 6 korrik 2015.
[1486] Intervistë me Biljana Kërstevskën, avokate, EURISK Consulting, 6 korrik 2015.
[1487] Intervistë me Biljana Kërstevskën, avokate, EURISK Consulting, 6 korrik 2015.

Maqedoni është relativisht e thjeshtë në praktikë dhe zgjat vetëm tre ditë[1488] (në krahasim me mesataren e OECP-së prej 4.8 ditë), ndërsa, çmimi i regjistrimit është 0.6% të të ardhurave për kokë banori (diku rreth 50 EUR), që është nën mesataren e OECP-së prej 8.8, dhe gjithashtu është nën mesataren prej 5.8 në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore[1489].

Ndonëse sipas indeksit të *Doing Business* të Bankës Botërore dhe Koorporatës Ndërkombëtare Financiare, Maqedonia ka normë të shtatë më të vogël në botë, elementet tjera që janë të nevojshme për klimë të volitshme afariste janë të dobëta. Maqedonia renditet në vendin e 74-të në mesin e vendeve të përfshira me hulumtimin në lidhje me thjeshtësinë e regjistrimit të pronës[1490]; në vendin e 89-të sipas dhënies së lejeve për ndërtim; në vendin e 88-të sipas marrjes së energjisë elektrike dhe në vendin e 85-të sipas tregtisë me vendet e huaja. Drejtimi i lartë shpenzon 119 orë në vit për zgjedhje të çështjeve lidhur me rregulloret qeveritare, që është më pak se mesatarja e OECP-së (175) si dhe nga mesatarja prej 234 në Evropë dhe Azi Qendrore[1491]. Për zbatim të marrëveshjes, një ndërmarrje shpenzon 604 ditë në gjykatat maqedonase, që është më e lartë se mesatarja e OECP-së (539,5), si dhe nga mesatarja e 448,1 në Evropë dhe Azi Qendrore [1492].

Mbyllja e ndërmarrjes ose shpallja e falimentimit është një proces më i ndërlikuar. Një ekspert ka theksuar që ndonëse ligji, sipas ligjit[1493], procedura e falimentimit nuk mund të zgjat më shumë se gjashtë muaj, në praktikë, ajo zgjat më shumë[1494]. Shpenzimet e procedurës janë 500 EUR, ndërsa taksat që duhet të paguajë përdoruesi për pjesëmarrje në fazën përgatitore, janë të vogla, rreth 20 EUR.

Të drejtat pronësore në përgjithësi respektohen, ndonëse ka edhe një numër të madhe të lëndëve në lidhje me denacionalizimin[1495], dhe raste të përkohshme të eksproprijim. Sipas Indeksit për liri ekonomike për vitin 2015 të fonacionit Heritixh[1496], regjistrimi i pronave dhe fitimi i fletë pronësisë për toka vazhdon të jetë i vështirë. Siç është theksuar nga një komentuese, ligjvënia e re i komplikon punët në lidhje me të drejtat e pronësisë në këtë mënyrë që pronarët e tokës janë të regjistruar si përdorues që duhet të dëshmojnë pronësinë e vendit, që në disa raste është blerë para 30 viteve[1497]. Maqedonia është në vendin e 81-të prej 178 për të drejta të shtypura të pronave sipas Indeksit për Liri Ekonomike për vitin 2015 të fondacionit Heritixh[1498] (dukshëm në rezultatin e parë të 67.1 të shkallës prej 0 deri 100, ku 0 është rezultat i mirë[1499]).

Të drejtat e pronësisë intelektuale nuk zbatohen në mënyrë efikase. Në raportin e KE-së për përparimin e Maqedonisë në vitin 2014 theksohet që "është arritur një përparim i caktuar në fushën e ligjvënies për të drejtat e pronësisë intelektuale, përpjekjet për zbatim vazhdojnë nga të gjitha institucionet, por ndërlikimi i sistemit për zbatim që mundëson procedurë qytetare dhe penale të zgjatë disa vite, e pengon mbrojtjen efikase të drejtave të pronësisë

[1488] The World Bank and the International Finance Corporation, Doing Business 2015, Ease of Doing Business in Macedonia http://www.doingbusiness.org/data/exploreeconomies/macedonia-fyr [qasur më25.3.2015].
[1489] Njëlloj.
[1490] Njëlloj.
[1491] Njëlloj.
[1492] Njëlloj.
[1493] Ligji për falimentim, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 34/2006, 126/2006, 84/2007, 47/11, 79/13 dhe 29/14.
[1494] Dejan Kostovski, ekspert për falimentim, akademik, http://www.akademik.mk/stechaj [qasur më27.3.2015].
[1495] Nuk ka raste të de-nacionalizimit në instancën e parë, por 3.000 raste janë në procedurë në gjykatat, MF-ja ka vendosur mbi 30.744 raste të de-nacionalizimit. http://www.time.mk/cluster/7fba7c6ac9/zavrsena-denacionalizacijata.html
[1496] http://www.heritage.org/index/country/macedonia [qasur më25.3.2015].
[1497] Trajko Nistovski, Radishani, deklaratë për Sllobodën Pecat, gazetë ditore. http://slobodenpecat.mk/Home/Item/5353 [qasur më23.3.2015].
[1498] http://www.heritage.org/index/country/macedonia [qasur më23.03.2015]
[1499] Heritage Foundation, *2015 Index of economic freedom*, http://www.heritage.org/index/country/macedonia#rule-of-law

intelektuale“[1500].

Ligji për shitje të tokës bujqësore në pronësi shtetërore[1501], i miratuar në qershor të vitit 2013, ende nuk zbatohet. Vendi është resursi i fundit për privatizim të Maqedonisë, dhe metodat për shitje janë përcaktuar në ligj dhe mund të krijojnë rrezik nga korrupsioni dhe nuk sigurojnë konkurrencë, sepse blerësit ekzistues kanë shumë pozitë më të volitshme. Me metodat për shitje të përcaktuar në ligj nuk do të bëhet testim i tregut, sepse kryesisht nuk përfshijnë konkurs publik[1502].

Qeveria ka reputacion që nuk bën me kohë pagesën për ndërmarrjet në lidhje me marrëveshjet për prokurime publike, si dhe të qytetarëve në lidhje me pagesat dhe subvencionet e ndryshme FMN-ja ka përshkruar situatën si “pagesë të vonuar në sektorin publik” që sipas ekspertit të huaj ekonomik z. Sem Vaknin, në mënyrë të lehtë tregon që Qeveria nuk i paguan borxhet e saj[1503]. Ndërmarrjet, gjithashtu, nuk kanë marrë kthim të TVSH-së për katër tremujorët e fundit në vitin 2014. Në vazhdim të këtij zbulimi, Raporti për konkurrencë globale 2014-2015, tregon që qasja në financa është faktori më problematik për udhëheqje të biznesit në Maqedoni (16,9)[1504].

14.1.3 PAVARËSIA (E DREJTA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle ka mbrojtje ligjore për parandalim të përzierjes së padrejtë në biznesin privat?

Nuk ka lëshime të mëdha në rregulloren ligjore që e cenon aftësinë e ndërmarrjeve private të funksionojnë pa ndikim të jashtëm. Megjithatë, ligjvënia shpesh ndryshohet dhe krijon pasiguri në ndërmarrje. Ndryshim dhe plotësimi vazhdimisht bëhet në lidhje me taksimin, kompensimet dhe llojet e ndryshme të taksave, siç janë për shembull, regjistrimi i pronësisë, ri-regjistrimi dhe dhënia e licencave.

Roli i nëpunësve shtetërorë në fillimin dhe mbështetjen e aktiviteteve afariste, siç janë, për shembull, regjistrim, licencim, markë tregtare dhe mbrojtje të praktikës afariste, është zvogëluar me prezantimin e e-regjistrimit dhe agjentëve për regjistrim[1505]. Nuk paguhet kompensim për regjistrim të ndërmarrjes së re me ndihmën e agjentit për regjistrim[1506].

Sërish, Regjistri Qendror (RQ), në përputhje me nenin 552-b të Ligjit për shoqëri tregtare[1507],mund të fillojë procedurë për fshirje të ndërmarrjeve që nuk kanë dorëzuar raporte financiare në RQ-së deri në fund të vitit të dhënë. Lista publikohet në internet faqen e RQ. Procedura mund të filohet për mosdorëzim të adresës elektronike (e-postë) për marrjen e

[1500] ”Strategjia për zgjerim dhe sfida kryesore 2014-2015”, konkluzione dhe rekomandime të Komisionit për ish republikën jugosllave të Maqedonisë. http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-the-former-yugoslav- republic-of-macedonia-progress-report_en.pdf

[1501] Ligji për shitje të tokës bujqësore, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. *87/13.*

[1502] Intervistë me Zoran Temellkovskin, korrik 2015

[1503] Sem Vaknin: Ku gjeti Stavrevski 10 milion EUR për zgjerim të Buxhetit? http://novatv.mk/index. php?navig=8&cat=18&vest=23746 [qasur më25.3.2015].

[1504] The Global Competitiveness Report 2014–2015, World Economic Forum, http://www3.weforum.org/docs/WEF_ GlobalCompetitivenessReport_2014-15.pdf [qasur më25.3.2015].

[1505] Ligji për ndryshim të Ligjit për sistem njësportel për udhëheqje të Regjistrit afarist dhe Regjistrit të personave tjerë juridikë, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr.*70/13.*

[1506] Ligji për sistemi njësportelit për udhëheqje të Regjistrit afarist dhe Regjistrit të personave tjerë juridik.

[1507] Ligji për shoqëri tregtare, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 28/04, 84/05, 25/07.

informatave zyrtare, në përputhje me nenin 21 të ligjit[1508].

Ligji për marrëdhënie obligative[1509] përmban mekanizma për ankesa të ndërmarrje për kërkesën e kompensimit në rast të ndikimit të jashtëm joadekuat. Ndërmarrjet, gjithashtu, mund të kërkojnë kompensim me anë të procedurës gjyqësore.

14.1.4 PAVARËSIA (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle sektori afarist është liruar nga ndikimi i jashtëm joadekuat në punën e tij në praktikë?

Dispozitat për mbrojtje të subjekteve afariste nga përzierja e padrejtë nuk zbatohen çdoherë në mënyrë efikase në praktikë, kryesisht, për shkak të mungesës së plotë të gjyqësorit të pavarur[1510]. Sipas një eksperti të intervistuar[1511], ndërmarrjet e mëdha në Maqedoni gëzojnë një bashkëpunim të pazakontë të afërt me Qeverinë. Ndërmarrjet që janë në projektin për rinovim "Shkupi 2014" kanë nënshkruar marrëveshje që bien dakord për pagesë me vonesë nga Qeveria për shtatë vite[1512]. Gjithashtu, bashkëfolësi shtoi që qeveria është investitori më i madh dhe punëdhënës, ndërsa komunat e udhëhequra nga opozita shpesh përballen me mungesë të ndihmës financiare për projektet e tyre. Gjithashtu, sipas rregullës, ndërmarrjet që marrin marrëveshje janë të lidhura ngushtë me qarqet politike[1513].

Sipas një hulumtimi relevant, përfaqësuesit e komunitetit afarist në Maqedoni e rendisin korrupsionin në Maqedoni si pengesë e pestë më e madhe për udhëheqjen e biznesit, pas tatimeve të larta, ndryshimeve të shpeshta të ligjeve dhe dispozitave, ligjeve të ndërlikuara tatimore dhe qasjes së kufizuar në financim[1514]. Raporti i BE-së për përparimi i vitit 2013 ka treguar që korrupsioni ndikon në mënyrë negative mbi klimën afariste në Maqedoni[1515]. Indeksi i lirisë ekonomike i fondacionit Heritixh thekson që korrupsioni paraqet një problem serioz në vend, veçanërisht në prokurimet publike[1516]. Pritet që ajo të vonojë zhvillimin e sektorit afarist për 30 vite[1517].

Ka raste kur funksionarët shtetërorë, gjoja, kërkojnë pagesa jozyrtare në punën e tyre me ndërmarrjet private, siç është rasti me ndërmarrjen ndërtimore "Beton" prej të cilës është kërkuar të paguhet transport i votuesve me avion nga Zvicra gjatë zgjedhjeve të vitit 2014[1518]. Gjithashtu, ka shembuj për keqpërdorim të pushtetit shtetëror për të fituar qasje në mjetet ose resurset e sektorit privat. Një shembull i këtillë ka të bëjë me tokën e malit Vodno, në afërsi të Shkupit[1519], që ishte shitur një ndërmarrje kontroverse "off-shore" lidhur me qarqet

[1508] Njëlloj, Neni 21.
[1509] Ligji për marrëdhënie obligative, Gazeta Zyrtare e RM-së, Neni 167.
[1510] Intervistë me Zoran Temellkovskin, korrik 2015
[1511] Intervistë me prof. Nikolla Popovskin, ish Ministër i Financave, 30 korrik2015
[1512] prof. Marjan Petreski, American College, Ekonomia maqedonase në rrezik të vërtetë, analizë e Prizma BIRN http:// prizma.birn.eu.com [qasur më25.5.2015].
[1513] Intervistë me Zoran Temellkovskin, korrik2015
[1514] Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krim (UNDOC), Raporti, 2013, Biznesi, korrupsioni dhe krimi në ish republikën jugosllave të Maqedonisë.
[1515] Komisioni Evropian, 2014
[1516] 2014, Index on Economic Freedom. Heritage Foundation. Shkarkuar nga: http://www.heritage.org/index/country/macedonia [qasur më25.5.2015].
[1517] Intervistë me Zoran Temellkovskin, korrik2015
[1518] http://a1on.mk/wordpress/archives/462237 [qasur më16.05.2015]
[1519] http://www.dw.com/mk/; http://24vesti.mk/canoski-urivanjeto-na-%E2%80%9Ekosmos%E2%80%9C-e-politichka-odluka [qasur më25.3.2015].

më të larta të pushtetit, pas ndryshimit të papritur të planit urbanistik të Shkupit. Një shembull tjetër është rasti "Kosmos[1520]" ku ishte shkatërruar konstruksioni në vlerë prej 60 milion EUR. Këto raste të ndikimit të padrejtë duhet të shqyrtohen nga Prokurori Special Publik, si pjesë e marrëveshjes politike të negociatave pas krizës së re politike[1521].

Në praktikë, është shumë vështirë një subjekt afarist të dorëzojë ankesë ose padi kundër sjelljes së administratës publike ose kundër nëpunësit shtetëror. Ky, si dhe problemet e përmendura më lartë, vështirësohet nga mungesa e gjyqësorit të pavarur në Republikën e Maqedonisë[1522], me çfarë subjektet afariste janë lënë pa mjete të mbrojtjes nga përzierja e paligjshme. Forumi për konkurrencë globale e rendit Maqedoninë në vendin e 98-të nga 148 vende në kuptim të pavarësisë së gjyqësorit[1523], ndërsa fondacioni Heritixh thekson që "korrupsioni dhe nepotizmi mbisundojnë në administratën publike dhe në procedurat për prokurime publike, me çfarë rriten shpenzimet për subjektet afariste dhe ngriten investimet e huaja"[1524].

Sipas një interviste të Transparency International – Maqedoni[1525], trajtimi i ndërmarrjeve nga organet tatimore ka tendencë të jetë tepër i vrazhdë dhe shpesh i motivuar politikisht. Përveç kësaj, pushtetet i përpunojnë kontestet tatimore me anë të sistemit të drejtësisë penale, ndërsa afaristët thjeshtë nuk kanë shpresë që do të fitojnë rastin e tyre[1526].

Pronarët dhe menaxherët e disa medieve të pavarura vazhdimisht pohojnë që ka kontroll jo të drejtë të medieve nga partia në pushtet për shkak të dominimit të shtetit në tregun e reklamave[1527]. Rasti me televizionin "A1" është shembull i përzierjes në punët e ndërmarrjes, ku qeveria ka shkua deri në mbylljen e ndërmarrjes[1528].

QEVERISJA

14.2.1 TRANSPARENCA (E DREJTA)

Nota **100**

Në çfarë shkalle ka masa për të siguruar transparencë në aktivitetet e sektorit afarist?

Në pajtim me Ligjin për Regjistrin Qendror[1529], Regjistri Qendror (RQ) themelon Regjistrin e Shoqërive Tregtare. Të gjitha të dhënat e regjistrave mund të përdoren nga personat fizikë dhe ligjorë[1530]. Të gjitha informatat nga regjistri mund të merren në vend ose me anë të postës elektronike.

1520 http://ohridsky.com/?p=667 [qasur më16.5.2015].
1521 Komisioni Evropian, Republika e Maqedonisë: Rekomandime të grupit të ekspertëve për probleme sistemore nga fusha e Sundimit të së Drejtës, dhe në lidhje me përgjimin e komunikacioneve, zbuluar në pranverë 2015 (Bruksel: Komisioni Evropian, 2015), http://ec.europa. eu/enlargement/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf [qasur më9.4.2015].
1522 Njëlloj në Raportin e Pribe, si problem kryesor.
1523 World Economic Forum, Global Competitiveness Report 2013-2014. http://www3.weforum.org/docs/WEF_GlobalCompetitivenessReport_2014-15.pdf [qasur më8.6.2015].
1524 The Heritage Foundation, 2015 http://www.heritage.org/index/country/macedonia [qasur më25.5.2015].
1525 Intervistë me Zoran Temellkovskin, korrik2015
1526 Rasti „A1" dhe Velija Ramkovski http://a1on.mk/wordpress/archives/88602
1527 Komisioni Evropian, Republika e Maqedonisë: Rekomandime të grupit të ekspertëve për probleme sistemore nga fusha e Sundimit të së Drejtës, dhe në lidhje me përgjimin e komunikacioneve, zbuluar në pranverë 2015 (Bruksel: Komisioni Evropian, 2015), f. 17. http://ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf [qasur më8.6.2015].
1528 http://en.rsf.org/macedonia-disastrous-summer-for-macedonian-17-08-2011,40797.html [qasur më8.6.2015].
1529 Ligji për Regjistrin Qendror, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 50/01, 49/03, 81/08.
1530 Ligji për Regjistrin Qendror, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 50/01, 49/03, 81/08, Neni 14.

Llogaria financiare vjetore është e detyrueshme për të gjithë personat juridikë në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare[1531] dhe ajo duhet të dorëzohet në fund të vitit kalendarik. Në pajtim me Ligjin për revizion (neni 32[1532]), ndërmarrjet kanë për obligim të përgatisin llogaritë e tyre në pajtim me standardet ndërkombëtare për informata financiare (IFAC)[1533]. Shkelja e kësaj kërkese paraqet shkelje disiplinore[1534].

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (BPRM) ka kompetencë për të bërë mbikëqyrje të sektorit financiar, duke përfshirë edhe kursimoret, lëshuesit e e-të hollave dhe institucionet tjera financiare[1535]. BPRM-ja mund të bëjë kontroll dhe revizion të punës së tyre, të pezullojë licenca dhe të imponojë sanksione. Komisioni për Letra me Vlerë[1536] themelohet si trup rregullator i pavarur në pajtim me Ligjin për Letra me Vlerë, Ligjin për fonde investuese, Ligjin për marrje të shoqërive tregtare dhe aktet nënligjore[1537]. Komisioni për letra me vlerë kërkon revizion të ndërmarrjeve në nivel vjetor nga revizorit jashtëm, ndërsa raportet e revizorëve të publikohen. Depozitari[1538] publikon përmbledhje të raporteve vjetore të revizionit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë, si dhe raport të plotë vjetor në internet faqen e tij[1539].

14.2.2 TRANSPARENCA (PRAKTIKA)

Nota **50**

Në çfarë shalle ka transparencë në sektorin afarist në praktikë?

Informatat për ndërmarrjet e regjistruara në Maqedoni janë ose lehtë të arritshme në internet ose me kërkesë. Bankat dhe bursa njoftojnë organet kompetente në pajtim me ligjin.

Regjistri Qendror ka bazë on-line me të dhëna që siguron informata për përdoruesit e regjistruar, si dhe me kërkesë. Informatat për strukturën e pronësisë nuk janë të arritshme në internet, ndonëse sipas një eksperti të intervistuar nga Transparency International – Maqedoni, ajo shpesh bëhet publike me kërkesë të dorëzuar në RQ[1540]. Gazetari hetues sërish theksoi që marrja e informatave për ndërmarrjet “off-shore” që punojnë në Maqedoni është shumë vështirë[1541]. Të dhënat për investimet e drejta të huaja tregojnë që vendet “off-shore” siç janë Qipro, Ishujt Virgjine Britanike, Belize, Linhenshtajn dhe Panama paraqesin burime të rëndësishme të rrjedhave financiare në Maqedoni[1542].

Të dhënat e përgjithshme të ndërmarrjeve, siç janë emrat e drejtorëve, detajet e kontaktit dhe raportet vjetore janë të arritshme për publikun me kërkesë. Nga Drejtoria të Hyrave Publike janë të arritshme informatat për regjistrat e ndërmarrjes dhe numrat tatimorë, si dhe

1531 Ligji për shoqëri tregtare, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 28/04, 84/05, 25/07, Neni 469
1532 Ligji për revizion, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 158/10,135/11, 188/13, 43/14 dhe 138/14
1533 International Standard for the Financial Information http://www.finance.gov.mk/files/u11/ifrs_for_sms.pdf [qasur më25.5.2015].
1534 Ligji për revizion, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 158/10,135/11, 188/13, 43/14 dhe 138/14, Neni 4, f. 14.
1535 Banka Botërore e RM-së http://www.nbrm.mk/default-en.asp?ItemID=7B388C2967979A4CA95D7EFBEB3F05D1 [qasur më4.6.2015]
1536 Internet faqja e Komisionit për Letra me Vlerë http://www.sec.gov.mk/Default.aspx
1537 Ligji për letra me vlerë, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 95/2005, 25/2007, 07/2008 и 57/2010.
1538 http://www.merriam-webster.com/dictionary/depository [qasur më4.6.2015].
1539 Ligji për letra me vlerë, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 95/2005, 25/2007, 07/2008 и 57/2010, Neni 70.
1540 Intervistë me Biljana Kërstevskën, EURISK Consulting.
1541 Intervistë me Sashka Cvetkovskën, gazetare.
1542 Belize, ana e fshehur e investitorëve maqedonas, Sashka Cvetkovska. http://novatv.mk/index. php?navig=8&cat=20&vest=21287 [qasur më8.6.2015].
Investime të drejtpërdrejta të huaja, shumë zhurmë, pak rezultate, Sërgjan Stojançov. http://novatv.mk/index. php?navig=8&cat=2&vest=22017

numrin e llogarisë bankare[1543].

Revizioni financiar dhe standardet për njoftim zbatohen në mënyrë efektive. Megjithatë, 25.000 ndërmarrje nuk kanë dorëzuar raporte financiare vjetore[1544]. Ndërmarrjet që refuzojn të dorëzojnë raporte vjetore financiare fshihen nga regjistri i ndërmarrjeve.

Drejtoria të Hyrave Publike është përgjegjëse për kontrollin e raporteve financiare. Megjithatë, kapaciteti administrativ në fushën e drejtimit, kontrollit dhe revizionit financiar duhet të përmirësohet[1545].

Vëllimi i revizionit të jashtëm të bankës ishte zgjeruar për tu përputhur me parimet e Bazelit për revizion të jashtëm të bankave[1546]. Bankat kanë obligim të themelojnë komisione për revizion, por nuk ka kusht ligjor që ato duhet të përfshijnë drejtorë të pavarur, ndërsa duket që bankat nuk kanë vendosur program për trajnim dhe prezantim të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës[1547]. Kur bëhet fjalë për kontrollin e brendshëm të bankave, rregullorja bankare e jep përgjegjësinë për organizim efikas të sistemeve për kontroll të brendshëm të këshillit drejtues dhe mbikëqyrës, ndërsa organi mbikëqyrës nuk kërkon njoftim të rregullt dhe publikim të funksionit të kontrollit të brendshëm të bankës[1548].

Nuk ka njohuri të mjaftueshme të çështjeve në lidhje me korrupsionin dhe konfliktin e interesave në kuadër të sektorit privat. Ka masa të dobëta për parandalimin e korrupsionit dhe përforcimit të integritetit në kuadër të sektorit privat. Sipas përfaqësuesit të sektorit privat, ryshfeti në sektorin privat në Maqedoni i përfshin edhe nëpunësit publikë. Pothuajse 68% të sektorit privat në Maqedoni shohin se si korrupsioni shumëzohet në mesin e nëpunësve publikë[1549].

14.2.3 LLOGARIDHËNIA (E DREJTA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle ka rregulla dhe ligje me të cilat rregullohet mbikëqyrja e sektorit afarist dhe me të cilat rregullohet drejtimi korporativ i ndërmarrjeve të caktuara?

Ligjvënia maqedonase për drejtim korporativ është përmirësuar gjatë viteve të fundit. Ligji për shoqëri tregtare përmban dispozita në lidhje me transparencën, përforcimin e mbrojtjes së palëve të interesuara dhe reforma të regjistrave të ndërmarrjeve[1550]. Kodi për drejtim korporativ ishte miratuar në vitin 2007, ndërsa në vitin e njëjtë ishte publikuar edhe Manuali për drejtim korporativ të Shoqërisë Aksionare Maqedonase[1551]. Gjithashtu, bursa ka miratuar

[1543] Internet faqja e Drejtorisë së të Hyrave Publike: http://www.ujp.gov.mk/e/javni_informacii

[1544] Deklaratë, Vanço Kostadinovski, drejtor i Regjistrit Qendror. http://kurir.mk/makedonija/vesti/158082-Kostadinovski-Do- krajniot-rok-onlajn--podenseni-okolu-14300-godisni-smetki-vo-Centralniot-registar?r1=http%3A%2F%2Fvesti.mk%2Fread%2Fnew s%2F189 0036%2F613369%2Fkostadinovski-do-krajniot-rok-onlajn-podenseni-okolu-14-300-godishni-smetki-vo-centralniot-registar [qasur më12.5.2015].

[1545] Komisioni Evropian, 2014: f. 44.

[1546] Komisioni Evropian, 2014: f. 33.

[1547] Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Ligjet komerciale në R. e Maqedonisë, qershor 2013, Vlerësim i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

[1548] Njëlloj.

[1549] Përforcimi i nevojës për luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar – Ad AKTA, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, 2015, Emilija Tuxharovska-Georgievska. http://www.mcms.org.mk/images/docs/2015/sledenje-na-vrskata- megju-korupcija-i-organiziran-kriminal-2del.pdf [qasur më23.7.2015].

[1550] Ligji për shoqëri tregtare, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 28/04, 84/05, 25/07. http://www.sfid.mk/comp_includes/webdata/ documents/ ZAKON%20ZA%20TRGOVSKI%20DRUSTVA%20+.pdf

[1551] Manual për drejtimin korporativ në shoqëritë aksionare maqedonase, Korporata Ndërkombëtare Financiare http:// www.mse.mk/ upload/datoteki/Priracnikot_MK-2.pdf [qasur më8.6.2015].

një kod të drejtimit korporativ të ndërmarrjeve të dala. Korniza ligjore përbëhet nga disa ligje (Ligji për shoqëri tregtare, Ligji për letra me vlerë, Ligji për marrje të shoqërive aksionare) [1552] dhe rregullore, që paraqesin një bazë solide për drejtimin korporativ.

Ligji përcakton strukturën e ndërmarrjeve dhe mekanizmat e njoftimit. Drejtuesit obligohen të dorëzojnë raport njëherë në vit në kuvendin e aksionarëve dhe të prezantojnë raportin financiar, të publikojnë bilance tremujore dhe një herë në vit të publikojnë raport vjetor dhe raport të përputhjes. Ka disa rregulla të caktuara për ndërmarrjet që dalin në tregun e bursave. Kodi i sjelljes në bursë parashikon formimin e "komisionit për revizion" që do të ketë kompetencë të bëjë mbikëqyrje të ndërmarrjeve dhe drejtimit. Vetëm Ligji për Banka përfshin dispozitat në lidhje me revizionin e brendshëm[1553].

Në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare[1554], ka një listë të ndërmarrjeve që duhet të bëjnë revizion të jashtëm (ndërmarrje të mëdha dhe të mesme), ndërsa Ligji për revizion i rregullon kompetencat dhe obligimet e revizorëve të jashtëm[1555]. Nuk ka rregullator konkret financiar për mbikëqyrje të ndërmarrjeve.

Bursa mbikëqyret nga Komisioni i Letrave me Vlerë që e rregullon mënyrën e tregtimit të letrave me vlerë në bursën e licencuar; e ndjek dhe bën mbikëqyrjen e punës së pjesëmarrësve në tregun e letrave me vlerë; e ndjek dhe mbikëqyr funksionimin e tregut të letrave me vlerë dhe përcakton standarde të konkurrencës mes ndërmjetësuesve të autorizuar të tregut në punën e tyre të letrave me vlerë, si dhe ndërmarrjet e autorizuara për drejtim me investime (gjegjësisht, fondet e investimit, me anë të inspektimeve ose në ndonjë mënyrë tjetër).

14.2.4 LLOGARIDHËNIA (PRAKTIKA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle ka drejtim efektiv korporativ në ndërmarrjet në praktikë?

Gjatë viteve të fundit është arritur përparim në zbatimin e rregullave për drejtim korporativ nga ndërmarrjet maqedonase, veçanërisht nga bankat. Megjithatë, disa mangësi të mëdha duhet të zgjidhen, dhe nuk ka agjenci për mbikëqyrjen e zbatimit të rregulloreve relevante.

Një ekspert, i marrë në intervistë nga Transparency International – Maqedoni ka theksuar që bankat maqedonase i ndjekin rregulloret ekzistuese për drejtim korporativ në mënyrë më të hollësishme nga llojet tjera të subjekteve ekonomike[1556].

Dispozitat ekzistuese janë pjesërisht efektive në sigurimin e drejtimit të mirë korporativ, por ende ka nevojë për aktivitete të koordinuara mirë të të gjithë aktorëve relevantë. Gjatë viteve 2007, 2008 dhe 2009, Transparency International – Maqedoni ka dhënë certifikata për drejtim korporativ të ndërmarrjeve që mund të dëshmojnë përputhje me kriteret e zhvilluara nga ndërmarrja dhe ekspertët[1557]. Kjo ka shënuar edhe fillimin e aktiviteteve të drejtimit korpo-

[1552] Ligji për shoqëri tregtare, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 28/04, 84/05, 25/07; Ligji për letra me vlerë, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 95/05, 25/07, 7/08, 57/10, 135/11, 13/13, 188/13, 43/14; Ligji për Marrjen e Shoqërive Tregtare, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 4/02, 37/02, 36/07.

[1553] Ligji për bankat, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 67/2007, Neni 95.

[1554] Ligji për shoqëri tregtare, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 28/04, 84/05, 25/07, Neni 470. http://www.sfid.mk/comp_includes/webdata/documents/ZAKON%20ZA%20TRGOVSKI%20DRUSTVA%20+.pdf

[1555] Ligji për revizion, Neni 24, 28, 31.

[1556] Zoran Temellkovski.

[1557] ProCredit Banka, Makpetrol, Ohridska Banka, NLB Tutnska Banka, Banka Komerciale, Stopanska Banka, ASP-PAK, Farmahem, Makstil, Rade Konçar – servis dhe riparim të produkteve elektrike, Kauf Radika, Agipo, Geoprom, Renova, Inet, Rede Konçar TEP,

rativ në sektorin privat, që ka sjellë miratimin e Kodit për drejtim korporativ të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Megjithatë, ka shumë për të bërë duke marrë parasysh që Raporti për konkurrencë globale në kuadër botëror e rendit efikasitetin e bordeve korportive maqedonase në vendin e 77-të të 144 vendeve dhe në vendin 53-të sipas mbrojtjes së interesit të aksionarëve pakicë.

Pothuaj se nuk ka aktivitetet nga ndërmarrjet në paraqitjen e korrupsionit. Sektori afarist është bërë pjesë e Programit shtetëror për parandalim të korrupsionit 2011-2015, si sektor i veçantë me masa dhe aktivitete për parandalimit të korrupsionit dhe konfliktit të interesave[1558].

Në kuptim të standardeve kontabël, sipas një eksperti të intervistuar nga Transparency International – Maqedoni, ndërmarrjet e mëdha dhe të mesme, në përgjithësi, i ndjekin standardet ndërkombëtare. Raporti global për konkurrencë më i ri i rendit cilësinë e revizionit financiar dhe standardet për njoftim të sektorit privat në Maqedoni në vendin 61 të 144[1559]. Raporti global për konkurrencë më i ri e rendit cilësinë e aktivitetit korporativ të ndërmarrjeve maqedonasve në vendin e 70 në mesin e 144 vendeve[1560], që tregon që ende ka mundësi për përmirësim në këtë fushë.

14.2.5 INTEGRITETI (E DREJTA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle janë vendosur mekanizma për sigurim të të integritetit të gjithë pjesëmarrësve në sektorin afarist?

Korniza ligjore përmban dispozita përkatëse për përcaktimin dhe ndalimin e praktikës korporatave në kuadër dhe mes ndërmarrjeve, si dhe dispozita përkatëse në lidhje me përgjegjësinë korporatave. Gjithashtu, ka rregulla të kufizuara në lidhje me konfliktin e interesave në sektorin privat. Në përgjithësi, ka mungesë të kodeve të sjelljes në nivel të sektorit dhe në nivel individual.

Ryshfeti në sektorin privat, ai aktiv dhe pasiv, është vepër penale sipas Kodit penal dhe mund të rezultojë me dënim me burg prej pesë deri më dhjetë vite[1561]. Kodi penal gjithashtu parashikon edhe dënime për larje parash dhe për keqpërdorim të detyrës zyrtare në prokurimet publike[1562]. Kodi penal përmban dispozita të përgjegjësisë korporatave. Personat juridikë (përfshirë edhe subjektet komerciale) mund të jenë përgjegjës për krim të bërë nga përfaqësuesit e autorizuar për shkak të përfshirjes së tyre të përfitimit personal. Llojet e dënimeve që mund t'i shqiptohen personit ligjor përfshijnë gjobë në të holla, ndalim të përkohshëm ose të përhershëm për kryerje të një veprimtarie të caktuar, pishim të personit juridik dhe sekuestrim të pronës[1563]. Gjithashtu, edhe personat juridikë të huaj i nënshtrohen ligjit, pa dallim nëse kanë ose nuk kanë filiale të themeluara në Maqedoni. Ligji rreptësishtë ndalon ryshfetin në punën me vendet e huaja.

Eurolink, Vialia dhe Teteks.

1558 Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, *Raporti Vjetor 2014*, (Shkup: KSHPK, 2014)

1559 World Global Competitiveness Report http://www3.weforum.org/docs/WEF_GlobalCompetitivenessReport_2014-15.pdf [qasur më8.6.2015].

1560 World Global Competitiveness Report http://www3.weforum.org/docs/WEF_GlobalCompetitivenessReport_2014-15.pdf 467

1561 Kodi penal, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 37/96, 80/99, 4/02, 43/03, 19/04 dhe 73/06. Amendamente të Kodit Penal ishin miratuar më 10 shtator 2009 (dhe publikuar në Gazeta Zyrtare e RM-së më 14 shtator 2009) me qëllim që të përputhin dispozitat në lidhje me korrupsionin. Amendamentet e përmendur më lartë kanë hyrë në fuqi më 22 mars 2010.

1562 Njëlloj, Neni 353, f. 5.

1563 Njëlloj, Neni 28, Kapitulli 6-a.

Siç është sqaruar më lartë, nuk ka kode të sjelljes në nivel të sektorit. Kodi i sjelljes së bursës parashikon rregulla për integritet të ndërmarrjeve që tregojnë në tregun me bursa. Nga anëtarët e organeve të drejtimit të këtyre ndërmarrjeve kërkohet të veprojnë në përputhje me parimet për integritet dhe në mënyrë që më së miri do tu shërbejë ndërmarrjeve dhe aksionarëve. Anëtarët e organit të udhëheqjes së një ndërmarrjeje obligohen të njoftojnë bordin e ndërmarrjes për çfarëdo transaksioni që përfshin konflikt të interesave. Ky lloj i informatave duhet të jetë i publikuar në mënyrë të drejtë[1564].

Sektori bankar është i vetmi që ka Kod të sjelljes[1565], të miratuar nga Shoqëria e Bankarëve të Odës Ekonomike. Bankat komerciale janë ndërmarrjet e vetme që kanë kod të detyrueshëm të sjelljes. Kodi i Bankës Komerciale SHA Shkup[1566] është një dokument i gjerë që përmban dispozita për transparencë dhe kontroll të brendshëm, por nuk përmend korrupsionin dhe nuk përfshin sjelljen e individëve. Kodi i drejtimit korporativ i HALK Bankës SHA Shkup përmban mekanizma për ndalimin e korrupsionit, përfshirë edhe mekanizëm dhe procedurë për mbrojtjen e "informatorëve[1567]". Bankat tjera komerciale kanë gjithashtu kode të sjelljes[1568], ndërsa dispozitat kanë të bëjnë edhe me bordet dhe përfshijnë konfliktin e interesave dhe praktikën e mirë afariste.

Ligji për prokurime publike parashikon përjashtimin e çdo ofruesi që është dënuar për shkelje gjatë pesë viteve të fundit, në lidhje me korrupsionin ose me larje parash[1569]. Megjithatë, nuk ka obligim ligjor për ofruesit e tenderëve publikë të kenë të vendosur programe etike dhe mekanizma përkatës për përputhshmëri. Gjithashtu, nuk ka obligim ligjor për korporatat e mëdha të kenë bashkëpunëtor kryesor profesional për përputhje.

14.2.6 INTEGRITETI (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle është siguruar integriteti i atyre që punojnë në sektorin afarist?

Dispozitat ligjore lidhur me integritetin nuk janë zbatuar dhe ka mungesë të kodeve sektoriale të etikës.

Një ekspertë, intervistuar nga Transparency International – Maqedoni, ka konfirmuar që disa ndërmarrje kanë kode etike ose programe, por pothuaj se nuk ka informata për zbatimin e këtyre rregullave në praktikë. Sipas bashkëfolësit, ndërmarrjet nuk janë të interesuara për kodet etike sepse nuk ka obligim ligjor për to[1570].

Një anketë e re e zbatuar nga MCMS-ja ka treguar që mungesa e drejtimit të mirë në sektorit privat siguron një vend të mirë për rritjen e krimit të organizuar[1571]. Në këtë drejtim, hulumtimi

[1564] Ligji për letra me vlerë, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 5/2005, 25/2007, 7/2008, Neni 14.
[1565] Kodi i drejtimit të mirë të bankave dhe kurismoreve në Maqedoni, Shoqata e Bankarëve në Odën Ekonomike, 2013 .
[1566] Banka Komerciale AD Shkup, Kodi i drejtimit korporativ, publikuar më 2010 , http://www.kb.com.mk/Handlers/ GetResource.ashx?id=ec3271a3-5b5f-44d0-82cc-c2ac3c01fca7 [qasur më23.5.2015].
[1567] Kodi i drejtimit korporativ të HALK Banka AD Shkup, 2014 , http://www.halkbank.com.mk/content/KODEKSOT_ NA_KORPORATIVNO_UPRAVUVANJE.pdf [qasur më26.5.2015].
[1568] http://www.eurostandard.com.mk/dokumenti/pdf/EtickikodeksnaESB.pdf
http://procreditbank.com.mk/WBStorage/Files/Code_of_Conduct_MKD.pdf
http://www.alphabank.com.mk/Default.aspx?tabid=1457&lang=mk [qasur më23.5.2015].
[1569] Ligji për prokurime publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 136/2007, 130/2008, 97/2010, 53/2011, 185/2011, 15/2013, 148/2013, 160/2013, 28/2014, 43/2014, 130/2014, 180/2014.
[1570] Intervistë me Zoran Temellkovskin, korrik2015
[1571] Emilija Tuxharovska-Georgievska, Misha Popoviq dhe Sllagjana Dimishvkosa, përforcimi i nevojës së luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (Shkup: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Qendra për Studimin e Demokracisë, 2015)

i MCMS-së ka treguar që 9.5% të ndërmarrjeve në sektori privat kanë konfirmuar që është bërë vepër penale në lokalet e ndërmarrjeve të tyre, prej të cilëve 7.89% konsiderojnë që vepra në lokalet e ndërmarrjes së tyre është bërë si pjesë ose në lidhje me krimin e organizuar.



Burim: MCMS Anketa afariste 2014.

Nuk ka politikë efikase për "informatorët". Nuk ka listë të zezë të ndërmarrjeve që kanë qenë ose janë përfshirë në praktika korruptuese dhe larje parash dhe nuk ka ndërmarrje që kanë nënshkruar marrëveshje për integritet. Shqetësimi për integritetin e sektorit privat ka sjellë përfshirje të sektorit si shtyllë e posaçme në Programin shtetëror për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të Interesave 2011-2015.[1572]. Megjithatë, raporti i fundit të realizimit të aktiviteteve që përbëjnë Programin Shtetëror[1573] tregon që prej gjithsej 13 masave, vetëm katër janë realizuar, katër janë në rrjedhë ndërsa pesë nuk zbatohen. Trajnimi për integritet është përfshirë vetëm në ndërmarrjet që punojnë në sektorin financiar.

Nuk ka të dhëna statistikore për ryshfet në sektorin privat.

ROLI

14.3.1 PËRFSHIRJA E POLITIKËS KUNDËR KORRUPSIONIT

Nota **0**

Në çfarë shkalle sektori afarist në mënyrë aktive përpiqet që pushteti kombëtar të luftojë kundër korrupsionit?

Lufta kundër korrupsionit nuk është në rend dite të takimeve të shoqatave të mëdha afariste, Odës Ekonomike me Qeverinë dhe nuk ka shembuj të shoqërive afariste që në mënyrë publike ftojnë qeverinë të luftojë kundër korrupsionit. Federata Afariste e Maqedonisë, si dhe vetëm disa ndërmarrje janë përfshirë në Marrëveshjen globale të OKB-së (Publicis dhe Makpetrol)[1574].

14.3.2 MBËSHTETJA PËR ANGAZHIM ME SHOQËRINË QYTETARE

Nota **0**

http://www.mcms.org.mk/images/docs/2015/sledenje-na-vrskata-megju-korupcija-i-organiziran-kriminal- 2del.pdf, f. 99.

1572 http://www.dksk.org.mk/images/Drzavni_Programi/ [qasur më8.6.2015].

1573 Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 2014 : f. 25.

1574 Internet faqja e UN Global Compact https://www.unglobalcompact.org/search?button=&page=1&search[document_type]=Participant&search[keywords]=Macedonia&utf8=%E2%9C%93 [qasur më8.6.2015].

Në çfarë shkalle sektori afarist është përfshirë në/jep mbështetje shoqërisë qytetare si detyrë të saj për luftë kundër korrupsionit?

Sektori afarist në Maqedoni ka angazhim të kufizuar në aktivitetet e shoqërisë qytetare për luftë kundër korrupsionit dhe nuk ka shembull për sponzorim të aktiviteteve të shoqërisë qytetare kundër korrupsionit.

Lidhja ndërmjet shoqërisë qytetare dhe sektorit afarist është e dobët. Organizatat qytetare pothuajse kryesisht mbështeten në donatorë të huaj. Ligji për donacione dhe sponzorime[1575] përshkruan një procedurë shumë të ndërlikuar për marrje dhe njoftime për donacione. Organizatat qytetare kanë nisur ndryshime të Ligjit dhe ligjeve tatimore që kanë të bëjnë me organizatat qytetare[1576]. Një numër i vogël i organizatave qytetare kanë afaristë në bordet e tyre, por ato janë përjashtime të rralla.

Aktiviteti i Transparency International – Maqedoni në lidhje me drejtimin korporativ, i zbatuar në periudhën 2007 deri 2009 ishte ndërprerë për shkak të mungesës së interesit nga sektori afarist dhe për shkak të mungesë së mbështetjes nga komuniteti ndërkombëtar. Megjithatë, Transparency International – Maqedoni ka publikuar parimet afariste në gjuhën maqedonase, projekt i mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë dhe në bashkëpunim me Transparency International të Norvegjisë dhe të Odës Ekonomike[1577]. Parimet janë prezantuar para anëtarëve të Shoqërisë së Grave Afariste[1578].

REKOMANDIME

R1. Odat Ekonomike duhet të miratojnë kod sektorial për drejtimin korporartiv që do të përmbajë procedura për zbatimin e kodeve të sjelljes dhe zhvillimit të programeve kundër korrupsionit dhe politika të subjekteve afariste.

R2. Komisioni Shtetëror për Letra me Vlerë dhe Bursa e Maqedonisë duhet të formojnë komision për revizion që do të ketë autorizim mbikëqyrjen e ndërmarrjeve dhe mënyrën e drejtimit të tyre.

[1575] Ligji për donacione dhe sponzorime në Veprimtaritë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 47/06, 86/08, 51/2011.

[1576] Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, *Raporti për zbatimin e Strategjisë për Bashkëpunim të Qeverisë me Sektorin qytetar* (Shkup, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, 2015) http://mcms.org.mk/images/ docs/2015/izveshtaj-za-sproveduvanjeto-na-strategijata-za-sorabotka-na-vladata-so-gragjanskiot-sektor.pdf [qasur më12.5.2015].

[1577] http://www.mchamber.org.mk/%28S%28esjigz45vp24qv45kwzj1045%29%29/default.aspx?mId=56&evId=393&lId=1 [qasur më12.5.2015].

[1578] http://www.transparency.mk/index.php?option=com_content&task=view&id=665&Itemid=77 [qasur më12.5.2015].

15. NDËRMARRJET PUBLIKE

PËRMBLEDHJE

Ndërmarrjet Publike (NP) janë persona juridikë, shpesh të themeluara nga shteti, që merren me aktivitete komerciale. Ndërmarrjet publike mund të jenë tërësisht ose pjesërisht në pronësi të shtetit, përfshirë edhe pushtetin qendror dhe lokal.

Ndërmarrjet publike në Maqedoni nuk janë institucione mjaft autonome, ndërsa korniza ligjore dhe ajo rregullatore nuk e mbrojnë pavarësinë e tyre. Qeveria është autorizuar të emërojë pjesën më të madhe të anëtarëve të bordit të ndërmarrjeve në pronësi shtetërore, por nuk ka zinxhir të qartë të njoftimit, sepse nuk ka obligim ligjor për dhënien e raporteve vjetore. Megjithatë, raportet vjetore janë të gatshme në internet faqet e disa NP-ve të caktuara.

Nuk ka dispozita të caktuara për integritetin e ndërmarrjeve në pronësi shtetërore. Enti Shtetëror për Revizion ka bërë revizion të NP-ve në pajtim me Programin vjetor të Entit Shtetëror të Revizionit, por jo çdo vit. Raportet e revizionit publikohen, por në vitet e fundit nuk ka shembull kur Kuvendi ka diskutuar për ndonjë prej raporteve të NP-ve, që thekson një shqetësim për kontrollin dhe për përcaktimin e gjendjes si dhe për llogaridhënien e NP-ve.

Tabela më poshtë i prezanton notat sipas treguesve, të cilët përmbledhin vlerësimin e ndërmarrjeve publike në lidhje me kapacitetin e tyre dhe drejtimin e tyre në sajë të Sistemit Kombëtar për Integritet të Maqedonisë. Pjesa tjetër e këtij kapitulli jep analizë cilësore për secilin tregues.

NOTA E PËRGJITHSHME PËR SHTYLLËN: 34,7/100

DIMENSIONI	TREGUESI	E DREJTA	PRAKTIKA
Kapaciteti 37,5/100	Resurset	/	/
	Pavarësia	50	25
Qeverisja 41,6/100	Transparenca	50	50
	Llogaridhënia	50	25
	Integriteti	50	25
Roli 25/100	Ndërmarrjet publike	25	

Nota e shtyllës sipas të drejtës dhe praktikës



STRUKTURA

Ndërmarrjet me kapital shoqëror që ekzistojnë në shumë sektorë, përfshirë edhe ndërmarrjet publike komunale, mediet, shërbimet me naftë dhe gaz, si dhe shërbimet për transport, kanë për obligim, në pajtim me Kushtetutën, të ristrukturohen dhe të privatizohen[1579]. Pronësia shtetërore e mjeteve ekonomike është në nivel relativisht mesatar prej rreth 15% të BPV-së[1580].

Ndërmarrjet publike themelohen nga shteti, nga komuna ose si ndërmarrje të përbashkëta publike. Ndërmarrjet publike themelohet nga shteti në pronësi të shtetit, ndërsa ndërmarrjet publike të themeluara nga komuna, gjegjësisht nga Qyteti i Shkupit janë në pronësi të themeluesit. Nëse ka investim të jashtëm në ndërmarrje, ajo mund të ristrukturohet si shoqëri tregtare me pjesëmarrje të shtetit.

Ndërmarrjet publike funksionojnë në disa sektorë të ekonomisë, përfshirë edhe sektorin energjetik, bankar, ujësjellës, shërbimet komunale dhe transport publik[1581]. Gjitashtu ka edhe sektorë siç janë sektori për prodhimtari të armëve dhe sektori për droga narkotike, në të cilin nuk mund të punojnë ndërmarrje publike pa aprovimin e Qeverisë.

Në këtë shtyllë analizohen ndërmarrjet të themeluara nga shteti (NP).

KAPACITETI

15.1.1 PAVARËSIA (E DREJTA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle korniza ligjore dhe rregullatore për NP-të sigurojnë funksionim të pavarur të NP-ve dhe sigurojnë situate në të cilat NP-të dhe ndërmarrjet e sektorit

[1579] Kekenovski, Ligjvënia për Sektorin Publik në Republikën e Maqedonisë, ekstrakt (Shkup: Kekenovski), f. 1.
[1580] Komisioni Evropian, 2014: f. 27
[1581] Ligji për ndërmarrjet publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 38/96; 9/97 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, Neni 2.

privat kanë gjasa të barabarta dhe të drejta për sukses?

Ndërmarrjet Publike (NP) konsiderohen si ndërmarrje publike në të cilat qeveria është aksionar dominues. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë parashikon kushte të njëjta të konkurrencës për ndërmarrjet private dhe publike në lidhje me qasjen në tregje, kredi dhe operacione tjera afariste, përfshirë edhe licenca dhe furnizime.

Gjithashtu, në pajtim me ligjin, NP-të nuk kanë pozitë më të volitshme ose përparësi materiale. Ato trajtohen në mënyrë të barabartë, përveç kur disave prej tyre u jepen të drejta të veçanta në interes të publikut. Ligji, gjithashtu, parashikon që me interes publik nënkuptohen të gjitha aktivitetet që janë me rëndësi themelore për jetën dhe për punën e qytetarëve, si dhe për punën e personave publikë dhe institucioneve publike[1582].

Obligimet dhe përgjegjësitë e NP-ve nuk përmenden në asnjë ligj, por mandati i tyre është qartë i përcaktuar në Vendimet me të cilat themelohen, si dhe me statutet e tyre. Në pajtim me Nenin 2-a të LNP-së[1583], NP-të nuk janë të liruara nga asnjë ligj ose rregullore në lidhje me konkurrencën e tregut. Ligji për mbrojtjen e konkurrencës dhe Ligji për kontrollin e ndihmës shtetërore, gjithashtu vlejnë për NP-të. Në LNP është përcaktuar që nuk mund të filohet procedurë falimentimi për ndërmarrjet publike.

Drejtuesit e përgjithshëm të NP-ve zakonisht emërohen nga Qeveria. Anëtarët e bordeve të drejtorëve të NP-ve zakonisht përbëhen nga anëtarë të brendshëm dhe të jashtë që janë të emëruar nga Qeveria. Mirëpo, drejtuesit e përgjithshëm të NP-ve rregullisht paraqesin raporte te ministri përkatës. Si rezultat i kësaj, e pazakontë në krahasim me vendet tjera, ligji mundëson përfshirje të madhe të qeverisë në drejtimin e përditshëm me NP. Disa prej NP-ve kanë kuvende të përgjithshme në të cilat pushteti shtetëror është anëtari i vetëm[1584].

15.1.2 PAVARËSIA (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle aktivitetet e përditshme të NP-ve bëhen në mënyrë të pavarur, pa përzierjen e padrejtë të shtetit, në praktikë?

Drejtorët e intervistuar të JP-ve[1585] kanë treguar që ato kanë detyrë të zbatojnë programin qeveritar, dhe në kohën e njëjtë të punojnë në interes më të mirë të ndërmarrjes. Drejtori i Makedonski Shumi NP, z. Karaxhoski, ka sqaruar që në shumë raste janë zhvilluar biseda të gjata (edhe për disa muaj) me Qeverinë në lidhje me vendimet e ndërmarrjes..

Përvoja maqedonase tregon që anëtarët e bordeve të NP-ve zakonisht veprojnë si dorë e vazhduar e Qeverisë dhe nuk ju japin prioritet interesave të ndërmarrjes. Kjo është kryesisht për shkak të faktit që anëtarët e bordit dhe drejtorët ekzekutivë janë politikisht të emëruar. Anëtarët e bordit janë zgjedhur nga Qeveria, ndërsa vitin e kaluar (2014), në bazë të shpalljeve publike për kandidatë për anëtar të bordit. Megjithatë, nuk ka informata të mjaftueshme për procesin e ankesës në lidhje me emërimet. Nuk ka procedurë transparente që do të

[1582] Ligji për ndërmarrjet publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 38/96; 9/97 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, Neni 1.

[1583] Ligji për ndërmarrjet publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 38/96; 9/97, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15.

[1584] Statuti i Shoqatës Aksionare për Ndërtim dhe Ekonomizim me Prona Banesore dhe Hapësire Afariste me rëndësi të Republikës së Maqedonisë, Neni 13 dhe 14 të Statutit. http://www.adsdp.mk/adsdpmk/dokumenti/podzakonski_akti/StatutNaADISSPDPZR.pdf [qasur më 23.7.2015].

[1585] Zharko Karxhoski, drejtor i NP Makedonski Shumi, intervistë më 24.8.2015.

mundësojë emërime të drejta dhe emërime në përputhje me kritere objektive në kuptim të profesionalizmit dhe integritetit. Shpesh ka ndodhur, emërimi i anëtarëve të bordit të NP-ve të shkaktojnë shqetësim në publik për shkak të konfliktit të interesit. Ky ishte rasti me emërimin e liderit të sindikatës si anëtar i bordit të fondit pensional, pasi e kanë mbështetur miratimin e Ligjit të ri për administratë publike[1586].

KE-ja ka theksuar çështjen e rritjes së numrit të punësimeve në sektorin publik, veçanërisht në ndërmarrjet publike[1587]. Praktika e përditshme e krijimit të vendeve të reja të punës, në baza sociale ose politike, ka krijuar shërbim të fryrë artificial publik, duke gropuar parimin e meritave, si dhe qëllimin kryesor për administratë efikase publike[1588]. KE-ja, gjithashtu, ka shqyrtuar edhe çështjen e rritjes së borxhit në shtete të huaja, si dhe rritjen e madhe të huave në shtetet e huaja për ndërmarrjet publike, si fuqi kryesore për rritjen graduale të borxhit bruto të jashtëm[1589]. Një shqetësim të posaçëm ka shkaktuar borxhi i akumuluar nga ndërmarrjet publike dhe obligimet e caktuara qeveritare për shkak të garancive për borxhin që vlerësohet në rreth 8% të BPV-së.

QEVERISJA

15.2.1 TRANSPARENCA (E DREJTA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle ka masa për sigurimin e transparencës në aktivitetet e ndërmarrjeve në pronësi shtetërore?

Dispozitat ligjore në lidhje me transparencën e NP-ve kanë natyrë të kufizuar. NP-të janë përfshirë me Ligjin për revizion, si dhe me Ligjin për qasje të lirë në informata me karakter publik[1590]. Ligji për Ndërmarrjet Publike është i vetmi që përshin dispozita në lidhje me transparencën e ndërmarrjeve publike.

LNP i rregullon parimet e transparencës në aktivitetet financiare të NP-ve[1591] dhe përmban parim të përgjithshme për transparencë në punën e NP-ve (Neni 8). Ndërmarrjet Publike janë regjistruar në Regjistrin tregtar, ndërsa informatat në lidhje me regjistrimin e ndërmarrjes publike duhet të publikohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë. NP-të janë lëndë e standardeve të njëjta kontabël dhe revizioni siç janë standardet ndërkombëtare për njoftim financiar (Neni 7).

NP-të nuk kanë obligim ligjor të përgatisin program për luftë kundër korrupsionit dhe prandaj nuk obligohen të njoftojnë për programet e tyre kundër korrupsionit.

Në Maqedoni nuk ka institucion që vepron si njësi e centralizuar koordinues për NP-të dhe nuk ka institucion që do të përgatisë njoftim përmbledhës për NP-të (përfshirë edhe treguesit financiarë, vlerën e NP-ve, zbatimin e politikës për pronësi shtetërore, strukturën votuese, anëtarësimin në borde të NP-ve ose njoftimin individual për NP-të më të rëndësishme).

[1586] http://www.telegraf.mk/aktuelno/makedonija/104172-sdsm-liderot-na-ssm-naznacen-za-clen-na-upravniot-odbor-na-piom [qasur më 23.7.2015].
[1587] Komisioni Evropian, 2014.
[1588] Njëlloj, f. 13.
[1589] Njëlloj, f. 22.
[1590] Ligji për qasje të lirë në informata me karakter publik, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 13/2006, 86/2008, 6/2010 dhe 42/2014.
[1591] Ligji për ndërmarrjet publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 38/96; 9/97, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, Neni 7.

15.2.2 TRANSPARENCA (PRAKTIKA)

Nota 50

Në çfarë shkalle ka transparencë në ndërmarrjet publike në praktikë?

NP-të e ndjekin obligimin ligjor për publikim të regjistrimit të tyre në Regjistrin tregtar dhe në Gazetën Zyrtare, por strukturat drejtuese dhe pronësore dhe relacionet me subjektet tjera në pronësi shtetërore nuk publikohen në internet faqet e tyre[1592]. Informatat më të gatshme janë struktura organizative dhe emri i drejtorit ekzekutiv, por jo edhe emrat dhe deklaratat e interesit të bordeve drejtuese.

NP-të janë lëndë e revizionit të jashtëm të pavarur nga Enti Shtetëror i Revizionit[1593], ndërsa disa NP emërojnë revizorë të jashtëm[1594]. Disa NP kanë themeluar njësi për revizion të brendshëm[1595], ndërsa te disa NP, Statuti kërkon që kuvendi të emërojë revizor të jashtëm të autorizuar[1596] për kryerjen e revizionit efektiv të jashtëm. Megjithatë, ka vetëm disa raporte të revizionit të publikuar në internet faqet e NP-ve[1597].

Nuk ka informata zyrtare të publikuara në lidhje me obligimet e shërbimit publik dhe kompensimin eventual financiar. Siç është sqaruar më lartë, nuk ka njësi koordinuese përgjegjëse për punën e NP-ve dhe prandaj nuk ka raporte përmbledhëse për NP-të. Gjithashtu, nuk ka internet faqe që centralizon informata për NP-të të gatshme për publikun.

15.2.3. LLOGARIDHËNIA (E DREJTA)

Nota 50

Në çfarë shkalle ka rregulla dhe ligje me të cilat rregullohet mbikëqyrja e NP-ve?

LNP-ja përmban rregulla për kontroll dhe mbikëqyrje të NP-ve, përfshirë edhe me anë të funksioneve të bordit. LNP-ja qartë përcakton si duhet të drejtohet dhe të organizohet NP-ja. LNP-ja përmban dispozita për bordin drejtues, udhëheqësin (drejtorin) dhe bordin mbikëqyrës. LNP-ja, gjithashtu obligon NP-të të miratojnë Statut në të cilin më tutje do të zhvillohen dispozitat.

Bordi drejtues përmban pesë deri në pesëmbëdhjetë anëtarë të emëruar nga themeluesi (Qeveria) me mandat prej maksimum katër vitesh. Për qëllimet e zbatimit të kontrollit të punës materiale-financiare të ndërmarrjes publike, formohet bord për kontrollin e punës materiale-financiare (në tekstin e mëtutjeshëm: Bordi për Kontroll) që përbëhet prej 5 anëtarëve[1598]. Anëtarët e bordit për kontroll i emëron, gjegjësisht i shkarkon themeluesi. Anëtarët e bordit për kontroll duhet të jenë persona që kanë arsim të lartë, kanë njohuri dhe

[1592] NP Makedonski Shumi http://www.mkdsumi.com.mk/zanas.php?page=2&s=2 NP për rrugë shtetërore http://www.roads.org.mk/ [qasur më 4.8.2015].

[1593] Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e RM-së, Neni 22, Gazeta Zyrtare e RM-së Nr. 66/10 dhe 145/10. http://www.finance. gov.mk/files/u11/zakon_za_dravna_revizija.pdf [qasur më 26.7.2015].

[1594] http://www.roads.org.mk/314/revizorski-izveshtai [qasur më 23.7.2015].

[1595] http://www.mkdsumi.com.mk/sektori.php?page=4&s=10
http://www.roads.org.mk/215/organizaciona-postavenost
http://www.posta.mk/za_nas/struktura/struktura_na_makedonska_posta.html[qasur më 26.7.2015].

[1596] http://www.adsdp.mk/adsdpmk/dokumenti/podzakonski_akti/StatutNaADISSPDPZR.pdf [qasur më 21.7.2015].

[1597] http://www.roads.org.mk/314/revizorski-izveshtai [qasur më 23.7.2015].

[1598] Ligji për ndërmarrjet publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr.38/96; 9/97, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, Neni 26.

përvojë përkatëse, veçanërisht në fushën e financave dhe kontabilitetit.

LNP-ja i obligon NP-të t'i dorëzojnë raporte tremujore themeluesit (shtetit, komunave, gjegjësisht Qytetit të Shkupit). Drejtori u dorëzon raport dy herë në vit themeluesit dhe bordit drejtues[1599]. Bordi për kontroll detyrimisht i shqyrton llogaritë vjetore dhe raportin mbi punën e ndërmarrjes publike, pas së cilës e dorëzon mendimin e vet para Bordit Drejtues[1600].

Nuk ka procedura të posaçme për llogaridhënien e NP-ve para Kuvendit, përveç atyre të përcaktuara me Ligjin për revizion shtetëror. Neni 16 i Ligjit parashikon obligim për njoftim, por nuk sqaron nëse raporti duhet të dërgohet në Kuvend dhe nuk përcakton obligimin e Kuvendit të debatojë dhe të miratojë raportin. Kjo ka të bëjë madje edhe me Radio Televizionin Maqedonas, që është ndërmarrje publike e themeluar nga Kuvendi[1601].

Siç përmendëm më lartë, nuk ka njësi koordinuese përgjegjëse për punën e NP-ve. Megjithatë, puna e NP-ve u nënshtrohet inspektimeve në përputhje me Ligjin për mbikëqyrje inspektuese[1602]. Ligji për mbikëqyrje inspektuese nuk përfshin dispozita të posaçme për mbikëqyrje të ndërmarrjeve publike. NP-të mund të jenë lëndë e mbikëqyrjes inspektuese[1603], për shembull, nga Inspektorati Shtetëror i Punës, Inspektorati Administrativ Shtetëror, Inspektorati Shtetëror i Devizave, Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor.

15.2.4 LLOGARIDHËNIA (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle bëhet mbikëqyrje efektive e NP-ve në praktikë?

Meqë nuk ka informata të mjaftueshme që janë të gatshme për publikun, shumë vështirë është të përcaktohen fakte të qarta në lidhje me rolin e bordeve të NP-ve për atë si zbatojnë autorizimet e tyre, kompetencat, si dhe për objektivitetin e tyre në kryerjen e funksionit për sigurim të drejtimeve strategjike dhe ndjekjen e drejtimit. Shumë rrallë NP-të i publikojnë raportet e tyre vjetore në internet faqet zyrtare.

Megjithatë, drejtorët e intervistuar të NP-ve kanë deklaruar që bordet i kryejnë funksionet e tyre në përputhje me qëllimet e caktuara nga Qeveria. Ne intervistën me drejtorin e NP Makedonski Shumi[1604], drejtori na informon që NP-ja i dërgon raporte tremujore qeverisë. Njoftimi dhe mbikëqyrja organizohen në mënyrë vertikale, ashtu që në çdo tre muaj, drejtori dorëzon raporte te bordi drejtues, që pas shqyrtimit, dërgohen në Qeveri. Raporti gjysmëvjetor shqyrtohet vetëm nga bordi drejtues. Megjithatë, nuk ka informata nëse bordet e NP-ve bëjnë ndonjë vlerësim të punës së tyre me qëllim të vlerësimit të efikasitetit të tyre.

Në një rast, një ndërmarrje publike e themeluar nga qyteti i Shkupit (që është ndryshe nga ndërmarrjet në pronësi shtetërore, por ka funksionin e njëjtë në nivelin lokal) transformohet në shoqëri aksionare (deponia sanitare Drisla), në të cilën 80% e pronësisë është e një

[1599] Ligji për ndërmarrjet publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 38/96; 9/97, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, Neni 19.
[1600] Ligji për ndërmarrjet publike, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 38/96; 9/97, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, Neni 27.
[1601] Ligji për themelimin e Ndërmarrjes Publike Radio Televizioni i Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr.6/98, 48/09.
[1602] Ligji për mbikëqyrje inspektuese, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 50/10.
[1603] Ligji për mbikëqyrje inspektuese, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 50/10, Neni 2.
[1604] Zharko Karxhoski, drejtor i NP Makedonski Shumi, intervistë më 24.8.2015.

investitori të huaj. I ngjashëm është rasti edhe me ndërmarrjen EVN Maqedonia AD[1605]. Në këto lloje të ndërmarrjeve nuk ka bord drejtues, por vetëm kuvend të përbërë nga pesë anëtarë, prej të cilëve një anëtar është i qytetit të Shkupit, si pronar i 20% të ndërmarrjes.

Megjithatë, shitja e Drisla-s u tregua si kontroverse për shkak të procedurës jo-transparente dhe zgjedhjes së kandidatit të suksesshëm me shkelje të kritereve themelore të tenderit[1606]. Komisioni për Prokurime Publike vendosi të zgjedh një ndërmarrje italiane që nuk ka qenë e regjistruar në kohën kur ishte publikuar tenderi dhe nuk ka treguar dëshmi për përvojën e nevojshme. Konkurrenti gjerman ka dhënë lëndën në gjykatën ndërkombëtare[1607].

15.2.5 INTEGRITETI (E DREJTA)

Nota **50**

Në çfarë shkalle ka themeluar mekanizma për sigurimin e integritetit të NP-ve?

Nuk ka kod të drejtimit korporativ të NP-ve. LNP (Neni 18) përmban dispozita për konflikt të interesave me të cilat rregullohet që një anëtar i bordit drejtues i ndërmarrjes publike nuk mund të ketë interesa në ndërmarrje ose shoqëri që është në marrëdhënie afariste me ndërmarrjen publike. Secili anëtar i bordit drejtues, gjegjësisht drejtori i përgjithshëm i ndërmarrjes publike, ka për obligim të paralajmërojë themeluesin për paraqitjen e një lloji të tillë të interesit të anëtarëve të bordit drejtues.

Siç është përshkruar në shtyllën e sektorit afarist, ryshfeti në sektorin privat, aktiv ose pasiv, është vepër penale sipas Kodit penal dhe mund të rezultojë me dënim me burg prej pesë deri më dhjetë vite. Kjo vlen edhe për NP-të[1608]. Kodi penal gjithashtu përmban dispozita për përgjegjësi korporative. Personat juridikë (përfshirë edhe NP-të) mund të jenë përgjegjës për krimin e bërë nga përfaqësuesuesit e autorizuar për përfshirjen e tyre ose për shkak të përfitimit personal.

Rregullat e përgjithshme për prokurime publike dhe kërkesat për transparencë vlejnë njëlloj për NP-të, si dhe për ndërmarrjet e sektorit privat gjatë punës me subjekte qeveritare. Sipas nenit 2-a të LNP-së, nuk ka përjashtime në lidhje me konkurrencën e tregut për NP-të.

Kodi zgjedhor ndalon donacione nga burime publike, në të holla ose në natyrë[1609], si dhe siç është përmendur në shtyllën për partitë politike, nëse KSHPK-ja vëren parregullsi në bazë të raporteve të dorëzuara financiare (siç janë përdorimi i fondeve publike dhe mjetet e ndërmarrjeve publike si dhe persona tjerë juridikë që disponojnë me kapital shtetëror), KSHPK-ja dorëzon raport në Kuvend në afat prej tre muajve, me detaje për keqpërdorimin e mundshëm në shembujt e lartpërmendur[1610].Ligji për parandalimin e korrupsionit e përcakton të

[1605] EVN Maqedonia AD është ndërmarrja e vetme për shpërndarje të energjisë elektrike në Republikën e Maqedonisë që shërben më tepër se 812.000 klientë dhe popullatë prej 2 milion banorë. Pa ndarjes së shërbimeve komunale shtetërore në ndërmarrje për prodhimtari, transport dhe shpërndarje, ndërmarrja ishte privatizuar në mars 2006, ndërsa 90% të aksioneve ishin shitur EVN AD për 225 milion euro. 10% të aksioneve të ndërmarrjes janë në pronësi të Qeverisë. https://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Macedonia-Snapshot.pdf f. 21.

[1606] Gazetari hetimore, lajm i Sashka Cvetkovskës, Vllado Apostollov, Nela Lazareviq, BIRN, Shkup 23.9.2014 http://novatv.mk/index.php?navig=8&cat=20&vest=16894

[1607] Njëlloj.

[1608] Kodi penal, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 37/96, 80/99, 4/02, 43/03, 19/04 и 73/06. Ndryshime të Kodit Penal të miratuar më 10 shtator 2009 (dhe publikuar në Gazetë Zyrtare të RM-së më 14 shtator 2009), për, mes tjerash, përputhje të dispozitave për luftë kundër korrupsionit. Ndryshimet e përmendura lartë kanë hyrë në fuqi më 22 mars 2010.

[1609] Kodi zgjedhor, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 40/06, 148/08, 155/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13 dhe 32/14, Neni 83.

[1610] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, Neni 12.

njëjtën[1611]. Përfaqësuesit zyrtarë të NP-së, gjithashtu kanë për obligim të sigurojnë deklarata për pronë për KSHPK-në[1612].

Ligji për lobim përmban dispozitë që ndalon aktivitete lobimi të personave përgjegjës në ndërmarrjet publike ose në institucionet publike të themeluara nga pushteti ligjvënës, ekzekutiv ose lokal; këto persona, gjithashtu nuk guxojnë të lobojnë në gjashtë muajt e parë pas përfundimit të mandatit të tyre[1613]. Megjithatë, NP-të nuk kanë asnjë dispozitë për lobim në rregulloret e tyre të brendshme.

Maqedonia nuk ka ratifikuar ende Konventën e OECD-së për luftë kundër ryshfetit të nëpunësve të huaj publikë në transaksionet ndërkombëtare afariste.

15.2.6 INTEGRITETI (PRAKTIKA)

Nota **25**

Në çfarë shkalle është siguruar integriteti i NP-ve në praktikë?

Integriteti i NP-ve nuk është siguruar dhe nuk ka mekanizëm efikas kontrollues. Për kundrazi, NP-të shpesh janë në sytë e publikut për shkak të problemeve me integritetin e tyre.

Përgjimet e telefonave të publikuara tregojnë përkulje të ndryshme të NP-ve ndaj partisë politike në pushtet. Më 25 prill 2015, opozita publikoi një bisedë telefonike ndërmjet drejtorit të Elektraneve të Maqedonisë (ELEM) dhe përfaqësuesit zyrtar të qeverisë (shefit të kabinetit të Kryeministrit[1614]), në të cilën, ndonëse shpallja e publikuar në ELEM është për ekspertë të energjisë nukleare, drejtori ka pranuar kërkesën e përfaqësuesit të qeverisë të punësojë shoferë dhe persona tjerë nga lista e partisë.

Në rast tjetër, ministri i Financave organizon lotari për punësim të 1.600 personave në Makedonski Shumi[1615]. Qeveria e paraqet atë si projekt për punësim të 1.600 personave të grupeve të cenuara sociale[1616]. Kandidatët e zgjedhur nga kompjuteri nuk ishin të gjithë të punësuar në Makedonski Shumi, por pjesa më e madhe ishin transferuar në institucione tjera. Kjo ishte interpretuar si taktikë popullsitë për përdorim të ofertës së punësimit për qëllime politike. Gjithashtu, ka edhe raste tjera të dokumentuara për përdorimin e mjeteve publike të NP-ve për qëllime politike, siç është, shembull, sigurimi i transportit ose ushqimeve për aktivitete politike.[1617]

Nuk ka të dhëna të qarta statistikore për ryshfet të bërë nga NP- të në vend ose jashtë vendit. Raporti vjetor i KSHPK për vitin 2014 thekson që KSHPK-ja ka paraqitur kërkesë penale në Prokurorinë Publike për krim të organizuar dhe për korrupsion të dy drejtorëve ekzekutivë dhe kryetarëve të bordit drejtues të ndërmarrjes publike Hekurudhat e Maqedonisë[1618].

[1611] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, Neni 10-15.
[1612] Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010.
[1613] Ligji për lobim, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 106/08 dhe 135/11.
[1614] Vllatko Çingovski dhe Martin Protugjer http://reporter.mk/2015/04/08/sdsm-protuger-so-nalog-za-partiski-vra/ [qasur më 28.7.2015].
[1615] http://republika.mk/?p=136480 Deklaratë për publikun nga Sektori për Marrëdhënie me Publikun i Qeverisë.
[1616] http://infomax.mk/wp/?p=7090 [qasur më 23.7.2015].
[1617] Deputeti Jani Makraduli në deklaratë për mediet më 29 prill 2011. http://sdsm.org.mk/print.aspx?articleId=5191
[1618] KSHPK, 2014 : http://www.dksk.org.mk/images/Drzavni_Programi/ [qasur më 2.8.2015].

Raporti i UNODC-së për krim afarist[1619] jep indikacion për shkallën e korrupsionit në NP me anë të llojeve të përhapjes së ryshfetit në sektorët afaristë në Maqedoni: ndërtimtari (11.7 për qind); tregti me shumicë dhe pakicë 97.5 për qind); prodhimtari, energji elektrike, gaz dhe ujësjellës (5.1 për qind); dhe objekte për akomodim dhe veprimtari shërbimi me ushqim dhe transport dhe magazinim (3.8 për qind). Nga kjo listë, energjia elektrike, gazi dhe ujësjellësi janë të përfshirë nga NP-të, dhe me sektorët tjerë NP-te janë të lidhur si përdorues të shërbimeve të tyre.

Nuk ka monitorim efektiv as të kodeve ekzistuese të sjelljes, as të dispozitave të konfliktit të interesave nga LNP-ja. Megjithatë, në bazë të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) publikon konflikte potenciale të interesave me anëtarë të bordeve dhe i publikon në publik në internet faqe. Por, nuk ka procedura të brendshme dhe/ose mekanizma për monitorim të NP-ve për parandalimin e rasteve të ryshfetit, ndërsa në Maqedoni nuk ka praktikë të NP-ve ose ndërmarrjeve tjera për nënshkrimin e marrëveshjeve për integritet.

Në praktikë, ka raste kur qeveria u ka dhënë trajtim më të volitshëm NP-ve. Për shembull, në shkurt të vitit 2010, Kuvendi, me propozim të Qeverisë, ka miratuar ndryshime ligjore për ri-programim, duke u lejuar NP-ve të paguajnë tatimore të lidhur me borxhet e tyre në afat prej 10 viteve, me grejs periudhë prej 3 viteve. Sektori privat ka dhënë deklaratë në të cilën kritikohet trajtimi i pabarabartë i sektorit publik dhe privat, që krijon përparësi të padrejtë për NP-të[1620]. Ligji ishte ndryshuar në vitin 2015 për të siguruar kushte të barabarta për gjithë sektorët[1621].

Drejtoria e të Hyrave Publike ka publikuar një raport për donacione financiare të partive politike, duke zbuluar donacione të NP Makedonski Posti për Bashkimin Demokratik të Shqiptarëve[1622]. Rasti nuk është shqyrtuar, as sqaruar nga institucionet përgjegjëse për kontroll të financimit politik.

REKOMANDIME

R1. Qeveria duhet të fillojë dhe të dorëzojë në Kuvend ndryshime të Ligjit për ndërmarrje publike në lidhje me obligimin ligjor të ndërmarrjeve publike për themelimin e programeve kundër korrupsionit.

R2. Qeveria duhet të vendosë një njësi të centralizuar koordinuese që duhet të njoftojë në lidhje me ndërmarrjet publike (me përfshirje të treguesve financiarë, vlerës së ndërmarrjeve në pronësi të shtetit, zbatimit i politikës për pronësi shtetërore, strukturat votuese, anëtarësia në bordet e ndërmarrjeve në pronësi shtetërore, si dhe njoftimi individual për ndërmarrjet publike më të rëndësishme).

R3. Qeveria duhet të themelojë internet faqe të centralizuar me të gjitha informatat publike në lidhje me ndërmarrjet në pronësi shtetërore.

R4. Qeveria duhet të fillojë dhe të dorëzojë në Kuvend ndryshime të Ligjit për ndërmarrje publike në lidhje me obligimin ligjor të ndërmarrjeve publike për publikim të strukturave të tyre pronësisë, si dhe për relacionet me subjektet tjera në pronësi shtetërore në internet faqet e tyre.

[1619] UNODC Biznes, korrupsion dhe krim në ish republikën jugosllave të Maqedonisë: Ndikimi i ryshfetit dhe lloje tjera të krimit në sipërmarrjen private 2013 https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/corruption/ Macedonia_Business_corruption_report_ENG.pdf [qasur më 23.7.2015].

[1620] Mile Boshkov http://daily.mk/vesti/privatniot-sektor-bara-ist-tretman-so-javnite-pretprijatija [qasur më 23.7.2015].

[1621] Oda Ekonomike e Maqedonisë aspx?lId=1&mId=55&evId=31023

[1622] http://faktor.mk/2014/04/05/ujp-gi-objavi-godishnite-donacii-za-partiite-od-gradonachalnici-i-direktori-do-obichni-lugje-i-javni-pretprijatija/ [qasur më 2.8.2015].

VII. REKOMENDIME

PUSHTETI LIGJVËNËS

R1. Kuvendi të kërkojë përgjegjësi nga personat zyrtarë që i kanë emëruar për të udhëhequr institucionet e kundër korrupsionit.

R2. Kuvendi të themelojë revizion të zbatimint të instrumenteve ndërkombëtare të kundër korrupsionit, siç janë UNCAC-ja dhe programin kombëtar për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

PUSHTETI EKZEKUTIV

R1. Qeveria duhet të ndërmarrë masa efektive rreth sigurimit të një liste të qartë dhe të përditësuar të nëpunësve të zgjedhur dhe të emëruar.

R2. Qeveria duhet të sigurojë përgjegjshmëri efektive, integritet dhe sjellje etike të ministrave dhe funksionarëve të pushtetit ekzekutiv.

R3. Qeveria duhet të prezantojë vegla për qytetarët për të siguruar kontroll dhe të zmadhojë transparencën e shpenzimit publik.

GJYQËSORI

R1. Këshilli Gjyqësor duhet të sigurojë zbatim të plotë të emërimit dhe avancimit të gjykatësve në bazë të meritave, me çfarë do të përforcohet pavarësia, paanësia dhe integriteti i gjyqësorit.

R2. Këshilli Gjyqësor duhet të zhvillojë Kod të etikës gjyqësore të unifikuar dhe udhëzime për zbatimi e tij dhe të vlejë për të gjithë gjykatësit.

R3. Këshilli Gjyqësor duhet të vendosë rregulla dhe rregullore për gjykatës në lidhje me pranimin e dhuratave, mikpritjes dhe dobive tjera.

SEKTORI PUBLIK

R1. Duhet të vendoset mekanizëm (në formë të komisionit të parlamentit, agjenci e re ose ndonjë nga agjencitë ekzistuese) për mbikëqyrje të rregullt (mujore ose tremujore) të punësimeve të reja në administratën publike.

R2. Duhet të përcaktohen autorizime dhe procedura për mbikëqyrje të zbatimit të marrëveshjeve në prokurime publike.

AGJENCI PËR ZBATIM TË LIGJEVE

R1. Ministria e Punëve të Brendshme duhet të themelojë rregulla efektive lidhur me konfliktin e interesave për nëpunësit policorë.

R2. Ministria e Punëve të Brendshme duhet të sigurojë mekanizma efektivë kontrollues për zbatim të Kodeksit të etikës policore dhe rregullat për dhurata dhe mikpritje.

R3. Ministria e Punëve të Brendshme duhet të themelojë mekanizma efektivë për paraqitje të parregullsive, për parandalim të aktiviteteve politike në lokalet e policisë për të përforcuar aftësinë e nëpunësve policorë për kundërshtim të përzierjeve të papërshtatshme politike dhe aftësinë për kundërshtim të përdorimit të tyre si mjet të partive politike gjatë zgjedhjeve.

PROKURORIA PUBLIKE

R1. Këshilli i Prokurorëve Publikë duhet të vendosë mekanizëm efektiv për zbatimin e Kodit etik.

R2. Prokuroria Publike duhet të sigurojë informata të sakta dhe me kohë në lidhje me ndjekjen e rasteve të korrupsionit, si dhe për rastet që janë të lidhura me bisedat e përgjuara telefonike në mënyrë të paligjshme.

KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

R1. KSHZ-ja duhet të marrë autorizime dhe kapacitete për përgatitjen dhe zhvillimin efektiv të Listës zgjedhore.

R2. Duhet të miratohet Kod për sjelljen e nëpunësve zgjedhorë dhe mekanizma për zbatimin përkatës.

ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT

R1. Kuvendi duhet të mbështesë revizionin nga ana e ESHR-ja dhe të fillojë mekanizma për sanksionimin dhe zbatimin e rekomandimeve, me qëllim të përforcimit të rolit dhe efektivitetit të mbikëqyrjes mbi shpenzimet publike.

KOMENT:

ESHR-ja duhet të merret si shembull për shumicën ose për të gjitha shtyllat tjera. ESHR-ja mund të shërbejë si model i krahasimit të të gjitha kapaciteteve institucionale (në kuptim të resurseve) dhe zhvillimit të drejtimeve të përgjithshme për atë se çfarë është e nevojshme për zbatimin përkatës dhe të drejtë të detyrave.

AVOKATI I POPULLIT

R1. Ligji për Avokatin e Popullit duhet të ndryshohet dhe plotësohet me qëllim që të sigurohet përputhje e plotë me Parimet e Parisit që kanë të bëjnë me organet e të drejtave të njeriut, veçanërisht zgjerimin e të autorizimeve të Zyrës së Avokatit të Popullit për promovimin e të drejtave të njeriut.

R2. Janë të nevojshme resurse të mëdha njerëzore dhe financiare për Zyrën e Avokatit të popullit për të realizuar kompetencat.

R3. Qeveria dhe Kuvendi duhet të krijojnë një dispozitë ligjore me të cilën ndjekja e rekomandimeve të Avokatit të Popullit do të jetë e detyrueshme, me afate të qarta dhe të prezantojnë sanksione përkatëse për mosndjekjen e rasteve.

KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

R1. KSHPK-ja duhet të miratojë kod të brendshëm të veprimit për anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi dhe të themelohet një mekanizëm efektiv për zbatimin përkatës.

R2. Anëtarët e KSHPK-së duhet të sigurojnë që fletat e tyre anketuese janë publike, në përputhje me Ligjin për parandalimin të korrupsionit.

R3. KSHPK-ja duhet të sigurojë publikim të praktikës dhe sqarimeve të vendimeve, veçanërisht vendimet lidhur me financimin politik, konfliktit të interesave dhe fletave anketuese.

R4. KSHPK-ja duhet të publikojë raporte tjera, në përputhje me ligjin, duhet të plotësojë obligimin ligjor për parashtrimin e raporteve në Kuvend, si dhe raportin për financim të fushatave politike.

PARTITË POLITIKE

R1. Partitë politike duhet të akordohen për të përfshirë dispozita për zgjedhje të kandidatëve.

R2. Kuvendi duhet të miratojë ndryshimet e Ligjit për parti politike dhe Kodit zgjedhor për përfshirje të dispozitave për zgjedhje të kandidatëve nga partitë politike.

R3. Partitë politike duhet të sigurojnë mekanizmat dhe zbatimin e tyre për integritet me anë të miratimit të kodeve ose ndryshimeve të statutit.

MEDIET

R1. Shoqata e Gazetarëve duhet të miratojë kod unik të sjelljes për mediet.

R2. Shoqatat e Gazetarëve duhet të propozojnë ndryshime të Ligjit për përdorim të sjelljes etike dhe integritetit të medieve dhe gazetarëve.

R3. Qeveria duhet të ndryshojë Ligjin për medie dhe të sigurojë që reklamat politike nuk lejohen në servisin publik që rregullohet në lejet kombëtare.

R4. Drejtoria të Hyrave Publike duhet të zhvillojë mekanizëm efektiv për monitorim të donacioneve të partive politike nga mediet.

SHOQËRIA CIVILE

R1. Qeveria duhet të përmirësojë dhe të bëjë më transparente procedurat për konsultime në lidhje me politikat e grupeve të organizatave qytetare.

R2. Qeveria duhet të financojë aktivitetet e organizatave qytetare me anë të një procedure transparente dhe pjesëmarrës, të liruar nga ndikimi i padrejtë.

R3. Organizatat qytetare duhet të vetërregullohen dhe të përgatisin Kod të etikës së organizatave qytetare me qëllim të promovimit të qëndrueshmërisë së organizatave, mbrojtjes së profesionalizmit të të punësuarve dhe përmirësimit të kredibilitetit të organizatave qytetare ndërmjet donatorëve dhe publikut.

R4. Qeveria duhet të prezantojë lehtësime tatimore për organizata qytetare.

SEKTORI AFARIST

R1. Odat Ekonomike duhet të miratojnë kod sektorial për drejtimin korporartiv që do të përmbajë procedura për zbatimin e kodeve të sjelljes dhe zhvillimit të programeve kundër korrupsionit dhe politika të subjekteve afariste.

R2. Komisioni Shtetëror për Letra me Vlerë dhe Bursa e Maqedonisë duhet të formojnë komision për revizion që do të ketë autorizim mbikëqyrjen e ndërmarrjeve dhe mënyrën e drejtimit të tyre.

NDËRMARRJE PUBLIKE

R1. Qeveria duhet të fillojë dhe të dorëzojë në Kuvend ndryshime të Ligjit për ndërmarrje publike në lidhje me obligimin ligjor të ndërmarrjeve publike për themelimin e programeve kundër korrupsionit.

R2. Qeveria duhet të vendosë një njësi të centralizuar koordinuese që duhet të njoftojë në lidhje me ndërmarrjet publike (me përfshirje të treguesve financiarë, vlerës së ndërmarrjeve në pronësi të shtetit, zbatimit të politikave për pronësi shtetërore, strukturat votuese, anëtarësisë në bordet e ndërmarrjeve në pronësi shtetërore, si dhe njoftimit individual për ndërmarrjet publike më të rëndësishme).

R3. Qeveria duhet të themelojë internet faqe të centralizuar me të gjitha informatat publike në lidhje me ndërmarrjet në pronësi shtetërore.

R4. Qeveria duhet të fillojë dhe të dorëzojë në Kuvend ndryshime të Ligjit për ndërmarrje publike në lidhje me obligimin ligjor të ndërmarrjeve publike për publikim të strukturave të tyre dhe pronësisë, si dhe për relacionet me subjektet tjera në pronësi shtetërore në internet faqet e tyre.

8

VIII. BIBLIOGRAFIA

- *Ad hok* Komiteti i Byrosë së Kuvendit, Njoftues: Zhan-Çarls GARDETO, grupi i Partisë Popullore Evropiane, *Vëzhgimi i zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Republikën e Maqedonisë (5 qershor 2011)*
- Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, *Raport vjetor për punën e Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë për vitin 2014*, (Shkup: Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, 2014).
- Andreja Bogdanovski, Buletin 2012: *Bashkëpunëtor profesional, Programi për politikë sigurie*, (Shkup: Analitika, 2012).
- Byroja për Prokurime Publike, Raporti vjetor i Byrosë për Prokurime Publike për vitin 2013 (Shkup: Byro për prokurime publike, 2013).
- Buxheti i Republikës së Maqedonisë për vitin 2012, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 180/2011.
- Buxheti i Republikës së Maqedonisë për vitin 2013, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 167/2012.
- Buxheti i Republikës së Maqedonisë për vitin 2014, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 180/2013.
- Vera Koco dhe Margarita Caca Nikoloska, Analiza për dispozitat e Ligjit për përgjegjësi qytetare për ofendim dhe shpifje (Shkup: Instituti për të Drejta të Njeriut, 2012).
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë, *Vendimi për formim të Këshillit për Avancim të Bashkëpunimit, Dialogut dhe Nxitjes së Zhvillimit të Shoqërisë Qytetare* (Shkup: Qeveria e Republikës së Maqedonisë, viti 2014).
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Strategjia për bashkëpunim të Qeverisë me sektorin qytetar 2012-2017. (Shkup: Qeveria e RM-së, 2012).
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Udhëzime për procedura ministrore në procesin e aplikimit të ndikimit të rregullores (Shkup: Qeveria e Republikës së Maqedonisë, viti 23.7.2013).
- Gordan Kallajxhiev, *Mbrojtja efektive në procedurën penale në Republikën e Maqedonisë, Analizë e ligjit,* (Shkup: Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni, 2014).
- GREKO, Rrethi i tretë i vlerësimit, Raport i dytë i Republikës së Maqedonisë për përputhshmëri *"Inkriminime (ETS 17 dhe 191, GPC 2)", "Transparenca e financimit të partive"* (Strasburg: GREKO, 2014).
- GREKO, Rrethi i katërt i vlerësimit, *Parandalimi i korrupsionit në lidhje me anëtarët e kuvendit, gjykatësve dhe prokurorëve, Raport për vlerësim të Republikës së Maqedonisë* (Strasburg: GREKO, 2014).
- Enti Shtetëror për Revizion, *Raport vjetor i Entit Shtetëror për Revizion për 2013* (Shkup: Enti Shtetëror për Revizion, 2013).
- Enti Shtetëror për Revizion, *Raport vjetor i Entit Shtetëror për Revizion për* 2014 (Shkup: Enti Shtetëror për Revizion, 2014).

- Enti Shtetëror për Revizion, *Strategjia për komunikim me Entin Shtetëror për Revizion për periudhën 2008-2012* (Shkup: Enti Shtetëror për Revizion, 2012).
- Enti Shtetëror për Revizion, Strategjia për zhvillim 2013-2017. (Shkup: Enti Shtetëror për Revizion, 2012).
- Enti Shtetëror për Revizion, Raport përfundimtar i revizorit shtetëror të autorizuar të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, nr *09-270/12* (Shkup: Enti Shtetëror për Revizion, 2012).
- Enti Shtetëror për Statistikë, *Indikator 2015*. (Shkup: Enti Shtetëror për Statistikë, 2015).
- Rregullorja për punë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 36/2008.
- Rregullorja për punë e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, Vendim i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve më 4 korrik 2006.
- Rregullorja për punë e avokatit të popullit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 92/2011.
- Rregullorja për punë e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 91/2008, 119/2010.
- Rregullorja për punë e gjykatave, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 66/2013.
- Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit, *Raport vjetor për vitin 2012* (Shkup, Komisioni shtetëror për Parandalim të Korrupsionit, 2012).
- Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit, *Vlerësim i shkallës dhe natyrës së korrupsionit, si dhe dukshmërisë dhe perceptimit për politika për parandalim të korrupsionit* (Shkup: KSHPK, 2015).
- Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, *Plani strategjik i Komisionit Shtetëror i zgjedhjeve për periudhën 2012-2016* (Shkup: Komisioni Shtetëror u Zgjedhjeve, 2012).
- Komisioni Evropian, Raporti i progresit për Republikën e Maqedonisë 2015 (Bruksel: Komisioni Evropian, 2015).
- Komisioni Evropian, Raporti i progresit për Republikën e Maqedonisë 2014 (Bruksel: Komisioni Evropian, 2014).
- Komisioni Evropian, Raporti i progresit për Republikën e Maqedonisë 2013 (Bruksel: Komisioni Evropian, 2013).
- Komisioni Evropian, Raporti i progresit për Republikën e Maqedonisë 2011 (Bruksel: Komisioni Evropian, 2012).
- Komisioni Evropian, *Republika e Maqedonisë*: *Rekomandime nga një Grup ekspertësh për probleme sistematike në sundimin e të drejtës për ndjekjen e komunikimeve, shpallur në vitin 2015, (Bruksel:* Komisioni Evropian, 2015).
- Emina Nuredinovska, Marija Saydovski dhe Borjan Gjyzelov, *Raport për vlerësimin e korrupsionit në Maqedoni* (Shkup: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, 2014).
- Emilja Tupanxhinska-Gjorgjevska, *Raport për ndjekjen e rreziqeve të korrupsionit dhe krimit të organizuar* (Shkup: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, 2015).
- Komisioni Evropian për demokraci nëpërmjet të së drejtës (Komisioni i Venedikut), *Mendim për shtatë ndryshimet e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë që kanë të bëjnë me*

Këshillin Gjyqësor, kompetencat e Gjykatës Kushtetuese dhe zonat e posaçme financiare (Romë: Komisioni Evropian, miratuar nga Komisioni i Venedikut në seancën plenare të 100-të, 10-11 tetor 2014).

- Kodeksi etik i nëpunësve shtetërorë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 59/2000, 112/2000, 34/2001, 103/2001, 43/2002, 98/2002, 17/2003, 40/2003, 85/2003, 17/2004, 69/2004, 81/2005, 61/2006, 36/2007, 161/2008, 06/2009, 114/2009, 35/2010, 167/2010, 36/2011, 6/2012, 24/2012, 15/2013, 82/2013, 106/2013 и 132/2014, si dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese).
- Ligji për Akademinë për gjykatës dhe prokuror publik, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 88/2010, 166/2012, 26/2013.
- Ligji për buxhete, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 64/2005, 4/2008, 103/2008, 156/2009, 95/2010, 180/2011, 171/2012.
- Ligji për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 59/2000, 12/2003, 55/2005, 37/2006, 115/2007, 19/2008, 82/2008, 10/10, 51/11, 15/2013.
- Ligji për punë të brendshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 42/14, 116/14, 22/2015.
- Ligji për kontrolle financiare të brendshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 90/09.
- Ligji për prezantimin e menaxhimit me cilësi dhe kornizë të përbashkët për vlerësim të efikasitetit dhe sigurimit të shërbimeve në shërbimin shtetëror, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër, nr. 69/2013.
- Ligji për nëpunës shtetërorë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 27/2014.
- Ligji për nëpunës shtetërorë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 59/2000, 112/2000, 34/2001, 103/2001, 43/2002, 98/2002, 17/2003, 40/2003, 85/2003, 17/2004, 69/2004, 81/2005, 61/2006, 36/2007, 161/2008, 6/2009, 114/2009, 35/10, 167/10, 36/11, 6/12, 24/12, 15/13, 82/13, 106/2013.
- Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 66/10, 145/2010, 12/2014, 43/2014.
- Ligji për furnizime publike, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 136/2007, 130/2008, 97/2010, 53/2011, 185/2011, 15/2013, 148/2013, 160/2013, 28/2014, 43/2014 dhe 130/2014.
- Ligji për prokurori publike, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 150/2007,11/2008.
- Ligji për nëpunës shtetërorë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 136/2007, 130/2008, 97/2010, 53/2011, 185/2011, 15/2013, 148/2013, 160/2013, 28/2014, 43/2014 dhe 130/2014.
- Ligji për shfrytëzim dhe disponim me sendet në pronë shtetërore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 8/2005.
- Ligji për shfrytëzim dhe disponim me sendet në pronë shtetërore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 98/2008, 145/2010, 104/2013.
- Ligji për procedurë penale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 15/97, 44/2002, 74/2004, 83/2008, 67/2009.
- Ligji për pagat e gjykatësve, Gazeta

Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 110/2007, 103/2008, 161/2008, 153/2009, 67/10, 97/10, 135/11.

- Ligji për deputet, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 84/05, 161/2008, 51/11, 109/2014.
- Ligji për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 82/2008, 13/2013.
- Ligji për polici, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. nr. 114/2006, 6/2009, 45/2012, 41/2014,33/2014.
- Ligji për prokurorin publik, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 30/2003, 114/2009.
- Ligji për ratifikimin e protokollit fakultativ ndaj Konventës kundër torturës dhe llojit tjetër të trajtimit mizor, çnjerëzor dhe degradues ose ndëshkimore (OPCAT), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 165/2008.
- Ligji për qasje të lirë ndaj informatave me karakter publik, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 13/2006, 86/2008, 6/2010 dhe 42/2014.
- Ligji për parandalimin e konflikteve të interesit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 70/2007.
- Ligji për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 104/2009.
- Ligji për parandalimin e korrupsionit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010.
- Ligji për gjykatat, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 58/2006, 35/2008, 150/2010, (D. br. 256/07, 74/08, 12/11).
- Ligji për buxhetin gjyqësor, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 60/03, 37/06, 103/08, 145/10.
- Ligji për Buxhetin gjyqësor, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 60/2006, 150/2010, 100/2011.
- Ligji për inspektoratin e punës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 97/97, 164/2013.
- Kodi zgjedhor, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 40/2006, 136/2008, 148/2008, 155/2008, 63/2008, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14.
- Ilina Mangova, A jep rezultate modeli kundër korrupsionit rezultate në Maqedoni? -Faktorë kryesorë për model të suksesshëm, (Shkup: Instituti për demokraci “Societas Civilis” – Shkup (IDSCS) 2013).
- Instituti për demokraci “Societas Civilis” – Shkup (IDSCS), *Vëzhgimi i Kuvendit! Përforcim i debatit politik dhe diskursit deliberativ* (Shkup: Instituti për demokraci “Societas Civilis”, 2014).
- Ixhet Memeti, *Avokati i popullit i Republikës së Maqedonisë: Karakter institucional (*Shkup: Avokati i popullit të RM, 2012).
- Prokuroria publike, *Raport vjetor i Prokurorisë publike për vitin 2013* (Shkup: Prokuroria publike e RM, 2013).
- Zyra e Kombeve të bashkuara për drogë dhe krim, *Korrupsioni në Republikën e Maqedonisë*: *ryshfeti i përjetuar nga ana e popullatës* (Viena: Programi për zhvillim të Kombeve të bashkuara, 2011).
- Kenan Hasip, Deputet në Kuvendin e

Republikës së Maqedonisë, Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie mes bashkësive, numër 12-1812, 9 maj 2013.

- Kimio Uno, *Tregues social dhe tregues për zhvillimin e kulturës,* Universiteti Keio, Japoni 2004)
- Kodi i etikes i të punësuarve në Entin Shtetëror të Revizionit, (Shkup: Enti Shtetëror i Revizionit, 2006
- Kodi i Etikës së nëpunësve shtetërorë në Republikën e Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Nr. 133/2011, 139/2011.
- Kodi i Etikës së prokurorëve publik të Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 194/2014.
- Kodi i Etikës së anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Nëpunësve shtetërorë të emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, 7 prill 2010
- Kodi Penal, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Nr. 37/96, 80/99, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/11, 135/11, 185/11, 142/12, 166/12, 55/13, 82/13, 14/14, 27/14, 28/14, 115/2014.
- Kodi Maqedonas i etikës policore bazohet në Kodin e Etikës (2001) të Këshillit të Evropës, zyrtarisht i promovuar në vitin 2004
- Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, *Korrupsioni dhe krimi i organizuar si kërcënim për raportin e monitorimit* (Shkup: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, 2014).
- Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, *Vlerat Shoqërore Maqedonase (*Shkup: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, 2010).
- Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, *Pasqyra e Qeverisë, Pas transparencës së procesit të përgatitjes së ligjeve, Raporti tremujor Nr. 1 për periudhën prej 1 tetor -31 Dhjetor* (Shkup: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar). 2013)
- Margarita Caca Nikollovska, *Analiza e pavarësisë së gjyqësorit të Republikës së Maqedonisë – perceptime, vështirësi dhe sfida (*Shkup: Instituti për të drejta të njeriut (IDNJ), Shkup 2013
- Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme Revizore, ISSAI 30, *Kodi e Etikës (*Vjenë: INTOSAI – Sekretariati i Përgjithshëm).
- Instituti Ndërkombëtar Republikan, *Hulumtimi i Mendimit Publik Maqedonas, 29 gusht – 5 shtator 2014, Perceptimi i Kuvendit, Përvoja me deputetët dhe Pasqyrë e ditës së zgjedhjeve,* (Shkup: Instituti Ndërkombëtar Republikan, 2014).
- Ministria e Punëve të Brendshme, *Raporti Vjetor për vitin 2014 të Seksionit për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale* (Shkup: Ministria e Punëve të Brendshme, 2014).
- Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë, *Raporti vjetor për zbatimin e Planit të Veprimit për Partneritet të Hapur Qeveritar 2014-2015.* (Shkup: Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratë, 2015).
- MOST, Vëzhgimi vendor i zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare të parakohshme 2014 (Shkup: 2014, MOST).
- Kombet e Bashkuara, Kuvendi gjeneral, Raporti i njoftuesit special për përparim

dhe mbrojtje të së drejtës së lirisë së të menduarit dhe shprehjes, Frank La Ru, 16 maj 2011.

- OSBE/ODHIR *Raporti i Fundit i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve, Republika e Maqedonisë, Zgjedhje parlamentare presidencial dhe të parakohshme parlamentare, 13 dhe 27 prill 2014* (Shkup: OSBE/ODHIR, 2014).
- Vendim i Qeverisë Nr. 23-6094/1 më 13 shkurt 2001, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Nr. 12/2001.
- Marrëveshja Kornizë e Ohrit, miratuar më 13 gusht 2001
- Rregullore për mënyrën e zbatimit të revizionit shtetëror, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 158/2011.
- Rregullore për përmbajtje ne dokumentacionit të tenderit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 19/2008.
- Rekomandim i Këshillit të Ministrave, *roli i prokurorëve publik në sistemin e drejtësisë penale,* nr. 19 (2009).
- Programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara, 2014, *Raporti i zhvillimit njerëzor, Mirëmbajtja e përparimit njerëzor, zvogëlimi i cenueshmërisë dhe ndërtimit të rezistencës* (Nju Jork: Programi për zhvillim për vitin 2014 të Kombeve të Bashkuara
- SIGMA/OECP, *Raporti i vlerësimit për vitin 2012, Republika e Maqedonisë,* SIGMA, *Raporte të vlerësimit për vendin, 2012/05 (*Bruksel: OECP, 2012).
- SIGMA/OECP, Raporti i vlerësimit për vitin 2012, Republika e Maqedonisë: *Nëpunës shtetëror dhe punësime në Sektorin publik* (Bruksel: SIGMA/.OECP, 2013)
- SIGMA/OECP, *Vlerësimi i reformave në administratën publike të Republikës së Maqedonisë* (Paris: SIGMA.OECP, 2014)
- SIGMA/OECP, *Shërbimet publike dhe vlerësimi i kornizës administrative,* (Bruksel: SIGMA.OECP, 2008)
- SIGMA/OECP, *Raporti për integritet i vitit 2009.* (Bruksel: OECP, 2009).
- Simona Ognenovska dhe Borjan Gjuzelov, *Pasqyra e Qeverisë: Pjesëmarrje të publikut ne procesin e përgatitjes së ligjeve* (Shkup, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar
- Slagjana Taseva dhe Dragan Malinovski, *Raporti i parë dhe i dytë i gjendjes faktike të realizimit të projektit Shkupi 2014 në komunën Qendër* (Shkup: Komuna Qendër, 2013).
- Snezhana Tërpevska dhe Igor Micevski, *Përse është i rëndësishëm integriteti i medieve – Kthimi i interesit publik në punën e medieve dhe gazetarisë (*Shkup: Instituti Maqedonas për Medie, 2014).
- Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Komisioni për Sistem Politik dhe Marrëdhënie mes Komuniteteve, numër 12-2429, 1 korrik 2014.
- Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Komisioni për Sistem Politik dhe Marrëdhënie mes Komuniteteve, numër 12-1813, 9 korrik 2013.
- Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, *Raporti për punën e Kuvendit të përbërjes së shtatë parlamentare 25 qershor 2011-05 mars 2014 (*Shkup*:* Kuvendi i RM-së, 2014).
- Gjykata e Revizionit të Republikës Federale të Gjermanisë, Peer Review, në lidhje me raportin e fundit të Entit Shtetëror të Revizionit të Republikës së

Maqedonizë, gz 15-2007- 1009, (Shkup: Gjykata e Revizionit të Republikës Federale të Gjermanisë 2007)

- Këshilli Gjyqësor i RM-së, *Raporti i Këshillit Gjyqësor i RM-së për vitin 2013, (*Shkup: Këshilli Gjyqësor i RM-së, 2014).
- Avokati i Popullit, Enti Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave, *Raporti vjetor për shkallën e respektimit, përparimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut 2013* (Shkup: Avokati i Popullit, 2013).
- Propozim amendamentet XXXIII, XXXIV, XXXVI, XXXVIII dhe XXXIX të Kushtetutës së RM-së, Konkluzionet e Kuvendit të RM-së të 27 gushtit 2014.
- Neda Korunovska, *Mekanizëm i pavarur i njoftimit Maqedoni: Raporti i Përparimit 2012-2013.* (Shkup: Reaktor – hulumtim në aksion, 2013)
- Transparency International, *Udhëzues në gjuhë të thjeshtë për parandalimin e korrupsionit (*Berlin: Transparency International, 2009).
- Transparency International, *Barometri global i korrupsionit 2013.* (Berlin: Transparency International, 2013).
- Transparency International, Barometri global i korrupsionit 2008. (Berlin: Transparency International, 2008).
- Transparency International, *Indeksi i perceptimit të korrupsionit, 2014* (Berlin: Transparency International, 2014).
- Transparency International – Maqedoni, *Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike* (Shkup: Transparency International – Maqedoni, KSHPK dhe OSBE, 2012).
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Nr. 52/1992.
- Fondacioni Heritixh, 2015, *Indeksi i lirisë ekonomike, (*Uashington, DC: Fondacioni Heritixh, 2015/
- Fondacioni Shoqëri e Hapur Maqedoni, *Kontrolli parlamentar mbi Qeverinë e Republikës së Maqedonisë* (Shkup: Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni, 2013).
- Komiteti i Helsinkut për të Drejta të Njeriut i Republikës së Maqedonisë, *Raport i veçantë për seancën e 49-të të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë e mbajtur më 24 dhjetor 2012 – Zhvillimi i ngjarjeve para dhe pas në Kuvend,* (Shkup: Komiteti i Helsinkut për të Drejta të Njeriut, 2013).
- Komiteti i Helsinkut për të Drejta të Njeriut i Republikës së Maqedonisë, *Raporti mujor për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë Janar 2013* (Shkup*:* Komiteti i Helsinkut për të Drejta të Njeriut, 2013).
- Komiteti i Helsinkut për të Drejta të Njeriut i Republikës së Maqedonisë *Hulumtim për kuptimin dhe vetëdijen e të drejtave të njeriut dhe mekanizmat për mbrojtjen e qytetarëve në rast të shkeljes,* (Shkup*:* Komiteti i Helsinkut për të Drejta të Njeriut i Republikës së Maqedonisë, 2015).
- CIVIL, *Zgjedhjet 2014: Demokracia e diskualifikuar* (Shkup: CIVIL, 2014).

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

343.35(497.7)”2015/2016”(047.3)

SISTEMI kombëtar për integritet : vlerësimi për Maqedoninë : maj 2016 / [hulumtues kryesor Slagjana Taseva ; drejtues i projektit Metodi Zajkov ; bashkëpunëtore në hulumtim Dona Dimov Markovska, Juliana Karai]. - Shkup : Transparency International - Maqedoni, 2016. - 276 стр. : граф. прикази ; 29 см

Превод на делото: Национален систем за интегритет : оценка за Македонија : мај 2016. - Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 281-288

ISBN 978-608-65772-6-1

а) Справување со корупција - Македонија - 2015-2016 - Извештаи б) Македонија - Корупција - 2015-2016 - Извештаи
COBISS.MK-ID 104576266